monumentet



DO NOT COPY

1/1986

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

1/ 1986 (31)

KOLEGJIUMI I REDAKSISË

SOTIR KOSTA (KRYEREDAKTOR)
APOLLON BAÇE (ZEV. KRYEREDAKTOR)
ALEKSANDËR MEKSI, ALI MUKA, EMIN RIZA
GJERAK KARAISKAJ, HASAN NALLBANI

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
Pranë Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi» Nr. 7, Tel. 55-23 Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

ARTIKUJ

Sotir Kosta

20 vjet veprimtari për mbrojtjen, studimin dhe restaurimin e monumenteve 5

Guri Pani
Lazër Papajani

Një furrë antike në Durrës dhe probleme të zhvendosjes së saj 15

Apollon Baçe
Avenir Aleksi

Skelat grykëlumore të Adriatikut gjatë mesjetës (shek. XI – XV) 25

Gjergj Frashëri

Konservime arkeologjike në Kalanë e Krujës 35

Neritan Ceka

Fortifikimet parahistorike ilire II 49

Emin Riza

Dy komplekse të zhvilluara banimi 85

Gjerak Karaiskaj

Frëngjitë për topa në fortifikimet mesjetare, origjina dhe evolucioni i tyre 93

Faik Alimehmeti

Mbi disa veçori të banesës fshatare të zonës fushore kodrinore të Tiranës në vitet e para pas çlirimit 113

MATERIALE

Bep Jubani

Plotësime për monumente arkeologjike në Shqipërinë e Veriut 125

Petrit Basha

Gjurmë fortifikimesh mesjetare në rrethin e Gramshit 157

KRONIKË

Neritan Ceka

Kuvendi II i studimeve ilire 161

Emin Riza

Mbledhje jubilare 162

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

Pag

ARTICLES

Sotir KOSTA

20 années d'activité pour la protection, l'étude et la restauration des monuments 1

Guri PANI
Lazër PAPAJANI

Le four antique à Durrës 2

Apollon BAÇE
Avenir ALEKSI

Les quais des embouchures de l'Adriatique au cours du Moyen Age 3

Gjergj FRASHËRI

Archaeological conservations in the Castle of Cruja 4

Neritan CEKA

Les fortifications de la phase protourbaine 7

Emin RIZA

Deux complexes évolués d'habitation 9

Gjerak KARAISKAJ

Les canonnières dans les fortifications médiévales, leur origine et leur évolution 10

Faik ALIMEHMETI

Sur quelques traits de l'habitation rurale des alentours de Tirana dans les premières années après la libération nationale 12

MATERIAUX

Bep JUBANI

Supplément sur les monuments archéologiques dans l'Albanie du Nord. 15

Petrit BASHA

Traces de fortifications médiévales dans la région de Gramsh 16

COMMUNICATIONS

Neritan CEKA

Deuxième conférence des études illyriennes 16

Emin RIZA

Session jubilaire 16

Nr. 1 1986

DO NOT COPY

SOTIR KOSTA

20 VJET VEPRIMTARI PËR MBROJTJEN, STUDIMIN DHE RESTAURIMIN E MONUMENTEVE

Ngritja e Institutit të Monumenteve të Kulturës, 20 vjet më parë, është vepër e Partisë dhe e kujdesit të drejtpërdrejtë të udhëheqësit të paharruar të Partisë dhe të popullit, shokut Enver Hoxha. Ky kujdes, i cili u shfaq që në vitet e stuhishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, shprehte thelbin e pushtetit të ri, si pushtet popullor, i cili, i dalë nga gjiri i popullit, vuri në mbrojtje gjithçka që krijoi gjenia popullore shqiptare në shekuj. Patriotizmi i vërtetë, ruajtja dhe vlerësimi i dëshmive historiko-kulturore të etnosit tonë, shkonin krahas luftës për përmbysjen e së vjetrës, luftës kundër nënvleftësimit të krijimtarisë shqiptare dhe kozmopolitizmit që barte gjithmonë rrezikun e asimilimit nga të ashtëquajturat kultura të mëdha. Pra, monumentet e kulturës hynë në jetën e popullit tonë, së bashku me aspiratat për çlirimin kombëtar e shoqëror, si një realitet i lidhur ngushtë me të sotmen dhe të ardhmen e kombit tonë, si një dëshmi e prekshme e forcës së tij për të jetuar i lirë e për të krijuar vepra të denja në shekuj.

Krijimi i Institutit të Monumenteve shënon një ngjarje të rëndësishme për jetën tonë kulturore. Interesimi i Partisë dhe personalisht i shokut Enver, arkitekt i Shqipërisë sonë Socialiste, për monumentet, zë fill që në Kongresin e Përmetit, pra në Majin e vitit 1944. Me krijimin e Institutit të Shkencave, fill pas Çlirimit, u ngrit edhe një bërthamë për gjurmimin dhe restaurimin e monumenteve. Ngritja e Grupit të Kulturës Materiale, pranë Institutit të Historisë e të Gjuhësisë, i cili varej nga Universiteti i Tiranës, i dha një hop cilësor punës me monumentet e kulturës. Brenda këtij grupi ishin ngritur dy sektorë që merreshin drejtëpërdrejt me monumentet, ai i restaurimit të monumenteve dhe sektori i historisë së arkitekturës dhe artit mesjetar. Puna e këtyre sektorëve, si në gjurmimin e vënien në mbrojtje të monumenteve ashtu edhe në atë të ndërhyrjeve të shpëtimit qe e rëndësishme. Si organizma shkencorë, në kuadrin e një institucioni me përvojë, që praktikisht kishte në gjirin e tij kuadrot më të përgatitur për kohën, këta sektorë hodhën bazën metodike për kalimin në një etapë të re e më të lartë të veprimtarisë me monumentet. Pikërisht mbi bazën e sektorit të restaurimit, me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, më 1965 krijohet Instituti i Monumenteve të Kulturës, i cili që në fillimet e tij deri më sot është mbështetur tërësisht në forcat e veta. Detyrat që i ngarkoheshin këtij Instituti nga Partia ishin të qarta, shoku Enver Hoxha që më 3 prill 1962, në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH theksonte: «Natyrisht në momentet aktuale duhet të tregohet kujdes shumë i madh për të ruajtur e për të konservuar monumentet e kulturës, për t'u bërë atyre «biografitë», për të shkruar për to dhe për t'i fotografuar. Kjo është një shkencë e tërë.» Kështu përcaktoheshin saktë idetë themelore në punën me monumentet, roli i tyre në jetën e sotme, si dhe puna që duhej bërë për gjurmimin, mbrojtjen dhe restaurimin e tyre.

Që në fillimet e veta, puna për mbrojtjen dhe restaurimin e monumenteve u kuptua si një veprimtari komplekse shkencore, që ka në përmbajtjen e saj gjurmimin, vënien në mbrojtje, dokumentimin, studimin, restaurimin dhe botimin. Ky këndshikim, metodikisht i drejtë, u përgjigjej më së mi-

ri nevojave të ngutshme për të ecur sa më shpejt dhe me siguri mbi baza të shëndosha shkencore, në rrugën për vlerësimin e trashëgimisë së kulturës sonë materiale. Pikërisht ky konceptim i qartë i detyrave të Institutit, i cili organizativisht ngrihej mbi bazën e një sektori shkencor, që mbështetja e strukturës së tij. Instituti i Monumenteve u formua nga një sërë sektorësh që mbulonin gjini të ndryshme monumentesh. Ndarja në sektorë dhe për pasojë specializimi i kuadrit sipas gjinive të monumenteve ka qenë pa dyshim një prej masave më frytdhënëse, për të arritur brenda një periudhe krahasimisht të shkurtër, në mbulimin me kompetencë profesionale të problematikave të larmë e të vështira që paraqiste praktika studimore-restauruese. Sektorëve u vihej detyra e gjurmimit, vënies në mbrojtje, dokumentimit, studimit dhe restaurimit sipas gjinive të monumenteve. Duke pasur parasysh shpërndarjen territoriale të monumenteve në mbarë vendin dhe mirëmbajtjen e tyre praktika e ngritjes së atelieve në qendra të ndryshme të tij, u gjet si më e përshtatshme. Këto atelie organizativisht u konceptuan si pjesë përbërëse të Institutit. Edhe sot, pas një përvoje 20-vjeçare, mund të pohojmë se kjo skemë organizmi ka qenë e goditur dhe frytdhënëse.

Gjatë viteve 1965-1970 Instituti i Monumenteve bën përpjekje të sukseshme për krijimin e një metodologjie sa më shkencore në proçeset e ndryshme të punës së tij. Në ato vite theksohej rëndësia e organizimit të punës së sektorëve dhe të gjetjes së metodave më të efektshme për të kryer mandej gjurmimin, studimin dhe restaurimin e monumenteve. Që në atë kohë hidhej ideja dhe bëheshin përpjekje për të përgatitur kuadrot, të cilët do të merreshin nga shkollat e vendit, dhe t'u besohej detyra fisnike për mbrojtjen dhe restaurimin e monumenteve. Një prej përfundimeve më të rëndësishme të këtyre viteve është futja me sukses e projekteve të restaurimit në praktikën e punës sonë. Projektet e para, të hartuara mbi bazën e studimeve mbi monumentet te të cilat do të ndërhyhej, presupozonin edhe njohjen e kritereve të restaurimit, si bazë e domosdoshme për të mbajtur qëndrime të drejta karshi monumenteve. Përvetësimi i këtyre parimeve nuk paraqiste një akt të vetëm e të menjëhershëm, ai ishte një proçes dialektik njohjeje, që çonte në përgjithësime mbi bazën e respektimit të vlerës së dyfishtë të monumentit, si dokument historik dhe vepër arti. Të mbështetur në vlerën e monumentit dhe vendit të tij në jetën e sotme, që në fillimet e punës sonë u mbajt një qëndrim i drejtë metodik në ndërhyrjet restauruese, duke synuar në ruajtjen e fazave të ndërtimit dhe në përpjekjet për konsolidimin e qëndrueshmërisë së tij pa tjetërsuar vlerat historiko-artistike. Konsultimet mbi bazë sektorësh, shfrytëzimi i literaturës bashkëkohore dhe vetëkualifikimi nëpërmjet punës, dhanë shpejt fryte të mira, siç flasin restaurimet e kryera gjatë kësaj periudhe: në nimfeun e Apolonisë, në muret rrethuese të Lisit e Zgërdheshit, ato në kishën e Shën Kollit Voskopojë, në Xhaminë e Beqarit Berat, në kishën e Marmiroit, dhe në banesën e Zekatëve. Për t'u përmendur janë edhe punimet sistematike restauruese në pazarin e Gjirokastrës, të përfunduara në vitin 1968 me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes së shokut Enver Hoxha. Arritje të rëndësishme të kësaj periudhe janë edhe punimet e plota restauruese rreth trevjeçare në pazarin e Krujës, me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeut. Këto punime qenë një shkollë e mirë për restauratorët tanë.

Në monumentet e artit, kryesisht në pikturën murale, gjatë këtyre viteve kryhet një punë e mirë për konsolidimin e pjesëve të afreskeve që rrezikoheshin të rrëzoheshin. Krahas, në këto vite u bë punë e mirë për dokumentimin e veprave të artit, sidomos në atë fotografik. Dokumentacioni shkencor e sidomos ai grafik dhe fotografik shënojnë një rritje të ndjeshme në këto vite. Ekspedita për dokumentim u kryen në shumë monumente, disa prej tyre mjaft të thelluara. Por, me gjithë arritjet, mbetej detyrë e rëndësishme që të thellohej më shumë puna për gjurmimin sistematik të monumenteve, dokumentimin më të plotë të tyre, e të ndërhyhej më gjerë dhe më thellë me restaurime në monumente të veçanta dhe ansamble. Në ato vite bëhej e ngutshme zgjidhja e një sërë problemesh të karakterit juridik për mbrojtjen e monumenteve, si dhe i rrugëve të reja të propagandimit dhe botimit.

Vitet 1970-1980 shënojnë periudhën e konsolidimit të fizionomisë së Institutit mbi një bazë të re cilësore, në drejtimet themelore të detyrave që ishin ngarkuar.

Duke ndjekur problemet e gjurmimit të monumenteve në vitet 70-75, u kryen një sërë ekspeditash të cilat prunë një material të pasur, veçanërisht për fortifikimet dhe banesën qytetare, mbi bazë e të cilave u vunë në mbrojtje një numër i madh monumentesh. Këto përfundime, krahas punës me arritje më të sukseshme në restaurimin e monumenteve, zgjuan te kuadrot tanë të rinj dëshirën e madhe për t'u futur më thellë në vlerësimin e monumenteve, në historinë e arkitekturës dhe arteve. Këto dëshira kërkuan domosdoshmërisht nevojën e publikimit të mendimit shkencor. Botimi i numrit të

DOKTORI

parë të revistës «Monumentet» në vitin 1971 shënon një ngjarje të rëndësishme në jetën shkencore. Vlerësimet e mira nga studiues brenda dhe jashtë vendit tregonin qartë se tashmë Instituti ynë kishte hyrë me guxim në rrugën e vështirë të shkencës me nivele bashkëkohore.

Sesioni I Shkencor, mbajtur në vitin 1969, qe një ngjarje e rëndësishme për të ardhmen e punës studimore-restauruese. Aty u tregua se forcat e reja shkencore të këtij institucioni kishin fituar një përvojë të mirë dhe ishin në gjendje të zgjidhnin probleme të vështira. Vështrimi analitik i përfundimeve të arritura dhe bindja se në fushën e vlerësimit kishte ende shumë për të bërë, qenë një shtytje e rëndësishme për të kërkuar rrugë të reja në punën me monumentet dhe për të zgjeruar në të gjitha drejtimet përpjekjet për arritje më të mëdha, në përputhje me problemet komplekse që shtronte trashëgimia jonë arkitektonike-artistike.

Detyrat e shtruara në Sesionin I Shkencor të Institutit hapën një perspektivë të re në punën tonë. Puna studimore restauruese po dilte me shpejtësi nga faza kërkimore e kritereve dhe metodave, drejt konsolidimit të përvojës 5-vjeçare dhe zgjerimit të veprimtarisë. Të udhëhequr nga mësimet e shokut Enver Hoxha mbi vlerën aktive të monumenteve për ndërtimin e socializmit dhe për rritjen e prestigjit të vendit tonë në arenën ndërkombëtare, kolektivi ynë u kushtoi rëndësi të madhe botimeve dhe në përgjithësi propagandimit të vlerave të monumenteve. Kështu krahas revistës «Monumentet», në vitin 1975 filloi botimi i një serie me botime shkencore-popullore, e cila pati jehonë shumë pozitive. Botimi i albumit «Monumente të arkitekturës në Shqipëri» shënonte gjithashtu një sukses të rëndësishëm në punën botuese të Institutit.

Mbajtja me sukses e Kuvendit I të Studimeve Ilire në vitin 1972, shënoi edhe për kolektivin tonë një arritje të rëndësishme si me punët e kryera në kuadrin e tij, ashtu edhe me kumtesat.

Për punonjësit tanë gjurmimi i monumenteve në mënyrë të veçantë, i ndërtimeve popullore fshatare, monumenteve të artit, qendrave historike etj, ishte një shqetësim i logjikshëm. Gjatë viteve 1970-80 kolektivi i Institutit të Monumenteve, nëpërmjet ekspeditave të shumta gjurmuese, i ra kryq e tërthor vendit, duke vënë në mbrojtje me qindra monumente të gjinive të ndryshme. Të rëndësishme ishin gjurmimet në fushën e fortifikimeve prehistorike, antike e mesjetare. Krahas, u vunë në mbrojtje një numër i madh ndërtimesh inxhinjerike, ujësjellës, çezma, ura, banja etj. Edhe në fushën e ndërtimeve popullore u krye një veprimtari e gjërë gjurmuese. Filloi rishikimi i qyteteve, si dhe u vunë në mbrojtje qendrat historike të Korçës dhe Elbasanit. Por, ndërmarrja më e gjërë në këtë gjini monumentesh është ajo që lidhet me gjurmimin e ndërtimeve fshatare me vlerë. Kësaj detyre i dha shtytjen përfundimtare vendimi i Këshillit të Ministrave i vitit 1974 «Mbi gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të ndërtimeve popullore». Mbi këtë bazë, në vitin 1978 u njoftua përfundimi me sukses i gjurmimit të mbarë ndërtimeve popullore fshatare. Në këtë aksion, punonjësit e sektorit të ndërtimeve popullore, por edhe ata të sektorëve të tjerë, morën pjesë aktive në kryerjen e kësaj detyre të madhe. Mbi 30 ekspedita të kryera prunë dokumentimin e rreth 600 ndërtimeve fshatare, nga të cilat 200 u vunë në mbrojtje shtetërore. Një veprimtari me përfundime të rëndësishme u krye edhe në fushën e vënies në mbrojtje të monumenteve historike. Kujdes iu kushtua bazave të Luftës Nacionalçlirimtare dhe veçanërisht atyre që lidheshin me veprimtarinë e shokut Enver Hoxha. Veprimtaria në fushën e vënies në mbrojtje të zbukurimores shënoi gjithashtu përfundime me vlerë. Gjurmimi në stil të gjerë i monumenteve të të gjitha gjinive, provoi gatishmërinë dhe përgatitjen e mirë shkencore të kuadrove tanë të rinj, të cilët përballuan një veprimtari me përgjegjësi të madhe për të ardhmen e pasurisë së kulturës materiale të popullit tonë. Mbi këtë veprimtari popullit tonë i bëhej e njohur kjo pasuri e jashtëzakonshme e krijuar brez pas brezi. Mund të thuhet pa mëdyshje, se kolektivi i Institutit të Monumenteve ka dhënë kontributin themelor për vënien në mbrojtje të monumenteve me vlerë, detyrë kjo e një rëndësie të jashtëzakonshme.

Në raportin e mbajtur nga shoku Enver Hoxha në Kongresin e 7 të Partisë theksohej se: «prapambetja që vihet re në disa lloje të artit e sidomos në arkitekturë, kërkon të ndërmerren studime dhe të bëhet një punë e madhe kërkimore». Mbështetur në këtë detyrë, kolektivi i Institutit tonë iu përvesh menjëherë punës për hartimin e maketit të «Historisë së Arkitekturës Shqiptare» prej fillimeve deri në vitin 1912. Me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes së shokut Enver Hoxha, më 16 tetor 1978, kopja e parë e këtij maketi iu dërgua udhëheqësit tonë të paharruar. Ky punim tregonte qartë se kolektivi ynë tashmë ishte në gjendje të ndërmerrte studime të rëndësishme përgjithësuese, që kapin shumëllojshmëri problemesh dhe shtrirjeje të gjërë kohore.

Vizitat e shokut Enver Hoxha në rrethet e Gjirokastrës dhe Sarandës në vitin 1978, shënuan një ngjarje të rëndësishme edhe për kolektivin tonë. Porositë e çmuara të udhëheqësit të Partisë u bënë

DOKTORATURA

nxitëse për një shikim me një kënd më të gjërë dhe perspektiv të problematikës së mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve.

Gjatë kësaj periudhe, u krye një veprimtari e frytshme edhe në fushën e legjislacionit për mbrojtjen e monumenteve. Ligji i vitit 1948 «Për mbrojtjen e monumenteve», tashmë nuk i përgjigjej shkallës së problematikës që shtronin monumentet. Ligji mbi «Mbrojtjen e monumenteve kulturore-artistike e të pasurisë natyrore të rralla», i cili u aprovua më 23 shtator 1971, dhe mbi bazën e tij «Rregullorja për mbrojtjen e monumenteve kulturore e historike», zgjidhnin drejt problematikën që shtronin monumentet e kulturës. Aprovimi i rregulloreve për mbrojtjen e qytetit muze të Gjirokastrës dhe qendrave historike të Korçës dhe Elbasanit, krahas rregullores së qytetit-muze të Beratit, të aprovuar që në vitin 1961, krijonte një bazë të shëndoshë juridike për administrimin e këtyre qendrave.

Në fushën e restaurimit, gjatë këtij dhjetëvjeçari u shënuan përfundime të rëndësishme si në zgjerimin e ndërhyrjeve në të gjitha gjinitë e monumenteve, ashtu edhe në atë të thellimit të tyre. Punimet shumëvjeçare në kalatë e Lezhës, Beratit, Krujës, Gjirokastrës, në qendrat antike të Butrintit dhe Apolonisë, në qytete-muze të Beratit e Gjirokastrës, mbi bazën e studimeve më të thelluara, shënojnë arritje të rëndësishme. Një pjesë e këtyre ansambleve po kthehej shpejt në qendra të vizitueshme, duke zgjedhur kështu një nga qëllimet kryesore për të cilin ruhen dhe mbrohen monumentet. Krahas ansambleve monumentale, arritje me vlerë pati edhe në restaurimin e monumenteve, në mënyrë të veçantë; punimet në Shtëpinë e Partisë, Shtëpia e Rinisë, në ndërtesën ku zhvilloi punimet Kongresi i Përmetit, ato në banesat e patriotëve Pashko Vasa e Mic Sokoli, në banesat e militantëve Gogo e Kozma Nushi në Vuno, në kishat e Perondisë, Shën Mëhillit dhe Shën Todrit në Berat, në një sërë banesash fshatare etj. Në fushën e monumenteve të artit u punua kryesisht në disa kisha të Beratit, të rrethit të Korçës, në trapezarinë e manastirit të Apolonisë etj. Gjatë kësaj kohe filloi edhe puna restauruese në mozaikët e Tiranës, Pojanit, Elbasanit, Antigonesë etj. Me këto punime shkohej drejt heqjes së rrezikut të dëmtimit të monumenteve dhe kthimit sa më parë të tyre në të vizitueshme.

Puna dokumentuese me monumentet pësoi rritje të ndjeshme gjatë këtij dhjetëvjeçari. Në arkivin e sistemuar sipas kriteresh të shëndosha shkencore u grumbullua një material i pasur dokumentar.

Në ndihmë të punonjësve të Institutit erdhi edhe një informacion i pasur shkencor nëpërmjet këmbimit të botimeve tona me ato të institucioneve paralele jashtë vendit. Kështu përvoja jonë çdo ditë pasurohej.

Sesioni III Shkencor i vitit 1975 dhe ai i vitit 1980 shënuan ngjarje të rëndësishme në jetën e Institutit. Për nivelin, gjërësinë dhe thellësinë e trajtimit të problemeve, ato shënonin arritje me vlerë, të cilat premtonin ecje më të shpejtë në kapjen dhe zgjidhjen e problematikës studimore-restauruese të monumenteve.

Hapa të rëndësishëm për kualifikimin e kuadrit u bënë gjatë kësaj periudhe, sidomos për shkallën e parë të kualifikimit pasuniversitar, i cili shënon një sukses të kolektivit tonë. Krahas kësaj forme, u ndoqën edhe forma të tjera kualifikimi, për të shfrytëzuar sa më mirë të gjitha mundësitë e brendshme në këtë fushë për punonjësit e të gjitha shkallëve, specialistët e ndërtimit deri te kuadrot e lartë.

Vitet 1980-1985 shënojnë fillimin e një etape më të lartë në punën për vlerësimin e monumenteve. Si për të gjithë punonjësit e vendit tonë, edhe për ne, vendimet historike të Kongresit VIII të Partisë, hapën perspektiva të reja në mbarë veprimtarinë tonë. Tashmë, kur thuajse ishte kaluar faza e mënjanimit të rreziqeve imediate për dëmtimin e monumenteve, kur ishin përvijuar kriteret e ndërhyrjeve në to dhe kur kuadri restaurator ishte rritur në përvojë e numër, krijoheshin kushtet për një hop cilësor. Ky hop pasqyrohet në të gjitha fushat e veprimtarisë, duke u dalluar në radhë të parë për gjerësinë e ndërmarrjeve, thellësinë e saktësinë shkencore të trajtimit të problemeve. Megjithëse në përgjithësi puna për gjurmimin e ndërtimeve dhe veprave të artit me vlera, kishte dhënë përfundime pozitive, ajo vazhdoi me dendësi më të vogël edhe gjatë kësaj periudhe, si një proçes dialektik vlerësues.

Vendimet e rëndësishme të Plenumit të 8 të Komitetit Qendror të Partisë të vitit 1980, hapën horizonte të reja për thellimin e punës kërkimore-restauruese edhe në fushën e monumenteve. Duke analizuar punën e bërë, me mendjen tek orientimet e Partisë ne rishikuam detyrat për të rritur shkallën cilësore të tyre dhe domosdoshmërinë e kualifikimit të mëtejshëm të kuadrit. Mbi këtë bazë lindi edhe ideja e rëndësishme e hartimit të «Atllasit të Monumenteve».

Gjatë këtyre viteve krahas punimeve në monumente të veçanta, u kalua në restaurimin e ansambleve mbi bazën e studimeve disavjeçare. Kujtojmë punimet sistematike në kalatë e Beratit, Lezhës, Gjirokastrës dhe Krujës, ato në Apoloni e Bylis, në kalatë e Shkodrës, Tepelenës, Kaninës, etj, të cilat shkallë-shkallë po kthehen në të vizitueshme. Punime disavjeçare po kryhen në manastiret e Ardenicës dhe Zvernecit. Kishat e lagjes «Kala» në Berat janë

DOKUMENT

DO NOT COPY

të gjitha të restauruara. Me rëndësi të veçantë janë edhe ndërhyrjet sistematike në ansamblet: rr. «Enver Hoxha» – Shkodër, në rr. «Justin Godard» – Vlorë, ato në pazarin e Korçës, në dyqanet e lagjes «Mangalem» – Berat, në manastirin e Apolonisë etj. Vend të veçantë zënë punimet sistematike të kryera në bazat e luftës Nacionalçlirimtare ku ka qëndruar shoku Enver Hoxha, të cilat janë kthyer të vizitueshme. Në fushën e monumenteve të artit gjithashtu janë bërë hapa përpara, në përballimin e problematikës së vështirë të restaurimit të afreskeve dhe ikonave. Kjo shihet si në kriteret ashtu edhe në metodat e zbatuara, shpesh të shoqëruara me studime analitike dhe ekzaminime radiologjike. Një hop cilësor është bërë edhe në dokumentacionin shkencor në këtë fushë. Fillimet për restaurimin e veprave në gur dhe në dru janë inkurajuese, ndërsa puna për restaurimin e mozaikëve ka hyrë në fazën e konsolidimit të kritereve dhe teknikave restauruese. Hop të rëndësishëm cilësor në mbarë punën restauruese përbëjnë hartimi i studimeve për kriteret e restaurimit: «Restaurimi i banesave popullore» dhe «Restaurimi i monumenteve të arkitekturës». Hartimi kohët e fundit i «Kritereve për restaurimin e monumenteve të arkitekturës dhe artit» përbën një ngjarje të rëndësishme me karakter shkencor për të ardhmen e monumenteve në vendin tonë.

Viti 1980 shënon një hop cilësor e sasior në fushën e botimeve. Krahas revistës «Monumentet» dhe botimeve me karakter shkencor-popullor fillojnë të botohen një sërë monografish mbi gjini të ndryshme monumentesh. Deri më sot janë botuar 5 monografi, ndërsa dy janë në shtyp. Krahas, janë botuar dhe janë në shtyp 2 albume, 3 broshura dhe 2 bibliografi. Në shtyp është dërguar dhe fletorja «Restauratori», e cila do të pasqyrojë kryesisht ndërhyrjet në monumentet si tribunë e përvojës restauruese.

Thellimi i punës kërkimore-restauruese në vështrim të gjërë të saj, krahas kërkonte edhe specializimin e kuadrit, i cili tashmë është angazhuar dhe po ecën me sukses drejt përfshirjes në shkallën e parë të kualifikimit pasuniversitar. Tematika e studimeve të kuadrove tanë me përvojë i përgjigjej problematikës themelore të punës me monumentet. Kuadrot e kualifikuar përbëjnë një bazë të shëndoshë për specializimin në shkallë të gjerë edhe të kuadrove të rinj, por edhe si nxitje për të rritur në një shkallë më të lartë nivelin e tyre shkencor. Kursi një mujor për specializimin e kuadrove në fushën e monumenteve të artit me program të gjërë, përbën një sukses të punës sonë për kualifikimin e kuadrit.

Sukseset e punës 20-vjeçare të kolektivit të Institutit të Monumenteve janë frymëzuese. Ato i dedikohen kujdesit të Partisë, e cila bëri që brenda një periudhe krahasimisht të shkurtër specialistët shqiptarë, të frymëzuar dhe të udhëhequr nga mësimet e shokut Enver Hoxha, të marrin në duart e tyre e të zgjidhin me sukses probleme të mëdha e tepër komplekse që përfshin fusha e studimit dhe restaurimit të monumenteve. Për ne mbetet mësim i madh dhe i paharruar fjala e shokut Enver Hoxha e 9 Majit të vitit 1983, kur ai theksoi ndër të tjera se «. . .mbrojtja dhe restaurimi bëhen dhe duhet të bëhen mbi baza shkencore». Në këtë vështrim, me gjithë sukseset e arritura, kolektivi ynë është i ndërgjegjshëm se kjo pasuri e madhe që i është besuar kërkon një rritje të mëtejshme të shkallës së njohjes mbi bazën e metodologjisë marksiste-leniniste, cilësisë dhe metodave të vlerësimit dhe ndërhyrjeve.

Shoku Ramiz Alia, gjatë vizitave në rrethet e Korçës dhe Kolonjës dha porosi të rëndësishme, në mënyrë të veçantë për rritjen e nivelit cilësor të punës shkencore në të gjitha fushat. Kjo është e rëndësishme edhe për ne. Përfshirja e kolektivit tonë në lëvizjen e madhe revolucionare «Flamurtarë të zbatimit të mësimeve të shokut Enver Hoxha», është garanci për vlerësimin e monumenteve, ne mbajmë të ndezur dhe të paharruar vlerën e mendimit teorik udhëheqës të shokut Enver Hoxha për të ngritur më lart nivelin e shkencës sonë të restaurimit.

Viti 1985, i cili shënon mbylljen me sukses të pesëvjeçarit të 7, ka krijuar tashmë perspektivën e qartë të ecurisë së mëtejshme të punës kërkimore restauruese. Pesëvjeçari i ardhshëm, i cili është hartuar mbi bazën e arritjeve të derisotme, do ta çojë kolektivin tonë drejt zgjidhjes së problemeve të reja më të mëdha e më të vështira, për t'iu përgjigjur me nivelin e duhur shkencor kërkesave në rritje që shtron sot Partia në këtë fushë.

SOTIR KOSTA

DO NOT COPY

20 ANNEES D'ACTIVITE POUR LA PROTECTION, L'ETUDE ET LA RESTAURATION DES MONUMENTS

La création de l'Institut des Monuments Culturels, il y a 20 ans, fut l'oeuvre du Parti du Travail d'Albanie et du soin direct du dirigeant inoubliable du Parti et du peuple, le camarade Enver Hoxha. Cette attention, manifestée même durant les années de la Lutte de Libération Nationale, exprimait le coeur même du nouveau pouvoir en tant que pouvoir populaire qui, émané du sein du peuple, mit sous protection tout ce que créa le génie populaire albanais le long des siècles. Le vrai patriotisme, la sauvegarde et l'appréciation des témoignages historiques-culturels de notre ethnie allaient de pair à la lutte contre la sous-estimation de la création albanaise, le cosmopolitisme portant le danger de l'assimilation par les soi-disantes grandes-cultures. Donc, les monuments culturels s'introduisirent dans la vie de notre peuple ensemble avec les aspirations pour la libération nationale et sociale comme une réalité étroitement liée à l'état actuel et à l'avenir de notre nation, en tant que témoignage de sa force pour vivre en liberté et créer de dignes oeuvres le long des siècles.

La création de l'Institut des Monuments Culturels marqua un important événement dans notre vie culturelle. L'intérêt du Parti et personnellement du camarade Enver Hoxha, l'architecte de l'Albanie Socialiste, débuta au congrès de Përmet, donc en mai 1944. Avec la création de l'Institut des Sciences, directement après la libération, se forma également un centre pour la recherche et la restauration dans le domaine des monuments. La formation du Groupe de la culture matérielle, auprès de l'Institut de l'Histoire, sous la direction de l'Université de Tirana fit un bond qualitatif au travail avec les monuments culturels. A l'intérieur de ce groupe il y avait deux secteurs qui s'occupaient directement des monuments, celui de la restauration des monuments et celui de l'histoire de l'architecture et de l'art médiéval. Ces deux secteurs jouaient un rôle important dans le domaine de la recherche et la mise sous protection des monuments, ainsi que dans les interventions de sauvegarde. En tant que organismes scientifiques dans le cadre d'une institution qui avait de l'expérience possédant les meilleurs cadres de l'époque, ces secteurs jetèrent la base méthodique du passage à une nouvelle étape plus qualifiée de l'activité avec les monuments. Notamment, sur la base du secteur de la restauration, avec décision du Gouvernement fut créé en 1965 l'Institut des Monuments Culturels qui du début jusqu'à l'heure actuelle, s'est appuyé sur ses propres forces. Les tâches que le Parti confia à cet Institut étaient claires, en effet le camarade Enver Hoxha déjà le 3 avril 1962, au cours de la réunion du sécrétariat du Comité Central du PTA soulignait: «Naturellement à l'heure actuelle l'on doit prendre un grand soin pour sauvegarder et conserver les monuments culturels, pour leur dresser la «biographie», pour écrire à leur sujet, pour les photographier. Ceci représente une science entière». Ainsi ont été définies clairement les idées essentielles dans l'activité sur les monuments, le rôle qu'ils jouent dans la vie d'aujourd'hui, ainsi que le travail à effectuer dans la recherche, la sauvegarde et la restauration de ceux-ci.

Dès ses débuts, le travail pour la sauvegarde et la restauration des monuments fut considéré comme une activité scientifique complexe s'occupant de la recherche, la mise sous protection, la documentation, l'étude, la restauration et l'édition. Cette considération juste du point de vue méthodique, répondait assez bien aux besoins urgents du progrès sur de saines bases scientifiques pour l'appréciation de l'héritage de notre culture matérielle. C'est notamment sur cette nette conception des devoirs de l'Institut, lequel s'élevait sur la base d'un secteur scientifique, que s'appuya sa structure, L'Institut des Monuments Culturels se forma sur la base de quelques secteurs qui s'occuppaient de différents genres de monuments. La division en secteurs et par conséquent la spécialisation des cadres selon les genres de monuments, furent sans doute l'une des meilleures mesures pour atteindre dans un court délai le traitement avec compétence professionnelle des problèmes variés et difficiles de la pratique des recherches et de la restauration. C'était aux secteurs qu'incombaient la recherche, la mise sous protection, la documentation, l'étude et la restauration selon le genre de monument. Ayant en vue la dispersion régionale des monuments dans le pays et leur entretien, on jugea nécessaire et convenable la création des ateliers en différents centres. Ces ateliers furent conçus en tant que parties intégrantes de l'Institut. Même à l'heure actuelle, 20 ans d'expérience après, l'on peut affirmer que ce schéma d'organisation fut le plus réussi et le plus fructueux.

Au cours des années 1965-1970, l'Institut des Monuments Culturels fit des efforts réussis pour la création d'une méthodologie scientifique dans les différents processus de son activité. A cette époque on mettait l'accent sur l'organisation

DO NOT COPY

du travail des secteurs et sur les méthodes les plus réussies pour la recherche, l'étude et la restauration des monuments. Dès lors, on essayait de préparer les cadres et de leur confier le devoir sublime de la sauvegarde et la restauration des monuments.

L'un des plus importants résultats du travail de ces années-là, fut l'utilisation des projets de restauration dans la pratique de notre travail. Les premiers projets, élaborés sur la base des études effectuées sur le monument auquel on allait intervenir, présuposait en même temps la connaissance des critères de la restauration, assez indisponsables dans l'attitude à adopter envers les monuments. L'assimilation de ces critères représentait un processus dialectique de connaissance, qui amenait à des généralisations sur la base de la double valeur du monument, comme document historique et comme oeuvre d'art.

Ayant en vue la valeur du monument et la place qu'il occupe dans la vie actuelle, on garde dès le début, une juste attitude méthodique envers les interventions de restauration visant à sauvegarder la valeur authentique du monument, les phases de construction et envers les efforts pour le consolider en gardant ses valeurs historiques-artistiques. Les consultes dans le cadre des secteurs, l'utilisation de la littérature contemporaine et la formation au cours du travail apportèrent de bons résultats, comme le démontrent les restaurations effectuées pendant cette période: au nymphée d'Apollonie, à l'enceinte de Lis de Zgërdhesh, à l'église de Saint Nicolas à Voskopojë, à la mosquée de «Beqari» à Berat, à l'église de «Marmiroi» et à l'habitation des «Zekat». Il faut également mentionner ici les travaux de restauration effectués au bazar de Gjirokastër, achevés en 1968 à l'occasion du 60ème anniversaire du camarade Enver Hoxha et les travaux complets de restauration, entammés pendant trois ans au bazar de Kruja, à l'occasion du 500ème année de la mort de notre héros national, Gjergj Kastriot Scanderbeg. Ces travaux de restauration ont été une grande école pour nos restaurateurs.

Au cours de ces années on effectua des travaux de restauration dans les oeuvres d'art, surtout, dans la peinture murale, consistant à consolider les parties menacées des fresques. De pair à la restauration on réalisa la documentation des oeuvres d'art, surtout celle photographique. La documentation scientifique et surtout celle graphique et photographique marqua un essor sensible à cette époque. Mais, malgré les bons résultats, il fallait toujours approfondir le travail de la recherche systématique des monuments, de leur documentation complète, élargir la restauration des monuments particuliers et des ensembles. Il fallait également résoudre une série de problèmes de caractère juridique sur la protection des monuments ainsi que sur les nouvelles voies de leur propagation et de leur édition.

Les années 1970-1980 marquent la période de la consolidation de la physionomie de l'Institut envers les principales activités qui lui incombaient, sur une nouvelle base qualitative.

Au cours de la recherche des monuments pendant les années 1970-1975, s'effectuèrent une série d'expéditions lesquelles apportèrent un riche matériel surtout sur la fortification et l'habitation urbaine qui aida à la mise sous protection d'un grand nombre de monuments. Ces conclusions, de pair au travail de restauration, éveillèrent chez nos nouveaux cadres le désir de s'approfondir encore plus à l'appréciation des valeurs du monument, à l'histoire de l'architecture et des arts. Cela exigea d'une façon incontestable le besoin de la publication de la pensée scientifique. L'apparition du premier numéro de la revue «Monumentet» marqua un important événement dans la vie scientifique de l'Institut. L'appréciation de la revue par les chercheurs à l'intérieur du pays ainsi qu'à l'étranger, montrait que l'Institut s'était déjà engagé dans la difficile voie de la science contemporaine.

La première session scientifique tenue en 1969 fut un important événement pour l'avenir du travail de recherche et de restauration. Elle démontra que les nouveaux cadres de cette institution avaient déjà, acquis une bonne expérience étant en mesure de faire face aux difficiles problèmes qui se posaient. L'étude analytique des resultats atteints ainsi que la conviction que dans le domaine de l'appréciation il restait encore beaucoup à faire, nous poussaient à chercher de nouvelles méthodes dans le travail de restauration et à multiplier nos efforts conforme aux problèmes complexes posés par notre heritage architectonique-artistique.

Les tâches posées par la première session scientifique de l'Institut ouvrirent une nouvelle perspective dans notre travail. Le travail de recherche et de restauration passait de la phase des recherches des critères et des méthodes, vers la consolidation d'une expérience quinquennale et l'élargissement de l'activité. Guidés par les enseignements du camrade Enver Hoxha sur la valeur active des monuments pour la construction du socialisme et l'élévation du prestige de notre pays dans l'arène internationale, nos travailleurs donnèrent une grande importance aux publications et à la propagation en général des valeurs des monuments. Ainsi, de pair à la revue «Monumentet» en 1975 apparurent une serie d'éditions scientifiques-populaires. L'apparition de l'album «Les monuments de l'architecture en Albanie» marqua un important succès dans l'activité d'édition de l'Institut.

L'étude des monuments, en particulier des constructions populaires rurales, des monuments d'art, des centres historiques etc., préoccupait sans cesse les employés de notre Institut. Au cours des années 1970-1980 on entreprit de nombreuses expéditions de recherche dans tous les coins du pays mettant sous protection un grand nombre de monuments de différents genres. Il y eut des recherches dans le domaine des fortifications préhistoriques, antiques et médiévales. On mit sous protection aussi un grand nombre de constructions d'ingénierie tels des aqueducs, des fontaines, des ponts, des bains thermaux etc. Même dans le domaine des constructions populaires on effectua une large activité de recherche.

La plus grande entreprise dans ce genre de monuments fut celle des recherches sur les constructions rurales de valeur. Appuyé par le décret du Conseil des Ministres de l'année 1974 «Sur la recherche et la mise sous protection des con-

DO NOT COPY

structions populaires» en 1978 on annonça la réalisation avec succès de la recherche de toutes les constructions populaires rurales.

Plus de trente expéditions effectuées apportèrent la documentation de plus de six cents constructions rurales desquelles deux cents furent mises sous la protection, de l'Etat. On fit attention surtout aux maisons où se déploya l'activité communiste pendant la lutte de Libération Nationale et surtout à celles reliées à l'activité du camarade Enver Hoxha. Les recherches effectuées dans tous les genres des monuments prouvèrent la bonne formation scientifique de nos jeunes cadres qui affronterent une activité de grande responsabilité pour l'avenir du patrimoine matériel culturel de notre peuple. Par cette activité l'on faisait connaitre à notre peuple cette extraordinaire richesse créée de génération en génération.

Dans son rapport présenté au 7e congrès du PTA, le camarade Enver Hoxha entre autres soulignait: «...le retard que l'on remarque dans quelques genres de l'art et surtout en architecture, exige que l'on entreprenne des études et qu'on attecte un grand travail de recherche». Appuyé sur cette tâche, le personnel de notre Institut se mit au travail pour élaborer la maquette de «L'histoire de l'architecture albanaise» (jusqu'en 1912). Le 16 octobre 1978, à l'occasion de son 70e aniversaire, le premier exemplaire fut envoyé à notre dirigeant inoubliable, le camarade Enver Hoxha. Ce travail faisait preuve que nos chercheurs déjà étaient à même d'entreprendre d'importantes etudes généralisatrices traitant de plusieurs problèmes au cours d'une large espace de temps.

Les visites du camarade Enver Hoxha dans les régions de Gjirokastra et de Saranda en 1978 constituèrent un important evenement pour nos chercheurs. Les précieux conseils du dirigeant du PTA nous poussèrent à mieux nous approfondir dans les problèmes de la defense et de la restauration des monuments.

Au cours de ces années, une activité fructueuse fut entamée dans le domaine de la legislation pour la protection des monuments. La loi de 1948 «Sur la protection des monuments» ne satisfaisait plus les problèmes que posaient les monuments. La nouvelle loi sur «La protection des monuments culturels historiques et des richesses naturelles» du 23 septembre 1971, ainsi que «Le reglement sur la protection des monuments culturels et historiques» resolurent les problèmes posés par les monuments culturels. La sanction du règlement sur la protection de la ville-musée de Gjirokastra et des centres historiques de Korça et d'Elbasan, de pair au règlement de la ville-musée de Berat sanctionné en 1961, assurait une solide base juridique pour l'administration de ces centres.

Dans le domaine de la restauration, pendant cette décennie il y a eu d'importants résultats. Les persistants travaux dans les forteresses de Lezha, de Berat, de Kruja et de Gjirokastra, dans les centres antiques de Butrint et Apollonie, dans les villes, musées de Berat et Gjirokastra, sur une base d'études bien approfondies, apportèrent d'importants résultats. Une bonne partie de ces ensembles se convertit en des centres accèssibles, réalisant ainsi l'un des principaux buts de la sauvegarde et de la protection des monuments. De pair aux ensembles de monuments on entreprit des aménagements dans la Maison du Parti, celle de la Jeunesse, dans la maison où s'est tenu le congrès de Përmet, dans les églises telles celle du village Perendi, celle de Saint Michel etc. On entama des travaux de restauration dans les monuments d'art aussi, tels les églises de Berat, de Korça, le réfectoire du monastère d'Apollonie etc. C'est à cette époque que commença aussi la restauration des mosaïques de Tirana, de Pojan, d'Elbasan, d'Antigone etc. Donc, on évitait ainsi le danger de l'altération du monument en le rendant de plus en plus accessible.

Quant au travail pour dresser une documentation, pendant cette décennie on remarqua un sensible essor. Dans l'archive, aménagée selon de vrais critères scientifiques on rassembla un riche matériel documentaire.

Les chercheurs de l'Institut furent aidés par une riche information scientifique apportée par l'échange de nos publications avec celles des autres institutions parallèles à l'étranger.

La troisième session scientifique de 1975 ainsi que celle de 1980 marquèrent un important événement dans la vie de l'institut. Quant au niveau, à la complexité et à la profondeur du traitement des problèmes, elles marquaient des réussites de valeur.

Les années 1980-1985 marquent le commencement d'une autre étape dans le travail d'appréciation des monuments. Les nouvelles décisions historiques du VIIIe congrès du PTA ouvrient de nouvelles perspectives dans toute notre activité. Alors que l'on avait presque dépassé la phase de l'élimination des dangers immédiats que pouvaient subir les monuments, quand l'on avait tracé les critères sur les interventions que l'on devait entreprendre sur eux, quand le cadre restaurateur avait agrandi dans le nombre et dans l'expérience, se créèaient les conditions pour faire un bond qualitatif. Ce bond se reflète dans tous les domaines, se distinguant par l'ampleur des travaux à entreprendre, par la profondeur et l'exactitude scientifique du traitement des questions. Bien qu'en général le travail de recherche des constructions et des oeuvres d'art qui ont des valeurs, avait donné des résultats positifs, il continua toujours lors de cette période avec une plus petite ampleur.

Les importantes décisions du VIIIe Plenium du Comité Central du Parti en 1980 ouvrirent de nouvelles voies à l'approrondissement du travail de recherche et restauration dans le domaine des monuments. En analysant le travail effectué, suivant les orientations du Parti, on pensa améliorer le travail de restauration et la qualification, ultérieure des cadres. On jeta l'idée d'élaborer un «Atlas des Monuments».

Au cours de ces années de pair à la restauration des monuments particuliers, on passa à la restauration des ensembles. Il faut rappeler ici les aménagements effectués dans les forteresses de Berat, Lezhë, Gjirokastër, Krujë, Shkodër, Tepelenë etc. lesquelles peu à peu deviennent accessibles. Des travaux à longue échéance s'entamèrent au monastère d'Ardenicë et de

DO NOT COPY

Zvërnec. Les églises du quartier «Kala» de Berat sont entièrement restaurées. Les interventions de restauration dans les ensembles: Rue «Enver Hoxha», à Shkodra, Rue «Justin Godard», à Vlorë, celles du bazar de Korça, du monastère d'Apollonie etc., se considèrent d'une grande importance. On restaura et convertit en musée les maisons où le camarade Enver Hoxha déploya une activité révolutionnaire pendant la Lutte de Libération Nationale. Dans le domaine des monuments d'art on réussit à faire face aux difficiles problèmes posés par la restauration des fresques et des icônes. Cela se voit tant dans les critères que dans les méthodes appliquées souvent accompagnées d'études analytiques, chimiques et d'examens radiologiques. Un bond qualitatifs se réalisa aussi dans la documentation scientifique de ces oeuvres d'art. Les premières restaurations des oeuvres en pierre et en bois sont encourageantes, tandis que la restauration des mosaïques se trouve dans la phase de la consolidation des critères et des techniques de restauration. Les études traitant des critères de restauration telles: «La restauration des habitations populaires, «La restauration des monuments de l'architecture», «Les critères de restauration des monuments d'architecture et d'art», constituent un important événement à caractère scientifique pour l'avenir des monuments de notre pays.

En 1980, parallèlement à la publication de la revue «Monumentet» et des éditions à caractère scientifique-populaire, commencent à paraître une série de monographies sur différents genres de monuments. Jusqu'à l'heure actuelle il y en a sept dont deux n'ont pas encore paru. Il y a aussi sous presse deux albums, trois brochures, deux bibliographies et le cahier «Le restaurateur» qui traitera essentiellement des interventions dans les monuments.

L'approfondissement du travail de recherche et de restauration, exigeait la formation des cadres qui se sont engagés dans le premier degré de qualification post-universitaire. Le sujet des études de nos cadres correspond aux principaux problèmes de la restauration des monuments. Les cadres qualifiés constituent une solide base pour la spécialisation des jeunes cadres, ils les stimulent à atteindre un niveau scientifique plus élevé. Le stage de formation qui dure un mois fut un succès de notre travail pour la qualification des cadres.

Les succès obtenus pendans ces vingt années d'activité par le personnel de notre Institut, sont dédiés au PTA. C'est grâce à ses soins que dans une courte période de temps les spécialistes albanais guidés par les enseignements du camarade Enver Hoxha, réussirent à résoudre avec succès de grands problèmes assez complexes, quant aux différents domaines de l'étude et de la restauration des monuments. La phrase «... la sauvegarde et la restauration se réalisent et doivent se réaliser sur des bases scientifiques» prononcée entre autres le 9 mai 1983 par le camarade Enver Hoxha, devient un précieux conseil inoubliable pour nous. De ce point de vue, malgré les succès obtenus, nous sommes conscients que ce grand héritage qui nous est confié exige de plus profondes connaissances sur la base de la méthodologie marxiste-léniniste, de la qualité et des méthodes des appréciations et des interventions.

Le camarade Ramiz Alia, lors des visites qu'il effectua dans les régions de Korça et de Kolonja, donna d'importants conseils, en particulier pour l'accroissement du niveau qualitatif du travail scientifique dans tous les domaines. Ceci regarde également notre travail. Notre engagement dans le grand mouvement révolutionnaire «Porte-drapeau dans l'application des enseignements du camarade Enver Hoxha», est une garantie dans l'estimation des monuments; nous gardons allumé et inoubliable la valeur de la pensée théorique du camarade Enver Hoxha pour élever le niveau de notre science de restauration.

L'année 1985 qui marque la réalisation réussite du 7ème quinquennat, a créé déjà la claire perspective de la marche en avant du travail de recherche dans le domaine de la restauration. Le prochain quinquennat, rédigé sur la base des résultats obtenus jusqu'à présent, amènera notre personnel vers la résolution des nouveaux problèmes plus grands et plus difficiles, de manière à mieux répondre au niveau scientifique des exigences toujours croissantes que le Parti demande.

DO NOT COPY

Nr. 1 1986

monumentet

DO NOT COPY

GURI PANI
LAZËR PAPAJANI

NJË FURRË ANTIKE NË DURRËS DHE PROBLEME TË ZHVENDOSJES SË SAJ

Gjatë punimeve për ndërtimin e një godine shumëkatëshe në afërsi të muzeut të ri arkeologjik në Durrës, rreth 100 m në të djathtë të rrugës që të çon në Currila, ndeshën gjurmët e një objekti antik dhe disa fragmente qeramike.

Punimet e sondazhit që u kryen për evidentimin dhe njohjen e objektit, u bënë nga Bërthama Arkeologjike e Durrësit dhe autorët e këtij punimi.[1] Sondazhet treguan se gjurmët e zbuluara i përkisnin një furre antike. Ajo u zbulua në thellësinë 2,5 m nga sipërfaqja e terrenit të sotëm dhe kishte formë kuadratike (fig. 1) me këto përmasa: gjatësi 4m, gjerësi 3 m e lartësi deri në nivelin e ruajtur 1,2 m. Nga materialet qeramike të zbuluara përreth e konstruksioni i ndërtimit të kësaj furre na shtyn të mendojmë se kemi të bëjmë me një furrë qeramike për pjekjen e enëve. Ajo është e tipit të njohur të këtyre objekteve të përbëra nga dy ambiente dhoma e pjekjes dhe vatra e zjarrit. Dhoma e pjekjes ndahet prej vatrës së zjarrit nga një shtresë horizontale e formuar nga tulla të papjekura, të lidhura me njëra tjetrën me llaç balte, që formojnë skarën me vrima. Skara mbështetet në 7 mure paralele, që ndanin vatrën e zjarrit në drejtimin më të ngushtë në 6 hapësira (fig. 2). Vetë muret mbajtëse të skarës ishin të hapura në pjesën e poshtme tejpërtej në formë ovale (fig. 3) për të lejuar futjen e lëndës djegëse në brendësi të furrës. Hapësira në formë ovale (fig. 3) që është lënë për futjen e lëndës djegëse, arrin rreth 60 cm lartësi, dhe ishte formuar nga vendosja e tullave të papjekura, njera mbi tjetrën pak të spostuara në drejtimin horizontal, duke formuar një pseudo-hark. Dhe mbyllja e sipërme e hapësirave, ndërmjet mureve horizontale që formonin skarën kuadratike me dimensione 280 x 180 x 28 cm, ishte ndërtuar me tulla të papjekura (fig. 4). Tullat e përdorura për ndërtimin e këtyre mureve, kishin dimensione 37 x 23 x 7 cm, 47 x 26 x 5 cm dhe 44 x 21 x 8 cm. Trashësia e mureve formohej nga gjërësia e një tulle. Si material lidhës ka shërbyer argjila.

Janë ruajtur në gjendje të mirë në skarën e furrës dhe vrimat nëpërmjet të cilave kalonte nxehtësia. Ato ishin vendosur në radhë paralele (fig. 5), 10 rradhë prej të cilave ruhen, kurse 2 radhë janë dëmtuar së bashku me konstruksionin mbajtës. Vrimat janë të rrumbullakta me diametër rreth 3,5 cm. Ata ishin të suvatuara përreth me argjil; gjatë gjithë lartësisë së skarës, e cila dukej mjaft kompakte nga ngurtësimi i saj si rezultat i temperaturës së lartë, që formohej gjatë funksionimit të furrës. Vrimat e skarës ishin lënë për lehtësi ndërtimi në hapësirën ndërmjet mureve paralele, në vendtakimet e tullave në formë pyke që mbyllnin këtë hapësirë dhe formonin trashësinë e skarës rreth 30 cm (fig. 2).

Dhamë më lart disa karakteristika konstruktive

1) Për kryerjen e punimeve të konsolidimit dhe transportimit të furrës në një nga ambientet e muzeut arkeologjik ndihmoi Ateljeja e Monumenteve të Kulturës Durrës. Kjo ishte faza e parë e ndërhyrjeve tona konsoliduese-restauruese në këtë objekt. Faza e dytë e punimeve e cila do të fillojë me përfundimin e Muzeut të ri Arkeologjik, do të konsistojë në montimin e furrës në një nga sallat e këtij muzeu.

Për transportin e furrës ndihmoi N.N. Durrës me mjetet e ngritjes dhe të transportit.

DO NOT COPY



Fig. 1

të furrës së zbuluar në Durrës, që e dallojnë atë nga furrat për pjekjen e materialeve të ndërtimit[2] si tulla ose tjegulla. Ajo konsiston në mënyrën e ndërtimit të dhomës së pjekjes. Në ato raste kur ajo është ndërtuar mbi një konstruksion solid mbajtës, kuptohet se ka shërbyer për të mbajtur një peshë të rëndë, siç janë tullat ose tjegullat. Këto furra janë të mëdha ose të ndërtuara po në atë mënyrë si furrat e sotme të prodhimit artizanal të tullave.

Furrat qeramike që përdoren për pjekjen e enë-

2) Furra e zbuluar në Kuç të Zi, konstruksionin mbajtës të dhomës së pjekjes e ka të ndërtuar me harqe konstruktive prej tullash D. Komata, — Zbulimi i një furre antike të vjetër në Kuç të Zi, «Iliria» 1, Tiranë 1971, fq. 265, fig. 3,6.

DO NOT COPY



Fig. 2

ve, ishin më të vogla dhe kanë një konstruksion të thjeshtë, siç e pamë dhe në furrën tonë. Konstruksioni mbajtës i dhomës së pjekjes, kuptohet ka për të mbajtur një peshë të lehtë të enëve të vendosura në një ose dy radhë, në dhomën e pjekjes, e cila është e mbuluar me qemer cilindrik ose kube. Për furrat e pjekjes së enëve të vogla janë gjetur gjurmë mjaft të fragmentuara në vendin tonë[3] e në disa vende të Europës si Rumani, Hungari e Jugosllavi[4], që kanë forma të ndryshme si ovale, ose të rrumbullakëta.

Për mbulimin e dhomës së pjekjes në furrën e zbuluar në Durrës, nuk u gjet asnjë gjurmë, prandaj vlen të marrim parasysh të dhënat analoge të furrave që përdoreshin për pjekjen e enëve prej qeramike që



Fig. 3

3) Një furrë e rrumbullakët për pjekjen e enëve është gjetur pranë qytetit antik të Dimalit.

4) J. Todosoviç, Fours paleoslaves a Visujica, Starinar N.S. VII-VIII, Beograd, 1958, fq. 329.

përmendëm më lart. Ka dhe një arësye për të menduar se ky ambient duhet të ketë qenë i mbyllur lart me një mbulesë të përhershme. Në qoftë se do të mendonim se mbyllja nga sipër mund të bëhej me copa tjegullash siç praktikohej në furrat për pjekjen e materialeve qeramikë për ndërtim, pesha e kësaj mbulese relativisht të rëndë do t'i deformonte enët e holla prej balte. Prandaj furra jonë, me sa duket ka qenë ndërtuar me një kube të përhershme prej tullash, me një ose me dy gryka, ndërmjet të cilave materiali i papjekur shtrohej mbi skarën e pjekjes. Grykat mbylleshin pastaj me pllaka ose me një rradhë tullash e lyheshin me baltë në kohën e proçesit të pjekjes së enëve.

Vatra e zjarrit, për ta kaluar nxehtësinë kryesisht në dhomën e pjekjes, ishte veshur anash me një radhë tullash dhe e suvatuar nga ana e jashtme me baltë. Përveç kësaj nga ana e jashtëme ajo është plotësuar dhe me një mur tjetër veshës të ndërtuar me gurë e copëra tullash të lidhura me llaç balte. Trashësia e këtij muri veshës arrinte 60-65 cm trashësi (fig. 4). Gjatë zbulimit të furrës doli dhe një masë e madhe rëre, që rrethonte dhomën e zjarrit nga jashtë, që shërbente si masë e fundit për të mos lejuar nxehtësinë e krijuar në dhomën e zjarrit të kalonte jashtë pareteve anësore.

Lidhur me përdorimin e kësaj furre e kemi të vështirë të japim një mendim përfundimtar. Gjatë zbulimit të saj siç e përmendëm në fillim, u gjetën vetëm disa fragmente qeramike të datuara në shek. II-IV e.r. Për problemin e datimit ne mund të gjy-



KONSTRUKSIONI I FURRES

Fig. 6

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

kojmë më tepër nga materiali i përdorur për ndërtimin e furrës. Përmasat e tullave prej qerpiçi na drejtojnë në shekujt e parë të erës sonë. Kjo duhet të jetë dhe koha e ndërtimit të furrës, ndërsa koha e përdorimit të saj duhet të jetë e gjatë, meqenëse duken dhe ndërhyrje të herëpasherëshme të riparimit të saj.

Furrat për pjekjen e qeramikës të ngjashme me furrën tonë e kanë origjinën që nga kohët më të hershme të antikitetit.[5] Deri sot në vendin tonë janë zbuluar disa furra antike, por ato na paraqiten mjaft të fragmentuara. Më mirë ruhen të dokumentuara një furrë për pjekjen e tullave, zbuluar në Kuç të Zi[6]), dhe një në afërsi të Elbasanit në Jagodinë (fig. 6). Furra në Kuç të Zi i përket periudhës para pushtimit romak[7]), ndërsa ajo e zbuluar në Jagodinë, shekujve të parë të erës sonë. Është për tu përmendur se furrat për pjekjen e qeramikës duke qenë të caktuara për të plotësuar nevojat si për material ndërtimi, e orendi të ndryshme shtëpiake, kanë pasur një përdorim intensiv. Prandaj një pjesë e mirë e tyre ose janë prishur e zhdukur me kohë, ose janë riparuar e përpunuar në përshtatje me kërkesat e reja ndaj tyre. Në një shkallë të gjërë i shohim ato të përhapura në shekujt e mëvonshëm në provincat e Perandorisë Romake.[8] Kjo traditë vazhdon gjatë gjithë mesjetës. Në vendin tonë si në kohën antike dhe gjatë mesjetës janë përdorur si degë të veçanta të zejtarisë, që plotësonin siç thamë nevojat për material ndërtimi si në shtëpitë e banimit, ndërtesat me karakter shoqëror, ashtu dhe në ndërtimet mbrojtëse, gjurmët e të cilave i ndeshim mjaft herët në Apolloni.[9]

Problemi i konservimit të furrës duke parë dhe rëndësinë e ruajtjes së këtij objekti, si monument i vetëm i kësaj gjinie i ruajtur në mënyrë të plotë, përbën dhe qëllimin kryesor të këtij punimi. Që ky objekt të ruhej në gjendjen që doli nga gërmimi dhe në vendin ku u zbulua, u organizuan disa konsulta nga sektori i monumenteve antiko-mesjetare, komisioni i restaurimit të IMK e Bërthamës Arkeologjike. Në bazë të konsultave u përcaktua masa e ndërhyrjes konservuese e metoda e punës për transportin e saj, e cila doli e domosdoshme në bazë të konsultave me I S P Nr. 1 e zyrën e Urbanistikës të rrethit të Durrësit. Transportimi i furrës është i domosdoshëm për shkak të vështirësive konstruktive, që lindnin për të ekspozuar e konservuar në themelet e godinës shumëkatëshe (fig. 7), të bllokut të ri të banimit që po ndërtohej, meqenëse nuk si-

5) Dictionaire des Antiquides greques et Romaines, Vëll. XII, Paris 1896, fq. 1255--1256.
6) D. Komata, **vep.cit,** fq. 263
7) D. Komata, **vep.cit,** fq. 267
8) R. Cognot, et V. Diapat, Manual d'argjeologie romaine, II, fq. 462, S. Leoschsche. Die romischen Diegelofen in gemeindewald von speider, Tuerer Zeitschrift VI, 1931, fig. 2,3.
9) H. Ceka, Muri rrethues i Apolonisë B U SH T 1963/3.

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

gurohej qëndrueshmëria e ndërtesës nga ana sizmike.

Konservimi i furrës, lidhur dhe me problemin e transportit të saj kërkonte në radhë të parë të zgjidheshin disa probleme teknike, që kushtëzoheshin dhe me gjëndjen konstruktive mjaft të dobët të saj. Gjatë zbulimit vumë re se konstruksioni i furrës duke qëndruar për një kohë të gjatë nën tokë e nën veprimin e lagështirës së terrenit, kishte filluar të degradohej. Dy nga muret mbajtëse ishin shëmbur, duke dëmtuar pjesërisht dhe zgarën në pjesën e përparme dhe pjesën fundore të furrës. Vetë konstruksioni mbajtës i sgarës kishte mjaft të çara dhe dëmtime, si rezultat i veprimit të nxehtësisë gjatë përdorimit të furrës. Argjila e përdorur si material lidhës ose për përgatitjen e pjesës së mirë të tullave, nuk ishte e pastër, por e përzier me torfë, e cila nën veprimin e nxehtësisë vende-vende ishte kthyer në zgjyrë ose në mjaft vënde ishte çarë.

Nga sondazhet rezultoi se furra duket se ishte shëmbur pjesërisht dhe rindërtuar, duke ruajtur pa lëvizur vetëm muret prej guri të jashtëm veshës.

Këto ishin disa nga të dhënat e përftuara nga sondazhet e kryera për fillimin e punimeve. Në bazë të tyre ne përcaktuam metodën e ndërhyrjes dhe masën e domosdoshme që duhet të ruanim dhe të transportonim, në mënyrë që monumenti të mos humbiste vlerat e veta historike e estetike. Për këtë arësye e domosdoshme ishte të ruanim skarën me vrima të furrës, si elementi më i rëndësishëm i saj, dhe konstruksionin mbajtës të skarës, duke e liruar objektin nga muri veshës prej guri që rrethonte furrën. Për pjesët e hequra u përgatit dokumentacioni i nevojshëm grafik e fotografik, që do të na ndihmonte për rivendosjen e tyre, mbas montimit të furrës në muzeun e ri arkeologjik.

Për transportimin e furrës ne duhet të merrnim disa masa të nevojshme teknike, që do të konsistonin në konsolidimin e objektit për të kryer procesin e fundit të transportit. Fillimisht u përgatit një shtrat metalik me profile «U» dhe «L» nën muret mbajtëse të furrës (fig. 8). Procesi i dytë ishte shkëputja e mureve mbajtëse nga dyshemeja e furrës, e cila duke qenë prej argjile me trashësi rreth 40 cm, gjatë shfrytëzimit të furrës ishte pjekur, duke krijuar një masë mjaft voluminoze dhe të rëndë, që duke iu shtuar furrës, do të kalonte kapacitetin ngritës të mjeteve që do të përdornim. Për këtë arsye vendosëm që dyshemenë e furrës të mos e merrnim së bashku me furrën, pra ta shkëpusnim nga muret mbajtëse që ishin njëkohësisht ambienti i zjarrit. Duke menduar për destinacionin e ri të këtij objekt

DO NOT COPY



LIDHJE KONSTRUKTIVE PER ÇVENDOSJEN E FURRES

Fig. 9

dilte e panevojshme gjithashtu çvendosja e dyshemesë origjinale për arsyen e vetme se dyshemeja e furrës tani do të ishte terreni i rrafshët i sallës ku do të ekspozohej furra.

Për të shkëputur këmbët konstruktive nga dyshemeja e furrës, u përdorën disa pllaka metalike, të cilat u vendosën nën çdo këmbë të konstruksionit mbajtës të furrës, dhe u mbështetën në dy profilet «U» më të afërta, që ndodhen në dy krahët e mureve-mbajtëse (fig. 9). Në këtë mënyrë pesha e furrës, me anën e këtyre pllakave i transmetohet dyshemesë metalike. Gjithashtu u morën dhe disa masa të tjera si shkarkimi i peshës së zgarës me vrima, që arrinte një trashësi 30 cm dhe një peshë rreth 3,5 ton në platformën metalike ose tirantimi tërthor i furrës që do të garantonte qëndrueshmërinë e saj, meqenëse në kemi hequr muret veshës anësorë të furrës.

Në përfundim të masave konsoliduese ishte e nevojshme të kryheshin disa punime për të mbrojtur shtresën e trashë të skarës prej argjile. Për këto arësye menduam të bënim një veshje me allçi të saj, mbasi kishim vendosur më parë dhe një armaturë të lehtë me rrjetë teli (fig. 10).

Mbasi kishim kryer të gjitha proçeset e nevojshme teknike konsoliduese dhe u bindëm për qëndrueshmërinë e konstruksionit të formuar, filluam proçesin e fundit që ishte ngritja me autovinç, vendosja në mjetin transportues e transportimi i saj në Muzeun Arkeologjik të Durrësit. (fig. 11, 12).

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12

Në fazën e dytë të punimeve, që do të konsis-
tojë në montimin e furrës në një nga sallat e muzeut
të ri arkeologjik, është menduar që të plotësohen
pjesët e dëmtuara të mureve mbajtëse, e të sigurohet
drejtpeshimi i furrës në bazamentin e ri. Përpara se
të hiqen elementët konstruktivë mbajtëse, do të
kryhen të gjitha punimet restauruese në vëndet e ne-
vojshme të dëmtuara nga koha ose transporti. Në
përfundim të punimeve mendojmë të lëmë të duk-
shme elementët konstruktivë e funksionale të furrës
me qëllim që objekti të jetë i kuptueshëm për vi
zitorët e ndryshëm.

Ndoshta në të ardhmen do të na dalin të dhëno
të reja në zbulimin e monumenteve të kësaj gjinia
edhe brenda territorit të qytetit antik të Durrësit
Sidoqoftë, ekspozimi i këtij objekti në një ambien
muzeal do të ndihmojë të hedhë dritë mbi një ng
aspektet e jetës së kësaj popullsie që pa dyshim k
luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e lasht
të popullit tonë.

GURI PANI
LAZËR PAPAJANI

DO NOT COPY

LE FOUR ANTIQUE A DURRËS

Au cours des travaux de construction d'un édifice près du nouveau musée archéologique de Durrës, environ 100 m à droite de la rue menant à Currila, on rencontra les traces d'un objet antique et quelques tessons de poterie. Les sondages effectués montrèrent qu'on avait à faire à un four antique du type connu composé de deux ambiances: du foyer et de la zone à cuir.

Puisqu'on ne pouvait pas exposer et conserver cet objet dans les fondations de l'édifice, on décida de le transporter au nouveau musée archéologique.

Les fours de céramique, pareils à ceux dont nous parlons, prennent leur origine depuis les plus anciennes époques de l'antiquité. Jusqu'à l'heure actuelle, on en a découverts chez nous beaucoup, mais ils se présentent assez fragmentés. Seulement les fours de Kuç i Zi et celui de Jagodine au voisinage d'Elbasan, se conservent bien documentés.

Chez nous, pendant l'Antiquité et le Moyen-Age, les fours complétaient les besoins en matériel de construction pour les habitations, les constructions sociales et les constructions défensives dont les traces se rencontrent souvent en Apollonie.

Les fours qui servaient à cuir des poteries étaient assez petits, d'une simple construction qui pouvait tenir une ou deux rangées de pots dans la zone déstinée à la cuisson. surmonté d'une voûte cylindrique. Pour cuir de petits objets de poterie on utilisait aussi des fours en forme ovale ou circulaire, dont on ne conserve que des fragments dans notre pays ainsi que dans quelques autres pays d'Europe, tels Roumanie, Hongrie et Yougoslavie.

Afin de créer une image plus ou moins complète sur le four découvert à Durrës, nous allons nous arrêter, un peu sur son mode de construction.

Le four fut découvert à une profondeur de 2,5 m en dessous de la surface du terrain actuel, il avait une forme quadrangulaire de dimension: 4 x 3 x 1,2 m. jusqu'au niveau conservé. La zone déstiné à cuir, est séparée du foyer par une couche horizontale de briques crues entreliées de mortier de boue. Cette couche s'appuyait sur sept murs parallèles qui divisaient le foyer, dans sa plus étroite partie, en six espaces. Les murs de soutènement de cette couche étaient percés en forme ovale dans leur partie inférieure, afin d'introduire le combustible à l'intérieur du four. L'ouverture ovale, haute de 60 cm, était formée par la disposition des briques crues l'une sur l'autre, un peu déplacées horizontalement, formant ainsi un pseudo-arc. La fermeture supérieure des espaces entre les murs horizontaux qui formaient la grille quadrangulaire aux dimensions 280 x 180 x 28 cm était construite par des briques crues. Pour la construction de ces murs on utilisait des briques de dimensions: 37 x 23 x 7 cm, 47 x 26 x 8 cm, 44 x 21 x x 8 cm liées par de l'argile. De la grille du four on conserve 10 rangées de trous en bon état, tandis que les deux autres rangées sont assez endommagées. Ce sont des trous ronds, d'un diamètre 3-5 cm environ. Au moyen de ces petits trous passait une partie de la chaleur qui servait pour la cuisson des poteries fines. On ne peut pas admettre l'idée que la couverture du four était réalisée par des tuiles, comme dans les fours qui servaient à cuir des matériaux de construction en céramique, parce que son poids relativement lourd allait déformer les poteries fines. Donc, il parait que notre four était couvert d'une coupole permanente de briques.

Afin de faire passer la chaleur dans la zone à cuir, les parois latéraux du foyer était munis d'une rangée de briques enduit de pisé à l'extérieur. A part cela, de l'extérieur, le foyer est complété d'un autre mur construit de pierres et de morceaux de briques liés avec du mortier de pisé. L'épaisseur de ce deuxième mur atteint 60-65 cm.

Quant à la datation du four, nous devons plutôt consulter le matériel utilisé à sa construction. Les dimensions des briques en pisé remontent aux premiers siècles de notre ère auxquels appartient aussi la construction du four. Les nombreuses interventions de réparation font preuve d'un assez long usage.

D'après les premiers sondages effectués on précisa le mode de l'intervention et le volume indispensable qu'on devait conserver et transporter dans le musée afin de ne pas effacer les valeurs historiques et esthétiques du monument. Il a fallu prendre quelques mesures techniques pour consolider l'objet pendant le transport. Au début on a réalisé un support métalique utilisant de prophilés «U» et «L» que l'on a placés en dessous des murs principaux du four, après avoir enlevé les murs en pierre et avoir creusé au-dessous de ces murs principaux parallèles les cannaux où ils seraient logés. Pour assurer la levée uniforme de l'objet, on a placé les prophiles «L» en dessous de ceux «U» en biais, créant ainsi un support

idéal. Le second processus était celui du décollement des murs principaux du sol du four. Puisque le plancher du four serait appuyé sur le terrain plat de la salle de l'exposition, il n'était pas nécessaire de mettre le plancher original du four. Afin de diminuer le poid des murs de soutènement placés de travers au four, il fallait prendre d'autres mesures de consolidation. Donc, il a fallu alléger le poid de la grille épaisse de 30 cm, au chassis métallique préparé, par quelques supports verticaux. D'autres mesures ont été prises pour assurer la rigidité du four durant le transport et la manipulation. Pour cette raison des tirants métalliques ont été utilisés qui étaient fixés en leur deux bouts par des poutres en bois qui entouraient la partie extérieure du four. Ces poutres en bois, où ont été fixés les tirants, de 25 cm de large, placés à la mi-hauteur des murs principaux de biais, garantissaient leur appui latéral très nécessaire en remplaçant les murs en pierre enlevés. Une fois terminées ces mesures de consolidation, il était nécessaire d'effecteur des travaux qui protégeraient l'épaisse couche de la grille du four en argile. On a procédé en plaçant une grille de renforcement en fil de fer et en couvrant celle-ci par une couche de plâtre.

Après avoir efectués tous ces travaux nécessaires techniques de consolidation et ayant été convaincu pour la rigidité de la construction commença le dernier processus qui était le soulèvement par auto-grue, le chargement sur le véhicule de transport et son transport jusqu'au Musée Archéologique de Durrës.

Peut-être dans le futur nous découvrirons de nouvelles données dans les découvertes des monuments au territoire de la ville antique de Dyrrah. De toute façon l'exposition d'un tel objet dans une ambiance muséale nous aidera a jeter de la lumière sur les aspects de la vie de cette population, qui sans aucun doute a joué un rôle important dans l'histoire très ancienne de notre pays.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

APOLLON BAÇE
AVENIR ALEKSI

SKELAT GRYKËLUMORE TË ADRIATIKUT GJATË MESJETËS (Shek. XI-XV)

Bregu lindor i Adriatikut nuk ka karakter të njëjtë morfologjik. Në veri, nga Istria deri në Ulqin, ai është abraziv, me male të larta e të thikëta, që shtyhen deri në buzë të detit. Si e tillë, kjo perde malore kalohet me vështirësi nga rrugët, të cilave në brendi u kundërvihen male të tjera. Rrjedhimisht, përkitja e detit me tokën, përkatësisht e skelave me rrugët, në këtë vend është e dobët. Në të kundërt, në pjesën jugore, nga Ulqini në Kepin e Gjuhës, kemi një bregdet depozitimi, të pasrendur prej njërës nga fushat më të mëdha të Ballkanit, nga Ultësira Perëndimore. Fusha përshkohet nga lindja në perëndim prej një sërë lumenjsh, luginat e të cilëve paraqesin rrugë të përshtatshme dhe të vetme për kalimin në brendi të gadishullit. Rrjedhimisht, këtu sigurohet mirë kontakti skelë-rrugë, në rradhë të parë nga qytetet-skela (Ulqini, Durrësi, Vlora). Por krahas tyre një sërë skelash të vogla në derdhjen e lumenjve, siguronin edhe më mirë lidhjen e prapatokës me botën e jashtme (Fig. 1). Këto skela morën një hov të veçantë në shek. XIV me fuqizimin e ekonomisë feudale, duke i shërbyer në radhë të parë eksportit të drejtëpërdrejtë të tepricës së rentës feudale, pa iu nënshtruar kontrollit dhe taksave të qyteteve-skela, të cilat mund të ishin nën vartësi të institucioneve të tjera shtetërore osa të feudalëve të tjerë. Të tilla janë skelat në rrjedhjen e Matit, Ishmit, Shkumbinit, Semanit. Një rol disi të ndryshëm ka Vjosa dhe ca më tepër skelat në rrjedhjen e Bunës dhe Drinit të kontrolluara përkatësisht nga Shkodra, Ulqini dhe Lezha.

Sot, përjashtuar Bunën ku mund të lundrojnë anije deri 100 tonëshe[1], lumenjtë janë praktikisht të palundrueshëm. Por në antikitet dhe në mesjetën paraturke rrjedhja e tyre e poshtme qe e kalueshme për anijet. Kështu, para erës sonë në Lis dhe Apoloni, përkatësisht në Drin dhe Aos (Vjosë), strehoheshin flotat ushtarake. Ana Komnena na bën të ditur se në shek. XI Drini ishte i lundrueshëm.[2] Kjo dëshmohet dhe nga dokumentet, të cilat tregojnë se në vitin 1377 barkat e mëdha shkonin tej Danjës[3] dhe se në v. 1474 në Shirgj qëndronte flota veneciane për mbrojtjen e Shkodrës[4]. Nga Pahymeresi mësojmë se në v. 1281 Osumi ishte i lundrueshëm pranë Beratit,[5] ndërsa një fragment tjetër i Ana Komnenës tregon se Vjosa lundrohej deri afër Bylisit, ku normanët kishin krijuar një bazë të flotës së tyre.[6] Por prerja masive e pyjeve, e përshpejtuar në gjysmën e dytë të shek. XIV dhe veçanërisht në periudhën e pushtimit osman, solli një rritje të depozitimit të materialit të ngurtë, me pasojë rritjen e deltave në derdhje të cilat nuk shpëlaheshin dot

1) P. Geço, **Gjeografia fizike e Shqipërisë,** Tiranë, 1963, f. 66.
2) **Alex,** I, VI, 32.
3) L. Thalloczy, C. Jireçek, E. Sufflay, **Acta et diplomata res Albaniae mediae aetetis illustrantia,** Vindobonae, 1918, (më tej A. Alb) II 329, 23 Shkurt 1377 «al Dagno si parecava cum ladia».
4) K. Jireçek, **Skutari und sein Gebiet im Mittelalter,** «illyrisch-albanische Forchungen» Munchen-Leipzig, 1936, f. 106 (në vitin 1474).
5) G. Pachymeres, **Historiae,** Bonnae, 1835, I, VI, 32.
6) **Alex,** II, XIII, 5.

DO NOT COPY



Fig. 1

nga maretë.[7] Kështu në v. 1521 në «Bahriye» në librin e lundërtarëve të Piri Reisit lexojmë se në «Biusa» (Vjosë) hynë anije, por nganjëherë deti sjell rërë dhe atëhere nuk kalojnë dot galerat... Nga këtu deri në Durrës ka lumenj të tjerë, por tërë grykat e tyre janë me cektina dhe ata janë të palundrueshëm[8]».

Shtimi i depozitimit të materialit solli në të njëjtën kohë dhe një ngritje, cektësim e zgjerim të shtratit të lumenjve me pasojë kënetëzimin në rritje të fushës. Faktor tjetër negativ që ndikoi në drejtim të kënetëzimit është zhytja e rripit bregdetar me një shpejtësi jo të vogël, rreth 1-1,5 mm në vit. Ky proçes, në të kundërt me çka është pranuar në tërë literaturën e derisotme gjeografike dhe historike, dëshmohet qartë nga rrënojat e ndërtimeve dhe monumenteve.[9]. Kështu në kepin e Rodonit nën pasqyrën e ujit ndodhet jo vetëm fortifikimi ilir[10], por edhe një pjesë e fortifikimit të Skënderbeut. Në grykën e derdhjes së Ishmit kemi vrojtuar se skela e viteve 20 të shekullit tonë ndodhet rreth 1 m nën pasqyrën e ujit, afro 100 m larg bregut. Në Durrës disa banesa të kapërcyellit të erës sonë gjenden 1.5-2 m nën pasqyrën e detit, në territorin e mbuluar mirë nga kënetat e dikurshme[11]. Në Treport në truallin e Aulonës antike një ndërtim monumental ndodhet 1-1.5 m nën nivelin e detit, nën nivelin e ujërave që filtrojnë prej tij.[12] Së fundi, pjesa e poshtme e gurores antike në Karaburun ndodhet rreth 1 m nën nivelin e detit[13].

Rripi bregdetar i Adriatikut Jugor ka qenë pjellor, i drenuar nga shtretërit e thellë të lumenjve. Këtë e tregon eksporti në rritje i drithërave të kësaj zone që nga shek. XI, dhe përshkrimet e kryqtarëve, Ana Komnenës dhe historianëve të tjerë. Kjo dëshmohet nga lindja dhe zhvillimi i skelave, të cilat eksportonin pikërisht prodhimet e kësaj zone.

Buna dhe Drini kanë sistemin më të ndërlikuar të skelave grykëlumore dhe të vetë lumenjve. Drini, lumi më ujiplotë dhe i gjatë në Shqipëri (283km),

trason njëkohësisht dhe rrugën tepër të rëndësishme për në Prizren e mëtej në Danub, rrugën e Zentës. Si i tillë, ai është dhe lumi i parë që haset në kartografinë mesjetare, në vitin 820[14]. Në afërsi të Danjës (Vaut të Dejës) lumi ndahet në dy pjesë. Pjesa më ujëshumë lidhet me Bunën, mbas daljes së Bunës nga liqeni, ndërsa tjetra, Drini i mirëfilltë vazhdon deri në Lezhë. Siç e tregojnë dokumentet, kjo panoramë dëshmohet gjatë tërë mesjetës paraturke. Përzierja e dy lumenjve ka sjellë dhe përzierjen e emrave; Skela e Shirgjit në Bunë përmendet që në mars të v. 1283 me emrin» porti i Shën-Sergjit të Drinos (portus Sancti Sergii de Drino) dhe këtë emërtim ajo e ruan në tërë dokumentet. Po kështu edhe skela tjetër e Bunës, në Shën Koll del me emërtimin Shën-Nikolla i Drinit (San Nicolo de Drino). Vetë dega e Drinit në Lezhë, Drini i mirëfilltë, përmendet në 7 janar 1388 si lumi i Lezhës (flumen Lesii)[15]. Duket sikur ky dokumenti i sqaron të tëra: se Drini quhej lumi i Lezhës dhe Buna quhej Drin. Por në një dokument tjetër të 14 marsit 1355 lexojmë se kripa e Durrësit në tregun e Bunës kushton më tepër se në tregun e Drinit, dhe në Mat[16], ndërsa Shën-Kolli përmendet si «abacia e Shën-Kollit të grykës së Bunës»[17]. Rrjedhimisht, diferencimi i qartë i skelave të këtyre dy lumenjve është i vështirë. Por pavarësisht se nga cila pikë nisen ata konvergojnë në Danjë.

Skela e parë në Bunë ndodhej në abacinë e Shën-Nikollës (San Nicolo de Drino, ose Oldrino, abacia di Santo Nicola de la foza de la Boiana), një manastir i vjetër benediktin i peshkopatës së Ulqinit[18] që gjendet afër grykës së Bunës, afër Ulqinit, në një truall me pyje dhe arra. Por, në krahasim me skelën tjetër, atë të Shën-Sergjit, ai përmendet mjaft rrallë. Kjo e fundit gjendet 28 km në brendi të lumit, drejt e në buzën e tij, rreth 10 km larg Shkodrës, rrjedhimisht në kontrollin e saj. Kisha e Manastirit, me përmasa të konsiderueshme dhe arkitekturë të përkujdesur daton, sipas një mbishkrimi, në v. 1290. Ky datim mbështetet dhe nga stili gotik i zhvilluar me elemente të romanikut të vonë.[19]. Por fakti që porti përmendet në vitin 1280 dhe vetë manastiri në 21 mars 1283[20] tregon se para kësaj kishe ka pasur një kishë tjetër, çka përkon dhe me thënien e presbiterit të Dioklesë se në të ndodhen varret e mbretërve të Dioklesë të shek. XI-XII.[21] Kjo lidhet mirë dhe me emrin e martirëve ushtarakë, Sergjit e Bakut, që u ishte dedikuar kisha, nderimi i të cilëve në shek. VI pati arritur kulmin. Krahas manastirit dhe skelës, në këtë vend ndodhej një magazinë kripe dhe dogana. Në vitin 1335 këtu përmendet dhe kështjellari (castellanis sancti Sergii)[22] ndërsa në korrik të v. 1423 vetë kështjella me mure prej qerpiçi (bastita a latere S. Sergii). Në këtë drejtim skela e Shirgjit kishte dhe rolin e një skele të fortifikuar lumore ku qëndronte flota. Kështu në v. 1422-1423 dhe në Rrethimin e Parë të Shkodrës, në Shirgj qëndronin galerat e flotës Veneciane[23]. Rolin tregtar të kësaj skele, përveç një shumice dokumentesh për transaksione tregtare, e dëshmon dhe panairi që mbahej në çdo 27 shtator.[24].

Prodhimi kryesor që eksportohej nga këto dy

7) Në bregdetin Adriatik ato kanë një amplitudë 0.50-0.60 m (P. Geço) **vep.cit,** f. 26).
8) H. Mžik, **Beiträge zur Kartographie Albaniens nach orientalischen Quellen,** «Geologica Hungarica, series geologica», III, Budapest 1929, f. 638.
9) A. Baçe, **Rrugët shqiptare në mesjetë,** (VII-XV), «Monumentet» 1, 1984, f. 59-68.
10) N. Ceka-M. Zeqo, **Kërkime nënujore në vijën bregdetare dhe ujërat e brendëshme të vendit tonë,** «Monumentet» f. 128.
11) H. Myrto, — **Të dhëna mbi shtrirjet e Dyrrahut në pjesën jugperëndimore të kënetës,** f. 143.
12) A. Baçe, — **Rrugët ...,** f. 60,
13) N. Ceka-M. Zeqo, **vep.cit,** f. 130.
14) H. Mžik — **Vep.cit,** f. 628-632.
15) K. Jireçek, **Scutari...,** f. 117.
16) **A.Alb,** I, 789.
17) S. Ljubic, — **Listine o odnosajih izmedju Južnov slavjenstva i Mletačke republike,** «Monumenta spectantia historia slavorum Meridionalum» Zagreb 1868 — 1902. 9, 10.
18) K. Jireçek, **Scutari...,** f. 117.
19) A. Meksi, **Kisha mesjetare të Shqipërisë së Mesme e të Veriut,** «Monumentet» 2, 1983, f. 82-185.
20) **A.Alb,** I, 469.
21)K. Jireçek, **Shutari...,** f. 117.
22) C. Mijatoviç; **Despot Djuragj Brankoviç, gospodar Strima, Podunavlju i zetskom Primorju,** Belgrad, 1907, 1, f. 40
23) C. Mijatoviç, **Po aty,** N. Jorga, **Notes et extraits pour ser vir a l'histoire de Croisades aux XV siècle, Paris, Budapest,** 1899, 1916, I, f. 329, K. Jireçek **Scutari...,** f. 106.
24) **A.Alb,** II, 344 27 Shtator 1377, panairo Sancti Sergii de Zenta.

DOKUMENTY

pika ishte druri, shitja e të cilit përmendet që në mars të v. 1283[25]) e këtej.[26]) Nga një dokument tjetër i 11 janarit 1325 kuptojmë se ky material eksportohej i përpunuar, dërrasa e trarë (doghe, trabes). Ndërsa nga një dokument i 4 shkurtit të këtij viti mësojmë se një pjesë e mirë e drurit pritej përreth. Në të tregohet se pagesa e druvarëve kryhej nga abati i manastirit të Shën-Kollit[27]). Së fundi, nga një kontratë e majit 1379 kuptojmë se druri ishte pishë dhe se përgatitej kryesisht në formë dërrasash 5,8 dhe 14 hapa të gjatë 11; 11,6; 30,8 m të përshtatura kryesisht për anije.[28])

Skela tjetër e këtij sistemi gjendet në Lezhë, në rrëzë të qytetit të fortifikuar, i cili në antikitet shtrihej nga maja e kodrës, gjatë tërë shpatit të saj e deri në buzë të lumit. Pikërisht brinja nga lumi shërbente si mur anësor i skelës. Të dhënat e para për të i kemi nga Cezari, i cili na bën të ditur se «ai vetë u nis për Lis, ku u ra të tridhjetë anijeve të transportit që kishte lënë M. Antoni brenda limanit»[29]). Kjo afri e qytetit me skelën shpjegon dhe faktin se, me gjithë tkurrjet e herëpashershme të qytetit në mesjetë, qyteti i poshtëm i fortifikuar buzë lumit nuk u braktis asnjëherë, por bashkëjetoi me qytetin e sipërm, kështjellën. Si treg i veçantë (mercatum de Llesio) Lezha përmendet në vitin 1331[30]). Por, në krahasim me skelat e Bunës, prej nga anijet mund të kalonin lehtë në liqenin e Shkodrës ose Danjës, skela e Lezhës përmendet më rrallë. Në të vërtetë lumi më lart ishte i palundrueshëm për anije, qoftë të tonazheve të mesme, dhe këtu niste rruga tokësore. Kjo ishte pika nga niseshin mallrat e rënda të papërshtatura për transport lumor. Kështu në v. 1421, 143, 5 tonë mall për «Sklavoni» nisen pikërisht përmes Lezhës. Nga ana tjetër, kjo duket se është dhe rruga e preferuar për transportin e argjendit nga minierat e Kosovës, çka duket nga mosmarrëveshjet midis raguzianëve dhe venecianëve në v. 1428-33 dhe sekuestrimi nga këta të fundit i këtij metali.[31])

Mati derdhet dhjetë km në jug të Drinit. Në një dokument të v. 1335 ai përmendet dhe me emrin Foluolati[32]). Praninë e skelës në të e kuptojmë që në v. 1323 kur raguzianët presin Uroshin III në Ulqin ose Mat (a la Mate). Së fundi, Matin e gjejmë në një letër të Balshajve të v. 1375[33]) që u dërgohet raguzianëve në breg të Matit. Kjo tregon dhe për një treg të tyrin në këtë vend.

Ishmin, mendojmë se fillimisht e hasim në një dokument venecian, të 26 shtatorit 1393, ku lexojmë se kapiteni i Durrësit duhet të marrë masa që tregtia e kripës të mos zhvendoset nga Lezha në Shufada (Suffada), që është një vend 8 mile larg[34]). Në këtë largësi (12.87km) vjen në konsideratë vetëm grykëderdhja e Ishmit, e cila ndodhet afro 13,5 km larg derdhjes së Drinit. Rrjedhimisht, me skelën e Shufadasë në kuptojmë pikërisht skelën në grykëderdhjen e Ishmit e cila komunikon lehtë me Krujën, malësinë e Matit dhe tërë zonën e Tiranës. Rëndësinë e kësaj skele e kuptojmë dhe nga burimet e këtij tregu. Për herë të parë, nëse pranojmë njësimin e Shufadasë me Ishmin, ajo përmendet më 3 tetor 1320, kur vihet në dukje prania në të e tregtarëve raguzianë. Rreth vitit 1359 zot i saj është Karl Topia[35]). Me sa duket, në këtë kohë Ishmi, i njohur dhe për pasurinë e tij me dru[36]), kthehet në një kantier naval ku ndërtohet një numër i madh anijesh të ndryshme të armatosura (galera et ligna. . . navigia armata in mari)[37]) Konsistenca e kësaj flote duket nga fakti se, përveç kapitenëve të anijeve të veçanta, Topia kishte të emëruar dhe komandantët e flotiljes[38]). Pikërisht

25) **A.Alb,** I, 469.
26) 4 Shkurt, 12 Mars, 1325, 17 janar, 27 shkurt, 4 mars 1329, 15 Nëntor 1340 18 qershor 1366, 9 maj 1377, 2 tetor 1381, A. Ducellier (Vep. cit, f. 360, 589-90, 573).
27) **A.Alb,** II, 308.
28) A. Ducellier, **Vep. cit,** f. 889.
29) **Caes B. Civ.** III, 40, 5.
30) **A.Alb,** I, 770, 11 korrik, 1333.
31) A. Ducellier, **Vep. cit,** f. 604.
32) **A.Alb,** I, 789, 14 mars, 1335 «Fluminum Sclavoniae. . . Drini. . . Lesii. . . Folliolati».
33) K. Jireçek, **Die Lage und Vergangenheit der Stadt Durazzo in Albanien,** «Illyrisch-Albanische Forchungen» Munchen und Leipzig, 1916, f. 153.
34) **A.Alb,** II, 51.
35) C. Hopf, **Chronique Gréco-romaines inedites au peu connues,** Berlin 1873, Karl Topia del si zot i dy Skurjeve rrjedhimisht dhe i Ishmit.
36) A. Ducellier, **Vep. cit,** f. 588 përmend eksportin e drurit në qershor-korrik 1379, nëntor 1380, fund i shek. XIV.
37) N. Jorga, **Vep. cit,** IV, f. 18. Në të vihet në dukje se Topia po ndërton një fortifikim në Kepin e Melies (Rodon) dhe po armatos anije. Po këtë e shohim në një dokument të 14 majit 1364 **(A.Alb,** II. 329).
38) **A.Alb,** II 292. Më 4 korrik 1372, një anije e Karl Topisë sulmon anijet raguziane. Në të veç Janit prej Durrësit kapiten i anijes (Comitus) gjendej Gjon Balta, gjasisht komandant i flotiljes (qefalia).

DO NOT COPY

i bazuar në të, ai e rrethon Durrësin në v. 1363 nga toka dhe nga deti (për terram e për marem)[39] i cili kishte pa dyshim veç flotës së tij ndihmën e flotës së fuqishme veneciane. Sipas një dokumenti të 29 marsit 1368, Karl Topia e mori Durrësin «me veprën e tij detare»[40], ndërsa në v. 1373 e rimer për së dyti duke i stacionuar anijet e tij në Rodon e në Kepin e Polit. Përmendja e Ishmit në një sërë transakcionesh në v. 1371, 1377, 1379, 1380,1381 dhe veçanërisht në shtator-tetor të v. 1415.[41], kur në të përmendet doganieri tregon se Shufada-Ishmi, ndonëse në hije të Durrësit të afërt, kishte dhe një aktivitet tregtar në drejtim të blerjes së kripës dhe shitjes së drithit (1377, 1379) dhe drurit (1379-1380).

Erzeni, i cili vijon 26 km pas Ishmit, nuk përmendet në dokumentet bashkëkohëse, për faktin e thjeshtë se në të nuk lindi ndonjë skelë ose treg. Kjo, mbasi ai gjendet direkt në zonën e Durrësit dhe nga ana tjetër rrjedhja e tij, mbasi zbret nga veriu, i sillet fare afër Durrësit, duke paraqitur rrugën natyrore prej këtij qyteti për në fushën e Tiranës. Lumi tjetër, i cili shfaqet dendur në dokumentet mesjetare si skelë dhe treg, është Shkumbini.

Shkumbini në antikitet njihej me emrin Genus, ndërsa në mesjetë me emrat Breg (Vreg)[42] dhe më pak Shkumbin. Kështu më 1210, në një dokument, përmendet «lumi i quajtur Vrecus, në dukatin e Durrësit»[43] Të tillë atë e gjejmë dhe në hartat e Ortelit dhe Merkatorit (1589-dhe 1584). Në këtë kohë, në vitin 1570, lumi nis të përmendet me emrin e sotëm Shkumbin (Scumbino)[44]. Lundrimi i grykës së lumit kuptohet nga kërkesat e raguzianëve për të qarkulluar në të. Me kontrollin e kësaj lëvizjeje duket se lidhet dhe ndërtimi i kështjellës së Bashtovës nga shek. XIV[45], e cila sot ndodhet pak më në veri të lumit. Por Shkumbini shtratin e vjetër e ndjek vetëm deri te ura romake, ndërsa më tej ai vijonte më në veri duke kaluar rrëzë murit verior të kështjellës. Fillimisht tregu i Bregut përmendet në 20 prill 1345[46] si vendshitje druri. Më tej në 24 mars 1347, Bregu përmendet si qendër për shitjen e grurit[47]), ndërsa nga viti 1360 ai del vazhdimisht si treg i tillë[48]. Rëndësinë e kuptojmë nga nxitja e kështillit të vogël të Raguzës për importin nga Bregu[49] dhe takimet e shpeshta të raguzianëve me Malarangën për shkak të rritjes së doganës prej tij. Këto mosmarrëveshje rregullohen në 19 mars 1360 dhe Raguza dërgon një sindik të sajin për të qëndruar në Breg. Rroga e tij tepër e lartë; 35 hiperpera në muaj,[50] tregon pa dyshim për peshën e veçantë të Bregut në tregtinë me Raguzën. Gjallëria e këtij tregu solli dhe krijimin e një shtrese tregtarësh vendas (Theodhori i Bregut, Dhimo Bregu)[51]. Edhe më qartë kjo kuptohet nga grabitja më 26 Korrik 1371 e një tregtari të pasur raguzian, të cilit Muzaka me njerëz të Bregut i thyen portën dhe i merr 200 dukata si plaçkë, çka tregon se këtu po zhvillohej një qendër e pasur.

Laguna e Karavastasë, që në greqisht do të thotë vendqëndrim anijesh (καραβόδταδςμ) ndodhet në jug të derdhjes së Shkumbinit[52]. Në jug të kë-

39) **A.Alb,** II, 172.
40) **A. Alb,** II, 239.
41) **A.Alb,** II 275 A. Ducellier, vep. cit, f. 573, 537, 588, 575.
42) Mendojmë se forma Vreg në dokumentet në latinisht ka ardhur si pasojë e keqësimit të emrit Breg nga dokumentet greqishte ku mund të lexohet si Breg ashtu dhe Vreg.
43) G. Tafel-G. Thomas, **Urkunden zur alteren Handels und staatengeschichte der Republik Venedig,** Wien 1856, f. 67, 2, f. 121, 12, 195.
44) Starine
45) Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Bashtovës,** «Monumentet» 15-16, f. 59-77 jep përshkrimin e plotë të kështjellës. Por thënia e tij se ajo u ndërtua nga Venecianët në shek. e XV është e gabuar, pasi ndërtimi i saj nuk do të tolerohej në asnjë mënyrë nga turqit, të cilët ishin zotër të kësaj zone dhe vetë venecianët, tepër të kujdesshëm, nuk do të guxonin ta bënin këtë. Përveç kësaj vetë arkitektura nuk ka asgjë të përbashkët me ndërtimet e tjera veneciane dhe së fundi mungon baza dokumentare, kur dihet se venecianët dhe një meremetim të thjeshtë e pasqyronin me një sërë dokumentash.
46) **A.Alb,** II, 14.
47) **A.Alb,** II, 31, Për tregun e grurit studimi më i plotë është ai i B. Hrabakut **Eksportimi i drithit nga Shqipëria në shek.** XIX-XV, «Konferenca e II e Studimeve Albanologjike» , 1969.
48) A. Ducellier, **Vep. cit,** f. 583, v. 17, III, 21, IV, 1360, 23 IX, 1363, 1. III 1364. 25.IV.1366, 28.I.1367, 6.XI.1369, 10.XII.1369.
49) **A.Alb,** II. 31.
50) A. Ducellier, **Vep. cit,** f. 578..
51) **A.Alb,** 2, 207, (1.III.1364), 2, 224c (28.I.1367)
52) H. Arhweiler, **Byzance et la mer,** Paris, 1966, f. 52. 125., mendon se këtu ka pasur një kantier ndërtimi anijesh që ushqehej me drurët e Myzeqesë.

DO NOT COPY

netës, e cila duket se dhe në mesjetë ka qenë një gji detar, të cilit iu zu gradualisht gryka dhe u mbush me llum, gjendet fshati Karavasta. Këtë emër e njohim që në vitin 1297, kur njerëzit e Matarangës të Karavastasë (homines Matarangi de Caravastasi) sulmojnë dhe grabisin një anije që kishte ndaluar në të.[53] Fshati Karavasta përmendet dhe në regjistrin e v. 1431 si fshatskelë me 22 shtëpi, ku taksa e skelës ishte rreth 7400 aspra[54]. Së fundi, një lumë me emrin Chrevasta e gjejmë si remineshencë dhe në hartën e Martelit, të vitit 1788[55]. Me sa kuptohet, këneta e Karavastasë në këta shekuj ishte e lundrueshme dhe shërbente si vendqëndrim anijesh dhe ndoshta si vend për ndërtimin e anijeve.

Semani gjendet 6-7 km më në jug të lagunës së Karavastasë. Por që nga vendi ku Osumi bashkohet me Devollin për të dhënë Semanin, shihet një shtrat tjetër, lumi i Dellit, i cili vazhdon në vijë të drejtë përmes fshatit Karavasta dhe derdhet në lagunën e Karavastasë. Por se kur ka ndodhur ky kalim, nuk mund të thuhet me siguri.

Vetë Semani, i cili në antikitet quhej Aps, në mesjetë mban emrin Devoll (Diaboli, Devol, Djavol, flumen Daemonis, Dievalo). Emërtimi i tij dhe lumi i Pirgut e përcakton qartë grykën e derdhjes[56]. Këtë emër ai e mori nga një kullë e fuqishme (gr. πύργομ), themelet e së cilës ruhen në derdhje të lumit.[57] Kulla përmendet së pari në vitin 1388[58]. Në këtë vend, i cili në vitet 1297-1374 ishte nën Matarangët e më tej, deri në vitin 1417, kryesisht nën Muzakët, shohim të lindë e të zhvillohet një treg me të vërtetë i gjallë për shitjen e drithit.[59] Kjo ndodhi mbasi Devolli paraqiste boshtin ekonomik të Myzeqesë, Artikujt e importuar, kryesisht artikuj luksi, verë d cohëra[60], tregojnë se kjo skelë shërbente pikëri për këmbimin e tepricës së rentës feudale me sen luksi për feudalët. Kjo është dhe arsyeja e grindje mes tyre. Synimi i zonjës së Vlorës për ta shtënë dorë Pirgun tregon gjithaq shqetësimin që i si ky treg tregut të Vlorës.[61]

Spinarica (Sfinarsa, Sfinarita, Spinariça, Spir za) ndonëse ka pasur një jetë veçanërisht të gjo dhe një rol të rëndësishëm, s'është identifikuar p fundimisht. Mendimet më të shumta janë se gjendej në grykën e Vjosës, madje brenda në la nën e Nartës.[62]

Fillimisht Spinarica përmendet në v. 1205 «partitio-n» e Perandorisë Bizantine, si pjesë që i pet Venedikut bashkë me Glavenicën e Vlorën Po kështu, ajo është pjesë e prikës së Manfred h henshtaufenit në vitin 1258[64]. Në gusht të vitit 1 një anije e Brindisit sulmohet «midis Spinaricës Kepit të Kavalionit» në afërsi të Vjosës.[65] Në lu met midis bizantinëve e anzhuinëve shohim se S narica dhe Berati janë nën bizantinët nën koman e një «kapiteni» (qefalie»)[66], ndërsa Vlorën e k anzhuinët. Por para 10 majit 1279; para fillimit sulmit kundër Beratit, anzhuinët sulmojnë dhe r rrin Spinaricën,. Së fundi, një anije raguziane e njës që udhëton nga Raguza në Vlorë ndalon pa prakisht në Spiranicë. Të tëra këto të dhëna trego se Spinarica ndodhej disa dhjetëra kilometra l Vlorës. Në dokumentet bizantine të v. 1297-98 p menden udhëtimet nga Durrësi në La Polina, në g kën e Spinaricës (foca Spinarica). Nga ana tj Manfredi e quante veten zot të Durrësit, Belgradit,

53) **A.Alb,** I, 528, 19, IX, 1297.
54) H. Inalçik, **Sureti Defter-i sancak-i Arvanid hicri 835 tarihli,** Ankara, 1954, 10 b.
55) F. Nopçsa, **Zur Geschichte der Kartographie Nordalbaniens** «Mitteilungen der K.K. Geogr. Gesellschaft» Bd. 59. Heft/8-9, Wien, 1916.
56) K. Jireçek, **Valona in Mittelalter,** «Illyrisch-Albanische Forsehungen», Munchen-Lepizig, I. 1916, f. 170.
57) N. Ceka; **Pirgu i Myzeqesë,** «Monumentet historike në vendin tonë», 1978, f. 68-71.
58) K. Jireçek, **Spomenici...,** I, 11, 14, 17, v. 1888, II. 453. v. 1389.
59) A. Ducellier, **Vep. cit,** f. 391, 19 Tetor 1342 blerje në tregun e Devollit, 25 gusht, 30 shtator 1343, dhe 27 shkurt 1344, krijohet në Raguzë një kolegancë për blerje drithi në Devoll 5-24 mars 1347, blerje drithi nga Komuna, (**A.Alb,** II 31). Për vitet e mëtejshëm A. Ducellier, vep. cit, f. 583) 30.X.1348. 30.IX,1350, 20,XIII,1351. 10.V.1354 11.VII.7.XI.1355, 17.II.15.III.1356, 27.IX.1363, 27,IV,1365 25.IX.1366, 28.I.1367.
60) K Jireçek, **Valona...,** F. 170.
61) Në 30 gusht 1390 Komita, zonja e Vlorës, zë rob Nikolla Muzakën, të cilin pranon ta lirojë vetëm mbas lirimit të kullës së Pirgut (**A.Alb,** 453).
62) C. Jireçek, **Valona...,** f. 174. A. Ducellier, **Vep. cit,** f. 36.
63) **A.Alb,** I. 130.
64) **A.Alb,** I, 245. II,. 1258.
65) Cavo de Caurioni del në hartat e Ortelit dhe Merkatorit para Vlorës e pas Spinaricës F. Nopsca, **Vep. cit,** Sipas K. Jireçekut, **Valona...,** f. 175) Aosi quhej Kaurioni.
66) **A.Alb.** I, 368.

DO-NOT COPY

lonës dhe Kodrave të Spinaricës (Σφηγαριτων Λόφων). Këtyre të dhënave mendojmë se i përgjigjet territori i Apolonisë, prania e jetës në të cilën, të paktën në gjysmën e I të shek. XII dëshmohet nga kisha dhe manastiri i Shën Mërisë.[67] Portreti i Andronikut II (1282-1328) që e rindërtoi atë, tregon tërthorazi për rëndësinë e kësaj qendre.

Deri në gjysmën e dytë të shek. XIV tregu i grurit të Spinaricës është më i lulëzuari i Shqipërisë së Jugut. Eksporti i grurit, që nis në janar të v.1276[68], vazhdon deri në v. 1345[69]. Gjallërinë e këtij tregu e dëshmon dhe prania në të e tregtarëve të huaj venecianë dhe raguzianë që në vitet 1297[70], të cilët më tej i shohim dhe të organizuar në koloni. Kështu kolonia raguziane dëshmohet në 13 shtator 1301 dhe 16 prill 1301 e organizuar dhe me zyrë konsultore[71], ndërsa në 26 maj 1335 dëshmohet dhe kolonia veneciane.[72]. Në këtë kohë shohim se Spinarica kthehet në një qendër me banorë të sajtë. Kështu në 1326 dhe 1328 përmendet në Raguzë i biri i Nikollës së Spinaricës dhe Maria, bija e Mihalit të Spinaricës. Por në v. 1431-32 Spinaricën e shohim thuajse të braktisur.[73]

DO NOT COPY

67) A. Meksi, **Arkitektura dhe datimi i kishës së manastirit të Apolonisë,** Monumentet 1, 1981, f.
68) Tafel-Thomas, **vep. cit,** III 182, 29 maj 1277. **Po aty.**
69) 16 prill 1302, korrik 1312, 5 dhjetor 1313, 6 korrik 1335, 15 mars 1344, 23 shkurt 1345, (**A.Alb,** I, 794, II, 2, 13, A. Ducellier, **Vep. cit,** f. 394, 363).
70) **A.Alb,** I. 529.
71) **A.Alb,** I. 540.
72) **A.Ib,** I. 793.
73) H. Inalçik, **Vep. cit,** 167, fshati Isfenarice fil-asl 3 hali.

APOLLON BAÇE
AVENIR ALEKSI

DO NOT COPY

LES QUAIS DES EMBOUCHURES DE L'ADRIATIQUE AU COURS DU MOYEN AGE

La côte orientale de l'Adriatique, ne présente pas le même caractère morphologique. Au Nord, d'Istria jusqu'à Ulqin, les hautes montagnes abruptes arrivent jusqu'à la mer. Cette barrière montagneuse est difficilement parcourue par des voies qui à l'intérieur se heurtent à d'autres montagnes. A cause de ce terrain accidenté, le contact du pays avec la mer, par les quais qui sont difficilement liés avec les routes, est moindre. Au contraire, dans la partie méridionale, d'Ulqin à Kep i Gjuhës (cap de la Langue) on rencontre une zone sédimentaire suivie d'une des plus grandes plaines des Balkans, le Bassin Occidental. La plaine est parcourue d'Est en Ouest par une série de fleuves dont les vallées favorisent le passage à l'intérieur de la péninsule. Dans cette région, le contact quai-route était bien réalisé par les quais des villes (Ulqin, Durrës, Vlora). Mais une série de petits quais à l'embouchure des fleuves assuraient mieux la communication entre l'arrière-pays et le monde extérieur. Ces qui connurent un élan particulier au XIVe sc avec l'affermissement de l'économie féodale, en réalisant l'exportation directe des surplus des rentes féodales, sans se soumettre au contrôle et aux impôts des quais des villes qui dépendaient des autres institutions d'état ou des autres féodaux. Tels sont les quais des courants de Mat, Ishëm, Shkumbin, Seman. Aux quais des courants de Vjosa, Buna et Drini contrôlés respectivement par Shkodra, Ulqin, et Lezha, on attribue un rôle quelque peu différent.

A l'heure actuelle, à part le fleuve de Buna, où peuvent naviguer des navires jusqu'à 100 ton, les autres rivières ne sont pas navigables. Mais pendant l'Antiquité et le Moyen Age, avant l'occupation turque, leurs courants étaient naviguables en aval. Ainsi, avant notre ère, à Lis et Apollonie, respectivement à Drin et Aos (Vjosë) s'étaient installées les flottes militaires. Anne Comnène nous fait savoir qu'à XIe sc. le fleuve de Drin était naviguable. Cela est témoigné aussi par les documents qui montrent qu'en 1377, les petits navires passaient au delà de Danjë et en 1474 à Shirgj s'était installé la flotte vénétienne pour la défense de Shkodra. Par Pohymeres nous apprenons qu'en 1281, Osum était navigable près de Berat, tandis qu'un autre passage écrit par Anne Comnène nous indique que Vjosa était navigable jusque près de Bylis, où les normans avait créé une base de leur flotte. Mais la coupe massive des forêts, assez accélérée à la deuxième moitié du XIVe sc et surtout à la période de l'occupation ottomane, appo un grand dépôt du matériel solide, qui s'ammassait aux est res et qui ne pouvaient pas être éléminés par la faibles mar Ainsi en 1521 dans le «Bahriye», le livre des naviguants, Piri Reis on lit que «...à «Biusa» (Vjosa) il y a des bate qui entrent mais leur passage devient parfois difficile à ca du sable amené par la mer. D'ici jusqu'à Durrës il y a d'au rivières mais la profondeur de leur embouchure est superfici et pas conséquent elles ne sont pas naviguables...» Ceci que la profondeur des rivières diminua au fur et à mes leur lit devient beaucoup plus large et par conséquent on a la création croissante des marécages. Un autre facteur nég qui y influa, fut l'enfoncement de la côte littorale à une vite de 1-1,5 mm par an. Ce processus, contrairement à ce qu'ad la littérature actuelle géographique et historique, est netten prouvé par les ruines des constructions et des monuments. Ai au cap de Rodon, se trouve submergé, à part la fortifica illyrienne une partie de la fortification de Skënderbeg. A l' bouchure du courant d'Ishmi on remarque que le quai des nées 20 de notre siècles se trouve un mètre au dessous de surface de l'eau de la mer, persque 100 m loin de la côte Durrës, quelques habitations de la fin du XIXe sc. se trouv 1,5-2 m au dessous de la surface de l'eau de la mer, d le territoire de l'ancienne marée. A Treport, dans le territ de l'Aulone antique, il y a une construction monumentale -2,5 m au dessous du niveau de la mer. Enfin, la partie i rieure de la carrière antique de Karaburun se trouve envi 1 m au dessous du niveau de la mer.

Les quais des fleuves de Buna et de Drini sont d'un sy me plus compliqué. Drini, le plus long et le plus alimenté fleuves de l'Albanie trace l'importante route qui mène à zren et plus loin, à Danube, la route de Zentë. Tel quel est le premier fleuve qui se rencontre à la cartographie méd vale, en 820. Aux environs de Danjë (Vau i Dejës) le fle se ramifie en deux: la partie la plus alimentée se rattache Buna, l'autre continue jusqu'à Lezhë. D'après les docume ce panorama demeure pendant tout le Moyen Age avant l' cupation turque. La rencontre des deux fleuves apporta le m lange de leurs noms aussi. Le quai de Shirgj du fleuve Buna, est mentionné depuis le mois de mars 1283 par le n «portus sancti Sergii de Drino», qu'il conserve dans tous

documents. L'autre quai de Buna, celui de Saint Nicolas, apparait par le nom «San Nicolo de Drino». La branche de Drin à Lezhë le 7 janvier 1388 est mentionnée par le nom «flumen Lesii». Il parait que ce document rend claire tout: que Drin s'appelait le fleuve de Lezhë, et Buna, s'appelait Drin. Mais par un autre document du 14 mars 1335 on apprend que le sel provenant de Durrës coûte plus cher dans le marché de Bune que dans le marché de Drin et de Mat, tandis que Saint Nicolas est mentionné comme «l'abbaye de Saint Nicolas à l'embouchure de Buna». Donc, il est assez difficile d'établir une nette diférenciation entre les quais de ces deux fleuves. Indépendamment de leur point de départ, les deux routes convergent à Danjë.

Le premier quai 'de Buna' se trouvait à l'abbaye de Saint Nicolas (San Nicolo de Drino, ou Oldrino, abacia di San Nicola de la foza de la Boiana), un vieux monastère bénédictin de l'archevêché d'Ulqin, qui se situe près de l'estuaire de Buna, a Ulqin. L'autre quai, celui de Saint Georges, se trouve 28 km en amont du fleuve, directement sur sa rive, environ 10 km loin de Shkodra. D'apres une inscription, l'eglise du monastere, aux dimensions considerables et à une architecture bien traitee, date du 1290. Mais le fait que le port est mentionné en 1280 et le monastère le 21 mars 1283, affirme qu'avant cette église il y a eu une autre, ce qui approuve les données du presbitere de Diokle, d'apres lequel on y trouve les tombes des rois de Diokle des XI-XIIe sc. Cela se rattache bien au nom des martyres militaires, Serge et Bok, auxquels l'eglise etait dediee, et dont l'honneur atteignit son apogée au VIe sc. De pair au monastère et au quai dans cet endroit se trouvaient un magasin de sel et la douane. En 1335 on y mentionne le chatelain (castellanus sancti Sergii) en juillet 1423 le chateau avec des murs en pisé (bastita a latere S. Sergii). Ainsi le quai de Shirgj jouait le rôle d'un quai fortifié fluvial où était installée la flotte. En 1422, 1423 et pendant le premier siege de Shkodra, à Shirgj restaient les galeres de la flotte venetienne. A part les nombreux documents des transactions commerciales, le rôle commercial de ce quai est attesté aussi par la foire qui s'y tenait chaque 27 septembre.

La vente du bois, le principal produit d'exportation de ces deux quais, est mentionnée en mars 1283. Par un autre document du 11 janvier 1325 on en comprend que ce materiel était exporté sous la forme des planches et des poutres (dogne, trabes), tandis que par un autre document du 4 fevrier de la meme année l'on apprend qu'une bonne partie du bois était coupée dans les forêts aux alentours. Il y est aussi mentionné que les bûcherons étaient payés par l'abbé du monastère de Saint Nicolas. En fin par un contrat du mois de mai 1379 on comprend que l'on avait à faire avec du bois de pin présenté nous forme de planches de longueur 5,8 et 14 pas, adaptées principalement pour la construction des bateaux.

L'autre quai de ce système se situe à Lezhe, au pied de la ville fortifiée qui pendant l'Antiquité s'étendait du sommet de la colline, le long de tout son flanc, jusqu'au bord du fleuve. Notamment la rive de ce fleuve formait le mur latéral du quai. Les premières données sur ce quait sont de César qui nous fait savoir «qu'il partit lui-même pour Lis, où il attaqua les 30 navires de transport, installées par M. Antoni à l'intérieur du quai». Ce voisinage de la ville au quai explique aussi le fait que malgré les retrécissements de la ville pendant le Moyen-Age, la ville inférieure fortifiée, ne fut jamais abandonnée, elle coexista de pair à la ville supérieure, la forteresse. C'est en 1331 qu'on mentionne pour la première fois le marché de Lezha, mais en comparaison avec les quais de Buna, par lequel les navires pouvaient passer facilement au lac de Shkodra ou Danjë, le quai de Lezhë est rarement mentionné. En réalité, un peu plus en amont le fleuve, n'était plus navigable, même pour les navires d'un tonnage moyen, et à cet endroit commence la voie terrestre. C'est par là qu'on transportait les lourdes marchandises, infavorables au transport fluvial. Ainsi, en 1421, 5 tonnes de marchandises, partent pour «Sklavoni» à partir du quai de Lezhë. D'autre part, il parait que c'est la route la plus préférée pour le transport de l'argent des mines de Kosova, ce qui se voit par les discordances entre les ragusiens et les vénétiens en 1428-33 et la séquestration de ce métal, par ceux derniers.

La rivière de Mat se jette 10 km au sud de l'estuaire de Drin. Dans un document de 1335 on le recontre sous le nom «Folliolati». L'existence du quai est affirmé dès l'année 1323, quand les habitants de Raguse attendent Uroshe III, à Ulqin ou à Mat, (à la Mate). Enfin, on retrouve Mat dans une lettre des «Balshaj» de 1375, adressées aux habitants de Raguse «à la rive de Mat». Cela fait preuve de leur marché dans cet endroit.

Dans un document de Venise, du 26 septembre 1393, on écrit que le Capitaine de Durrës doit prendre des mesures pour que le commerce du sel ne soit pas déplacé de Lezhë à Shufada (suffada), un endroit loin de 8 milles. A une telle distance (12, 87 km) se trouve l'embouchure d'Ishmi, 13,5 km loin de l'embouchure de Drin. Par conséquent, par le quai de Shufada, on doit comprendre le quai de l'embouchure d'Ishmi, lequel communique bien avec Kruje, Mat, et toute la zone de Tirana. Si l'on accepte l'unification de Shufada avec Ishëm, son quai est mentionné pour la permière fois le 3 octobre 1320, quand on met l'accent sur la présence des commerçants de Raguse. Vers l'année 1359, c'est Karl Topia qui domine cette région. Il parait qu'à cette époque, Ishmi, riche en bois, se convertit en un chantier naval où l'on construit de différents types de navires armées (galea et ligna ...navigia armata in mari). Appuyé sur cette flotte, Karl Topia, qui fut aidé également par la puissante flotte de Venise, en 1363 assiègea par terre et par mer la ville de Durrës (per terran e per marem). D'après un document de 29 mars 1368, Karl Topia prit la ville de Durrës «par son oeuvre maritime», tandis qu'en 1373 il la reprit en stationnant ses navires à Rodon et au Cap de Fal. La mention d'Ishëm dans une série de transactions pendant les années 1371, 1377, 1379, 1380, 1381 et surtout en septembre-octobre 1415 où l'on parle du douanier, montre que Sufada-

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Ishmi, connut une activité commerciale, bien que locale, dans l'achat du sel et la vente des céréales (1377, 1379) et du bois (1379-1380).

La rivière d'Erzen qui suit celui d'Ishmi, n'est pas mentionnée dans les documents contemporains par le simple fait qu'elle ne connut pas de quai, ou de marché parce qu'elle passe dans la zone de Durrës en formant la voie naturelle reliant cette ville à la plaine de Tirana. La rivière de Shkumbin est une autre rivière dont le quai et le marché apparaissent assez souvent dans les documents médiévaux.

Pendant l'Antiquité elle est connue par le nom Genus tandis qu'au Moyen Age par le nom Breg (Vreg) et quelquefois Shkumbin. Ainsi dans un document de 1210 on trouve «la rivière vrecus, dans le duché de Durrës». On le trouve telle quelle dans les cartes d'Ortel et de Merkator. (1598 et 1584). A cette époque, en 1570, on la mentionne par le nom Shkumbin Scumbiano). Premièrement le marché de Breg fut mentionné le 20 avril 1345 comme un lieu de vente de bois. Plus tard, depuis le 24 mars 1347, il est mentionné en tant que centre de la vente du blé.

La lacune de Karavasta se situe au sud de l'embouchure de Shkumbin. Au sud de la marée, qui, parait-il au Moyen Age fut une baie dont la gorge peu à peu fut fermée et remplie de boue, se trouve le village de Karavasta. On connaît ce nom depuis 1297, quand les gens de Matarange de Karavasta (homines Matarangi de Caravastasi) attaquèrent et pillèrent un navire qui y était installé. Le village de Karavasta figure aussi dans le régistre de 1431 comme un village-quai avec 22 habitations où l'impôt du quai attegnait environ 7 400 aspres. Enfin, une rivière avec le nom Chrevasta, se trouve comme réminiscence dans la carte de Marten, de l'année 1788. Il parait qu'au cours de ces siècles, la marée de Karavasta était naviguable et jouait le rôle d'un quai, peut-être on y construisait aussi des navires.

La rivière de Seman se trouve 6-7 km au sud de la lacune de Karavasta. Mais, dès l'endroit où Osum se joint au Devoll pour former Seman, on aperçoit le lit d'une autre rivière celle de Delli, laquelle en ligne droite traverse le village Karavasta et se jette dans la lacune de Karavasta. Mais quand ce passage et lieu? On n'en peut rien préciser.

La rivière de Seman, qui pendant l'antiquité était appelée Aps, au Moyen Age portait le nom Devoll (Diaboli, Devol, Djavol, flumen Dalmonis, Diavolo). Sa nommination et a rivière de Pirg précisent bien son embouchure. Elle prit ce nom par une puissante tour dont les fondations se conservent à l'embouchure de la rivière. Pour la première fois cette tour est mentionnée en 1388. En cet endroit on voit naître et se développer un marché pour la vente des céréales parce qu'à cette époque-là Devoll représentait le noyau économique de Myzeqe. Les articles importés, le vin, les tissus, montrent que ce quai servait notamment à l'échange du surplus de la rente féodale avec des objets de luxe pour les féodaux. C'est là, la cause de leur querelles. Le but de la Dame de Vlora pour mettre la main sur Pirg montre aussi le souci que ce marché causait à celui de Vlora.

Spinarice, (sfinarsa, Sfinarita, Spinariça, Spiranza) malgré sa vie bien animée et son rôle important, n'est pas identifié définitivement. Nombreux sont ceux qui pensent qu'elle se situait à l'embrouchure de Vjosa, à l'intérieur de la lacune de Narte.

Taut d'abord on la mentionne en 1205 dans «la partition» de l'empire byzantin en tant que territoire donné à Venise, de pair au territoire de Vlora et Glavenice. De même, elle fait partie à la dotation de Monfred Hohenshtanfen, en 1258. En août 1270, un navire de Brindés fut attaqué «entre Spinarice et le cap de Kavalion» près de Vjose. Par les combats entre les byzantins et les angevins on apprend que Spinarice et Berat sont sous l'influence de Byzance, sous la commande d'un «capitaine», tandis que Vlora sous l'influence des angevins. Mais avant le 10 mai 1279, avant l'attaque contre Berat, les angevins prirent Spinarice. Enfin, un navire de Raguse, de l'itinéraire Raguse-Vlore, s'arrête d'abord à Spinarice. Toutes ces donées affirment que Spinarice se situait quelques dizaines de km loin de Vlora. Dans les documents byzantins de 1279-98 on mentionne les voyages de Durrës à la Polina dans l'embouchure de Spinarice. (foca Spinariça). D'autre part, Manfred se considérait maître de Durrës, Belgrad, Aulone et des collines de Spinarice. Nous pensons que ces données correspondent au territoire d'Apollonia, dont l'existence de la vie, au moins pendant la première moitié du XIIe sc. est témoignée par l'église et le monastère de Sainte-Marie. Le portrait d'Andronik II, qui la reconstruisit, prouve indirectement d'importance de ce centre.

Jusqu'à la deuxième moitié du XIVe sc. le marché de la vente du blé de Spinarice demeure de meilleur de l'Albanie du Sud. L'exportation du blé qui commence en janvier 1276 continue jusqu'en 1345. Plus tard, c'est le marché de Devol qui substitue celui de Spinarice. Cela affirme que le marché de Spinarice était fourni par Myzeqe et se situait plus au nord qu'on le croyait. L'activité de ce marché est affirmé aussi par la présence des commerçants étrangers de Venise et Raguse, qui en 1297 sont organisés en colonies. Ainsi la colonie de Raguse en 13 septembre 1301 et 16 avril 1301, figur organisée, ayant un bureau, tandis que celle de Venise e 26 mai 1335.

A cette époque on remarque que Spinarice se convertit e un centre avec ses propres habitants, et vise devenir une vill Ainsi en 1326 et 1328 on parle à Raguse du fils de Nikol de Spinarice et de Marie, fille de Michel de Spinarice. Ma pendant les années 1431-32 Spinarice se trouve presque aban donnée. D'après ces données, Spinarice a dû se trouver quelqu part près d'Apollonie.

Nr. 1 1986

monumentet

DO NOT COPY

GJERGJ FRASHËRI

KONSERVIME ARKEOLOGJIKE NË KALANË E KRUJËS[1]

Ndonëse arkeologjia ka pasur njëfarë veprimtarie edhe më parë, mbrojtja shkencore e monumenteve të kulturës në Shqipëri nisi dhe u zhvillua vetëm pas Çlirimit të vendit, pa pasur asnjë traditë teorike e praktike në këtë fushë. Si rrjedhim, këtu konservimi arkeologjik, si një nga çështjet më të mprehta të mbrojtjes aktive të monumenteve, ka një moshë akoma më të re, afërsisht tri dekada. Megjithëkëtë, në saje të kushteve të favorshme të krijuara nga shteti për mbrojtjen, ruajtjen dhe paraqitjen në tërësi të monumenteve të kulturës, edhe arritjet në konservimin e mjediseve dhe të objekteve arkeologjike janë sot të dukshme.

Në krahasim me territorin e saj të vogël, Shqipëria ruan një numër të konsiderueshëm mjedisesh arkeologjike nga të gjitha periudhat historike, pjesa dërrmuese e të cilave është ende e pagërmuar. E drejta për të shpallur një mjedis arkeologjik në Shqipëri dhe për të kryer mbi të zbulime e konservime arkeologjike, i takon vetëm shtetit. Vetë shteti, këtë të drejtë e ushtron me anën e personelit tekniko-shkencor të specializuar në fushat e historisë, arkeologjisë, arkitekturës, artit, inxhinierisë dhe në disiplinat e tjera ndihmëse. Nga pikëpamja organizative kjo punë udhëhiqet nga bashkëpunimi i dy institucioneve kërkimore-shkencore me qendër në Tiranë — nga Qëndra e Kërkimeve Arkeologjike (QKA) nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK) së bashku me qendrat që varen prej tyre në rajone të ndryshme të vendit. Në veprimtarinë e tyre të konservimit arkeologjik, specialistët shqiptarë kanë pasur parasysh edhe përvojën teorike dhe praktike të specialistëve të ICCROM-it dhe të vendeve më të përparuara në këtë disiplinë tekniko-shkencore. Midis tyre si pikëmbështetje në këtë veprimtari ka shërbyer sidomos Rekomandimi i Unescos i vitit 1956. Puna intensive e kryer gjatë tri dekadave të fundit për zbulimin dhe konservimin e mjediseve arkeologjike, si në Buthroton, Apollonia, Lissus, Epidamnus, Antipatrea, Scodra, Antigonea, Nikea, Bylis, Amantia, Dimalum etj. ka grumbulluar tashmë një eksperiencë mjaft të pasur vëndase. Kjo eksperiencë teorike e praktike e konservimit arkeologjik është pa dyshim në përshtatje me nivelin shkencor të vendit dhe me interesat intelektuale të shoqërisë. Një nga rastet tipike të eksperiencës shqiptare në fushën e konservimit arkeologjik përbën, midis të tjerave, praktika e zbatuar në Kalanë mesjetare të Krujës.

* *
*

Kruja, rreth 30 km në veri të Tiranës, është një ndër katër qytetet mesjetare të Shqipërisë që janë shpallur qytete-muze, për hir të vlerave të tyre historike, urbanistike, arkitektonike, artistike dhe inxhinierike. Kalaja e saj është e ngritur mbi një kreshtë shkëmbore natyrore, që dominon tërë qytetin e sotëm. Qendër epishkopale qysh në shek. IX, Kruja u bë në shek. XII kryeqyteti i Principatës së Arbrit, formacionit të parë shtetëror mesjetar shqiptar. Shkëlqimin e saj politik ajo e pati në shek. XV kur

1) Këtë kumtesë autori e ka paraqitur në Konferencën Ndërkombëtare mbi «Masat preventive gjatë gërmimit dhe mbrojtja e qendrave arkeologjike», mbajtur më 6 deri 13 nëntor 1985 në qytetin Ghent të Belgjikës, organizuar nga Qendra Ndërkombëtare e Konservimeve dhe e Restaurimeve të Monumenteve në Romë në bashkëveprim me Universitetin e Ghentit.

u bë kryeqyteti i shtetit shqiptar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, udhëheqësit legjendar të luftës epike çlirimtare që zhvilluan shqiptarët kundër ushtrive të Perandorisë Otomane. Por këtë shkëlqim kalaja e pagoi me rrënimet e mëdha që pësoi disa herë gjatë ndeshjeve luftarake të mesjetës, e sidomos me rrënimin e saj të plotë më 1478, kur ra përfundimisht në duart e sulltan Mehmetit II. Prej asaj kohe qyteti i fortifikuar i Krujës i humbi dëshmitë materiale të qytetërimit të saj mesjetar. Koha që pasoi i mbuloi mbetjet e tyre me veshjen e zakonshme që krijojnë shekujt. Me përjashtim të strukturave ndërtimore të hyrjes, të donzhonit dhe të disa fragmenteve muresh rrethuese, asgjë tjetër nuk dukej mbi sipërfaqen e kësaj veshjeje historike, të përbërë nga dheu e pjesërisht nga ndërtesat e dy shekujve të fundit. Përveç kësaj pamjeje të varfër të mbetjeve mesjetare mbi sipërfaqen prej 4 ha të kalasë, jeta e qytetit mesjetar të Krujës trashëgoi një varfëri akoma më të madhe burimesh të shkruara historike. Të nisur nga kjo gjëndje dokumentare, mjaft studiues kanë menduar se luftërat e shumta nuk kanë lënë më në Kalanë e Krujës gjurmë nga kultura e saj mesjetare. Midis tyre, bile, studimtari austriak medievist Th. Ipen, i cili e vizitoi kalanë më 1907, ka shkruar se historia e Kalasë së Krujës do të mbetet kurdoherë e errët dhe nuk do të sqarohet kurrë duke lënë të kuptohet se një gjëndje të tillë nuk mund ta ndryshonin as ndërhyrjet e arkeologut. Megjithëkëtë, Kalaja e Krujës qe ndër të parat mjedise arkeologjike që u vu në mbrojtje shtetërore dhe iu nënshtrua menjëherë kujdesit të konservimit arkeologjik.

1. Te ne praktika në terren ka vërtetuar se mjediset arkeologjike në çfarëdo gjendje që të jenë, të zbuluara apo të mbuluara me veshjen historike të shekujve, posa të diktohet vlera e tyre, domethënë posa të deklarohen në mbrojtje, duhet të konservohen. Edhe kur nevoja e mundësia për gërmime arkeologjike në një mjedis është ende larg, ndërhyrja konservuese në të ka vend për të vepruar. Në këtë etapë mjedisi mbrohet nga gërryerja e përrenjve ujorë që formohen spontanisht në sezone rreshjesh, nga prezenca e bimësisë me rrënjë të mëdha e të thella, nga mekanizmat e rëndë shtypëse që mund të lëvizin mbi sipërfaqen e tij, nga shkarjet e tokës e nga shumë shkaqe të tjera. Derisa gërmimi arkeologjik i mjedisit të bëhet fakt i kryer, e gjithë shtresa e veshjes historike, e cila funksionon si mbrojtje natyrore e lëndës arkeologjike në nëntokë, mbahet në konservim. Në këto kushte, konservimi i mjedisit arkeologjik nënkupton pikërisht konservimin e «veshjes historike» të tij. Pra, të deklaruarit në mbrojtje e një mjedisi shënon fillimin e konservimit të tij. Nga ky moment konservimi bëhet



Fig. 1. – Blloku shkëmbor në cepin VL të kalasë.

një proçes i pandërprerë, i lidhur ngushtë me el zistencën e vlerave të mjedisit. Në të gjitha rast kujdesi për konservimin e mjediseve arkeologjik i besohet që në fillim IMK.

Për më se tre dhjetëvjeçarë Kalaja e Krujës mbajt nën kontrollin dhe masat e konservimit të v shjes historike të saj. Konsolidimi i vazhdueshëm atyre pak muraturave të panjohura, që dilnin m sipërfaqe, ndalimi i marrjes së gurëve në shtresën veshjes historike, moslejimi i instalimeve në nënto dhe i ndërtimeve të reja brenda saj, ndalimi i pë dorimit të sipërfaqes si tokë për mbjellje, çlirimi n ndonjë ndërtesë e vonë e rastit, prerja e disa p mëve të mëdha pranë mureve rrethuese dhe past mi i vazhdueshëm i tyre nga shkurret sezona qenë disa nga masat preventive, të cilat lidhesh me ruajtjen e lëndës arkeologjike ende të pazbulu

Problem me rëndësi që u trajtua në këtë eta të hershme të konservimit ishte studimi për që drueshmërinë e masivit shkëmbor mbi të cilin ësh ngritur mjedisi i Krujës. Mjafton t'i hedhësh një anës veriore e lindore dhe kuptohet se masivi shk mbor që mban mjedisin, i përbërë nga formaci gëlqeror, është në proçesin e dekompozimit të shp tuar natyror. Përveç blloqeve të mëdha të shkëp

DO NOT COPY

DOKUMENT

tura me kohë nga masivi shkëmbor, akoma shumë fraktura të thella e në drejtime të ndryshme tregojnë për shkëputje eventuale të tjera copash të konsiderueshme të tij. Prej tyre, si më i avancuar, ishte ai në cepin VL të kalasë (me një vëllim prej afër 3 000 m³), lëvizja e të cilit do t'i shkaktonte dëme serioze mjedisit (fig. 1). Për stabilizimin e lëvizjes së tij u shqyrtuan disa ide. Në fillim u bënë përpjekje për betonime lidhëse të tij me brendësinë e masivit, por, për shkak të dekompozimeve që tregonte shkëmbi në thellësi, kjo lidhje u gjykua më dëmprurëse. Ndërhyrja më e sigurt e më praktike u konsiderua shfrytëzimi i dherave që do të dilnin kur të fillonin gërmimet në akropolin e kalasë. Kështu edhe u veprua. Rreth 800 m³ dhe iu ngjeshën në formë skarpati bazamentit të bllokut shkëmbor në anën e rëndesës së tij (fig. 2).

2. Vlera e madhe historike e Kalasë së Krujës nga njëra anë dhe varfëria po aq e madhe e dëshmive dokumendare të saj nga ana tjetër, diktuan nevojën imediate të gërmimeve arkeologjike të mjedisit. Proçesi i zbulimit arkeologjik konsiderohet si operacioni i lindjes së mjedisit, i të sjellit të tij në jetën kulturore të shoqërisë. Dihet se ky është momenti më kritik i mbrojtjes aktive të tij, prandaj ai pa dyshim që kryhet nëpërmjet një etape përgatitore. IMK nuk lejon asnjë tentativë për zbulime arkeologjike nga ana e QKA, pa kryer më parë për këtë qëllim studimin arkeologjiko-konservues të mjedisit dhe pa përgatitur mjetet e domosdoshme për kurimin profilaktik të materialit arkeologjik që mund të shfaqet gjatë gërmimit. Nga ky çast mjedisi merret në studim prej një grupi specialistësh, në themel të të cilit qëndron bashkëpunimi i ngushtë i arkeologut me konservuesin. Puna e tyre në këtë etapë të konservimit synon në hartimin e hartografisë arkeologjiko-konservuese të krejt hapësirës së mjedisit dhe të programit të gërmimeve. Hartografia përmban në njërën anë të dhënat arkeologjike të siguruara nga burimet e shkruara historike dhe nga sondazhet e kryera në terren, kurse në anën tjetër të dhënat konservuese për llojin dhe gjendjen e lëndës arkeologjike, për topografinë e përafërt të truallit bazë të mjedisit, për karakteristikat e klimës, të lagështisë relative, të periudhës së ngricave, të vërshimit të ujërave, të drejtimit të erërave, të frekuencave të saj, për karakteristikat e materialeve ndërtimore tradicionale që vazhdojnë të përdoren akoma në zonën e banuar përreth mjedisit etj. Programi përmban zonat e zgjedhura arkeologjike-konservuese që do të preken nga hartografia e mjedisit, strategjinë e fillimit të gërmimeve të tyre, sjelljen në mjedis të mjeteve të domosdoshme të konservimit dhe fondet dypalëshe.



Fig. 2. – Gjatë mbushjes me dhé të bazamentit të bllokut shkëmbor.

Gjatë hartimit të hartografisë, e cila u krye në vitet 1976-1978, u kuptua se trualli i kalasë ruante dëshmi të kulturës së qytetit mesjetar. Aty u fiksuan gjurmët e një numri veprash arkitektonike, si dhe vendndodhja e disa gropave arkeologjike me stratigrafi të qartë e të pasur. Zbulimi u lejua dhe u programua vetëm në tri zona të saj (që përbënin afërsisht 25% të sipërfaqes së kalasë) në zonën JP ku do të zbulohej oborri i fortifikuar që mbronte dikur burimin me ujë të pijshëm të kalasë, në qendër të mjedisit ku do të gjendeshin elementet e bërthamës urbane të qytetit së bashku me ujësjellësin e tij dhe në anën VL për zbulimin e akropolit të kalasë (fig. 3). Programi do të plotësonte tri kushte:

a) Materiali arkeologjik që do të zbulohej nga këto tri zona duhej të ishte i mjaftueshëm për ndriçimin e historisë mesjetare të mjedisit.

b) Forcat konservuese do të ishin në gjendje t'u përgjigjeshin problemeve që do të hapnim ato.

c) Të lihej një sipërfaqe arkeologjike e paprekur për gërmimet e brezave të ardhshëm.

3. Gërmimi arkeologjik konsiderohet një ndërhyrje e përkohshme që ndodh në procesin e përhershëm konservues të një mjedisi të pazbuluar. Por koha relativisht e shkurtër e kryerjes së tij dhe pasojat që i sjell ai materialit arkeologjik, duke i prishur ekuilibrin shekullor, kërkojnë prej konservuesit vëmëndjen dhe energjinë më intensive të veprimit, ndoshta më tepër se në çdo etapë tjetër të ekzis-

DO NOT COPY



Fig. 3. – Planimetria e kalasë, tre zonat arkeologjiko-konservuese në të cilat u kryen punimet.

tencës së mjedisit. Në një gërmim arkeologjik ne nuk e ndajmë përgjegjësinë midis arkeologut dhe konservuesit në lidhje me suksesin apo dëmet që shkaktohen. Gjatë gërmimit kontradiktat e shumta që lindin midis pasionit për operacione të arkeologut dhe kurimit të çdo rrënoje apo objekti të konservuesit, është detyrë të zgjidhet me urgjencë dhe nën përgjegjësinë e tyre të përbashkët, në dobi të ruajtjes e të konteksit sa më të plotë të materialit arkeologjik. Si rrjedhim, dinamika e gërmimit karakterizohet nga ndërimi elastik i kritereve të tij, nga kriteri që përkon me interesin e arkeologut në atë që pajtohet me qëllimin e konservuesit dhe e kudërta, ashtu siç diktojnë nevojat imediate gjatë avancimit. Gërmimin e konsiderojmë të përfunduar me sukses kur është siguruar konservimi i të gjithë materialit arkeologjik (mjedisit dhe i objekteve) të porsadalë, qoftë edhe provizorisht.

Gërmimet në të tri zonat e kalasë u kryen me rradhë në vitet 1977-1983. Në anën JP u arritën disa zbulime të rëndësishme të udhëhequra më tepër nga kriteri i gjurmimit të mbetjeve arkitektonike dhe njëherazi u kryhen edhe konservimet e tyre. Kështu u bë zbulimi i plotë i konstruksioneve të mbe tura nga kullat e nga muret e oborrit të fortifikuar të shoqëruara me një sërë ndërhyrjesh konsoliduese Konservime gjatë zbulimit u bënë gjithashtu në këtë anë për muret e kullat e kalasë si edhe për një kapelë të shek. IX (e ritit bizantin), për të cilën u krye edhe mbulimi definitiv (fig. 4, 5, 6, 7).

Dëshmi me vlerë urbanistike u morën nga zbu limet në pjesën qendrore të mjedisit. Ndërhyrje konservuese të kryera këtu në kohën e duhur, shpë tuan mjaft gjurmë fragmentare e strukturalisht t dobta të dy fazave të hershme të rrugës kryesore t kalasë, të rrënojave të disa banesave (fig. 8), të mbe tjeve arkitektonike të një xhamie, të fragmenteve t ujësjellësit të shek. XV etj. Duke mos u ndalur n morinë e problemeve që lindën dhe u zgjidhën n ecurinë arkeologjiko-konservuese të mjedisit, po për qëndrohemi vetëm në metodikën e konservimit gjat zbulimit të zonës së tretë, akropolit të kalasë (fig. 9

DO NOT COPY



Fig. 4. — Kapela në zonën JP të kalasë gjatë zbulimit.



Fig. 5. — Mbulesë provizore e kapelës në zonën JP, e ngritur posa u diktua në të prania e pikturës murale (strukturë e thjeshtë druri me fletë eterniti).



Fig. 6. — Kapela në JP të kalasë, konservimi përfundimtar i saj nëpërmjet krijimit të një hapsire volumore, për nevojat e mikroklimës së pikturës murale (pamje jugore).



Fig. 7. — Pamje perëndimore e konservimit përfundimtar të kapelës.

Për ekzistencën e murit të akropolit, i lidhur ky në anën veriore me donzhonin dhe në anën jugore me mbetjet e një kulle tjetër të pazbuluar, ishim njohur qysh në fazën e hartimit të hartografisë. Bile, piketat ishin vënë edhe për rrënojat e një kishe në brëndësi të tij. Kjo paranjohje e orientoi strategjinë e gërmimit. Ato filluan me zbulimin e murit të akropolit, me drejtimin nga donzhoni te kulla jugore. Muri i akropolit, i gjerë gati 5 m, përbëhej nga katër perde muresh të puthitura, të ndërtuara në kohë të ndryshme (fig. 10). Muri i dytë në radhë (nga ana e sulmit), i cili lidhej me substraksionet e donzhonit, ishte më i lashtë dhe i takonte shek. XII. Ndërsa tri të tjerat që i mbështeteshin atij nga të dy anët, njëri nga ana e sulmit (me faqe të pjerrët) dhe dy të tjerat nga ana e brendëshme e akropolit, duket se ishin ndërtuar radhazi gjatë shek. XV. Po në këtë kohë ishte ngritur edhe kulla jugore. Për shkak të

DO NOT COPY



Fig. 8. – Zona qëndrore e kalasë, konservime rrënojash gjatë zbulimit të tyre.



Fig. 9. – Akropoli i kalasë (zona VL), përpara fillimit të gër mimeve.



Fig. 10. – Perdet e murit të akropolit gjatë gërmimit.

materialit të dobët ndërtimor (llaçit të varfër në gël-qere), kryesisht të mureve të shek. XV, zbulimi i murit të akropolit u shoqërua nga konsolidimet në çdo hap (fig. 11, 12). Në faqet e tij, në nivele të ndryshme lartësie, u shfaqën boshllëqe të muraturës në formë zgavrash, për të cilat u bënë aty për aty plotësimet, duke shmangur rrezikun e shembjes së strukturave të mbivëna (fig. 13, 14).

Gërmimet vazhduan në hapësirën e brendshme të akropolit në një sipërfaqe prej 160 m² mbi një gropë arkeologjike të njohur nga sondazhet (fig. 15). Si terren i virgjër nga rrënojat arkitektonike, gër-mimi u drejtua këtu tërësisht nga arkeologët. Objek-tet me inventar të pasur që dolën nga të gjitha pe-riudhat e mesjetës iu nënshtruan konservimit të tyre në terren. Në anën VP të sipërfaqes tashmë të zbu luar, u diktuan në themelet e murit të akropo mbetjet e një abside në përmasa të vogla, e mbi luar nga copa pikture murale, që tregonte për ekzi tencën e një kapele të panjohur (fig. 16). Meqenë të gjitha mbetjet arkeologjike të kapelës, me përj shtim të absidës, shtriheshin nën themelet e mu të akropolit, konservimi i tyre mori përparësinë dl gërmimi arkeologjik u ndërpre. Sezoni i zbulimit kapelës u shty deri në përfundimin e studimit pë katës konservues dhe absida e ekspozuar u rimbu përsëri me dhe.

Punimet konservuese u përqendruan më tej zbulimin e mbetjeve të kishës pranë donzhonit, n e cila njiheshin paraprakisht disa elemente të pla

DO NOT COPY



Fig. 11. – Perdja e parë e murit të akropolit gjatë zbulimit.



Fig. 12. – Konsolidime dhe plotësime gjurmësh të perdes së parë të murit të akropolit gjatë zbulimit.



Fig. 13. – Boshllëqet e shfaqura në faqen e brëndëshme të murit të akropolit.



Fig. 14. – Plotësimet e përkohëshme me muraturë të boshllëqeve të murit të akropolit, për të eliminuar rrezikun e shëmbjeve.

DO NOT COPY



Fig. 15. – Kuadratet arkeologjike në hapsirën e brëndëshme të akropolit.



Fig. 16. – Vendndodhja e kapelës së akropolit.



Fig. 17. – Gërmimi i anëve të jashtme të kishës pranë donzhonit.



Fig. 18. – Kisha pranë donzhonit përpara fillimit të gërmimeve në brendi.

metrisë. Për sqarimin paraprak të fazave të ndërti mit, të njohjes së gjendjes fizike të rrënojës, të kri jimit të mundësive më të mëdha për pajantime dhe të vendosjes së shtyllave për mbulimin provizor t faltores, gërmimi u krye fillimisht në të katër anët jashme të saj (fig. 17). Qysh në këtë fazë të punë u bë e qartë se kishim të bënim me mbetjet e d kishave, gati mbi njëra tjetrën. Rrënojat e kishës s poshtme i takonin shek. X-XI, ndërsa ato të kishës s sipërme shek. XV (e ritit latin). Mjaft probleme kon servimi paraqitën mbetjet e murit perëndimor t kishës së shek. XV. Konsolidime u bënë që në hapa e parë të zbulimit, si për mbushjen e çarjeve verti kale të tij, ashtu edhe për forcimin nga sipër t strukturës shumë të dobët. Nga ana tjetër meqenës themelet e tij nuk mbështeteshin plotësisht mb substruksionet e kishës më të lashtë, një sistem i tër pajantash u vu për mbajtjen e tij nga jashtë deri n plotësimin e themelit. Po ashtu mbi dhe të shkrifë ishin edhe themelet e qoshes JP të kësaj kishe. Ne voja për thellimin e gërmimeve në këtë pikë çoi n këtë rast në vendosjen për themel të rrënojës të nj trau metalik definitiv etj.

Përpara se të fillonte gërmimi në brendinë e ki shave, u ngrit një strehë provizore me kapriata dërras dhe fletë eterniti për tërë hapësirën (fig. 18, 19, 20 Avancimi i zbulimit të brendisë u bë me tri zon tërthore, për shkak të plotësimit pjesë-pjesë të the melit të murit perëndimor. Ai u ndoq këtu me anë t rrjetit planimetrik me kuadrate të dendura (i ashtë quajturi sistemi grid e metriks) për të regjistruar çd fragment të pikturës murale të rënë në brendinë faltoreve, por që në fakt rezultoi tepër e dëmtuc nga djegia. Disa fragmente pikture në mbetjet mureve u konsoliduan. Gjithashtu u përforcuan m

DO NOT COPY



Fig. 19. – Struktura e strehës provizore, prej kapriate dërrase e fletë eterniti.

llaç të gjitha pjesët e sipërme të mbetjeve të mureve (fig. 21).

Ndërkohë u përgatit projekti i zbulimit të mbetjeve të kapelës nën murin e akropolit. Vetë kondita e ruajtjes edhe të murit të akropolit edhe të mbetjeve të kapelës, gjithnjë me synimin e zbulimit të saj, na detyroi në këtë rast që proçesi konservues të përbënte edhe metodën zbuluese të kapelës. Pa provuar se në ç'marrëdhënie arkeologjike qëndronin mbetjet arkitektonike të kapelës me ato të murit të akropolit, një çlirim (hapje) në lartësi e gjerësi e strukturave të tij do të ishte i gabuar. Prandaj fi-



ig. 20. – Mbulesa e rrënojave të kishës pranë donzhonit përpara fillimit të gërmimeve.



Fig. 21. – Kisha pranë donzhonit, konsolidime gjatë zbulimit të mbetjeve të mureve dhe të pikturës murale të saj.



Fig. 22. – Hapja e galerisë për gjurmimin e kapelës nën muret e akropolit.

llimisht u hap në formë galerie vetëm pjesa e themeleve të dy perdeve të shek. XV të murit të akropolit (fig. 22, 23). Nga kjo hapësirë e krijuar u larguan të tëra pjesët e rrënuara të pikturës murale duke kryer njëherësh edhe disa rikompozime të mundshme të tyre në telajo speciale. Materiali arkeologjik e datoi këtë kapelë të shek. VI (paleokristiane). Më në brendi, mbetjet e mureve të saj ruanin pothuajse tërë lartësinë dhe shtriheshin në tërë seksionin tërthor të murit të akropolit. Çlirimet e mëtejshme për evidentimin e kapelës u lanë të vendoseshin mbas ballafaqimit të përgjithshëm të vlerave të mjedisit dhe konservimit definitiv.

4. Puna konservuese në fazën e gërmimit arkeo-



Fig. 23. – Çlirimi i pjesshëm i dy perdeve të murit të akropolit për zbulimin e kapelës.

logjik quhet e kryer, atëherë kur janë stabilizuar të gjitha nevojat urgjente të shfaqura dhe kur problemet e mbetura të konservimit të mëtejshëm të mjedisit dhe objekteve kanë fituar kohë për t'u zgjidhur më qetësisht. Projekti i konservimit mbas gërmimit bëhet mbi bazën e një shqyrtimi përfundimtar të përbashkët arkeologjik e konservues të gjithçkaje të dalë nga gërmimi, të vlerësimit të rrënojave dhe objekteve që meritojnë të ruhen e të ekspozohen. Ky vlerësim synon, në radhë të parë, të sigurojë dëshmitë arkeologjike prej të gjitha periudhave historike të mjedisit, në radhë të dytë të theksojë dëshmitë që i përkasin periudhës historike më të rëndësishme të tij. Pas këtij vlerësimi të përbashkët të mjedisit arkeologjik, konservimi synon të jetë sa më përfundimtar në kuptimin që një ndërhyrje tjetër e këtij lloji të mos përsëritet ose të jetë sa më e largët në kohë.

Pa dyshim, duke u vlerësuar si një nga dëshmitë më të çmueshme për historinë e mjedisit të Krujës, evidentimi i mbetjeve të kapelës, mori përparësi, duke pranuar çlirimin e strukturave sipër saj, vetëm të dy perdeve të shek. XV, pa e shpuar murin e akropolit tejpërtej seksionit të tij. Një strehë e thjeshtë me mbulesë eterniti iu vu mbetjeve të kapelës, e dukshme vetëm nga ana e brendshme e akropolit. Disa rrënoja arkitektonike spontane e shumë të vona, të lëna gjatë gërmimit, u hoqën. Të gjitha kornizat e sipërme të rrënojave arkitektonike të zbuluara, si në krejt mjedisin pa përjashtim, u lidhën me një rresht gurësh e llaç të pasur me gëlqere të stazhionuar e me 5% çimento, ndërhyrje kjo e natyrës konsoliduese dhe njëkohësisht e kuptueshme nga studiuesit vendës. Si domosdoshmëri, u paraqit edhe mbulimi i përhershëm i rrënojave të kishave pran donzhonit dhe i pikturës murale të tyre. Një mbules e hapur do të ishte e mjaftueshme për t'i siguruc ato. Por kjo zgjidhje u çua më tej – mbulimi të bëhe i mbyllur, për faktin se, si një ndërtesë e tillë, aj plotësonte kushtet për të ligjëruar edhe një funksio të vizitueshmërisë, atë të muzeut të mjedisit. Pë këtë arsye, ndërhyrja përfundimtare konservuese r rrënojat e kishave të donzhonit u la për t'u kryer n etapën e vizitueshmërisë. Së fundi, objektet arke logjike mbas vlerësimit, u ndanë në dy grupe, sipo vlerës dhe nevojave mbrojtëse. Pjesa më e madhe tyre u mbajt provizorisht në një ambient të siguruc pranë mjedisit, ndërsa të tjerat u larguan për n laborator.

5. Zbulimi dhe konservimi i mjediseve arkeolo gjike, ashtu si tërë veprimtaria mbrojtëse e monu menteve në Shqipëri, nuk bëhet në asnjë rast për siguruar fitime materiale. Fondet shtetërore, i vetr burim shpenzimesh në këtë veprimtari, jepen p interesat e historisë dhe të edukimit patriotik të sh qërisë. Për këtë arsye, paraqitja e dëshmive arke logjike të mjedisit në mënyrë të kulturuar e të l xueshme për qytetarët është një domosdoshmëri. V ndosja e tabelave në pika të ndryshme të mjedi për shpjegimin e gjetjeve, vazhdon të ketë efektivit dhe përdoret gjerësisht. Për t'i bërë rrënojat arkite tonike më të lexueshme për vizitorin, ndonjëhe është kryer edhe ndonjë rikonstruksion apo resta rim plotësues i tyre. Për rritjen e konsiderueshme informacionit arkeologjik të mjedisit, është bërë pra tikë edhe nga specialistët shqiptarë ngritja e m zeut të mbyllur brenda hapësirës së tij, i cili plotësojë kushtet për mirëmbajtjen e vazhdueshr të objekteve të vendosura në të. Jo vetëm pse br nda këtij muzeu do të qëndrojnë objektet e vje nga mjedisi, por edhe pse aty me mjete të ndryshr grafike, si skica, vizatime, makete etj, mund të r tet në mënyrë të ndryshme informacioni për dom thënien e shumë rrënojave e objekteve, shpesh pakapshme nga vizitori në terren.

Detyra për lexueshmërinë e materialit arkeol gjik të mjedisit të Krujës (të rrënojave dhe objekte te vizitori çoi në disa punime të tjera konservi Me qëllim që të lexoheshin fazat ndërtimore të m rit të akropolit, muratura e perdes së dytë, e c lidhej në lartësi me murin e donzhonit, u evident ndaj të tjerave duke u ngritur akoma me tri r shta gurësh (fig. 24). Punime restaurimi plotësu të muraturës u kryen në të tri faqet e kullës jug që të lexohej forma e saj (fig. 25, 26). Mbule provizore e rrënojave të kishave pranë donzhonit kthye në një muze të mbyllur të mjedisit. Ai u ng në volum mbi rrënojat planimetrike të kishës

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 24. – Ndërhyrja përfundimtare në perdet e murit të akropolit.



Fig. 26. – Pamje perëndimore e kullës jugore të akropolit pas konservimit për vizitushmëri.



Fig. 25. – Kulla jugore e akropolit pas ndërhyrjeve.



Fig. 27. – Muzeu i mjedisit arkeologjik të kalasë.

shek. XV, pa pasur asnjë pretendim për rikonstruksion dhe u modelua me skelet druri, veshur me panele zdrukthi. Çatia e tij u konstruktua me kapriata druri dhe mbulesa me tjegulla tradicionale. Në dy anë u vendosën edhe dritare për dritë e ajrosje (fig. 27). Për ngritjen në volum të muzeut dhe për materialet e përdorura për të u patën parasysh integrimi i natyrshëm i tij në mjedisin e kalasë pa u ndier në siluetin e përgjithshëm historik të saj, reversibiliteti dhe funksioni plotësisht i justifikuar. Muzeu modest i mjedisit arkeologjik i Krujës, përveçse me objekte arkeologjike, u pajis edhe me disa skica, vizatime e ndonjë maket, të cilat sqaronin përmbajtjen origjinale të dëshmive të mjedisit. Ndërhyrje konservuese për vizitushmëri ishte gjithashtu restaurimi i donzhonit sipas pamjes dhe funksionit të tij të shekujve të fundit si kullë Sahati (fig. 28). Lënia e rrugës për vizitorët nëpër akropol, mbjellja me bar e vëndeve të përshtatshme etj qenë midis ndërhyrjeve të fundit të vizitueshmërisë (fig. 29).

6. Pas kësaj pune të kryer në cilësinë e duhur, materiali arkeologjik i mjedisit të Krujës u vu nën kontrollin e mirëmbajtjen e vazhdueshme. Nga ana e vet pjesa e pazbuluar e mjedisit mbeti gjithnjë nën kujdestarinë e konservimit të veshjes historike. Si për të gjithë mjediset arkeologjike në vendin tonë, edhe për Krujën, në varësi nga madhësia dhe problemet e mirëmbajtjes e të konservimit, një grup

DO NOT COPY



Fig. 28. – Kulla e Orës (donzhoni) pas restaurimit.

prej pesë vetash, i përbërë nga specialistë e punëtorë, mbeti përgjithnjë në mjedis. Puna e tyre programohet herë pas here nga konservuesit e IMK. Për ruajtjen e mjedisit qysh nga momenti i deklarimit të vënies në mbrojtje të tij, qëndron përherë një kujrestar, i varur po ashtu nga IMK dhe që mban lidhje me autoritetet shtetërore lokale.

Nëse mund t'i përmbledhim etapat e konservimit aktiv të mjedisit të Krujës, ku u kryen gërmime arkeologjike, do të jepnim pak a shumë skemën A.

Veprimet arkeologjiko-konservuese të kryera në mjedisin e Krujës dhanë rezultate të kënaqshme në mbulimin dhe mbrojtjen e dëshmive të reja dokumentare të historisë së saj. Përdorimi i metodave dhe materialeve tradicionale qe një hap tjetër i suksesshëm i specialistëve vëndas në konservimet arkeologjike.

SKEMA A

DEKLARIMI I MJEDISIT	KONSERVIMI I VESHJES HISTORIKE			
	KONSERVIMI I MATERIALIT ARKEOLOGJIK			MIRËMBAJTJE
	KONS. STUDIMOR	KONS. PROVIZOR	KONS. DEFINITIV	KONS. VIZITUESH
	Hartografia dhe programi ark-kons.	Gërmimi arkeologjik	Vlerësimi përfundimtar i materialit arkeol.	Paraqitja mat. ark. dhe punime për vizitorët
	3	4	5	6



Fig. 29. – Planimetria e akropolit të kalasë pas ndërhyrjeve arkeologjiko-konservuese.

DO NOT COPY

NERITAN CEKA

FORTIFIKIMET PARAHISTORIKE ILIRE II

III. Fortifikimet e fazës protoqytetare (shek. VII-V p.e.s.)[1]

Që nga gjysma e dytë e shek. VII p.e.s vihen re ndryshime të rëndësishme në tiparet e fortifikimeve të lashta ilire, të cilat lidhen me fillimin e proçesit të urbanizimit (fig. 1). Vendbanimet e fortifikuara marrin tani një funksion të ri, duke u bërë qëndra të prodhimit dhe të shkëmbimit. Në të përqëndrohen forcat e reja shoqërore të shkëputura nga rendi fisnor, që përfaqësojnë vendosjen e marrëdhënieve të reja skllavopronare.[2] Në fillim ky përqëndrim është i vogël, duke reflektuar kështu një numër ende të kufizuar të elementit njerëzor që shkëputet nga bashkësia fisnore. Gjatë shek. VI-V p.e.sonë numri i vendbanimeve të fortifikuara të tipit të ri rritet dhe sipërfaqja e banuar e tyre zmadhohet, duke përgatitur kushtet për kalimin në qytetet e mirëfillta si qendra të prodhimit skllavopronar. Evolucioni i fortifikimeve na dëshmon kështu një periudhë kalimtare në zhvillimin e proçesit të urbanizimit, kur, krahas zëvendësimit të marrëdhënieve fisnore me ato skllavopronare, përvijohen tiparet arkitektonike që do të formohen plotësisht në trajtat e qyteteve të ardhshme ilire. Kjo periudhë është karakterizuar për këtë arsye si protoqytetare dhe datohet për Ilirinë e Jugut dhe Epirin që nga gjysma e II e shek. VII p.e.sonë deri në gjysmën II të shek V p.e.sonë, kur dalin qytetet e mirëfillta të tipit Amantie. Për bregdetin verior të Ilirisë ky proçes zhvillohet rreth një shekull më vonë, gjë që vlen edhe për krahinat e brendshme lindore.

Një vendbanim tipik protoqytetar, i sqaruar nga gërmimet arkeologjike është Mashkjeza, pranë Ca-



Fig. 1

1) Artikulli përbën pjesën e dytë të punimit të autorit të botuar me të njëjtin titull në «Monumentet» 1, 1985 (shën. i red).

2) N. Ceka, **Lindja e jetës qytetare tek ilirët e jugut,** «Iliria», 2, 1983, fq. 171-172.

DO NOT COPY



Fig. 2

kranit (fig. 2). Me vendosjen mbi një kodër të vogël pranë rrugës natyrore që lidhte fushën pjellore të Cakranit me luginën e Gjanicës (fig. 2), ky vendbanim shprehte interesin për bujqësinë dhe tregtinë.[3]. Shtresat kulturore të tij nisin rishtas në fund të shek. VII dhe dendësohen gjatë fundit të shek. VI p.e.sonë, duke u lidhur me muret e një fortifikimi. Sipërfaqja e fortifikuar është mjaft e vogël, vetëm 0,21 ha, por ka qenë banuar dendur. Gjithashtu, që në fillimet e veta, një pjesë e mirë e vendbanimit ka qenë vendosur jashtë murit rrethues, në grupe banesash në shpatin perëndimor dhe jugor të kodrës. Planimetria e fortifikimit është pothuaj katërkëndëshe, me një thyerje të lehtë të krahut perëndimor (fig. 3). Traseja e mureve ndjek vija të gjata të drejta dhe bën kthesa me kënd të drejtë



Fig. 3



Fig. 4

3) Shih N. Ceka, **Vendbanime protourbane ilire,** «Iliria» VII-VIII, 1977-78, fq. 250 dhe Gërmime të vitit 1983–Mashkjezë, «Iliria», 2, 1983, fq. 251-254.

DO NOT COPY



Fig 5



Fig. 6



Fig. 7



Fig. 8

apo të gjerë. Hyrja e vetme ka qenë vendosur në njërin kënd të fortifikimit, ku afrohej rruga kryesore (fig. 4). Muri me gjerësi 2 m përbëhet nga dy faqe dhe mbushja midis tyre. Si themel është përdorur një radhë gurësh të papunuar, që del 0,10 m para planit të fasadës. Ndërtimi është bërë me gurë mesatarë e të mëdhenj, të thyer me çekan në forma katërkëndëshe e poligonale dhe të rrafshuar për puthithje më të mirë vetëm në faqet horizontale. Është ndjekur njëfarë nivelimi në rreshta me lartësi 0.650 m (fig. 5). Lartësia e murit ka qenë rreth 4 m.

Në një periudhë të dytë, që i takon shek. V p.e.sonë, i tërë fortifikimi është rindërtuar, duke ruajtur të njëjtën planimetri dhe formë të hyrjes. Ndryshimi qëndron vetëm në një trajtim më të kujdesshëm të muraturës, ku blloqet latohen përveç faqeve horizontale edhe në ato të jashtme, por jo në anësoret. (fig. 6).

Në dy periudha të njëjta ndërtimi kalon edhe fortifikimi protoqytetar i Margëlliçit. Periudhën e parë, që sot nuk ruhet më në sipërfaqe e njohim vetëm nga përshkrimi i Prashnikerit[4]. I ndërtuar me gurë të mëdhenj të punuar trashë, ai karakterizohej nga mungesa e kullave dhe kthesat me kënd të drejtë apo të gjera (fig. 7). Një trajtim më të kujdesshëm kishte një dorë e dytë, ku blloqet u afro-

4) C. Prachniker, A. Schober, **Archeologische Forschungen in Albanien, und Montenegro,** Wien 1920, fq. 76.



Fig. 9

heshin formave katërkëndëshe. Kjo periudhë e dytë, e zbuluar edhe gjatë gërmimeve arkeologjike të vitit 1982 lidhej me faqen e brendshme të murit me një shtresë kulturore të shek. V p.e.sonë. Kjo e fundit i mbivihej shtresës më të hershme protourbane të shek. VII-VI p.e.sonë, të depozituar rrëzë murit të hershëm protourban.[5]. Ndryshe nga Mashkjeza, Margëlliçi përfaqëson një vendbanim të madh protoqytetar me sipërfaqen prej 5 ha të banuar dendur.

Një radhë vendbanimesh protoqytetare në Ilirinë e Jugut kanë dhënë shtresa kulturore, disa herë të shoqëruara me arkitekturë. Pranë Mashkjezës, në kurrizin kodrinor që ndan luginën e Vjosës nga ajo e Gjanicës, gjendet fortifikimi i Gurzezës, me një formë të zgjatur katërkëndëshe, me sipërfaqe rreth 0,8 ha. Muri rrethues ndiqet në anën jugore në një vijë të drejtë i ndërtuar me blloqe gëlqerore të punuara vetëm në faqet horizontale të përputhjes (fig. 8).

Një periudhë të dytë të zhvillimit të fortifikimeve protoqytetare i takon Belishova, pranë së njëjtës rrugë natyrore që kalonte paralel me luginën e Vjosës në kurrizin e vargut kodrinor, ku ngrihej edhe fortifikimi i Gurzezës. Planimetria katërkëndëshe përsërit formën e njohur nga Mashkjeza, madje dhe vendosjen e hyrjes në njërin kënd të fortifikimit, por me një trajtim të njërit krah në funksionin e një bastioni (fig. 9). Në teknikën e punimit të gurëve Belishova ka të njëjtat tipare me fazën II të Mashkjezës në kalimin në format katërkëndëshe të blloqeve, por pa latim të faqeve anësore (fig. 10). Si-



Fig. 10

5) N. Ceka, **Kultura protoqytetare ilire,** «Iliria» 1, 1985, f. 117.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12



Fig. 13

si Kanina, Mavrova, Treporti, Berati, Belshi, Selca etj nuk kanë dhënë ende mbetje fortifikimesh. Në jug, në trevën e Kaonisë, kemi dy fortifikime të sigurta protoqytetare në Butrot dhe Kalivo. Fortifikimi i Butrotit, i quajtur si prehistorik nga Ugolini [7]), është i lidhur me shtresën arkaike të datuar nga materialet arkeologjike të gjysmës së II të shek. VII p.e.s[8]). Ai përfshinte pjesën më të lartë të kodrës. Nga traktet e ruajtura në anën jugore mund të plotësohet afërsisht traseja që ndiqte një linjë të thyer buzë rrëpirës, duke bërë edhe kthesa me kënd të drejtë. Bllоqet e murit janë punuar paraprakisht me çekan dhe janë rrafshuar në faqet e përputhjes horizontale në mënyrë të ngjashme me Mashkjezën (fig. 11). Boshllëqet ndërmjet tyre janë plotësuar me gurë më të vegjël. Nuk ka një rreshtim të caktuar në vendosjen e gurëve që krijojnë kryesisht figura poligonale. Lartësia e ruajtur prej 2 m dëshmon se muri ka qenë mjaft i lartë dhe krijonte një tarracë të përshtatshme për banim.

përfaqja prej 0,5 ha është banuar kryesisht në pjesën pranë hyrjes dhe gjetjet më të hershme i takojnë mesit të shek. V p.e.sonë.[6])

Një numër i madh vendbanimesh protoqytetare

6) **Po aty, Lindja e jetës qytetare,** fq. 159.
7) L.M. Ugolini, **Albania Antica II L'Acropoli di Butrinto,** fq. 86, 116.
8) N. Ceka, **Fortifikimi i Butrintit dhe i territorit të prosaibëve,** Monumentet 11/1976, fq. 28 dhe **Kultura protoqytetare,** f. 121.

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15



Fig. 16

Fortifikimin protoqytetar të shek. VII-VI e pason në Butrot një rindërtim me teknikën poligonale me kënde të zgjatura dhe faqe të sheshtë (fig. 12), i ngjashëm me Amantien, që datohet në gjysmën e II shek. V p.e.sonë[9], në fillim të periudhës qytetare.

Kalivoja përfaqëson fortifikimin më tipik protoqytetar[10], megjithëse, për arsye që nuk i dimë, nuk njohu një jetë të zhvilluar, për t'u kthyer në qytet. Muri rrethues, me gjatësi 1300 m, kapet në dy pikat ku kodra futet në liqen duke e lënë të hapur këtë anë në një gjatësi 650 m (fig. 13). Ky orientim i mbrojtjes vetëm nga ana e tokës presupozon një zotërim të ujërave me anë të anijeve. Në Kalivo traseja e mureve kalon buzë thyerjes së shpatit, njëlloj si në Butrot, duke ndjekur vija të drejta dhe të gjata. Në pjesën veriore, vetëm 20m mbi liqen ajo fillon me një bastion 6.20 m të gjërë dhe e ndjek harkun e kodrës nëpërmjet gjashtë kthesave me kënd të gjerë. Ka tri hyrje ballore të vendosura në pjesën më të lartë të fortifikimit, te të cilat vihet re zgjatja në brendësi e korridorit, që e dallon nga tipi Gajtan (fig. 14). Muratura është trajtuar me kujdes me blloqe me përmasa të mëdha e mesatare, me forma trapezoidale e poligonale. Latimi është përdorur gjerësisht në rrafshimin e faqeve horizontale dhe në faqen e fasadës (fig. 15). Ndjekja e formës fillestare të gurëve ka dhënë mjaft linja të harkuara përputhjeje të ngjashme me lesbianin grek. Në plotësimin e boshllëqeve në fushat anësore janë përdorur gurë më të vegjël. Ka një koncept të qartë në rreshtimin e blloqeve, por pa formuar radhë të rregullta. Fasada e murit ka një pjerrësi 10% për të si-

9) N. Ceka, **Fortifikimi i Butrintit,** fq. 26.
10) N. Ceka, **Lindja e jetës qytetare,** fq. 164-167.

DO NOT COPY



Fig. 17



Fig. 18



F.g. 19

guruar qëndrueshmërinë dhe mbështetet në një rresht themeli më të dalë. Gjerësia e zakonshme është 2.60 m dhe lartësia duhet të ketë qenë rreth 6 m. Nga pikëpamja teknike, veçanërisht nga latimi i blloqeve Kalivoja qëndron midis Butrotit I dhe II dhe mund të datohet në kapërcyellin e shek. VI p.e.sonë.

Fortifikimi i Kalivosë qoftë nga planimetria qoftë nga teknika e ndërtimit, përmban të gjitha veçoritë e reja që karakterizojnë fortifikimet protoqytetare dhe mund të merret si shembull i përkryer i tyre. Ai përfaqëson etapën e fundit të këtyre fortifikimeve, kur po bëhej hapi për kalimin e tyre në qytete.

Mungojnë të dhëna për fortifikime të tjera epirote që mund të vendoseshin në fazën protoqytetare. Nga përshkrimet e shkurtra duket se janë protourbane fortifikimet tesprote të Karbunarit pranë Pargës, të Sajadhës dhe të Kosepsit, që karakterizohen nga përdorimi i blloqeve të punuara trashë dhe mungesa e kullave.[11] Në Kastrin e Lias fortifikimi antik paraprihet nga një fortifikim më i hershëm, ku mbrojtja sigurohej nga një mur me gjatësi 60 m dhe gjerësi 1.70 m midis dy shkëmbinjve. Blloqet janë të skuadruara trashë, në një teknikë tipike për fazën protoqytetare. Ndoshta është i kësaj faze edhe fortifikimi i leromnimit[12]) në zonën e Janinës, me planimetri eliptike, hyrje të pambrojtur dhe punim të trashë të gurëve. Tipare më të qarta protoqytetare ka Liapohori në zonat lindore, ku muri është ndërtuar me blloqe të mëdha, të punuara trashë, dhe nuk ka tulla, por vetëm kthesa me kënd të drejtë e të gjërë.[14]) Brenda tij është ndërtuar më vonë një fortifikim antik me gurë të punuar dhe kulla. Në tipat protoqytetarë mund të klasifikohet për planimetrinë katërkëndëshe dhe gurët e punuar trashë edhe fortifikimi i Solomos[15]).

11) N.H.L. Hammond, **Epirus** Oxford, 1964, f. 80-81, 52.
12) **Po aty,** fq. 91.
13) **Po aty,** fq. 196-197, fq. 242.
14) **Po aty,**
15) **Po aty,** fq. 242.

DO NOT COPY



Fig. 20



Fig. 21

Një grup me tipare të përbashkëta formojnë fortifikimet protoqytetare në trevën që nga Shkumbini deri në Malin e Zi. Karakteristike për këtë zonë është trajtimi mjaft i kufizuar i blloqeve të mureve rrethuese, i cili shoqërohet me elemente të përparuara të planimetrisë. Gjithashtu sipërfaqet e fortifikimeve janë të vogla dhe gjetjet arkeologjike që vijnë prej tyre ose rrethinave japin një datim pas mesit të shek. VI p.e.sonë.

Në Dorëz të Tiranës fortifikimi protoqytetar zinte një sipërfaqe prej 1.8 ha (fig. 16), që do të trashëgonte edhe qendra qytetare[16]. Traktet e ruajtura kanë gjerësi 2.50 m dhe janë ndërtime të qëndrueshme me lidhje të mirë midis faqeve dhe mbushjes. Blloqet kanë shenja të punimit vetëm në faqet horizontale të përputhjes. Rreshtimi horizontal ndiqet vetëm për blloqet e mëdha, që plotësohen me gurë të vegjël midis tyre (fig. 17). Traseja e murit ndjek linja të gjata e të drejta, duke bërë një kthesë me kënd të drejtë në fillimin e saj, si në Kalivo. Një kthesë e dytë në vendin ku ndodhej hyrja, është veshur më vonë nga një faqe gurësh të punuar. Qeramika e gjetur në një zhveshje buzë murit datohet në mesin e shek. VI p.e.sonë[17]. Në fund të shek V p.e.sonë ka filluar rindërtimi i mureve me një teknikë të ngjashme me Klosin dhe Amantien dhe ka vazhduar pastaj me gjysmën e II të shek. IV p.e.sonë, me një riformim të zonës rreth hyrjeve. Kjo ka qenë edhe pjesa më e përshtatshme për zonën e banuar që zgjatet kryesisht në tarracën e murit rrethues.

Në Zgërdhesh planimetria e fortifikimit protoqytetar mund të plotësohet nga gjurmët e ruajtura në pjesën më të lartë, që në periudhën qytetare është kthyer në një akropol, duke rindërtuar trakte të tëra dhe duke shtuar disa kulla në pjesën më të ruajtur (fig. 18). Kjo dëshmon se fortifikimi protourban u zhvillua pa ndërprerje duke u përshtatur në sistemin fortifikues qytetar. Sipërfaqja prej 1.3 ha mjaft e përshtatshme për banim përfshihet brenda një fortifikimi me planimetri katërkëndëshe që karakterizohet nga përdorimi i kthesave me kënd të drejtë dhe i një hyrjeje harkore të vendosur në njërin kënd (fig. 19). Në teknikën e ndërtimit të mureve[18] vihet

16) H. Ceka, **Zbulimi i një qyteti antik në rrethin e Tiranës** f. 86-88, N. Ceka; **Lindja e jetës qytetare**, fq. 160.

17) N. Ceka, Kultura protoqytetare, fq. 120.

18) S. Islami, **Qyteti Ilir në Zgërdhesh**, «Iliria» 2, 1972, fq. 199, 200. Autori jep një diapazon të gjerë krahasimi kur e gjen të ngjashme teknikën e ndërtimit me Gajtanin. Dorzin I dhe II dhe Lisin I dhe II. Gjithashtu lidh me hyrjen një kullë katërkëndëshe pranë saj, që është shtuar në periudhën II. Nuk mund të lidhet me fortifikimin shtresa e gjetur rreth 250 m jashtë tij, që datohet prej autorit në shek. VI-V, por që në bazë të mungesës së importit duhet të jetë të paktën para mesit të shek. VI p.e.sonë).

DO NOT COPY



Fig. 22

re një punim i cekët i blloqeve, por edhe një prirje për t'i vendosur një radhë horizontale.

Fortifikimi i Akropolit është vendosur në lartësi 800 m mbi nivelin e detit, i pazakontë për vendbanimet protoqytetare. Sipërfaqja e tij prej rreth 2 ha do të ruhet më pas nga fortifikimi qytetar me disa rindërtime dhe përforcime të trasesë së mureve, njëlloj si në Zgërdhesh. Në formën e përafërt paralelograme dallohet si tipar protoqytetar përdorimi i një kthese me kënd të drejtë dhe vendosja e hyrjes në njërin kënd të fortifikimit (fig. 20). Muri me gjatësi 3.20 m ndjek linja të gjata e të drejta. Blloqet e tij janë gëlqerore me forma të përafërta katërkëndëshe të trajtuara me çekan dhe me prirje të qarta rreshtimi.[19] (fig. 21).

Një teknikë më e përparuar punimi është vënë në dukje në fortifikimin më të hershëm të kodrës së Kalasë së Lezhës, ku u vendos bërthama e parë të vetë qytetit të Lisit[20]. Me trajtimin e rrafshët të faqeve horizontale të përputhjes (fig. 22), ai është mjaft i ngjashëm me fortifikimet në jug të Shkumbinit, por paraqet një shkallë më të përparuar në krahasim me Dorzin I dhe Zgërdheshin I. Për këtë arsye do të vendosim Lisin II më tepër afër Dorëzit II si fillim i jetës së mirëfilltë qytetare, nga fundi i shek. V ose fillimi i shek. IV p.e.sonë.

Shkodra ende nuk ka dhënë gjurmë të ndërtimeve paraqytetare. Fortifikimi prehistorik, që citohet herë pas here, është në fakt një mur hendeku i shek. XV[21] që vazhdon para murit mesjetar edhe në anën perëndimore e jugore. I vetmi fortifikim që përmban në planimetrinë e vet elemente protoqytetare në trevën e pasur me fortifikime të liqenit të Shkodrës është Samobori (fig. 23). I vendosur mbi një gadishull në bregun lindor të liqenit, ky fortifikim përfshin pjesën më të lartë të kodrës me lartësi 83 m mbi nivelin e detit[22]. Në planimetrinë e tij në formë trapezi dallohet një hyrje harkore e vendosur në njërin kënd, njëlloj si në Zgërdhesh. Një periudhe të dytë i takon një zgjerim i fortifikimit deri në 1.5 ha. Në linjën e re të mureve dallohen kthesa këndore dhe një kullë. Gjithashtu teknika e ndërtimit është më e përparuar, nga dhënia e një forme më të



Fig. 23

19) F. Prendi, K. Zheku, **Qyteti ilir i Lisit** «Iliria» II, 1972, fq. 216. fig. 2, 3a, 6, e dallojmë këtë teknikë si më të hershme, por nuk sqarojmë planimetrinë e fortifikimit, ku përveç gjurmëve të kthesës këndrejt shënojmë edhe një kullë katërkëndëshe, që i takon periudhës qytetare. Teknika e punimit dhe elementët planimetrike janë këtu më të përparuara se në Marshej dhe Gajtan, me të cilat e krahasojnë autorët.

20) **Po aty,** fq. 220.

21) V. Kamsi, **Kështjella e Shkodrës dhe restaurimi i saj,** «Monumentet» 1, 1971, fq. 165-166.

22) C. Praschniker, A. Schober, **Vep. cit,** fq. 93.



Fig. 24



Fig. 25

rregullt blloqeve[23]. Nga kjo pikëpamje faza II e Samoborit korrespondon me fortifikime të tjera të zonës së liqenit Labeat ku gjatë shek. IV-III planimetritë e përparuara realizohen me një teknikë primitive (Kratul, Renc)[24].

Në trevat lindore ilire, megjithëse jeta proto tetare njohu një zhvillim të vrullshëm, na janë kumentuar ende pak fortifikime të kësaj faze. Se e Poshtme, që ka dhënë një shtresë të shek. p.e.sonë, dallohet për zgjedhjen e vendit në një dër të mbrojtur nga natyra, buzë rrugës natyrore Shkumbinit[25]. Sipërfaqja prej 1 ha e vendbani kufizohej në pjesën më të madhe nga rënie shl mbore.

Nuk kemi të dhëna për fortifikime protoqyteto edhe në pllajën e Korçës e të Kolonjës si dhe Trebenisht. Një zonë të pasur me fortifikime pro qytetare përbën Pelagonia, ku është vënë në dul një afrim i vendbanimeve pranë fushës dhe rrugë dhe një dendësim i jetës brenda fortifikime gjatë shek. VI p.e.s[26]. Më tipiku është Bu pranë Brodit, me një sipërfaqe katërkëndësh ku veçohet një lloj akropoli, ndoshta pjesa protoq tetare. I vendosur njëlloj pranë fushës dhe rrug natyrore, që mori më pas formën e rrugës Egnati gjendet Gradishta e Zhivojnos. Fortifikime të tje janë Peshta pranë Gradishnicës, Gorna Crkva, B shkovki pranë Rapeshit, Gradishta e Berancit[27] e Për arsye se nga këto qendra nuk kemi planimet dhe përshkrime të mureve rrethuese, përcaktimi ësh bërë në bazë të formave të terrenit dhe gjetjeve a keologjike.

Në trevën dardane një fortifikim tipik është Be laçevci në luginën e Drenicës. Planimetria e tij n formën e një trapezi 50 x 70m, përvijohet nga nj mur prej gurësh mesatarë. Ruajtja vetëm në një ra dhë nuk jep të dhëna për teknikën e ndërtimit. Mu është lidhur aty me një shtresë kulturore tipike pro toqytetare ku, krahas qeramikës së prodhimit tra dicional pa çark, zë vend edhe prodhimi vendës m çark i shek. VI p.e.s[28] Së njëjtës periudhë i përka sin në Dardani Hisari (IIb); Samoderzha, Cernica[29] dhe Lojana, që dallohet si një fortifikim katërkën dësh, por me qoshe të rrumbullakosura.[30]

23) P. Mioviç–M. Kovaceviç, **Gradovi i uverdenja u Crnoj Gori** Beograd 1975, fq. 11. e shtrijnë fazën e parë në gjithë fortifikimin, duke pranuar rindërtime të pjesshme në fazën e dytë. M. Korkuti, **Rreth vendbanimeve të fortifikuara ilire të periudhës së parë të hekurit në territorin e Shqipërisë,** «Studime Historike» 3, 1973, fq. 113. e veçon fazën I si të tipit Gajtan nga ndërtimet më të vona të periudhës qytetare.

24) Gj. Karaiskaj, **Gjurmë fortifikimesh ilire në disa kështjella të rrethit të Shkodrës,** «Buletin Arkeologjik» 4, 1974, fq. 150-154, F. Fistani, **Vendbanimi ilir i Kratulit**, «Iliria» 1, 1983, fq. 109.

25) N. Ceka, **Qyteti ilir pranë Selcës së Poshtme,** Tiranë 1975, fq 31-33.

26) I. Mikulcic, **Pelagonija,** Skopje, 1966, fq. 35.

27) **Po aty,** fq. 36.

28) N. Duric, **Gradina kod Belacevca,** Buletini i Muzeut të Kosovës, 1970, f. 281-293,

29) **Po aty,** f. 290.

30) M. Garasanin, **Agglomerations fortifiées dans la region frontiere du l'est du territore Illyrien,** «Utverdena Ilirska Naselja, Mostar 1972, Sarajevo, 1975, (cit. W. UIN) fq. 118.

DO NOT COPY



Fig. 26



Fig. 27

Në trevat ilire në veri të gjirit të Rizonit jeta protoqytetare njohu gjithashtu zhvillimin e saj, veçanërisht gjatë shek. V p.e.sonë. në përgatitje të krijimit të qyteteve nga gjysma II e shek. IV. p.e.sonë.

Në trevën e Daorsëve, ku jeta qytetare u zhvillua me forma të përafërta arkitektonike me Shkodrën dhe Lisin, kemi një fortifikim me tipare protoqytetare në Ograc. Përveç përdorimit të këndeve të trasesë e murit rrethues, atje ka dhe një hyrje me korridor të harkuar të tipit të Zgërdheshit. Sipërfaqja prej rreth 4 ha dhe jeta intensive tregon për një vendbanim të rëndësishëm.[31]

Në zonën e Glasinacit qëndron më afër tipareve protoqytetare fortifikimi i Kominës me një formë eliptike, me sipërfaqe rreth 3 ha (fig. 24). Hyrja e tij, e vendosur në këndin e fortifikimit, është trajtuar me tri porta të vendosura rresht, njera prej të cilave ka edhe një korridor. Në këtë kompleks është përdorur disa herë këndi i drejtë në kthesat e mureve.[32]

Treva liburne karakterizohet në shek. III-II p.e.s nga një urbanizim i zhvilluar që u parapri nga një fazë protoqytetare. Kjo është vënë në dukje në qytetin liburn të Varvaries, ku shtresa qytetare paraprihet nga dy faza më të hershme që i korrespondojnë shek. VI-V p.e.sonë.[33] Fortifikimi tipik protoqytetar është në këtë trevë Skol Veliki me një planimetri eliptike, por me një hyrje me korridor të zgjatur në thellësi, si i Kalivosë fig. 25). Edhe punimi i trashë i gurëve dhe plotësimi me gurë të vegjël i boshllëqeve tregon për një teknikë të përparuar.[34] Një tip të veçantë protoqytetar, karakteristik për trevat veriore, përfaqëson Jogodinja Gornja, me planimetri eliptike (fig. 26), por me vendosjen e një tu-

31) Z. Mariç, **Prahistorijska i protohistorijska utverdenja na podrucju daorsia,** «UIN» fq. 106, 108.

32) B. Covic, **Die Befestigungen und befestigte Siedlungen des Clasinacen Gebietes, «UIN»,** fq. 89.

B. Covic, **Pod kod Bugojno,** «UIN». Për nga tiparet urbanistike dhe shtresat kulturore i takon fazës protoqytetare fortifikimi i Podit pranë Bugojnos. Planimetria e tij i përshtatet formës së kodrës, por nuk njihen elementët e saj. Muri rrethues i ruajtur dobët ka qenë ndërtuar me gurë mesatarë të papunuar. Shtresë kulturore e daton atë në shek. VI p.e.sonë. shih: f. 121.

33) S. Batovic, **Caracteristiques des agglomerations fortifiées dans la region dei liburniens,** «Godisnjak» XV, Sarajevo, 1977, fq. 224.

34) **Po aty,** fq. 219, fig. 18 dhe tab. VIII 1,2 Autori e daton këtë qendër në ngjashmëri me fortifikimet e Shqipërisë së shek. V-IV, duke iu referuar sigurisht mendimit të Garashaninit për Gajtanin.

DO NOT COPY

mule për mbrojtjen e hyrjes[35]. Muri rrethues është ndërtuar me gurë të mëdhenj të thyer, por të palatuar me boshllëqet midis tyre të mbushura në fasadë. Sipërfaqja brenda tij ndahet në brezare nga katër mure të brendshme. Qeramika e importit e gjetur në shtresat e fortifikimit e daton atë në gjysmën I të shek. V p.e.sonë. Në muret rrethuese të Nedinit dallohet qartë një fazë protoqytetare me punim të faqeve horizontale të blloqeve dhe rreshtim të përafërt të tyre, e cila paraprin periudhën qytetare të fortifikimit të tipit Lis.[36]

Për trevën e istërve mungojnë të dhëna për shtresat kulturore, që do të ndihmonin vecimin e fortifikimeve protoqytetare. Duke u mbështetur nga veçoritë tipologjike, mund të quajmë si të tillë fortifikimin e Polanzës ku vihet re përdorimi i këndeve të drejta në murin rrethues dhe tarracat e banesave.[37] Për formën katërkëndëshe dhe trajtimin e kujdesshëm të murit rrethues mund të tipizohet si protoqytetar edhe Halmac (fig. 27) me një sipërfaqe prej rreth 0,9 ha.[38]

Treva Japode gjithashtu ka një mungesë të plotë të dhënash stratigrafike që do të ndihmonin për të dalluar tipat e veçantë në grupimin e madh të fortifikimeve paraqytetare. Klasifikimet e deritanishme janë formale dhe bëhen brenda një harku kohor mjaft të gjerë. Në ngjashmëri me fortifikimet liburne të përforcuara te hyrja me dy tumula mund të klasifikohen si protoqytetare Veliki dhe Mali Oblja në Gornje Vrhovne të rrethuara me mure prej bllo qesh të papunuara.[39] Mjaft i afërt me Jagodinjën liburne është edhe Vijenaci, ku përveç tumulave t hyrja ndeshim edhe tarracat e brendshme.[40] Në ra jonet e brendshme do të qëndronin si protourban ose edhe qytetare fortifikimet në Magdalenska Gor dhe Vishnji Gori, ku hyrjet janë tërthore.[41]

IV. Zgjedhja e vendit

Fortifikimet e hershme përbëjnë ende raste t veçuara për të nxjerrë karakteristika për vendosje dhe trajtimin e tyre. Nuk është ende i qartë funk sioni i fortifikimit neolitik të Kamnikut ku ishte për qëndruar një aktivitet ekonomik i bashkësisë, pro dhimi i qeramikës. I ngritur mbi një kalim të për shtatshëm nga pllaja e Kolonjës në luginën e but e të ngrohtë të Përmetit, ai mund të përftonte një kohësisht edhe nga lëvizjet e mundshme midis d krahinave. Megjithatë, Kamniku ishte mjaft i izo luar, po të krahasohej me vendbanimin e hapu bashkëkohës të Maliqit. Fortifikimet që datohen n

35) **Po aty,** fig. 2,20 dhe **Ostava iz Jagodinje Gornje u okviru zadnje faze liburnska kulture, «Diadora»** 7, 1974, fq. 160-164, fig. 1. Tab. IX, 5 e 7, qeramikë e tipit antik e fillimit të shek. V p.e.s. Një karakter të njëjtë ka fortifikimi i Radovinës pranë Zadrës, i vendosur në afërsi të bregdetit, midis dy gjireve. Sipërfaqja prej rreth 3.5 ha rrethohet sipas formës së terrenit me një mur me planimetri trekëndëshe. Tipike janë dy tumula të vendosura te hyrja, njëlloj si në Jagodinjë. Shtresa kulturore përmban dy faza pararomake të lidhura me fillimet e vendbanimit të shek. XI-X dhe me zhvillimin e plotë të tij në shek. VII-VI p.e.sonë. Me këtë të fundit duhet të lidhet edhe ndërtimi i fortifikimit dhe një radhë kthinash të tipit punishte apo dyqane. Një fazë të njëjtë protoqytetare ka kaluar edhe qyteti liburn i arvaries, ku janë gjetur shtresa kulturore të ngjashme me të Radovinit, por fortifikimin përkatës të tij ende nuk e njohim. shih: S. Botoviç, **Istrazivanje ilirskoj naselja u Radovinu,** «Diadora» 4, 1986, fq. 54-56.

36) Krks. Tab. XII a dhe b tek S. Botoviç, **Caracteristiques des aglomerations,** ... fq. 219, i cili dallon në përgjithësi një teknikë ndërtimi paraqytetare të shek. V-IV, p.e.s. dhe një qytetare të shek. III-I p.e.sonë.

37) V. Miroslavljevic, **Gradina i gradinski sistem u prethistorijsko doba,** «Arheoloski radovi i rasprave», VII, 1974, fq. 276, fig. 8b.

38) Po aty, fq. 277, fig. 4b. Për një grup tjetër fortifikimesh istriane përcaktimi në fazën protourbane mund të bëhet në sajë të tipit të përparuar të hyrjeve. Të tillë janë Magadani pranë Rovinjës ku hyrjet shoqërohen me mure në formë korridori, si në Kalivo, ose Karastak e Vrçin ku paraprihen nga një oborr i vogël i fortifikuar dhe Kunci, ku korridori ka gjerësinë e murit, por ngushtohet si në Kalivo ose trajtohet me zigzake si në Pepel. Shih, B. Bacic. **Prilozi poznavanju prahistorijske gradinske fortifikacija u istri,** «Adriatica Praehistorica et Antiqua» Zagreb, 1970, fq. 215-218, fig. 1,2, f. 220-221, fig. 7 dhe fq. 218, fig. 3,5.

39) R. Drechsler–Bizic, **Caracteristiques des agglomerations fortifiées dans la region centrale des japode,** «UIN» fq. 78, fig. 3.

40) **Po aty,** fq. 76.

41) S. Gabrovec, **Uberblick uber eisenzeitliche Befestigungen, in Slovenien,** «UIN» fq. 60, fig. 1. Për nga trajtimi i hyrjeve me një korridor të brendshëm apo vendosja e tumulës në hyrje mund të shtoheshin edhe Libna dhe Çepna japode. Shih M. Gustin, **Gradisca zelezne dobe Sloveniji** Archeoloski vestnik, 1978, fq. 119, fig. 5,8, fig. 11.

DO NOT COPY

kohën e hershme të bronxit në trevat dalmate, në Glasinac dhe në trevat liburne,[42] përbëjnë ende shfaqje të izoluara pa formuar sisteme mbrojtje. Nga vendosja ato nuk dallojnë nga fortifikimet e kohës së vonë të bronxit.

Një sistem i vërtetë fortifikimesh krijohet në trevat ilire vetëm në periudhën e vonë të bronxit, nën veprimin e faktorëve të njohur ekonomikë dhe shoqërorë. Numri i këtyre fortifikimeve është ende i paktë, gjë që pasqyron edhe dendësinë e popullsisë. Vendosja e tyre, nga ana tjetër dëshmon pak për një rol ekonomik kryesor. Fortifikimet më të rëndësishme si Trajani, Lleshani, Karosi etj gjenden në zona të brendshme, të izoluara nga rrugët kryesore natyrore, por në afërsi të drejtpërdrejtë me kullotat. Lartësitë ku janë vendosur këto fortifikime arrihen me vështirësi dhe shpesh janë të fshehura nga syri (Lleshan, Dedejan). Një kërkesë tjetër ndaj vendit të zgjedhur ishte mbrojtja natyrore e tij, me anë të pakalueshme nga rrëzimet shkëmbore, si dhe prania e materialit të ndërtimit, kryesisht blloqe të gatshme gurësh, që mund të mblidheshin në sipërfaqe.

Vendosja e fortifikimeve të periudhës së vonë të bronxit është e lidhur me karakterin e tyre, kryesisht si vendstrehim për njerëzit dhe pasurinë e tyre. Kjo provohet nga njëra anë prej tendencës së vogël të banimit brenda murit rrethues që shprehet me numrin e vogël të gjetjeve arkeologjike. Së dyti në trevat ku ngrihen këto fortifikime vendbanimet kryesore mbeten ato të hapura, në zonat e ulëta kodrinore buzë fushave. Ky raport del i qartë në lidhjen midis fortifikimit të Trajanit, Bellovodës, Lumalasit, Podgories etj. dhe numrit të madh të vendbanimeve të hapura, ku Maliqi zotëron me shtrirjen dhe dendësinë e banimit. Ky raport mund të kuptohet si një shprehje e karakterit të ndryshëm ekonomik të tyre, duke parë te fortifikimet një formë të lidhur kryesisht me ekonominë blegtorale, ndërsa te vendbanimet e hapura, formën më të përshtatshme për bujqësinë.[43] Nuk do të kundërshtonim me këtë edhe mundësinë që një pjesë e fortifikimeve të shërbenin në rast nevoje si vendstrehim për popullsinë e vendbanimeve të hapura. Madje në zona të veçanta të orientuara nga ekonomia blegtorale, siç është p.sh. Glasinaci, është vënë në dukje një zotërim i fortifikimeve të pabanuara[44], që shërbenin si vendstrehime dhe, me sa duket, stane të kopeve.

Në fazën e dytë të zhvillimit të fortifikimeve paraqytetare që e kemi cilësuar si Gajtan-Tren, del në pah karakteri ekonomik i tyre. Kjo është e lidhur me ndarjen e një sektori të tretë ekonomik, të karakterit zejtar, brenda veprimtarisë prodhuese të bashkësisë. Gajtani dhe Treni kanë dhënë dëshmi të qarta të prodhimit të qeramikës dhe njëkohësisht të një banimi të dendur, që përfaqësohet nga shtresat kulturore[45]. Gajtani na dëshmohet gjithashtu edhe si qendër kulti me veçimin brenda hapësirës së fortifikuar të një vendi të posaçëm të mbushur me urna me eshtra fëmijësh.[46]

Ndryshimet në karakterin e fortifikimeve të epokës së hekurit pasqyrohen edhe në zgjedhjen e vendit për ngritjen e tij. Një kusht i rëndësishëm bëhet afërsia ndaj burimeve ekonomike siç ishin territoret bujqësore, rrugët, ujërat, minierat etj. Në përgjithësi gjatë fazave I-II të epokës së hekurit (shek. XI-VII) ka një lëvizje nga lartësitë drejt fushave, që pasqyrohet edhe në praktisjen e mjaft fortifikimeve të bronxit të vonë.

Kjo është e lidhur me përparësinë që fitoi bujqësia mbi ekonominë blegtorale dhe me interesin për prodhimin zejtar, shkëmbimin dhe rrugët tregtare. Për këtë arsye nuk është e rastit që fortifikimet e kësaj periudhe gjenden në lartësi të vogël mbi fusha ose fare pranë rrugëve të rëndësishme natyrore.

Marrja e një funksioni të dyfishtë, mbrojtës dhe ekonomik, çoi në një kufizim të numrit të fortifikimeve të tipit Gajtan. Kjo është më e shprehur veçanërisht në rajonet më të zhvilluara, siç ishin fusha bregdetare ilire dhe fusha e Korçës, ku rrjetit të dendur të fortifikimeve të epokës së bronxit u përgjegjen vetëm pak fortifikime të epokës së hekurit, por me një jetë të dendur. Në krahinat e brendshme

42) Shih. A. Benac, **Utverdena ilirska naselja,** Sarajevo, 1985, fq. 190, B. Covic. **Die Befestigungen und befestigte Siedlungen der Glasinacen Gebietes,** «UIN» fq. 94, S. Batovic, Carasteristiques. . . . , fq. 223.

43) F. Engels, **Origjina e familjes, pronës private dhe shtetit** tek. K. Marksi, F. Engels, **Vepra të Zgjedhura,** Tiranë, 1968, fq. 239 e quan një dukuri tipike veçimin e prodhuesve bujqësorë nga ata blegtorë në shkallën e mesme të barbarisë, që në kronologjinë tonë përkon me periudhën e vonë të bronxit.

44) A. Benac, **vep.cit,** fq. 198 – 201. Në pllajën e Glasinacit del të kenë qenë banuar vetëm një e treta e fortifikimeve.

45) Shih. M. Korkuti. **Vendbanimi prehistorik i Trenit,** «Iliria» I, 1971, fq. 31 – 47 dhe N. Ceka, **Lindja e jetës qytetare,** fq. 152-153.

46) S. Islami – H. Ceka, **Të dhëna të reja për lashtësinë ilire, në territorin e Shqipërisë,** «Konferenca I e Studimeve Albanologjike», Tiranë, 1964, fq. 449.

DOKTORATË

dhe trevat veriore pati edhe një vazhdimësi më të gjatë të tipave të hershëm.

Është shfaqur mendimi se fortifikimet prehistorike në disa raste formojnë sisteme unike mbrojtëse rreth një treve të përcaktuar nga pikëpamja gjeografike dhe si të tilla lidhen me krijimin e federatave fisnore.[47] Për fushën e Korçës janë marrë në konsideratë fortifikime të kohëve të ndryshme, kryesisht të kohës së bronxit, pra para formimit të federatave. Për më tepër nuk është pasur parasysh edhe vetë karakteri i këtyre fortifikimeve, që në pjesën më të madhe janë vendstrehime dhe jo vendbanime të mirëfillta që mund të luanin një rol ekonomik dhe mbrojtës në territorin e federatës. Më i qartë është raporti midis fortifikimeve të së njëjtës periudhë në bregdetin kaon. Krahas fortifikimit kryesor të Karosit, ka një numër fortifikimesh të vogla si Gjashnjari, Badhra, Qyteza e Himarës, Kalaja e Himarës, Pirgu i Iljazit etj që mbulojnë pothuajse të gjitha mikrozonat. Ekzistonte njëkohësisht edhe tipi i vendbanimit, të hapur, të dëshmuar nga gërmimet në Ngurë të Qeparoit[48]. Megjithatë, pa u sqaruar karakteri i secilit prej tyre, është e parakohshme të nxirren përfundime për natyrën e bashkësisë që formonin vendbanimet e fortifikuara e të hapura dhe vendstrehimet e një krahine. Duhet menduar se një sistem mbrojtjeje me një rrjet fortifikimesh është një koncept mjaft i përparuar që zbatohet vetëm në periudhën qytetare.

Në fazën protoqytetare ndryshimet sasiore të arritura në vendbanimet e tipit Gajtan u transformuan gjatë shek. VII-V p.e.s në një revolucion të tërë në karakterin dhe format e vendbanimeve, thelbi i të cilit është kalimi në rendin skllavopronar. Megjithatë, ndaj vendosjes së fortifikimeve periudha e re nuk shtroi kërkesa të reja, por vetëm theksoi ato ekzistuese: mbrojtjen natyrore dhe afrinë ndaj burimeve ekonomike. Kjo është arsyeja që një pjesë e vendbanimeve të fazës paraardhëse si Belshi, e Selca e vazhduan jetën. Sidoqoftë dendësimi i veprimtarisë ekonomike solli nevojën e ngritjes së qendrave të reja të fortifikuara. Kështu u krijua një grup fortifikimesh protoqytetare në krahinën e pasur të bylinëve me Klosin, Belishovën, Mashkjezën, Gurzezën dhe Margëlliçin. Nga ana tjetër veproi edhe një seleksionim i qendrave të vjetra në dobi të atyre që kishin kushte më të përshtatshme për veprimtarinë ekonomike. Kjo do të ishte edhe arsyeja përse u braktis Gajtani në prag të fillimit të fazës protoqytetare, kur zotëroi plotësisht si qendër ekonomike vendbanimi i Shkodrës, vetëm 8 km larg tij, por me një pozitë qendrore ndaj fushës dhe kryqëzimit të rrugëve tregtare. Një grup i tretë vendbanimesh u implantuan në këtë fazë si qendra qytetare në formën e ngulimeve helene të Dyrrahut (627 – p.e.s) Apolonisë (588 p.e.s) dhe Orikut (shek. VI), Ambrakisë dhe ngulimeve të Elejve në Epir, Heraklesë në bregdetin dalmat.



Fig. 28

Në fazën protoqytetare krijohen edhe fortifikimet pranë skelave natyrore. Vetëm pak prej tyre si Treporti apo Varvaria liburne qenë vendosur në breg të detit. Vendi më i pëlqyer ishte një lartësi në brendësi të steresë që lidhej me detin nëpërmjet një lumi të lundrueshëm. Shembuj tipikë për këtë janë Buthroti, Kalivoja dhe Lisi. Në trevat veriore fortifikimet protoqytetare u zhvilluan edhe në ishujt liburnë apo istrianë (Holmac) ose në gadishujt e shumtë, siç ishte Radovin.

Procesi i krijimit të vendbanimeve protoqytetare me të cilat duhet kuptuar çdo lloj vendbanimi i lidhur me format e reja të prodhimit dhe shkëmbimit të mallrave, nuk ishte i njëllojtë për tërë trevat ilire. Dallohen për këtë trevat bregdetare midis gjirit të Artës dhe Dyrrahut dhe trevat e enkelejve e pajonëve, ku ky proçes zhvillohet që nga mesi i shek. VII, ndërsa ato më veriorë patën një vonesë prej rreth një shekulli. Nga fundi i shek. VI p.e.s fillon proçesi i urbanizimit edhe në trevën e Dardanisë.

47) Gj,. Karaiskaj, – P. Lera, **Fortifikimet e periudhës së parë të hekurit në pellgun e Korçës,** Kuvendi I i Studimeve Ilire, I, 1974, f. 272

48) J. Koçi, **Gërmime arkeologjike në fshatin Qeparo të Vlorës** Buletin arkeologjik 5. 1975, fq. 62.

DO NOT COPY

DOKUMENT

Në numrin e madh të vendbanimeve protoqytetare fortifikimet zenë një vend të rëndësishëm dhe bëhen forma përcaktuese. Ato janë vendosur mbi lartësi nga zotërohen fusha pjellore ose rrugë të rëndësishme dhe qarkohen nga një rrjet vendbanimesh të hapura. Kështu grupimi i fortifikimeve protoqytetare byline të Margëlliçit, Gurzezës, Belishovës, Mashkjezës dhe Klosit është vendosur përgjatë rrugëve natyrore në luginën e Gjanicës dhe të Vjosës, por formon edhe një sistem të plotë kontrolli mbi krahinën. Kjo është e lidhur edhe me krijimin e një sistemi mbrojtës, prapa të cilit qëndronte një bashkësi politike e krahinës.

Në zgjedhjen e vendit për fortifikim vazhdojnë të ruajnë rëndësinë e tyre edhe faktorët e sprovuar nga përvoja e gjatë, siç janë kërkimi i një kodre zotëruese, të mbrojtur nga natyra dhe të pasur me formacione shkëmbore për ndërtimet. Njëkohësisht theksohet kërkesa për sipërfaqe të përshtatshme për banim. Për këtë shfrytëzohen edhe terrene të pjerrëta brenda apo jashtë fortifikimit, gjë që lidhet me një tip banese me gjysmë kat apo me hajat.

V. Trajtimi i hapësirës së fortifikuar

Nuk ka dyshim se ideja e fortifikimit të një hapësirë lindi nga një përvojë e gjatë dhe njëkohësisht nga një nevojë e domosdoshme. Duhet menduar se modelin për krijimin e tyre e dhanë ndërtimet e drunjta që bëheshin rreth banesave apo vathat e bagëtive. Kjo mund të shpjegonte përse fortifikimet më të hershme si Luarasi, Koshutica, Kushaçe, Strane etj janë në terrene të rrafshëta dhe disa prej tyre kanë formë gjeometrike. Veçanërisht tipike janë Koshutica, një trapez me brinjë 50 m dhe Strane, një romb me brinjë 15 m, që përsërisnin forma të mundshme të vathave. Të dy kanë edhe një krah muri përpara hyrjes, gjatë futjes në sipërfaqen e fortifikuar. Hapësira e vogël, e përfshirë brenda mureve, dhe shtresat e varfra kulturore dëshmojnë se këto fortifikime nuk qenë vendbanime të përhershme. Badhra na ka dhënë për këtë një shpjegim të mundshëm sepse atje banesat gjenden të vendosura jashtë fortifikimit në anën e kundërt të hyrjes[49]. Kjo tregon se fortifikimi ende nuk është konceptuar si një element mbrojtës i vendbanimit dhe hapësirës e këtij të fundit përdorej në mënyrë të pavarur. Në këto kushte fortifikimi mund të shërbente si një vathë e përhershme për bagëtitë e bashkësisë dhe si vendstrehim i përkohshëm i saj.

Gjatë periudhës së vonë të bronxit zhvillimi ekonomik-shoqëror me krijimin e shtresave në gjirin e bashkësisë, grumbullimin e pasurive, shtimin e armëve dhe luftërave, por edhe përqendrimin e aktiviteteve ekonomike në vendbanimet më të përshtatshme, krijoi kushte të reja për zhvillimin e fortifikimeve. Detyra kryesore që shtrohej përpara ndërtuesve të tyre ishte bashkimi në një të vetme i hapësirës së banuar dhe asaj së fortifikuar. Ishte pikërisht ky drejtim që njohu risitë më të mëdha, ndërkohë kur teknika e ndërtimit mbeti në një nivel të ulët, për shkak të mundësive të kufizuara të veglave të punës.

Një përpjekje të hershme për bashkimin e të dy sipërfaqeve do të përfaqësonte Kushaçe dhe Çeljank, ku pjesa e banuar i ngjitet asaj së fortifikuar duke u përforcuar vetëm me një mur tarracimi. Në Kulla, që ka formën gjeometrike të një katërkëndëshi me brinjë 50 m, janë bashkangjitur dy tarraca të banuara, prej të cilave mund të mbrohej njëkohësisht edhe hyrja (fig. 28)[50].

Zgjidhja e dytë, më tipike, është bashkimi i të dy sipërfaqeve brenda një rrethimi të vetëm, por duke i ndarë me një mur të brendshëm. Ndoshta në Luaras kjo bëhet duke rrethuar me një mur të dytë sipërfaqen e banuar përpara pjesës së fortifikuar, një zgjidhje që është zbatuar edhe në fortifikimin e epokës së bronxit në Veliki Gradac të Privalit në

STIPANIÇ



Fig. 29

49) Kjo dukuri që ndeshet edhe në Kushaçe mund të shpjegohet me synimin për të mënjanuar ngatërrimin e bagëtive midis banesave gjatë futjes ose daljes nga fortifikimi.

50) B. Covic, **Die Befestigungen,** fq. 97, tab. II, 3.

DO NOT COPY



Fig. 30



Fig. 31

Glasinac.[51] Glasinaci na jep një variant tjetër të kësaj zgjidhjeje kur fortifikimi me ndarje paralele vendoset buzë një rrëpire si në Gradinën e Stipaniçit (fig. 29) dhe të Vidoshit[52]. Në të dy fortikimet kemi një komunikim midis pjesëve të veçanta; por edhe funksioneve të ndryshme të tyre, ku ndarja më e vogël, por më e mbrojtur ka një hyrje më vete. Edhe Kerin e Veliki Gradac i Prevalit përfaqësojnë zgjidhje mekanike me bashkimin e të dy sipërfaqeve, që komunikonin me njëra-tjetrën dhe kishin një hyrje të jashtme të përbashkët.[53] Një bashkim të përafërt të sipërfaqeve ndeshim edhe në Kalanë e Barmashit, ku ato janë vendosur në dy shpatet e kodrës.[54] Në Karos zgjidhja është e plotë dhe të tri ndarjet brenda rrethimit kryesor i takojnë së njëjtës kohë.[55]

Mënyra e kombinimit të sipërfaqeve dha një numër zgjidhjesh ku parimi kryesor është koncentrimi. Gjithashtu gjatë këtyre zgjidhjeve bëhet edhe kalimi nga format racionale gjeometrike të ndërtuara në terrene të sheshta, në format e parregullta, si rrjedhim i përshtatjes ndaj terreneve të thyera, që synonin një mbrojtje më të sigurtë. Për këtë arsye rrallë kemi një zgjidhje ideale me rrathë koncentrikë, siç është Porati në Kerk, Verçevo apo Mbolani.[56] Kjo figurë në disa raste ndërpritet nga vendosja në buzën e një rrëpire siç ndodh në Knezhak të Molatit, Sekoviç[57] (fig. 31), apo në Karos. Do të

51) Shih. resp. Gj. Karaiskaj, S. Aliu, **Vendbanime të fortifikuara në pllajën e Kolonjës, e në rrjedhjen e sipërme të luginës së Osumit,** «Monumentet».

52) A. Benac, **Vep.cit,** fq. 45-46, Tab. 8, fq. 97-98. Në Gornji Gradac të Pagut të dy sipërfaqet e bashkuara brenda një muri të vetëm rrethor janë të ndara nga njëra-tjetra dhe kanë hyrje të veçanta në anë të kundërta. Një konceptim të përafërt ka Zeliça, me dy sipërfaqe katërkëndëshe të bashkangjitura, që ndryshojnë nga madhësia sipas funksionit apo Bulbin, ku sipërfaqet janë gjysmëeliptike. shih: S. Batovic, **Prapovijesni ostavi nazadarskom otocju** «Diadora» 6, 1973, fig. 7.

53) A. Benac, **vep.cit,** fq. 42-44., Gj.

54) Gj. Karaiskaj, S. Aliu, **art.cit,** fq. 85-86, fig. 10.

55) J. Koçi, **Kalaja e Karosit,** «Iliria» VI, 1976, fq. 238.

56) Shih. resp. P. Mijoviç, M. Kovaçeviç, **Gradovi i utverdenja...** fq. 8-9, A. Benac, **Vep.cit,** fq. 183, S. Batoviç, **art.cit,** fig. 2, 18, N. Ceka; **Monumente antike dhe mesjetare në luginën e Osumit,** «Monumentet» 5-6, 1973, fq. 121 — 123.

57) S. Batoviç, **art.cit,** fig. 2, 11, M. Kosoriç **Praistorijsko naselje Gradina u Savicima kad Sekorica,** «GZM» 38, 1983, fq. 73-94.

përbënin një tip tjetër zgjidhjet kur rrathët takojnë në një pikë si Gradaci pranë Crvena Stijenes, Kalmi dhe Pukovinie te liburnët apo Vahta dhe Martin te japodët.[58] Zgjidhja më e përhapur është ajo kur ndarjet bëhen brenda rrethimit kryesor. Në këtë rast mund të veçohet vetëm një sipërfaqe e vogël në pjesën më zotëruese në formën e një «akropoli» si në Lleshan e Marshej[59]. Varianti më i përhapur i këtij tipi është kur ndarjet bëhen me harqe paralele që nisen nga muret anësore. Përfaqësues do të ishin Trajani, Kiçin te daorsët, Budini, Otoni, Dusharri te liburnët, Poshtela Volçje, Sv. Mihael Gradishta te japodët etj.[60]

Gërmimet arkeologjike nuk kanë sqaruar ende funksionet që mund të kishin hapësirat e ndara brenda fortifikimeve. Në rastet kur ato janë vetëm dy mund të mendohet për një dallim të pjesës së banuar prej asaj të përcaktuar për strehimin e bagëtive. Një ndarje e tretë apo e katërt mund të kishte kuptimin edhe të dallimit të një zone kulti në pjesën më të sipërme apo të njëfarë **intervallum** në atë të poshtme. Vrojtimet në disa qendra të kësaj periudhe si Kalaja e Dedejanit, Vrçevo tek liburnët, Çunshi, Stan; Ilovica, Bulbin etj tek istrët apo Rep, Creshnjevec etj. tek japodët dëshmojnë për organizimin racional të hapësirës së banuar në tërren të pjerrët. Kjo është arritur nëpërmjet krijimit të tarracave mbi të cilat ngriheshin banesat.

Në fazën e dytë të zhvillimit të fortifikimeve paraqytetare, që e kemi cilësuar si Gajtan, funksioni kryesor i tyre është sigurimi i banimit të përhershëm dhe i një veprimtarie ekonomike parazejtare siç është prodhimi i qeramikës, i metaleve apo edhe i shkëmbimit brenda bashkësisë. Në kushte të tilla vendbanimi ishte i lidhur kryesisht me ekonominë bujqësore dhe nuk kishte nevojë të domosdoshme për një ndarje të sipërfaqes së fortifikuar nëpërmjet mureve të brendshme. Pjesa më e madhe e fortifikimeve të tipit Gajtan kanë sipërfaqe të rrethuar nga një mur i vetëm, por vetë Gajtani ka treguar se ajo është e organizuar në njëfarë mënyre. Sheshi më i përshtatshëm dhe më pranë kontaktit me rrugën që lidhte fortifikimin me rrethinat ishte lënë aty për veprimtarinë shoqërore. Sipërfaqja e tij prej rreth 300 m^2 ishte ndarë në dy pjesë nga rruga që vinte nga jashtë përmes një hyrjeje në pjesën më të poshtme të fortifikimit. Në njërin prej tyre ishin vendosur furrat për prodhimin e qeramikës, ndërsa në tjetrën një grup urnash me eshtra fëmijësh me funksione të qarta kulti.[61]. Të dy veprimtaritë janë ushtruar për një kohë të gjatë, siç e dëshmonin horizontet e shumta të furrave dhe ripërtëritja e urnave në fazën III të Gajtanit (shek. VIII-VII p.e.s).

Ky veçim i zonës shoqërore kishte bërë të nevojshme në Gajtan edhe një komunikim të veçantë për zonën e banuar, të vendosur në dy shpatet e kodrave që përfshinte fortifikimi. Hyrja është vendosur aty në qendër të pjesës më të lartë, duke krijuar mundësi për një lëvizje më të lehtë në të dy pjesët e sipërfaqes së banuar.

Trajtimin pa ndarje të sipërfaqes së fortifikuar e ndeshim edhe në Tren, ku ajo është mjaft e kufizuar, e llogaritur vetëm për atë pjesë të bashkësisë që merrej me një veprimtari të caktuar ekonomike apo shoqërore. Në Iljak të Glasinacit na përsëritet tipi i Gajtanit me një sipërfaqe të gjerë, pa ndarje, me hyrjen në pjesën më të poshtme të fortifikimit.[62]

Për qendrat protoqytetare kërkesa kryesore për hapësirën e përfshirë në fortifikimet ishte përshtatshmëria e saj për banim të përhershëm dhe veprimtarinë ekonomike. Kjo e dallonte nga fortifikimet paraqytetare ku hapësira sa më e gjerë duhet të kishte vetëm një pjesë për këto qëllime, ndërsa pjesa tjetër do të shërbente edhe për strehimin e njerëzve dhe të bagëtisë. Fortifikimi protoqytetar ishte për kë-

58) Shih Resp. P. Mijoviç, M. Kovaçeviç, **Vep.cit,** fq. 9, S. Batoviç, **Art.cit,** fig. 3, 14, 4, 21. M. Gustin, **Gradisca zelezne dobe u Sloveniji,** «Arheoloski Vestnik» XXIX, 1978, fig. 5, 3, 4.

59) Shih. N. Ceka, **Fortifikimet parahistorike ilire,** «Monumentet», 1, 1985, fq. 32, 36.

60) **Po aty,** fq. 30-38.

61) Mund të mendohet për një lidhje të tyre me murin rrethues, por kryesisht grupimi i urnave duket se ka një funksion shoqëror kulti për të gjithë bashkësinë.

62) B. Covic, **Die Befestigungen und befestigte Siedlungen des Glasinacer Gebietes,** «UIN» f. 94. Në trevat veriore fortifikimet e tipit Gajtan ruajnë ende elemente të ndarjes së veçantë të sipërfaqes si në Vela Strazha që zhvillohet mbi bazën e një fortifikimi më të hershëm, i cili mbetet në rolin e akropolit. Në Stiçna që është mjaft e ngjashme me Gajtanin dhe Iljakun nga trajtimi i hapësirës dhe vendosjes e hyrjeve, ndarjet janë shtuar në periudhat më të vona të zhvillimit të vendbanimit, ndoshta edhe për krijimin e kushteve të veçanta të mbrojtjes së nipërfaqen e gjërë prej 16 ha. Shih: V. Mirosavlevic, **Gradine i gradinski sistem u prethistorijsko, doba»,** «Arheoloski Radovi i rasprave» VII, 1974, fq. 274; S. Grabrovec, **Uberblick uber eisenzeitlichen Befestigungen in Slovenien,** «UIN» fq. 64, 68.

DO NOT COPY

DOWNLOAD COPY

të arsye vendbanimi i përhershëm i një grupi të vogël njerëzish, ndërsa ai paraqytetar një vendbanim i përkohshëm për masën më të madhe të njerëzve që gjenin aty një vendstrehim në rast rreziku. Kjo përcaktoi edhe një trajtim të ri të hapësirës brenda dhe jashtë murit rrethues.

Në zhvillimin e tij spontan, vendbanimi protoqytetar i takonte një bashkësie të qëndrueshme njerëzish të bazuar jo në lidhjet e gjakut, por në veprimtarinë ekonomike, në prodhimin dhe shkëmbimin e mallrave. Si rrjedhim, në hapësirën e vendbanimit zona e banuar dhe ajo ekonomike shoqërore ishin njëlloj të rëndësishme. Sipas mundësive që jepte terreni, në ndarjen e tyre janë krijuar dy zgjidhje kryesore. E para, që i trajton të dy zërat brenda murit rrethues, është tipike për vendbanimet me sipërfaqe të madhe. Shembulli është Margëlliçi, ku zona e banuar është vendosur në tarracat e krijuara buzë murit rrethues, duke lënë të lirë për veprimtarinë ekonomike shoqërore pjesën qendrore.

Zgjidhja e dytë është tipike për vendbanimet ku hapësira e fortifikuar është mjaft e vogël dhe nuk jepte mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të dy zonave brenda mureve. Edhe këtu në fillimet e vendbanimit protoqytetar zona e banuar dhe ajo ekonomike kanë qenë vendosur brenda murit rrethues. Rasti i Mashkjezës dëshmon se vetëm pak kohë pas kësaj, në gjysmën I të shek. VI p.e.s, një pjesë e madhe e zonës së banuar ka qenë shtrirë jashtë mureve, në shpatin jugor dhe perëndimor të kodrës.[63] Brenda mureve banesat mbeten të vendosura në brezaren e murit rrethues, duke lënë të zbrazur sheshin qendror. Një ndarje të njëjtë të zonës së banuar **infra** dhe **extra muros** e kemi edhe në Belsh, ku një pjesë e zonës së banuar zhvillohet pa ndërprerë në lagjen e jashtme që ekzistonte që nga vendbanimi paraqytetar.[64] Kjo ndarje është tipike edhe për vendbanimin protoqytetar të Podit pranë Bugojnos në Bosnjen Qendrore. Këtu ndiqet në mënyrë të qartë edhe proçesi i lirimit të sheshit qëndror për veprimtarinë ekonomike-shoqërore nga ngushtimi i zonës së banuar brenda murit rrethues, i cili shoqërohet me një vendosje të rregullt të banesave në këtë të fundit.[65] Orientimi i banesave dhe ndarja e tyre nga rrugica ndërmjet dy rrugëve kryesore që ndërpriten në sheshin qendror, është një e dhënë për futjen e koncepteve urbanistike. Një shembull tjetër i organizimit të hapësirës brenda fortifikimit protoqytetar është Radovin i liburnëve, ku sheshi qendror është lënë i lirë dhe drejt tij qenë kthyer hyrjet e një vargu kthinash, me sa duket dyqane, ndërkohë kur midis tyre dhe murit rrethues ishte lenë një hapësirë si **intervallum**[66].

VI. **Trajtimi planimetrik**

Në zgjidhjet planimetrike të fortifikimeve paraqytetare kemi një evolucion të gjatë nga format e hershme racionale, të huazuara nga ndërtimet e vogla, në format iracionale, sipas përshtatjes së terrenit, dhe një rikthim tek racionalja, por kësaj radhe në bazë të funksioneve të reja që merrte fortifikimi në kuadrin e jetës urbane.

Format e rregullta gjeometrike të fortifikimeve të periudhës së bronxit na janë dëshmuar gjer më sot kryesisht në trevat e Veriut. Përfaqësues më tipikë janë Koshutica, Kula dhe Gradishta në Iz Mali në formën e një trapezi të çrregullt, Strane në formë rombi të zgjatur dhe Laçe në formë pesëkëndëshi[67]. Edhe Kushaçe i takon këtij tipi gjeometrik me kombinimin e formës rrethore të fortifikimit me atë me këndë në zonën e banuar. Kthesat me këndë nuk i përshtaten nivelit të ulët të ndërtimit dhe përfaqësojnë një zbatim të formave që realizoheshin lehtë në ndërtimet me dru. Një përhapje më të gjerë kanë format e rregullta rrethore dhe eliptike që gjithashtu trashëgonin nga ndërtimet e drunjta. Të tilla janë Marshej, Shueci, Luaraci, Pirgu i Iljazit, Gradec i Crvena Stijenës, Osovo, Sv. Juraj në Hvar, Molat,[68] etj. Këta duhet të jenë edhe fortifikimet më të hershme që mund të vendosen nga periudha e hershme në periudhën e mesme të bronxit. Forma gjeometrike pak a shumë e rregullt, përveçse përbënte një zgjidhje të gatshme të sprovuar më parë nga ndërtimet me dru, ishte e përshtatshme edhe për sipërfaqet e vogla që karakterizohen fortifikimet e kësaj kohe. Fuqizimi i bashkësive gjatë periudhës së vonë të bronxit rriti kërkesat për sipërfaqen e fortifikuar. Kjo bëri të nevojshme përshtatjen ndaj

63) N. Ceka, **Lindja e jetës qytetare...**, fq. 152.
64) N. Ceka, **Vendbanimi i hapur pranë qytezës ilire të Belshit,** «Iliria» III, 1974, fq. 435-442.
65) B. Covic, **Pod bei Bugojno...**, 121, fig. 3-5.
66) S. Batovic, **Istrazivanje ilirskog naselja u Radovinu,** «Diadoro» 4, 1968, fq. 58. Tab. X.
67) N. Ceka, **Fortifikimet parahistorike,** fq. 38-39.
68) **Po aty,** fq. 34, 35, 36, 38.

terrenit që për mundësitë e kufizuara teknike nuk mund të arrihej më me format gjeometrike. Megjithëse në trajtimin e përgjithshëm figura planimetrike zotërohet nga trajtat eliptike apo rrethore, risia kryesore në planimetrinë e kësaj kohe janë ndarjet e brendshme. Nuk është e rastit që ato ndeshen që në format e rregullta gjeometrike në Knezhak të Molatit, Porat të Krkës, Kalm të Kreshit, Pukovinjë, Sv. Martin etj.

Me tipat e Karosit, Trajanit, Kiçin, Oton, Poshtela etj bëhet një hap për të kaluar në formën iracionale që i përshtatet më mirë terrenit. Me këtë rast planimetria zhvillohet mbi bazën e një sipërfaqeje qendrore duke e shtuar hapësirën e fortifikuar me disa harqe muresh. Lleshani, Mbolani, Barmashi, Volçje etj duket se përfaqësojnë fazën e fundit të zhvillimit të planimetrisë tipike për epokën e bronxit. Në to ruhet ende një lloj koncentrizmi i mureve, rrethuese, por njëkohësisht mure të tjera të brendshme kalojnë sipas drejtimit të rrezeve, duke krijuar ndarje tërthore në sipërfaqen e fortifikuar. Kjo është edhe koha kur planimetria përvijohet pjesërisht edhe nga linja natyrore e rrëzimeve shkëmbore që shfrytëzohen për të kursyer punën që do të duhej për ndërtimin e një rrethimi të plotë.

Megjithëse planimetria me disa ndarje është forma më tipike e fortifikimeve të epokës së bronxit, bashkëjetuan me të edhe format e thjeshta me bazë rrethore apo eliptike, veçanërisht për fortifikimet e vogla.

Për fazën e dytë të zhvillimit të fortifikimeve paraqytetare (Gajtan) planimetria synon të përfshijë një sipërfaqe sa më të përshtatshme për banim, duke shfrytëzuar në shumicën e rasteve rëniet shkëmbore. Ndodh për këtë arsye një largim nga format gjeometrike megjithëse përshtatja ndaj terrenit me linja të gjata e të drejta jep figura shumëkëndëshe si në Gajtan, Iljak, Stiçna, etj. Ndërsa në kohën e bronxit traseja e mureve ishte e shkëputur nga funksionet e banimit, me fortifikimet e tipit Gajtan ajo përfshihej në detyrën e zgjerimit të sipërfaqes së banuar dhe në disa raste përbën tarracën kryesore të banuar. Këtë funksion e ndeshim në Gajtan e Tren, ku muri rrethues formon tarracat kryesore për zonën e banuar, apo atë ekonomike-shoqërore.

Tipari kryesor në planimetritë e fortifikimeve protoqytetare është kalimi drejt formave gjeometrike me përdorimin e këndeve të drejta apo të gjëra. Kjo i dallon ato nga fortifikimet paraqytetare, ku traseja e mureve mbështetej te vijat e drejta apo të lakuara. Shembulli më i qartë i një fortifikimi protoqytetar është Mashkjeza, i datuar nga shtresa kulturore si një ndërtim rreth gjysmës II të shek. VII p.e.sonë[69]. Forma e planimetrisë së tij është pothuaj katërkëndëshe këndrejtë dhe traseja ndjek linja të gjata e të drejta. Në një formë katërkëndëshe bazohet edhe planimetria e fortifikimit protoqytetar të Margëlliçit, por trajtimi i saj është më pak rigoroz duke iu përshtatur më mirë thyerjeve të terrenit. Për këtë qëllim kanë qenë përdorur kthesa me kënd të drejtë dhe të gjerë.[70]



Fig. 32

Rastet e tjera të njohura përsërisin këto dy tipa themelorë planimetrikë. Forma e rregullt gjeometrike katërkëndëshe e zgjatur që ka zëvendësuar formën eliptike të fortifikimeve të vogla të fazës paraqytetare zbatohet edhe në shek. V në Mashkjezë si një periudhë e veçantë ndërtimi mbi rrënojat e periudhës I. Po në shek. e V p.e.s kjo planimetri e rregullt na **del edhe në** fortifikimin fqinjë të Belishovës.

Në rastet e Dorëzit, Zgërdheshit, Akrolisit dhe Buthrotit, përshtatja ndaj terrenit ka dhënë deformime të formës bazë katërkëndëshi, megjithëse kjo njihet lehtësisht. Tipike për këtë tip është mbyllja e plotë e fortifikimit.

Forma e dytë, ajo shumëkëndëshe, mund të shikohet gjithashtu si një vazhdim i koncepteve planimetrike të fortifikimeve më të hershme. Atë e ndeshim në fortifikimin më të madh protoqytetar, në Kalivo, ku përdorimi i një numri kthesash me kënd të

69) N. Ceka, **Gërmime arkeologjike të vitit 1983,** «Iliria» 2, 1983, fq. 252.
70) N. Ceka, **Lindja e jetës qytetare,** fq. 160.
71) N. Ceka, **Po aty,** fq. 159.

DO NOT COPY

gjerë siguron mbylljen e fortifikimit në drejtim të tokës.[72] Si një vazhdim të koncepteve më të hershme të fortifikimit këtu lihet e parrethuar me mure ana e liqenit, ku mbrojtësit e ndienin veten plotësisht të sigurt.

Elementi më tipik i planimetrisë së fortifikimeve protoqytetare është përdorimi i kthesave me kënd të drejtë apo të gjerë. Kjo është e lidhur me një karakter zejtar të ndërtimit si dhe me një konceptim paraprak të planimetrisë së fortifikimit para fillimit të ndërtimit të saj. Për këtë arsye mund të themi se fortifikimet protoqytetare shënojnë fillimin e ndërtimeve të mirëfillta sipas një ideje dhe plani arkitektonik.

Në fortifikimet protourbane kthesa këndore sigurojnë lidhjen e vijave të drejta të trasesë së mureve, duke ua përshtatur ato formave të terrenit. Në fazën e parë të zhvillimit të fortifikimeve protoqytetare kthesa ende përbën një ndërtim jo shumë solid, ku nuk zbatohet kombinimi i alternuar i gurëve. Kështu në Kalivo vija përpendikulare e kthesës është punuar gjithmonë me blloqe të plota duke mos siguruar një lidhje të qëndrueshme të dy anëve të murit (fig. 32). Përdorimin më të gjerë e kanë kthesat me kënd të drejtë dhe më rrallë ato me kënd të gjerë (Kalivo, Mashkjezë).

Në një fazë të dytë, gjatë shek. V p.e.sonë kthesat përpunohen më tej dhe zbatohet tek ato vendosja e alternuar si në Belishovë.

Përdorimi i kthesave zgjeroi edhe konceptin e përdorimit të murit si vend luftimi. Kthesat ishin edhe pika të përqendrimit të luftimit nga mbrojtësit, për t'i flankuar më mirë anët e mureve dhe për të krijuar vende më të përparuara për goditjen e kundërshtarit. Këtë koncept e shohim të marrë formë të përcaktuar në Kalivo, ku fundi verior i murit është zgjeruar nga 2.50 m, në 6.20 m. Në gjatësinë prej 8.40 m ka marrë formën e një bastioni, nga ku mund të goditej kundërshtari që përpiqej të kalonte në hapësirën midis tij dhe liqenit.

Dalje të murit me kënd të drejtë luanin edhe rolin e bastioneve. Ato janë vendosur në kënde pak të mbrojtura nga natyra të fortifikimit (Zgërdhesh, Dorëz) ose pranë hyrjeve (Dorëz, Belishovë). Këto të fundit janë ndërtime më të plota që i afrohen konceptit të kullës, por nuk dalin para linjës së murit.

Veçoritë planimetrike të fortifikimeve protoqytetare në Ilirinë e Jugut mund të na shërbejnë si kriter për të veçuar një kategori të tillë edhe midis fortifikimeve të shumta të zonave veriore ilire.



Fig. 33

Tipi planimetrik gjeometrik me një hyrje harkore si Zgërdheshi ndeshet në Ograc të daorsve[73]. Varianti katërkëndësh ndeshet gjithashtu, por me qoshe të rrumbullakuara, në Polanze e Holmac të Istërve dhe në Belaçevc të dardanëve.[74] Risitë e mësipërme në planimetritë e fortifikimeve protoqytetare janë të rralla dhe format bazë mbeten ato rrethore eliptike apo të parregullta, me linja të harkuara. Dy fortikimet liburne të datuara në pe-

72) N. Ceka, **Po aty,** fq. 165. – 167.
73) Shih. Shën. 31.
74) Shih. Reps. V. Mirosavljevvc. **art.cit,** fq. 276, fig. 8b, 277, fig. 46 edhe N. Duriu, **art.cit,** fq. 281-282.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 34

riudhën protoqytetare nga shtresat kulturore, Radovin dhe Jagodinje Gornje, kanë planimetri rrethore me hyrje të përforcuar me një tip të veçantë tumule që luan rolin e kullës.[75]

Një grup tjetër fortifikimesh veçohen si protoqytetare nga përdorimi i korridoreve të jashtme e të brendshme në mbrojtjen e hyrjeve, sipas një skeme të njohur në Kalivo apo Zgërdhesh. Të tilla mund të jenë Komina dalmate, Skolj Veliki, Makadanj, Karastah, Vrçin të istërve, Libna e Japodëve[76].

Për trevat ilire mbi lumin Shkumbin, ku ka një vonesë në futjen e teknikës së latimit të gurëve, janë elementet planimetrike që shërbejnë si kriter themelor për të dalluar fortifikimet protoqytetare. Kjo vonesë krijon edhe një problem tjetër për të dalluar këto të fundit nga fortifikimet e mirëfillta qytetare. Kështu fortifikimet japode të Magdalenska

75) S. Batovic, Istrazivanje, fq. 54, 61-62 dhe **Ostave iz Jagodinje Gornje,** fq. 160. fig. 1. Nga ndarje e hapësirës së brendshme prej muresh koncentrikë, por që nuk formojnë rrathë të brendshëm si në fortifikimet e epokës së bronxit, mund të klasifikohen krahas Jagodinje Gornjes edhe fortifikimit liburn i Budinit. Tipi planimetrik i Radovinit me dy tumula që mbrojnë hyrjen na përsëritet edhe në Veliki dhe Mali Obljaj të japodëve. shih: R. Drechseler–Bizic, Caracteristiques. . , fq. 78, fig. 2, 7.

76) Sih. Resp. Z. Maric, **Die Befestigungen. . .,** fq. 97, fig. 3. S. Batovic, **Caracteristiques,** fq. 219, fig. 2,7.
B. Bacic, **Prilozi poznavanja. . .,** Fq. 215, 220, 221, M. Gustin, Gradisca. . ., fq. 120.

DO NOT COPY



Fig. 35a



Fig. 35b









Fig. 36

Gora dhe Vishnji Gori[77] me planimetri që do të rreshtoheshin në tipat protoqytetare, kanë hyrje tërthore, të cilat në fortifikimet juqore ilire ndeshen vetëm në fazën e mirëfilltë qytetare.

VII. **Hyrjet.** Në numrin e madh të fortifikimeve paraqytetare njihen relativisht pak hyrje. Kjo në njëren anë reflekton faktin se ato përdoreshin shumë rrallë në këto fortifikime. Nga ana tjetër gjendja rrënojë në të cilën ruhen fortifikimet jep pak mundësi për të dalluar hyrjet dhe aq më tepër konstruksionin e tyre. Klasifikimet e deritanishme mund të përmblidhnin në tipin ballor të thjeshtë e me korridor dhe tipin e tërthortë, ndërsa tipat e tjerë janë variante[78]. Edhe nga këto tipi i quajtur tangencial ose më saktë me korridor të tërthortë, i takon pa dyshim periudhës qytetare.

Duhet të pranojmë se për të gjithë periudhën paraqytetare tipi kryesor i hyrjes është ai ballor, kur korridori formohet nga ndërprerja e trasesë së murit dhe ka gjerësinë e tij. Në fazën e dytë të kësaj periudhe dhe në atë protourbane ka një prirje për ta zgjatur korridorin para dhe pastaj pas hyrjes. Një numër i madh variantesh është krijuar nga mënyra se si është vendosur ky tip hyrjeje në planimetrinë e fortifikimit si dhe nga përdorimi i shtojcave mbrojtëse pranë hyrjes.

Për periudhën e parë paraqytetare, që do t korrespondonte fundit të epokës së bronxit dhe fi llimit të asaj që hekurit, ndeshim në përgjithësi nj hyrje të vetme. Në fortifikime të mëdha si në Karo Bejkovë, Vahta, Poshtela, Volçje etj ndeshim edh hyrje që komunikojnë me hapësirat e veçanta. T gjitha këto hyrje janë të ngushta nga 1.20 (Ventrok deri 2.30 m (Shueci).

Varianti I i hyrjeve është ai i thjeshtë m ndërprerjen e trasesë së murit (fig. 33a). Në për gjithësi hyrja vendosej në pjesën më të ulët të for tifikimit, por edhe ku terreni kishte një pjerrësi, q në njërën anë vështirësonte sulmin e armikut, ndërs në anën tjetër lejonte një ngushtim të bagëtisë n ngjitje. Ky variant gjendet në Vagalat; Ventrok Porta, Sv. Martin, Gradacin e Crvena Stijenës, Ku shaçe etj. Një nënvariant më të përpunuar kemi në rastet kur kjo lloj hyrje zhvendoset afër rënieve shkëmbore, duke kufizuar hapësirën e sulmit (fig 33b). Hyrja është e vendosur shpesh midis fundit të murit dhe rënies shkëmbore, si në «akropolin e Marshejt» Smokovc, Oçestovo, Vir, Vlashic, Gjuriç, Maslovnik etj. Ky variant i hyrjes ballore, që ngushtonte hapësirën e sulmit para saj, është tipik për fortifikimet dalmate (Letka, Lib, Iviç, Isakoviç, Reljino etj[79]). Kjo zgjidhje do të ketë krijuar vështirësi për qën-

77) S. Gabrovec, **Uberlick...,** fq. 61. fig. 1

78) Shih Gj. Karaiskaj, **Fortifikimet prehistorike në Shqipëri,** Monumentet 14, 1979, fq. 28, S. Batovic, **Caracteristiques...,** fq. 219 M. Gustin, **Gradisca,** fq. 120.

79) A. Benac, **vep.cit.,** fq. 12, 23, 99, 157, 161.

DO NOT COPY



Fig. 37



Fig. 38

drueshmërinë e një porte prej druri. Për këtë arsye duket se pëlqehej vendosja me një farë largësie nga buza (fig. 33c) si në Shuec, Qukës, Skënderbej, Dugi, Otok, Zman etj. Në ndonjë rast si në Çepna vendosej edhe një tumul mbrojtëse për të mbrojtur hyrjen. Një zgjidhje interesante të këtij varianti përfaqëson Badhra, ku pas hyrjes është krijuar një hapësirë e kufizuar 2.20 x x 4.80 m nga një mur me kthesë.[80]. Në Dedejan krijimi i një hapësire të tillë ka dhënë formën e një korridori që zgjatet në thellësi ndërmjet brezareve të vendbanimit.[81]

Varianti II përmbledh hyrjet para të cilave është krijuar një hapësirë e kufizuar, një lloj korridori, i cili kishte më tepër qëllim që të orientonte bagëtitë drejt hyrjes sesa të mbronte atë. Përkundrazi, ky ndërtim mund t'u jepte sulmuesve një vend të mbrojtur për të mbështetur sulmin kundër hyrjes. Është kjo arsyeja që në mjaft raste muri kufizues i «oborrit» që formohej në këtë mënyrë përforcohej nga një tumul mbrojtëse. Llojin e thjeshtë të kësaj hyrjeje e ndeshim në Koshutica, Kula, Strane, Iz Mali, Bukovo, Aniç, Velika radina, Zamershçen (fig. 34a) etj. ku formohet një hapësirë para portës nga një hark muresh të ulta. Në Lleshan, Zagroviç, Stepaniç[82] ky hark është përforcuar me një tumul (fig. 34b, c) ndërsa në Osovo dhe Begovac përshkohej edhe nga një hyrje e veçantë (fig. 34 d). Në Karos ndeshim edhe një hark të dytë që formonte një hapësirë më të gjërë para hyrjes. Së fundi, në Volçje, Kerin dhe Bjellosavljeviç muri kufizues kapej në të dy cepat e tij me harkun e fortifikimit dhe përshkohej nga një hyrje, duke formuar njëfarë «oborri» të fortifikuar.

Varianti III përfshin hyrjet para të cilave ishte krijuar një hapësirë që mund të mbrohej më mirë si rrjedhim i përqëndrimit të goditjeve nga muret e fortifikimit. Forma më e thjeshtë është ajo e Pukovaçit: njera anë e trasesë nxirret më përpara hyrjes,

DO NOT COPY

duke e lënë portën në pozicionin ballor, por duke krijuar një kryqëzim zjarri për ata që e sulmonin drejtpërdrejt (fig. 35a). Formën më të zhvilluar e përfaqësojnë hyrjen në «akropolet» e Lleshanit dhe Mbolanit, kur të dy krahët e trasesë takohen te hyrja pothuaj në kënd të drejtë, duke krijuar para saj një hapësirë që goditej në dy anë (fig. 35b). Të njëjtën skemë e ndeshim edhe në gjurmët e një fortifikimi prehistorik në Ripës si dhe në të dy hyrjet e Poshtelës.

Faza e dytë paraqytetare, ajo e fortifikimeve të tipit Gajtan, krahas thjeshtimit të planimetrive sjell edhe pak variante hyrjesh. Tipi i vetëm mbetet përsëri ai ballor, me vendosje qendrore si në Gajtan dhe me gjerësi të vogël, që presupozon porta njëkanatëshe. (fig. 36a).

Variantin II të kësaj faze e përfaqësojnë hyrjet me një lloj korridori të jashtëm si në Vela Strazha Maslin e Stivan. (fig. 36b).

Varianti III përbën një vazhdim të hyrjeve me hapësirë të mbrojtur si në Stiçna dhe Cvinger. (fig. 36c).

Varianti IV ndeshet në Dobreniç dhe Cvinger dhe përfaqëson një risi me vendosjen e hyrjes në një kënd të fortifikimit, por pa krijuar një korridor të brendshëm si në fazën protourbane (fig. 36d).

Në fortifikimet protourbane hyrjet vazhdojnë të jenë të rralla. Fortifikimeve me planimetri të thjeshtë u korrespondon një hyrje e vetme e vendosur në njërën prej kthesave me kënd të drejtë, në vendin më të përshtatshëm të komunikimit me rrethina. Një vendosje të tillë pothuaj të njëjtë ka Mashkjeza, Belishova, Dorëzi dhe Zgërdheshi. Në këtë mënyrë, ndryshe nga Gajtani ku hyrja kryesore vihej në qendër të një vije të gjatë muri përballë një fronti të gjerë goditjeje, hyrjet protourbane, me zhvendosjen në kënd, buzë pjerrësisë e kufizonin miaft këtë front. Për më tepër në Mashkjezë, Dorëz, Zgërdhesh është pasur kujdes që balli i hyrjes t'u fshihej goditjeve që vinin nga drejtimi kryesor i afrimit për në fortifikimin, duke e vendosur atë pjerrësi këtij drejtimi.

Vlerësimi i rolit të hyrjes jo vetëm si një pikë kryesore e komunikimit, por edhe e mbrojtjes së vendbanimit të fortifikuar i dha shkas formulimit të ri arkitektonik të saj gjatë periudhës protourbane, jo si një e çarë e thjeshtë në murin rrethues, por si një ndërtim më vehte. Tipi i parë i hyrjeve ruan formalisht planimetrinë e hyrjeve ballore paraurbane, por me trajtimin e veçantë të korridorit formon diçka cilësisht të re. Ky është tipik për një fortifikim të madh si Kalivoja (fig. 37 a–c), ku sulmit të armikut mund t'i viheshin përballë një numër i madh forcash. Të tri hyrjet e Kalivosë janë ballore me korridore të gjata 3.50, 4.50 dhe 7.30 m por të ngushta (2.10, 1.72, 2.50 m). që vijnë e zgjerohen në brendësi. Ky tip ndeshet edhe në Makadanj dhe Skolj. Ndeshim edhe forma të tjera të përforcimit të hyrjeve ballore si në Komina ku dy dalje të mureve anësore krijojnë një thellësi të koridorit, në Karastak dhe Vrçin, ku para hyrjes krijohet me një mur një lloj oborri i ngushtë, apo si në Jagodinja Gornje, Radovin dhe Veliki e Mali Obljaj, ku në anët e hyrjes vendosen pirgje që të kujtojnë tumulat mbrojtëse të kohës së bronxit. Një zgjidhje tjetër interesante është edhe trajtimi në formë zigzagu i korridorit në Kunci një formë që do të ndeshet edhe në Pepel.

Tipi i dytë i hyrjeve lidhet me fortifikimet e vogla, që kanë zakonisht vetëm një të tillë. Vendosja e hyrjes ka krijuar në të gjitha rastet një epërsi të mbrojtësve ndaj sulmeve. Kio u bë nëpërmjet krijimit të korridorit të hyrjes ndërmjet njërit krah të murit rrethues dhe një muri të lirë, paralel me të. Këtë tip hyrjeje e ndeshim në dy variante: a) me korridor të drejtë (fig. 38a) në Mashkjezë, Belishovë (fig. 38b), Dorës b) me korridor të harkuar (fig. 38c) në Zgërdhesh dhe Ograc. Brenda variantit të parë ka një përpunim të mëtejshëm nga vendosja e thjeshtë e hyrjes në takimin e dy mureve në rastin e Mashkjezës dhe në zhvendosjen e saj për të krijuar një lloj bastioni 5-7 m të gjerë ndërmjet murit të korridorit dhe murit rrethues si në Belishovë e Dorëz.

Nuk kemi të dhëna të plota për trajtimin e korridorit dhe të portave, por zgjatja e tij dëshmon se ai duhet të ketë qenë i mbuluar për të siguruar një vend ndenjtjeje të përhershëm për rojat[83]. Gjithashtu në hyrjen nr. 2 të Kalivosë ruhet në njërën anë patura për vendosjen e kasës së portës. Për hyrjet e shek. VII-VI p.e.s. është karakteristike, gjerësia e vogël e korridorit që lëviz nga 1.78 në 2.50 m. Kj

80) M. Korkuti, **Die siedlungen du spaten Bronze and fruhen Eisehze it in Sudwest – Albanien,** «Sudosteuropa zwischen 1600 und 1000v. Chr.» Berlin 1982, fig. 2. Kthesat e planimetrisë dhe të hyrjes janë theksuar në skicë, sepse në fakt në këtë fortifikim ato mungojnë.

81) Njoftim nga N. Bodinaku.

82) N. Ceka, **Fortifikimet parahistorike...,** Tab. I, 3, A. Benac, **vep.cit,** fq. 45-64, Tab. 8. (Stepanic).

83) Për këtë mund të mbështetemi tek fakti se hyrja harkore e Amanties, që përbën një zhvillim të mëtejshëm të tipit protoqytetar ka qenë e mbuluar, siç tregojnë shenjat e trarëve të gdhendura në shkëmb.

presupozon dyer njëfletëshe. Në Kalivo prania e një pragu të lartë menjëherë pas hyrjes dëshmon se dera hapej nga jashtë.

Gjatë shek. V p.e.s. përpunimi i mëtejshëm i korridorit çoi edhe në zgjerimin e hyrjes siç dëshmon rasti i Belishovës. Korridori ka atje një thellësi prej më se 7 m dhe gjerësi 3.50 m. Me një gjerësi dhe thellësi të tillë të korridorit nuk ka dyshim se dera ka qenë dy flegërshe dhe ka mundësi që të ketë pasur edhe një derë të dytë në thellësi të tij.

Tumat kufizuese. Ky emërtim shpreh ende pasigurinë për funksionin që kishin pirgjet prej gurësh që ndeshen në mjaft fortifikime prehistorike. Ato mund të quhen si një nga elementet më tipike të fortifikimeve ilire dhe kanë një shtrirje të gjerë. Ato fillojnë, ndonëse të rralla, në trevat japode e liburne për të dendësuar në trevën dalmate. Përhapjen më jugore të këtij tipi arkitektonik e ndeshim në fortifikimet e Lleshanit dhe në atë të Ventrokut. Në përgjithësi është pranuar se funksioni themelor i tyre është ai mbrojtës[84], gjë që e dëshmon vendosja e tyre pranë hyrjes apo në pikat më të rëndësishme të sulmit në Lleshan e Ventrok[85]. Megjithatë në trevën dalmate, ku është vendi klasik i këtyre pirgjeve, janë vërtetuar raste të një funksioni thjesht religjioz të tyre në Mandina, Crvenica, Shiljak etj.[86].

Përderisa nuk janë bërë ende gërmime sistematike të këtyre tumave dhe nuk është vendosur një lidhje e tyre me vetë fortifikimet ku gjenden, mund të bëhet vetëm një përpjekje për një klasifikim të përgjithshëm, lidhur gjithmonë me planimetrinë e fortifikimeve. Është për t'u shënuar se tumat kufizuese janë karakteristike për planimetritë me shumë ndarje të tërthorta, siç është Lleshani, Veliki Gradac e Privalit, Stipaniç Vidosh te Dalmatët[87], Zagroviç te liburnët[88], Kerin te japodët[89], por mungojnë te planimetritë me ndarje koncentrike. Gjithashtu ato janë tepër të rralla në planimetritë rrethore[90] dhe zotërojnë në tipin gjysmërrethor dhe gjysmëeliptik që shfrytëzon thyerjet shkëmbore.

Për nga vendosja, pirgjet gjenden përgjatë murit ose pranë tij në brendësi të fortifikimit. Në Lleshan, Stipaniç, Zagroviç ato janë vendosur në murin pritë para portës, duke shprehur qartë funksionin mbrojtës. Nuk duhet përjashtuar edhe funksioni religjos që mund të kishin ato njëkohësisht në këtë vend, sepse kjo zonë e ruan një rol të tillë edhe më vonë në rastin e Gajtanit me vendosjen e urnave me flijime.

Një variant tjetër të vendosjes së pirgjeve për mbrojtjen e hyrjes e kemi në shumë fortifikime të thjeshta si Ventrok, në fortifikimet dalmate si Kovaç e Mandina, apo në Çepnën japode[91]. Pirgu është vendosur atje në fundin e murit, apo ledhit duke kontrolluar hapësirën e hyrjes që mbetej në buzë të rënies shkëmbore. Në këtë funksion të vrojtimit dhe krijimit të një zone më të lartë për mbrojtjen e fortifikimit pirgjet ndeshin edhe përgjatë ledhit larg hyrjes si në Lleshan, Lib, Velika Gradina në Mrhodol, Veliki Gradac të Privalit, Vidosh, Lip etj.[92].

Në konceptimin e saj si një pikë e fortë mbrojtjeje pirgu nuk lidhej me murin apo ledhin dhe nuk kalohej nga njëri te tjetri, siç bëhej më vonë me kullat antike. Kjo ndodhte për shkak të lartësisë dhe gjërësisë së vogël të murit, që nuk mund të shërbente si vendluftim por vetëm si gjoks mburoje. Për këtë arësye pirgjet ndeshen edhe në brendësi të fortifikimit si në Ventrok, Grdova[93], Kerin Porat[94].

Pirgjet janë karakteristike për fortifikimet e kohës së bronxit dhe nuk ndeshen te fortifikimet më të vona. Rritja e funksionit mbrojtës të murit, si rrjedhim i zgjerimit të tij, solli zhdukjen e këtij elementi që logjikisht duhet të kishte evoluar drejt kullës. Për këtë ndikoi sigurisht niveli ende i ulët i teknikës së ndërtimit, që nuk siguronte një unitet midis shtegut të murit dhe një ndërtimi që do të ngrihej mbi të, siç mund të ishte pirgu.

Një formë e re pirgu e ndihmuar nga kulla e mirëfilltë apo bastionet shfaqet te fortifikimet protoqytetare të Radovinit dhe Jagodinje Gornje të liburnëve[95].

84) A. Benac, **Quelques caractéristiques...**, fq. 86.
85) Shih N. Ceka, **Fortifikimet parahistorike...**, f.
86) A. Benac, **Utverdena ilirska naselja,** f. 198.
87) A. Benac, **Po aty,** fq. 44, 46, 98.
88) S. Batovic, **Caractéristiques...** fig. 2,5.
89) M. Gustin: **Gradisca..**, fig. 5,5.
90) A. Benac, **Vep.cit,** Angelica gradina në Lip, fq. 34.
91) **Po aty,** fq. 17,39. M. Gustin; **Gradisca...**, fig. 5,8.
92) Shih. Resp. N. Ceka; **Fortifikimet parahistorike...**, fq. 32. A. Benac, **Vep.cit,** fq. 23, 36, 42, 98, 134.
93) P. Mijoviç, M. Kovaçeviç, **Gradovi i utverdenja u Crnoj Gori,** Beograd 1975, fq. 9.
94) S. Batoviç, **Caractéristiques...**, fig. 2,18.
95) S. Batoviç, **Istrazivanje...**, fq. 62 dhe **Ostava iz Jagodinje Gornje,** fig. 1.

DOKTORATURA

DO NOT COPY

Teknika e ndërtimit

Përgjithësisht me teknikën e ndërtimit në fortifikimet prehistorike është nënkuptuar përdorimi i gurëve të palatuar. Megjithatë janë bërë përpjekje për të diferencuar faza të ndryshme në zhvillimin e kësaj teknike duke përqëndruar vëmendjen në dy elementet themelore të saj, strukturën e murit dhe trajtimin e gurëve në fasadë[96]. Në gjendjen e sotme të studimeve dhe kërkimeve arkeologjike tipologjia mbetet metoda kryesore për diferencimin e fazave të ndryshme në teknikën në dukje uniforme të fortifikimeve parahistorike. Krahas të dhënave ende të kufizuara stratigrafike, një mbështetje e domosdoshme në klasifikimin e fazave është korrespondimi i teknikës së ndërtimit me një tip të caktuar planimetrik.

Nga analiza e fortifikimeve parahistorike rezulton se periudhat e mëdha të zhvillimit të tyre i ka ndjekur edhe një ndryshim i teknikës së ndërtimit. Në radhë të parë duhet të shënojmë një ndarje të madhe në tipat e fortifikimeve për sa i përket teknikës së ndërtimit. Grupi kryesor përfaqësohet nga ato të ndërtuara me mure gurësh që kanë një përhapje pothuaj uniforme në të tëra trevat ilire. Grupi i dytë përmbledh fortifikimet me ledhe dheu e gurësh, që duke qenë mjaft të rralla në trevat jugore dhe në bregdetin liburn, gjenden me shumicë në trevat dalmate dhe japode.

Në fortifikimet me mure guri dallohet një evolucion sipas tri fazave të mëdha: epoka e bronxit, hekuri i hershëm dhe protoqytetare. Në bazë të fortifikimeve të datuara të Badhrës, Karositi, Margëlliçit, Luarasit, mund t'i shënojmë si karakteristikë të teknikës së ndërtimit në periudhën e mesme e të vonë të bronxit strukturën ende të dobët të murit që shprehet në trasenë e pasigurt, me lakime, lartësinë e ulët, përdorimin e gurëve krejt të palatuar. Muri përbëhet në gjerësinë e tij prej dy paretesh dhe mbushjesh, të palidhura mirë midis tyre. Në Karos dhe murin e Zvezdës ndeshim një paret të tretë që përshkon mbushjen[97]. Kjo strukturë ndeshet edhe në fortifikimet dalmate[98], liburne e japode[99], por te dy të fundit i takon një tradite që vazhdon në periudhën e hershme të hekurit (Stiçna) apo protoqytetare (Bribir-Varvaria). Linja e parregullt e trasesë murit dëshmon se ai nuk konceptohet si një ndërtim i vetëm, por realizohet pjesë-pjesë. Këtë e lejonte edhe lartësia e vogël e murit, që realizohet lehtë me gurët e mbledhur në sipërfaqe. Është kjo lartësi e vogël që lëvizte midis 1.50-2 m, që përcakton edhe gjerësinë e vogël të mureve të fortifikimeve të kohës së bronxit. Muret me gjerësi të vogël si Mbolani (1.40 m), Margëlliçi (2 m) Badhra (2-2,30 m), Podgoria (2 m) etj. janë tipike për këtë kohë, por ndodh që në të njëjtin fortifikim ato janë me gjerësi të ndryshme (Dedejani: 1,60, 2,6 3 m). Gjithashtu fortifikime tipike të kësaj kohe Trajani, Karosi, Lleshani kanë mure me gjerësi -3,50 m që do të jetë standarde për fortifikimet ed në periudhën e hekurit.

Natyra e gurëve që përmbante sipërfaqja e lë tësisë së zgjedhur për t'u fortifikuar, përcaktor edhe pamjen e jashtme të murit. Për kohën e bro xit ndeshim dy tipa fasadash të realizuara në të nj tët tipa planimetrikë: me gurë të vegjël (Luaras, D dejan, Mbolan, Ventrok, Karos) apo me blloqe mëdha (Lleshan, Tujan, Gjanomadh, Kakaç etj). rastin e parë qëndrueshmëria e murit është siguru nëpërmjet një lidhjeje më të mirë të pareteve mbushjen, duke i vendosur gurët e pareteve me p sën më të gjatë në drejtim të mbushjes. Kjo mën natyrisht dobësonte lidhjen e gurëve në fasadë, p ndaj stabiliteti i saj është siguruar në disa ra duke i dhënë asaj një pjerrësi deri në 10% (Ve trok, Dedejan, Mbolan). Në muret me gurë të n dhenj vihet re një diferencim më i qartë i paret nga mbushja, por edhe një lidhje më e paktë tyre. Paretet konceptohen si pjesë më vete edhe disa prej fortifikimeve kalohet në vendosjen e d blloqeve me faqen e gjerë nga jashtë. Megjitho edhe ky tip fasade mbetet ende i paqëndruesh për shkak të mosmbushjes së boshllëqeve midis bl qeve me gurë më të vegjël.

Fortifikimi me ledh përfaqësohet në trevat gore ilire vetëm nga rasti i Shuecit[100]. Për ndërti e tij ka qenë përdorur dheu me përzierje gurësh vegjël dhe ne nuk dimë nëse forma e tij e so

96) M. Korkuti, **Rreth vendbanimeve të fortifikuara ilire të periudhës I të hekurit në territorin e Shqipërisë,** «Studime Historike» 3, 1973, fq. 116. A. Faber, **Prilog kronologiji fortifikacija u primorskom iliriku,** «Jadranska obala u protohistoriji» Zagreb, 1976, fq. 230-248, Gj. Karaiskaj, **Fortifikimet prehistorike...,** fq. 24.

97) I. Koçi, **Kalaja e Karosit** «Iliria» 6; 1976, fq. 236, 238. Gj. Karaiskaj, P. Lera, **Fortifikimet e periudhës së parë të hekurit në fushën e Korçës,** «Kuvendi I i Studimeve ilire» Tiranë 1974, fq. 271.

98) A. Benac, **vep.cit,** fq. 195.

99) S. Batoviç, **Caractéristiques...,** fq. 216. (Eubir). M. Gustin, **art.cit,** fq. 220-Stiçna).

100) Gj. Karaiskaj, P. Lera; **art.cit, fq. 264.**

me gjerësi 11 m dhe lartësi 3 m vjen nga shkatërrimi i një ledhi të mirëfilltë apo të një mbajtësi të një konstruksioni prej druri.

Në trevat veriore, ku ledhi përbën një mënyrë mjaft të përhapur të fortifikimit, ndeshen disa forma të tij. Në fortifikimet e hershme të Kushaçes dhe Koshuticës, në trevën dalmate, ledhi prej gurësh të hedhur është ende i ulët, vetëm 2.5 m[101], gjë që ndoshta flet për një mbajtës të konstruksioneve të drunjta.

Përdorimi i pareteve prej druri për krijimin e mureve prej dheu apo gurësh është tipik për trevat japode, ku ndeshet në një periudhë të gjatë kohe, që fillon nga epoka e bronxit (Libna), vazhdon me hekurin e hershëm (Stiçna), deri në periudhën protoqytetare (Magdalenska gora)[102].

Për epokën e hekurit ndryshimi themelor në teknikën e ndërtimit është formimi i plotë i murit si një strukturë mbrojtëse. Kjo përmbledh konceptimin e tij si një ndërtim i vetëm, duke siguruar një unitet të trasesë së fortifikimit, si dhe stabilizimin e strukturës së vetë murit. E para shprehet në përcaktimin paraprak të trasesë që jep vija të gjata e të drejta të murit për distanca të konsiderueshme. Shembull tipik për këtë janë Gajtani, Stiçna etj. Forcimi i strukturës së murit arrihet nëpërmjet rritjes së qëndrueshmërisë së pareteve dhe lidhjeve të tyre me mbushjen. Gjerësia e murit standardizohet në 3--3,50 m. Në fasadë përdoren blloqe të mëdha, që vendosen në pjesën më të gjerë nga jashtë, duke rritur ritmin e ndërtimit. Vendosja e disa gurlidhësve siguronte edhe lidhjen e kësaj fasade me mbushjen. Gjithashtu boshllëqet midis blloqeve mbusheshin me gurë më të vegjël, duke rritur qëndrueshmërinë e tyre dhe duke e bërë të vështirë ngjitjen nga jashtë. Vetë faqet e jashtme të gurëve në fasadë janë të rrafshuara nga thyerje me çekan. Kjo punë bëhej pas vendosjes së tyre në mur, siç dëshmohet nga gjetja e mbeturinave të thyerjes para murit në Gajtan.

Lartësia e mureve të periudhës së hershme të hekurit përgjithësisht ishte rreth 3 m dhe me gjerësinë prej 3-3.50 m jepte mundësi që të përdorej nga mbrojtësit si vend luftimi. Muri i Gajtanit i ruajtur në lartësi 2.40 m nga jashtë dhe 1.40 m nga brenda dhe që kalonte në kurriz të kodrës[103] dëshmon për këtë funksion të ri që mori muri në këtë kohë.

Në periudhën protoqytetare ndryshimi në teknikën e ndërtimit bëhet më i ndjeshëm. Tipari themelor që e karakterizon teknikën e ndërtimit në këtë periudhë është përpunimi i gurëve me vegla hekuri para vendosjes në mur. Ky tipar është i kapshëm vetëm për fortifikimet ilire në jug të lumit Seman (Apsos), ndërsa në veri ruhen ende tiparet e muraturës së periudhës së hershme të hekurit të shoqëruara me elemente të reja të planimetrisë.

Kalivoja, Butroti, Mashkjeza, Margëlliçi na japin karakteristikat e teknikës së ndërtimit të mureve. Përveç Kalivosë, ku ruhet gjerësia standarte prej 3 m, në fortifikimet e tjera kemi një zvoglim të gjerësisë së murit në rreth 2 m. Kjo mund të shpjegohet me faktin se me rritjen e stabilitetit të murit si rrjedhim i latimit të gurëve, lartësia prej 3 m mund të arrihej me një gjerësi më të vogël, duke kursyer punën dhe materialin. Kalivoja përbën një përpjekje për ta rritur në mënyrë të ndjeshme këtë lartësi, duke e zgjeruar përsëri bazën e murit.

Në fortifikimin e fazës I të Mashkjezës dhe në Butrot që datohet në fund të shek. VII p.e.sonë latimi është bërë vetëm në sipërfaqet horizontale të blloqeve, duke mos prekur ato anësore dhe duke thyer trashë ato ballore. Në një fazë të dytë, që duket se fillon nga fundi i shek. VI p.e.s. dhe vazhdon në gjysmën I të shek. V, latimi përdoret edhe në faqet ballore, por ende jo në ato anësore. Është koha kur lindin edhe prirjet për dy tipat e muraturave: katërkëndëshe (Mashkjeza, Margëlliçi, Treport) dhe poligonale (Kalivo).

Si një element i ri për teknikën e ndërtimit duhet quajtur edhe punimi i kthesave, që kërkonte

101) B. Covic, **Die Befestigungen,**. fq. 68. Në këtë trevë ndeshim një numër të madhe variantesh të ledheve, që ende nuk janë diferencuar nga pikëpamje kronologjike. Megjithatë, duket se janë më të hershme ledhet me gurë të hedhur ose me dhe, që shoqërohen edhe me tumula kufizuese. Të tilla janë Gradaci i Vuçipoljes, ku është gjetur qeramikë e bronxit të hershëm, e Vasharovit (gjerësi deri 22m). Një grup të dytë, ku ledhi merr një funksion të mirëfilltë mbrojtës, formojnë fortifikimet ku ai është përforcuar nga jashtë me një mur si në Vidosh, vetëm nga poshtë si në Buhovo ose në të dy anët si në Zamershçen. Kësaj periudhe të dytë, që përkon me fazën e hershme të hekurit, i takon përdorimi i mureve mbi ledhe si në Gradinën Petroviç.

Shoqërimi i ledheve me palisadë për të mbyllur pjesë të hapësirës së fortifikuar, është përdorur gjithashtu në trevën dalmate në Sakovi Reljin etj. Gjatë ndërtimeve me ledhe janë krijuar edhe hendeqe nga marrja e materialit (Podgaj, Makronog).

102) M. Gustin, **art. cit.**

103) S. Islami, H. Ceka, **Të dhëna të reja mbi lartësinë ilire në territorin e Shqipërisë,** Konferencën e I e Studimeve Albanologjike, Tiranë 1964, fq. 448.

DO NOT COPY

një zgjidhje të veçantë për të ruajtur qëndrueshmërinë. Duket se në këtë periudhë kjo zgjidhje nuk u arrit plotësisht, siç provohet nga kthesat e Kalivosë. Ato bëhen me gurë të parapërgatitura, pa siguruar një lidhje të qëdrueshme të dy krahëve të murit.

Veçimi i themelit në strukturën e murit në Mashkjezë e Kalivo është gjithashtu një element krejt i ri në teknikën e ndërtimit. Pjerrja e fasadës për të rritur qëndrueshmërinë duket se s'ka të bëjë me traditën e kohës së bronxit, sepse mungojnë hallkat në fortifikimet e kohës së hekurit. Më e mundëshme është një ndikim nga fortifikimet arkaike në Magna Grecia e Siqeli (Leontinnoi, Megara Hyblea)[104].

Në periudhën protoqytetare procesi i ndërtimit kryhet nga grupe të specializuara, duke marrë një karakter zejtar. Shenjat e pykave në blloqet e murit të Butrintit I dëshmojnë se kishte filluar shfrytëzimi i guroreve nga shtresat sipërfaqësore. Përdorimi i daltës dhe çekanit për gdhendjen e faqeve horizontale e ballore është një tregues tjetër për krijimin e zejes së muratorëve në këtë kohë.

Për trevat ilire në veri të Semanit teknika e periudhës protoqytetare nuk dallohet lehtë nga ajo e periudhës I-II të hekurit. Ka një pirje më të theksuar për dhënien e formave katërkëndëshe gurëve dhe për ndjekjen e rreshtimit (Dorëz, Samobor, Skrip, Varvarie, etj).

* *
*

Parashtrimi i një materiali kaq të gjerë dhe njëkohësisht ende të pastudjuar mirë, siç janë fortifikimet parahistorike, nuk mund të bëhej pa një konsumim paraprak të asaj që do të përbënte kapitullin për kronologjinë. Kjo është arsyeja që në përmbyllje të artikullit tonë do të shtrojmë vetëm disa nga problemet që mbeten të trajtohen nga studimet e ardhshme në këtë fushë.

Çështja e datimit të fortifikimeve është pa dyshim kryesorja për të hapur rrugë në një material që shtrihet në një hapësirë kohore prej rreth 1500 vjetësh dhe në hapësirë gjeografike verijug po prej kaq kilometrash. Mund të ketë kritere të ndryshme për të përcaktuar kronologjinë e fortifikimeve, por ne mendojmë se është i domosdoshëm shoqërimi i saj me boshtin themelor të proceseve ekonomike-shoqërore, që përcaktojnë funksionet, format plani metrike dhe vetë teknikën e realizimit të fortifikimeve

Shembujt më të hershëm të fortifikimeve të do tuara në bazë të shtresave kulturore brenda tyr si Luaraci, Koshutica Kushace, i takojnë, ndonës ende në mënyrë jo tepër të sigurt, periudhës së he shme e të mesme të bronxit. Kjo është koha e ndry shimeve të rëndësishme ekonomike, shoqërore dh njëkohësisht e prishjes së ekuilibrit demografik, rrjedhim i ardhjes së grupeve të reja etnike nga l ndja.[105]. Vendin e shoqërisë matriarkale eneolitik të bazuar në ekonominë bujqësore, e zuri një sho qëri më dinamike, me një ekonomi bujqësore dh blegtorale dhe me strukturë patriarkale të organ zimit shoqëror. Është koha kur shtohet në mënyr të ndjeshme popullata në zona të banuara edhe m parë, si fusha e Korçës, dhe fillon popullimi i zonc ve të reja. Zgjerimi i ekonomisë blegtorale dha mu ndësi për shtrirjen në zona të papërshtatshme pë formën eneolitike të bujqësisë me shatë, siç jan lartësitë rreth fushës së Korçës e të Kolonjës, mo lësitë e Elbasanit, Tiranës, Shkodrës, luginat e the lla të Përmetit e Shkumbinit, apo zona bregdetare Jonit. I gjithë bregdeti dalmat dhe liburn përbënt gjithashtu një trevë tepër të përshtatshme për zhv llimin e ekonomisë blegtorale. Pikërisht në këto zon u shfaqën për herë të parë fortifikimet e hershm që nga format dhe mënyra e përdorimit duket s ishin më tepër ndërtime për mbajtjen dhe mbro tjen e kopeve, sesa vendbanime të mirëfillta.

Koha klasike e ndërtimeve të këtij tipi është p dyshim periudha e vonë e bronxit. Shtimi i popul sisë dhe përvetësimi i territoreve të reja shprehet n ndërtimin e një numri të madh fortifikimesh në tre vat ilire. Kjo është koha, kur, si rrjedhim i zbatim të metalit për vegla pune dhe i rritjes së rendimen teve, bëhet e mundur një diferencim i rajoneve bu qësore nga ato blegtorale dhe i vetë fiseve që me rreshin me dy format e ndryshme të ekonomisë. Fo tifikimet marrin tani edhe funksionin e banimit, duk rezervuar për këtë pjesë të veçanta të hapësirës s mbrojtur brenda mureve. Gjithashtu ka shumë mu ndësi që të jenë fortifikuar në këtë periudhë edh vendbanime të profilit bujqësor, siç është Ventrok e Bilishti. Është kjo periudha e krijimit të grupev të fortifikimeve që mbrojnë një territor të përcaktuc gjeografik, që është njëkohësisht territori i veprim

104) H. Treziny, Les techniques grecques de fortification et leur diffusion à la periphérie du monde grec d'occident «La fortification et sa place dans l'Histoire politique sociale et culturelle du monde grec» Valbonə – Cedex 1985, f. 2-3.

105) Shih. Referatet e M. Korkutit; F. Prendit dhe kumtesat e N. Bodinakut e Zh. Andreas në «Iliria» 2, 1985 (në shtyp).

DO NOT COPY

tarisë ekonomike të një fisi. Ishte logjike që në një zonë të tillë siç janë bregdeti i Himarës, pllaja e Kolonjës, apo ajo e Duvnos, fisi të krijonte disa qendra të fortifikuara ku mund të strehohej pasuria e tij d.m.th. kopetë dhe vetë njerëzit. Në këtë grup fortifikimesh u veçua edhe më kryesori, më i mbrojturi, që me sa duket u bë edhe qendër kulti e mbledhjesh për bashkësinë. Një raport i tillë shprehte në grupin e fortifikimeve të bregdetit Jon: Karosit, Gjashnjarit, Himarës, Pirgut etj. Në pamje të parë do të dukej e njëjta gjë për fortifikimet rreth Trajanit, Ventrokun dhe Shuecin, por ato dallohen qartë nga njëritietri për vendosjen, planimetrinë dhe teknikën mjaft të ndryshme të ndërtimit. Nuk ka dyshim se edhe brenda epokës së bronxit ka pasur disa periudha të ngritjes së fortifikimeve, që mund të vecohen në të ardhmen nga të dhënat e gjurmimeve arkeologjike. Karosi, Badhra dhe Margëlliçi na japin mundësi të grupojmë në periudhën e vonë të bronxit, fortifikimet me veçori të planimetrisë (ndarje të brendshme, linjë e pasigurt e murit) dhe të teknikës së ndërtimit (gurë të mëdhenj, të papunuar, me boshllëqe të pambushura në fasadë, lartësi e ulët).

Në vendosjen e kronologjisë së fortifikimeve të epokës së bronxit duhet marrë parasysh edhe dallimi kohor midis dy krahinave të largëta ilire. Kështu në trevat veriore ilire deri në Glasinac bronxi i hershëm do t'i korrespondonte periudhës së mesme të bronxit në trevat jugore. Veç kësaj, evolucioni i fortifikimeve qe në trevat veriore më i ngadalshëm qoftë në teknikën e ndërtimit, qoftë në format planimetrike, që u ruajtën edhe për epokën e hekurit.

Megjithëse të lidhura me një formë të caktuar të ekonomisë fortifikimet e epokës së bronxit ende nuk janë qendra të mirëfillta ekonomike, sepse i mungonte funksioni i prodhimit. Këtë funksion qendrat e fortifikuara e marrin vetëm në epokën e hekurit, kur në të vendoset sektori i tretë i ekonomisë, në formën e prodhimit të qeramikës apo veglave të punës.

Kjo solli natyrisht në një reduktim të numrit të fortifikimeve, duke i dhënë prioritet atyre që ishin më të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike, pra ishin më pranë fushave, ujërave e rrugëve natyrore. Shembuj të fortifikimeve të tilla janë Gajtani, Treni, Belshi, Stiçna, etj. Të dhënat e deritanishme japin si kohë të kësaj periudhe të re fortifikimet e shek. XII-X p.e.sonë, që përputhet me fillimin e epokës së hekurit. Koha e lulëzimit të plotë të tyre duhet të jenë të shek. X-VIII p.e.sonë, kur zbatohet më gjerësisht hekuri në ekonomi. Gajtani na jep dëshmitë se këto fortifikime janë qendra prodhimi të qeramikës, sendeve metalike dhe njëkohësisht qendra kulti. Kjo nuk do të thotë se çdo fortifikim i kohës së hekurit kishte patjetër përmbajtjen ekonomike-shoqërore të një qendre prodhimi. Gjetjet më të vona të epokës së hekurit në Trajan apo Ventrok dëshmojnë se disa nga fortifikimet më tipike të epokës së bronxit u përdorën edhe më pas pa e ndryshuar karakterin e tyre. Kjo do të përbëjë edhe në të ardhmen një problem për të lidhur fortifikimin me shtresën përkatëse kulturore, të cilit i takon ai. Sqarimi i kronologjisë së fortifikimeve në trevat jugore ilire, ku ka mundësi të bëhet një detajim më i mbështetur, lidhet me kronologjinë e vetë epokës së hekurit përgjithësisht. Në radhë të parë mbetet të sqarohet kronologjia e shtresës II të Gajtanit dhe të veçohet ajo e vendbanimit të fortifikuar të Trenit nga ajo e shpellës. Njëkohësisht do të ishte me rezultat një konformim i stratigrafisë dhe fortifikimeve të qendrave të afërta siç janë Trajani, Treni, Ventroku dhe Shueci. Nuk është pa rëndësi dhe zgjerimi i kuadrit të përgjithshëm të fortifikimeve të kohës së bronxit dhe të hekurit të hershëm nëpërmjet botimeve më të plota që do të jepnin me dokumentacion të qartë fortifikimet e një krahine të veçantë.

Fortifikimet protoqytetare dallohen tashmë si një fazë e veçantë në zhvillimin e përgjithshëm të fortifikimeve parahistorike dhe njëkohësisht përfaqësojnë preludin e vetë proçesit të urbanizimit. Trevat jugore ilire janë vendi i formimit të plotë të tyre për sa i përket fizionomisë arkitektonike. Në trajtimin e hapësirës së fortifikuar dhe në teknikën e ndërtimit, qendrat protoqytetare shënojnë një hap cilësor që parapërgatit formimin e plotë të qytetit ilir.

Të dhënat e deritanishme kanë sqaruar kryesisht tiparet e fortifikimeve protoqytetare, pa krijuar një tablo të qartë të aspekteve të tjera siç janë urbanistika dhe banesa. Një problem më vete përbën fortifikimi i Kalivosë, që, duke pasur tipare kryesore të një qendre protoqytetare, dallohet për sipërfaqen tepër të madhe, për gjurmë jete. Mbeten të saktësohen më tej edhe kriteret e dallimit të fortifikimeve protoqytetare në veri të lumit Seman, ku nuk shfaqen qartë elementet tipike të teknikës së ndërtimit.

Zhvillimi i ndryshëm ekonomiko-shoqëror ishte arsyeja kryesore e dallimeve që vihen re në periudhën protoqytetare midis fortifikimeve të krahinave të veçanta ilire. Megjithatë ka edhe në këtë periudhë një vazhdimësi të unitetit që përfaqësojnë aspekte të veçanta të arkitekturës së fortifikimeve në kuadrin e përgjithshëm të kulturës ilire. Që në epokën e bronxit vihet re një ngjashmëri e qartë midis fortifikimeve të trevave jugore e veriore ilire. Natyrisht që një pjesë e përkimeve kanë karakter të për-

Do not copy

gjithshëm dhe i detyrohen numrit të kufizuar të zgjidhjeve arkitektonike e mënyrave të thjeshta të ndërtimit. Me rëndësi janë ata përbërës që kanë të bëjnë me konceptimin e trajtimit të hapësirës së fortifikuar, me planimetrinë e fortifikimit dhe elementët e saj. Nuk mund të jenë të rastit zgjidhjet e njëjta planimetrike duke u zgjeruar nga një hapësirë qendrore e fortifikuar mbi bazën e koncentrizmit, që përbën kriterin themelor të fortifikimeve të kohës së vonë të bronxit në treva të gjera ilire (Karos, Trajan, Lleshan, Gradac, Porat, Holm, Vahta etj). Kjo është një zgjidhje e ndryshme nga fortifikimet e gadishullit Apenin, ku mbizotëron kriteri i shtimit të sipërfaqeve (Frosolone, Murgie, Timore)[106]. Me interes të veçantë janë zgjidhjet e njëllojta të hyrjeve në Karos, Osovc, Gradacin e Zamrshçevos e Gradinën e Begovacit në pllajën e Glasinacit, ku ledhi mbrojtës i hyrjes përshkohet gjithashtu nga një hyrje. Zgj dhje të njëllojtë me vendosjen e një pirgu në cep t ledhit gjejmë në Lleshan e Zagroviç. Të para n kuadrin e përgjithshëm të kulturës ilire ngjashmë ritë që vihen re në trajtimin e fortifikimeve dhe evo lucionin e tyre marrin vlerën e një dëshmie tjetë mbi unitetin që ekzistonte në këtë kulturë.

Studimi i fortifikimeve parahistorike ilire do t përbëjë një fushë të vazhdueshme kërkimesh. Ato d të jenë një objekt tepër me interes për arkeologjin por njëkohësisht edhe një temë themelore për histo rinë e arkitekturës ilire. Vetëm bashkërendimi i kë kimeve në të dy fushat mund të japë në të ardh men një kuadër më të plotë për fillimet, evolucioni karakterin dhe përgjithësisht për rolin që luajtën fo tifikimet parahistorike në rrugën e gjatë të urban zimit në trevat ilire.

DO NOT COPY

106) A. La Regiona, **Centri fortificati preromani nei territori sabelici dell' Italia centra adriatica,** «UIN» f. 278. D. Adamsteahu, **Tipi di insediamenti umani in Puglia e Basilicata), Po aty,** fq. 260-262.

Neritan Ceka

DO NOT COPY

LES FORTIFICATIONS PREHISTORIQUES ILLYRIENNES II

Les fortifications de la période protourbaine

Pendant la deuxième moitié du VIIe sc. av. n. ère on remarque d'importants changements quant aux traits des anciennes fortifications illyriennes lesquels se rattachent au commencement du processus d'urbanisation. Les habitats fortifiés revêtent une nouvelle fonction en devenant des centres de production et d'échange où se concentrent les nouvelles forces sociales lors du passage de la communauté primitive à l'ordre esclavagiste. Au début, cette concentration fut peu considérable, reflétant ainsi un nombre encore limité d'élément humain qui se détache de la communauté tribale. L'évolution des fortifications témoigne ainsi d'une période passagère dans le développement du processus de l'urbanisation, quand, de pair à la substitution des relations esclavagistes aux relations tribales, apparaissent les traits architectoniques qui prennent leur forme complète avec les prochaines villes illyriennes. C'est pour cette raison que la période entre la deuxième moitié du VIIe sc. et la deuxième moitié du Ve sc. est appelée pour l'Illyrie du Sud et l'Epire, la période protourbaine. Quant à la côte du nord de l'Illyrie et les régions intérieures de l'Est, ce processus eut lieu un siècle plus tard.

Mashkjeza près de Cakran, mis au jour par le fouilles archéologiques, représente un habitat typique protourbain. Son petit territoire fortifié bien que petit de seulement 0,21 ha, fut une assez dense agglomération. Dès le début, une partie de l'habitat se trouvait à l'extérieur de l'enceinte, sur le versant occidental et méridional de la colline. La planimétrie de la fortification est d'une forme presque quadrangulaire peu accidentée à l'ouest. Le tracé des murs suit de longues lignes droites et subit quelquefois des tournants à angle droit ou obtus. L'unique entrée se situait à l'un des coins de la fortification, près de la rue principale. Le mur, large de 2 m, se compose de deux parois remplis entre eux. Une rangée de pierres brutes, faisant une saillie de 10 cm à la façade, forme les fondations. C'est une construction réalisée par des pièces de pierres martelées de grosses et moyenne taille, bien aplanies seulement pour les jointures des faces horizontales. A la construction du mur, 4 m de haut, on a respecté une sorte de nivellement de rangées de 0,50 m de hauteur.

A une deuxième période, au Ve sc. av. n. e., toute la fortification fut reconstruite, conservant la même planimétrie et la même forme d'entrée avec des murs traités plus attentivement, par des blocs de pierres équarris aux faces horizontales, et à l'extérieur aussi, laissant brutes les faces latérales.

La fortification protourbaine de Margelliç subit les mêmes périodes de construction. A la différence de Mashkjeza, Margelliç représente un grand habitat protourbain d'une supérficie de 5 ha. Près de Marshkjezë, sur le versant de la colline qui sépare la vallée de Vjosa de celle de Gjanice, se situe la fortification du Gurzezë, d'une forme quadrangulaire allongée.

La fortification de Belishove appartient aussi à la deuxième période des fortifications protourbaines. Elle se situe près de la même rue qui traversait le versant de la chaîne des collines où s'élevait la fortification de Gurzezë.

Le deuxième complexe, comme nous l'avons déjà rappelé appartient à une famille féodale de Berat. Il est beaucoup moins grand que celui de la ville de Vlora, ce qui a conditionné une composition plus compacte des deux unités du complexe, de l'habitation des amis et de celle de la famille. Certainement, le deuxième exemple se rapporte à une famille, dont la situation économique est moins modeste que celle de la famille de Vlora.

A la différence de l'habitation de Vlora, ces deux habitations et les murs d'enceinte forment un contour fermé. On y accède par une seule entrée qui se trouve du côté de l'habitation des amis, dont le volume se détache de celui de l'habitation de la famille. Au centre de la petite cour de l'habitation des amis ainsi que de celle de l'habitation de la famille, se trouve le puit d'eau potable. La planimétrie de l'habitation des amis, à un étage, ressemble à un carré. Dans la partie frontale se trouve un étroit «tchardak», où l'on accède par un escalier extérieur et tout en face deux petites pièces. Tout près d'elle se trouve une tour qui lui servait. Elle possède les traits connus de ces constructions à défense passive, sur les quelles J.G.Han écrit: «Toutes les grandes habitations urbaines étaient précédées de tours qui s'élevaient au milieu de la cour». La tour en question est inclue dans le mur de séparation du territoire des deux habitations, parait-il pour économiser le terrain limité. Une porte percée dans le mur de séparation réalise la communication avec la cour de l'habitation de famille. Cette habitation est assez vaste. Il parait que sa composition est conditionnée par le terrain étroit. En face d'un «tchardak» étroit, sont disposées une série de petites pièces. C'est une habitation à un étage. Les pièces du rez-de-chaussé servent d'étable et de dépôt, tandis que la cuisine est une pièce particulière qui sert aux deux habitations. La tour de l'habitation de famille, à la différence de celle des amis, est incorporée à l'habitation, faisant saillie en forme de dent.

D'après les exemples en question, ainsi que ceux conservés complètement ou en partie jusqu'à l'heure actuelle, on peut affirmer que la construction d'une habitation particulière plus petite que la principale, celle de la famille, était un phénomène assez répandu dans les couches riches des féodaux albanais au cours des XVIIIe-XIXe sc. De pair, on appliquait la conception compositionnelle particulière de la même construction, en séparant d'une manière fonctionnelle le volume réservé à la famille de celui des amis, comme un exemple de Gjirokastër, où l'on ne rencontre pas une habitation d'ami séparée. Du point de vue de typologie, les deux habitations de ces complexes ne représentent pas de nouveautés qui les détacheraient de la typologie connue de l'habitation urbaine albanaise du féodalisme tardif.

DO NOT COPY

Nr. 1 1986

monumente

DO NOT COPY

GJERAK KARAISKAJ

FRËNGJITË PËR TOPA NË FORTIFIKIMET MESJETARE, ORIGJINA DHE EVOLUCIONI I TYRE

Ndërtimi i frëngjive për topa në fortifikimet mesjetare lidhet me një nga etapat e zhvillimit dhe të përhapjes në stil të gjerë të artilerisë me barut. Vendosja e tyre mbi mur midis hapësirave të bedenave apo në frëngji për armë të bardha të përshtatura për artileri, shihet si e një periudhe më të hershme.

Shfaqjet e para të artilerisë në Evropë, të futur nga arabët, i përkasin fundit të shek. XIII, kur ajo u përdor nga spanjollët kundër Kordovës[1], por u përhap vetëm gjatë shek. XIV derisa në fund të këtij shekulli ishte bërë një mjet i rrezikshëm për objektet e fortifikuara[2]. Një zhvillim të shpejtë pati artileria me barut gjatë shek. XV. Në çerekun e dytë të shek. XV ajo u përdor me efektivitet nga francezët, ndërsa turqit, në vitin 1453, në rrethimin e Kostandinopolit, përdorën topa të kalibrit të madh.[3] Në Shqipëri topat e parë u importuan rreth fundit të shek. XIV fillimi i shek. XV. Gjatë viteve 1384-1404 feudalët shqiptarë Balsha dhe Nikollë Topia u pajisën me armë zjarri nga Venedikut dhe Raguza[4]. Në vitin 1401 Kalaja e Shkodrës ishte pajisur me topa, nga sa kuptohet nga një dokument ku bëhet fjalë për dërgimin e 50 fuçive me barut për bombarda[5]. Në dekadat e para të shek. XV (viti 1417) me artileri ishte pajisur edhe principata e Dukagjinasve[6]. Në vitin 1436 Kalaja e Drishtit kishte një top të kalibrit të vogël ndërsa disa vite më parë (1431-32) në dokumente përmendet një topçi, i cili shërbente në Kalanë e Kaninës[7] dhe së fundi vlen të përmendim Kalanë e Krujës e cila në vitin 1450 kishte 30 topa[8]. Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, deri nga mesi i shek. XV artileria me barut ishte përhapur gjerësisht në fortifikimet mesjetare shqiptare, ku një rol të veçantë luajti Heroi ynë Kombëtar, Gjergj Kastrioti (Skënderbeu), i cili pajisi me topa të gjitha kalatë që kishte në zotërim. Në shek. XV u dukën dhe frëngjitë e para për artileri të ndërtuara bashkë me muret. Nga disa studjues është shprehur mendimi se frëngjitë për topa, të një kohshme me muret, u shfaqën vetëm nga fundi i shek. XV dhe atëhere vetëm në bazat e tyre, si dhe të kullave, pasi topi në stadet e tij fillestare nuk mund të vihej mbi muret e të ulej sa të qëllonte armikun poshtë tyre, ndërsa frëngji topash më të hershme qenë përshtatur nga frëngji-shigjetë[9]. Por, siç do të shohim nga shtjellimi i materialit të mbledhur në kështjellat mesjetare shqiptare, si dhe nga disa shembuj në vende

1) F. Engels, **Vepra të zgjedhura ushtarake.** Vëll. I (Artileria) Tiranë, 1975, fq. 318.
2) R. Gutbier, **Der Baumeister Jakob von Ettlingen und der Frühneuzeitliche Festungsbau in Hessen,** Bulletin IBI Nr. 39, 1981, fq. 48.
3) S. Toy, **A History of fortification,** London 1954.
4) R. Drishti, **Armët dhe armëtarët shqiptarë,** Tiranë, 1976, fq. 25.
5) D. Thalloczy, G. Jireçek, M. Shuflay **«Acta et diplomata res Albaniae Mediae Aeatis illustrantia,** Wien, 1918, vol. I, Dok. 672.
6) R. Drishti, **Armët dhe armëtarët shqiptarë,** Tiranë 1976, fq. 25.
7) H. Inalçik, **Suret-i Defter-i Sancak-i Arvanid,** Ankara, 1954.
8) F.S. Noli, **Historia e Skënderbeut,** Tiranë 1962, fq. 64.
9) S. Toy, **Vep.cit,** C. Nigra, **Torre Castelli e caseforti del Piemonte (dal 1000 al sec. XVI),** Aosta, 1974.

DO NOT COPY

të tjera, kjo datë duhet afruar së paku deri nga mesi i shek. XV.

Frëngjitë për topa, duke filluar që nga shek. XV deri në fillim të shek. XIX, kanë forma dhe përmasa të ndryshme, të cilat lidhen me perfeksionimin e vazhdueshëm të artilerisë, si dhe me shumëllojshmërinë e kalibrave të tyre. Brenda tipave më të përgjithshëm vërehen variante, të cilat dëshmojnë jo vetëm për shprehi të ndryshme të ndërtuesve të tyre, por në mjaft raste edhe për evolucionin në kohë të këtyre frëngjive. Nga shqyrtimi tipologjik si dhe i varianteve brenda tipave, mund të arrijmë në një renditje kronologjike të tyre, gjë që do të shërbente edhe për datimin e pjesëve të veçanta të fortifikimeve të njëkohëshme me frëngjitë që po shqyrtojmë. Po të nisemi nga prefeksionimi i armës së artilerisë, frëngjitë për topa do t'i ndanim në tre tipa kryesorë të cilët përfaqësojnë edhe periudha të ndryshme kohe; frëngji me ngushtim nga jashtë, frëngji me shpatulla të drejta dhe frëngji me hapje nga jashtë. Ky klasifikim nuk mund të jetë i vlefshëm për të gjitha vendet evropiane, pasi secili prej tyre ka veçoritë e tij specifike si në drejtim të traditave ndërtimore, ndikimeve dhe në zhvillimin e pabarabartë të artilerisë dhe kalibrave të saj. Megjithatë, në vija të përgjithshme ai përputhet me etapat më të rëndësishme të zhvillimit të fortifikimeve për artileri në vende të ndryshme të Ballkanit dhe të Evropës në përgjithësi.

Frëngjitë me ngushtim nga jashtë

Nga frëngjitë me ngushtim nga jashtë janë konsideruar më të hershme frëngjitë me dalje të rrumbullakët për grykën e zjarrit dhe me një çarje vertikale në pjesën e sipërme për vrojtim, të cilat janë quajtur edhe frëngji në formë vrime çelësi (Schlüsselscharten). Prej tyre na janë ruajtur në një kullë të kështjellës së Petrelës[10]. Vetëm njëra nga kullat e kësaj kështjelle është pajisur me frëngji për topa. Kulla është e një tipi të hershëm, e lartë e me mure vertikale. Kati i parë shërbente si sterë, kati i dytë formonte një ambient me dy frëngji topash, ndërsa kati III një erker me konstruksion druri. Kulla i përket periudhës së tretë të ndërtimeve në kështjellë dhe ndodhet në një pozicion, prej të cilit nga frëngjitë e saj kontrolloheshin drejtimet më të rëndësishme të sulmit.

Në anën e brendshme të kullës frëngjitë kanë pamjen e një kamareje të mbuluar me një qemer sektorial tullash. Në ballë kamarja mbyllet nga nj mur në të cilin ndodhet përsëri një kamare më ngushtë e më e ulët e mbuluar me hark rretho brenda të cilës në pjesën e poshtme është hapu vrima rrethore për daljen e grykës së zjarrit me dia metër 17 cm, ndërsa sipër saj një e çarë vertikal e shkëputur nga vrima, shërbente për të drejtu qitjen. (Tab. I, 1).

Zakonisht në frëngjitë në formë çelësi, e çar vertikale për vrojtim është e lidhur me vrimën e rru mbullakët të grykës së zjarrit dhe bashkë me të pu nohej në një pllakë guri monolite. Në kështjell mesjetare të Piemontit e çara vertikale është ndarë, ku vrimat e rrumbullakëta dhe nganjëher drejtkëndëshe të quajtura bombardiere, qenë ado tuar nga frëngji më të vjetra shigjetë[11] Vrima rr thore për topa të ndarë nga e çara vertikale jan konstatuar në Angli në fortifikimet e Kerbi Makllor dhe Lesterit, që u përkasin viteve 1480-1484. Në k pin e Rodonit frëngjitë për topa janë të ngjashm me ato të Petrelës dhe për më tepër mund të pë caktohet koha e ndërtimit të tyre në vitet 1451-6 Me frëngji topash ka qenë pajisur bastioni që mbr nte hyrjen, pjesa e sipërme e të cilit ku ishin hap frëngjitë nuk ruhet më, por disa frëngji kanë mbet akoma në një mur të harkuar, i cili formonte m bestionin korridorin e hyrjes. Frëngjitë formohen ng kamare me gjerësi 2.60 m dhe lartësi 1.20 m, cilat ngushtohen në anën e jashtme. Ato janë mbu luar me qemerë të shtrirë tullash si në Petrel Frëngjija përfundon me një vrimë rrethore të gdhe dur në një bllok monolit guri (Tab. I,3). Diametri vrimës është 30 cm. Disa nga frëngjitë mund të ker qenë më të çarë vertikale për drejtimin e qitjes, ng sa kuptohet, nga një e hapur vertikale mbi njërë nga pllakat e gurit (fig. 1) si dhe nga fakti që m këto pllaka muri është i rënuar (fig. 2). Nga gjurm e ruajtura rezulton se në të shumtën e rasteve çara vertikale ka qenë e ndarë, por nga ndonjëhe ajo ishte e bashkuar me vrimën e grykës së zjarr (fig. 1). Nga frëngjitë e këtij muri ajo që zë një p zicion qendror kundrejt të tjerave na paraqitet n një formë të veçantë. Ana ballore është krejtësisht hapur duke pasur një hapësirë drite prej 85 cm, p brenda kësaj hapësire në të dy shpatullat e frëngji ruhen gjurmët e dy kanaleve që shërbenin për të l vizur dhe fiksuar një kanat të fuqishëm prej dru me trashësi 30 cm. Kur kanati ishte i hapur, d.m.t kishte rrëshqitur deri në fund të kanalit në krah

10) A. Baçe-Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Petrelës,** Monumentet 5-6, 1973, 139-160. Gj. Karaiskaj, **5000 vjet fortifikime në Shqipëri,** Tiranë, 1981, fq. 132.

11) C. Nigra, **Vep.cit,** fq. 12.

DO NOT COPY



Fig. 1

e majtë, hapësira e dritës për grykën e topit mbetej 52 cm. (Tab. I,6).

Kjo frëngji shërbente, me sa duket, për të vendosur një top të një kalibri më të madh dhe, duke qenë se paraqiste rrezik për mbrojtësit, pasi mund të shërbente nga armiku si hyrje për në kala, për më tepër ngaqë frëngjitë janë vendosur në rrëzën e murit, është menduar që të sigurohej mbyllja e saj me një kanat druri aq të fuqishëm sa t'i bënte ballë edhe goditjes së artilerisë së armikut. Këtë kala Skënderbeu e ndërtoi në vitet 1451-52[12]., por, meqë të dy hyrjet që formohen në këtë korridor nuk lidhen me bastionin, muri me frëngji mund t'i përkasë një faze të dytë ndërtimi dhe pikërisht asaj të vitit 1463, kur Skënderbeu kreu përsëri ndërtime në këtë kala.. Në skajin perëndimor të murit të harkuar ruhen rrënojat e një kulle të rrumbullakët për artileri, në të cilën sot nuk ka mbetur asnjë gjurmë frëngjie, por në qemerin e mbulesës së saj të rrënuar ruhet gjurma e një oxhaku me prerje drejtkëndëshe (25 x 30 cm) që shërbente për nxjerjen e tymrave që shkaktoheshin nga djegia e barutit (fig. 3). Petrela dhe kepi i Rodonit përbëjnë shembuj fortifikimesh ku gjejnë përdorim frëngjitë për topa të tipit në formë vrime çelësi, për të cilat në përgjithësi mendohet se janë përhapur në Evropë rreth fundit të shek. XV. Ato i shohim rreth kësaj kohe të bashkëjetojnë me frëngji të tipave më të zhvilluar në muret mesjetare të Raguzës[13], gjithashtu në kështjellat e Piemontit



Fig. 2

12) P. Thomo, **Kalaja e Skënderbeut në kepin e Rodonit,** Studia Albanica, 1967, 103-108.

13) A. Deanović, **Les plane régionaux de fortification des frontierés croate a travers les siécles de guerre contre les Turcs et les ouvrages les plus caracterristiques du XVI e XVII et XVIII siécle** Bulletin, IBI, Nr. 29, 1971, fq. 19.

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4



Fig. 5

etj[14]. Pas vitit 1460, në Hesen të Gjermanisë, në sajë të krijimtarisë së mjeshtrit Hans Jakob Fon Ettlingen, frëngjitë në formë çelësi filluan të zëvendësoheshin me të ashtëquajturat «frëngji-grykë» (Maulschartten), ndërsa vazhduan të përdoreshin të par dhe në kulla të ndërtuara posaçërisht për artil të quajtura rondele[15]. Sidoqoftë, me frëngjitë e P trelës e të Rodonit kemi të bëjmë me tipa të he

14) C. Nigra, **Vep.cit,** fq. 70-76, fig. 153.
15) R. Gutbier, **Vep.cit,** fq. 49.

shme të tyre, prej të cilave ato të Petrelës nuk duhet të jenë më të vona se mesi i shek. XV. Nga ana tjetër, në Rodon shohim të lindë një tip më i zhvilluar frëngjie i përshtatshëm për topa të kalibrave më të mëdhenj e për më tepër që lejon një manovrueshmëri më të madhe të tyre, siç është frëngjia qendrore e pajisur me kanat druri. Frëngji për topa me vrimë të rrumbullakët në dalje pa të çarë vertikale për vrojtimin e qitjeve, të fundit të shek. XV, kemi dhe në kështjellën e Prezës, e cila ka formë pesëkëndëshe me kulla rrethore në katër prej tyre. Dy nga kullat kanë nga tri frëngji për topa, njëra prej tyre dy, ndërsa kulla e fundit ruhet nën nivelin e frëngjive. Të gjitha frëngjitë janë ndërtuar me të njëjtën mënyrë. Në pjesën e brendshme kanë formën e një dritareje të mbuluar me hark tullash. Ana e jashtme e dritares është mbyllur nga një mur i hollë me gjerësi 0,42 m, në të cilin është hapur një vrimë e rrumbullakët me diametër 0,18-0,30 m për vendosjen e grykës së zjarrit (Tab. I,2) (fig. 4). Nga jashtë frëngjitë janë dekoruar me rrathë tullash e tulla radiale në formën e një rozete (fig. 5). Frëngjia jugore e kullës 1 kufizohet nga katër rrathë koncentrikë tullash, prej të cilëve njëri, i vendosur në formë dhëmbë sharre, ajo veriore me dy rrathë, ndërsa frëngjia jugore e kullës 4 vetëm me një rreth në formë rozete, i cili shoqërohet me të njëjtin dekoracion keramoplastik. Të tilla janë frëngjitë në një kullë të ndërtuar për artileri në kështjellën e Smederevos në Serbi e datuar në vitin 1480[16], si dhe ato në kalanë Ram pranë Smederevos dhe të Gollubacit të ndërtuara rreth kësaj kohe[17]. Frëngjitë për topa të shek. XV në disa raste na paraqiten si një zmadhim i thjeshtë i frëngjive për armë të bardha. Shembullin më të hershëm të datuar e kemi nga Kalaja e Elbasanit[18]. Kullat e rindërtuara në vitin 1466 nga Mehmeti II u pajisën përgjithësisht me nga 3 frëngji topash me hapësirë të brendëshme 0.80-1.00 m, të cilat ngushtohen nga jashtë në 0.62-0.70 m. Më mirë frëngjitë ruhen në kullat e këndeve. Ato mbyllen nga ana e brendshme me nga një hark rrethor me tulla dhe nga një qemer në formë kalote sferike, ku nuk mungojnë edhe elementet stalaktite të formuara nga gurët që dalin respektivisht njëri përmbi tjetrin e të kujtojnë trompat e xhamive (fig. 6). Shpatullat anësore të frëngjive gjithashtu kanë formë të harkuar, duke u afruar në anën e jashtme. E çara vertikale, mjaft e gjerë në krahasim me frëngjitë në formë çelësi apo me vrimë rrethore, shërbente për vendosjen e grykës së topit në pjesën e poshtme dhe njëkohësisht për vrojtimin e qitjeve. Frëngjitë me ngushtim nga jashtë janë mjaft të përhapura, por me brinjë anësore të harkuara ato i takojnë përveç Elbasanit edhe në kështjellën e Delvinës (Tab. II, 1). Vetëm njëra nga kullat e kësaj kështjelle, në gjendje relativisht të mirë, ruan gjurmët e tri frëngjive për topa që shohim në drejtime të ndryshme, kryesisht drejt zonës nga shtrihej dikur qyteti mesjetar i Delvinës, si dhe në kodrat që ndodhen nga ana juglindore, të cilat me lartësinë e tyre e zotërojnë kodrën e kështjellës. Kjo kullë është përcaktuar si e fazës së parë të ndërtimit, duke u datuar në shek. XI-XII[19]. Jo vetëm prania e frëngjive për topa, por edhe vrojtimi më i kujdesëshëm i mureve në bazamentet e kullës do të bënin të qartë se kulla i përket një periudhe të mëvonshme edhe që nuk është më e hershme se e shek. XV. Frëngjitë nuk ruhen të plota; por nga gjurmët e ruajtura në pjesën e sipërme të njërës prej tyre kuptohet se ato mbuloheshin me qemer konik. Hapësira e brendshme ka një gjerësi prej rreth 1.40 m, ndërsa nga jashtë ngushtohet në 0.65 m, masë që i përgjigjet asaj së frëngjive të kalasë së Elbasanit. Forma frëngjie topash, që të kujtojnë frëngjitë për shigjetë, hasim



Fig. 6

16) A. Deroko, **Smederevski grad,** Starinar II, 1951. fq. 58-98.
17) A. Deroko, **Grad Gollubac,** Starinar II, 1951.
18) Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Elbasanit,** 1/1971, fq. 61-77.
19) A. Baçe, **Kështjellat e Kardhiqit e Delvinës,** Monumentet 13; 1977, fq. 64.

DO NOT COPY

edhe në Kalanë e Bashtovës[20], e të Drishtit. Në Bashtovë si frëngjitë e shigjetave dhe ato të topave janë ndërtuar në të njëjtën mënyrë veçse ndryshojnë në përmasa. Frëngjitë për topa janë hapur në bazat e mureve rrethuese, si dhe në kullat. Ato kanë në planimetri formën e një trapezi me bazë nga jashtë, mbulohen rrafsh me pllaka guri dhe përfundojnë në anën e jashtme me një të çarë vertikale me gjerësi 0,35 m dhe lartësi 1 m, sa është lartësia e vetë frëngjisë (Tab. I, 4), ndërsa njëra nga këto frëngji e hapur në bazamentin e një kulle është aq e gjerë nga jashtë, sa të krijon përshtypjen e një dritareje me hapësirë drite katrore. Në Drisht një frëngji e tipit të Bashtovës ndodhet në një kullë drejtkëndëshe, të kështjellës, e cila është ndërtuar para vitit 1478[21]. Frëngjia nuk ruhet e plotë dhe për shkak të gjerësisë së hapësirës së saj të jashtme vetëm 0.18 m, qëllimi i përdorimit të saj mbetet i dyshimtë.



Fig. 7

Shumica e frëngjive për artileri të shek. XV deri nga fillimi i shek. XVI mbulohen me një qemer trung-konik dhe përfundojnë nga jashtë me një hapësirë në formën e një dritareje të mbuluar me hark guri apo tullash. Të tilla janë frëngjitë në kështjellën në lartësinë 59 në Durrës[22]. Kullat tetëkëndëshe të kësaj kështjelle janë pajisur me nga tri frëngji secila për topa, të ruajtura mjaft mirë, të vendosura 0.30 m mbi nivelin e dyshemesë të katit të dytë. Frëngjitë mbulohen me qemer trung konik prej tullash, nga brenda kanë një gjerësi 1.40 m dhe lartësi 1.80 m, ndërsa nga jashtë gjerësia është 0.83 m dhe lartësia 0.90 m, në fasadë përfundojnë në formën e një dritareje me hark gurësh të latuar (Tab. III 2). Këto het të jenë nga frëngjitë më të hershme për arti të këtij lloji, pasi kështjella në *l* 59 është më e h shme se një mur i vitit 1502, që i mbështetet d dhe për më tepër se një kullë para pushtimit të l rrësit nga turqit e ndërtuar me shumë mundësi rr viteve 80 të shek. XV[23]. Frëngjitë e kullave dr këndëshe të murit të periudhës së pushtimit turk 1502) nuk ndryshojnë në formë nga të parat, ve në detaje të parëndësishme (Tab. III, 3) (Fig. 7). të gjitha këto frëngji gjerësia e hapësirës së dal së grykës së zjarrit shkon nga 0.33-0.38 m. Frën me ngushtim nga jashtë të mbuluara me qemer l nik, por me një hapësirë drite më të madhe në da (0.70 m) takojmë në kështjellën e Kaninës në mu verior të Citadelës ku ndodhet një ambient me frëngji (Tab. II, 3), si dhe në një nga kullat poli nale të kësaj kështjelle. Në periudhën e parë ndërtimit në kështjellën e Peqinit ruhen gjurmët



Fig. 8

njërës nga shpatullat e një frëngjie të tillë, e cil është murosur në një periudhë më të vonë. Frëngji ka qenë mbuluar me qemer tullash dhe duket s kishte në dalje një gjerësi prej rreth 0.60 m (Tal II. 4). Frëngjitë më të zhvilluara të kësaj periudhe kemi në një kullë për artileri në Kalanë e Durrësit, ndërtuar me sa duket në vitin 1478. Kulla i ka t gjitha cilësitë e një fortifikimi që do të përballont goditjen e artilerisë armike (e ulët, me mure të gjer 3.75 m e mbushur me dhe në pjesën e poshtme

20) Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Bashtovës,** Monumentet 5-6, 1973, fq. 59-80.
21) Gj. Karaiskaj, **5000 vjet fortifikime në Shqipëri,** Tiranë 1981, fq. 147.
22) Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Durrësit në mesjetë,** Monumentet 13, 1977, fq. 29-53.
23) Gj. Karaiskaj, **Po aty,** fq. 29-53.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nga ana tjetër ajo ishte një pikë e fuqishme zjarri, duke strehuar një bateri me 5 topa (fig. 8). Në planimetri frëngjitë formohen nga dy trapeza të bashkangjitur nga baza e vogël. Trapezi i dytë, mbi të cilin formohet dritarja e daljes së grykës së zjarrit është mjaft më i vogël se i pari, duke pasur vetëm një prerje të lehtë të brinjëve anësore në dalje të frëngjisë, kështu në tërësi frëngjia i përmbahet më tepër tipit me ngushtim nga jashtë (Tab. III, 1).

Frëngjitë e këtij tipi, me ndryshime të vogla, vazhduan të përdoreshin edhe gjatë shek. XVI e XVII.

Frëngji me shpatulla të drejta

Në një nga muret e Kalasë së Drishtit, i cili para vitit 1478 qe përshtatur për artileri duke i shtuar gjerësinë nga 0.80 m në 2 m, nëpërmjet ndërtimit të një muri të brendshëm shtesë, është hapur një frëngji për top. (Tab. II, 2). Frëngjia është 0.90 m e gjerë si nga brenda edhe nga jashtë dhe ka një lartësi prej 0.70 m. Muri i jashtëm më i vjetër është hapur me rastin e ndërtimit të frëngjisë dhe nuk ka patura të rregullta. Forma e kësaj frëngjie me shpatulla të drejta mund të jetë një zgjidhje rastësore e kushtëzuar nga periudha më e hershme e ndërtimit të kalasë, por frëngji me shpatulla të drejta, të ndërtuara njëkohësisht me kullat ne takojmë në kështjellën trekëndëshe pranë kanalit të Vivarit në Butrint. Kullat e pajisura me këto frëngji i përkasin periudhës së tretë të ndërtimeve të kështjellës dhe janë ndërtuar rreth mesit të shek. XVII[24]. (Tab. II, 5) (fig. 10). Gjithashtu në Kalanë e Ishmit ruhen gjurmët e një frëngjie për top, e ndërtuar njëkohësisht me muret, të cilat datohen në vitet 1572-74[25]. (Tab. II, 6). Frëngjia ka pasur formën e një dritareje me brinjë anësore të drejta dhe mbulohej nga një qemer guri. Nga ana e brendshme ajo ka një gjerësi prej 1.20 m, ndërsa hapësira jashtë ngushtohej nëpërmjet paturave në 0.70 m. Në vitin 1574 kjo kështjellë u pajis me dy topa të sjellë nga Kalaja e Shkodrës.



Fig. 9



Fig. 10

FRËNGJITË ME HAPJE NGA JASHTË

Deri tani u njohëm me frëngjitë për artileri me ngushtim nga jashtë, tipike për shek. XV; si dhe me shembuj të paktë të vazhdimit të tyre deri rreth mesit të shek. XVI, si dhe me frëngjitë me shpatulla të drejta që i hasim kryesisht në fortifikime të shek. XVI-XVII. Vumë re gjithashtu se në shembujt më të zhvilluar të frëngjive me ngushtim nga jashtë, si në ato në kullën rrethore të Durrësit, vërehet tendenca për një pjerrje të lehtë të shpatullave anësore nga jashtë apo nga zgjerimi i hapësirës për daljen e grykës së zjarrit. Por nuk mund të bëhet fialë akoma

24) Gj. Karaiskaj, **Butrinti dhe fortifikimet e tij,** Tiranë 1984, fq. 109.
25) Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Ishmit.** Monumentet 15-16, 1978; fq. 243-247.

për ekzistencën e frëngjive me hapje të theksuar të shpatullave anësore nga jashtë gjatë shek. XV dhe ndoshta edhe gjatë gjysmës së parë të shek. XVI, evolucion që lidhet me një stad më të zhvilluar të artilerisë në drejtim të kalibrave më të mëdhenj brenda kullave të kështjellave, me qëllim që të mbaheshin sa më larg mureve të kështjellave bateritë armike në një kohë kur artileria e rrethimit ishte zhvilluar aq sa këto mure nuk e përballonin më. Përcaktimi i kohës së fillimit të përdorimit të frëngjive të hapura gjerë nga jashtë do të shërbente edhe si një element datimi për fortifikimet apo për periudhat e ndryshme të ndërtimeve në to.

S. Toi mendon se, pasi vrima për top në frëngjitë mori forma të ndryshme nga ajo rrethore, në përgjithësi qe e pjerrë, gjerë në anët për t'i dhënë topit fushëpamjen më të madhe të mundur djathtas e majtas dhe se në pozicionet sipër mureve pragjet qenë pjerrë shpejt nga poshtë për të zmbrapsur operacione në rrëzë të tyre[26]. Ky përfundim është i vlefshëm në një vështrim më tërësor të fortifikimeve mesjetare. Por vende të ndryshme na paraqiten me tipare të veçanta, që lidhen me kushte specifike ekonomike e politike. Nga ana tjetër nuk mund të ndiqet një kronologji e tipave pa të meta e zbrazëti, duke u mbështetur në një rajon apo në një vend të vetëm. Por, përveç ndonjë rasti të rrallë, frëngjitë nuk janë bërë objekt i veçantë studimi dhe për më tepër nuk jepen të dhëna teknike mbi to në studimet e ndryshme për fortifikimet. Për këto jemi të detyruar të ndjekim ecurinë e tyre nëpërmjet fotove të dhëna aksidentalisht, si dhe të skicave të vogla dhe në të shumtën e rasteve të përfshira në planet e përgjithshme të fortifikimeve. Frëngjitë e tipit «grykë» (Maulscharten) të sipërpërmendura të ndërtuara në vitin 1478 në të ashtuquajturën «Kulla e Shtrigave» të kështjellës së Shvajnsbergut, kanë pragje të pjerrëta nga jashtë, gjithashtu shpatulla anësore që zgjerohen në të njëjtin drejtim. Por këto të fundit formojnë një kënd të ngushtë që fillon në mesin e trashësisë së murit dhe hapësira e dritës në dalje nuk e kalon gjerësinë e kamares së brendshme në të cilën vend
sej topi[27], ndërsa në një kështjellë tjetër të kës
krahine këto frëngji i takojnë një faze të dytë ndë
timi në vitin 1498, pas frëngjive vrimë «Schiessl
cher»[28]. Frëngji të këtij tipi takojmë edhe në k
shtjella me tipare karakteristike për shek. XVI[29]. Z
konisht frëngjitë e tipit grykë përfundojnë në anën
jashtme me një të çarë horizontale drejtëkëndësh
apo të mbuluar me një hark të shtrirë.

Në fortifikimet e Dubrovnikut të shek. XV-X
shohim frëngji të ngjashme me ato të kullës për a
tileri në Durrës, me ngushtim nga jashtë ose n
shpatulla të drejta[30]. Të tilla janë frëngjitë për top
edhe në Rondelin Jugor të kështjellës mesjeta
mbretërore të Budës (Hungari), e ndërtuar rreth vi
1480[31]. Në kështjellën Soko në Bosnjen Perënd
more në një kullë drejtkëndëshe, që nuk është ka
rakteristike për artileri, e ndërtuar me sa duket m
dis viteve 1464-1518, ndodhen një frëngji me shpa
tulla të drejta dhe me një vrimë katrore nga jasht
rreth 1 x 1 m[32]. Në kullën për artileri të kështjellë
së Dilingenit në bregun e Danubit (Bavari) e ndër
tuar në vitet 1545-1590 frëngjitë për topa nuk jan
me hapje të gjerë nga jashtë[33]. Akoma në fund t
shek. XVII takojmë frëngji me shpatulla të drejta
ngushtim nga jashtë brenda bastioneve, krahas frën
gjive me hapje të gjerë nga jashtë në parapete, s
në kështjellën Karababa (Greqi), e ndërtuar në vite
1680-1690[34]. Një përjashtim përbëjnë në këtë drej
tim kështjellat e Bosforit të ndërtuara nga Mehmeti II
ku takohen frëngji të mëdha për topa me hapje ngu
jashtë. Së pari, ato i takojmë në murin e jashtën
(barbakan) e më të ulët të Rumeli Hisarit, të ndër
tuar nga Mehmeti II në vitin 1452 disa muaj para
marrjes së Kostandinopojës si dhe në atë të Ana
dollit[35]. Të njëjtat frëngji, të drejtuara nga ana e
detit, kanë edhe kështjellat e Dardaneleve, njëra e
quajtur Kështjella e Sulltanit dhe tjetra Kilitbahi
(çelës i detit) që ndodhet përballë së parës në bre
gun evropian. Të dyja janë ndërtuar gjithashtu nga
Mehmeti II në vitet 1459-1460[36]. Frëngjitë përfun-

26) S. Toy, **vep.cit,**
27) R. Gutbier, **vep.cit,** fq. 50, fig. 28.
28) **Po aty,** fq. 49.
29) R. Gutbier, **vep.cit,** fig. 30. fq. 60.
30) A. Deanović, **La situation de conservation du Patrimoine de l'architecture fortifiee en Jugoslavie,** Bulletin IBI, 37, 1980, fq. 128.
31) L. Gerö, **Über die sogennanten Rondele,** Bulletin IBI, nr. 33, 1977, fig. 46.
32) L. Bojanovski, **Sokol na Plivi,** Nasè Starine XIII, Sarajevo, 1972, fq. 41-69.
33) V. Mayer, **Studienfart des Internationalen Burgen Instituts in Bayern,** 1966, Bulletin IBI, nr. 24, 1968, fq. 83.
34) N. Osnuk, **ZSV Nova Gorica,** Varstvo Spomenikov, XXV, Lubljana, 1983, fq. 273.
35) D. Azivas, **The turkish fortress of Karababa,** Actes VIII, **Reunion Scientifique;** Athenes, 1963, fq. 147-156.
36) I. Oz. **Les chateaux forts-existant en Turquie,** Bulletin IBI. nr. 37, 1980, fq. 181-182.

DOKTORATURA

dojnë nga jashtë me një hapje horizontale të mbuluar me një hark sektorial. Në kështjellën e sulltanit frëngjitë formohen në plan nga dy trapeza që kanë të përbashkët bazën e vogël dhe ku ai i jashtmi është mjaft më i madh. Në një kullë të Kilitbahirit të shtuar në vitin 1541 me bazament trungkonik të kufizuar me kornizë që të kujton kullat veneciane, frëngjitë janë të larta dhe mbulohen me hark rrethor. Autori i studimit nuk i përmend si frëngji topash këto të hapura në mure që përmendëm më sipër. Ai thotë se topat qenë vendosur në hapësirat midis bedenave që ishin mjaft të gjera[37]. Por ato nuk ka se si të mos kenë qenë frëngji për topa, përndryshe do të përbënin një rrezik për kështjellën, duke qenë të hapura në pjesën e poshtme të mureve. Frëngji me hapje të gjerë nga jashtë, të formuar në plan nga bashkimi i dy trapezave, i takojmë edhe në rondele me gjerësi të brendshme 18 m në kështjellën e Diosgiorit (Hungari), për të cilin nuk jepet koha e rindërtimit[38]. Dihet se Mehmeti II për pushtimin e kryeqytetit të Bizantit derdhi topa të kalibrave të paparë për atë kohë dhe bëri përgatitje të mëdha siç tregon dhe ndërtimi i dy kështjellave të Bosforit. Këto kështjella përbëjnë në këtë drejtim një përjashtim edhe kundrejt fortifikimeve të tjera të kohës të ndërtuara nga osmanët në krejt perandorinë, të cilat ishin të rralla dhe nuk ndryshonin nga kështjellat e vjetra mesjetare[39]. Tipi i frëngjive për topa i kështjellave të Bosforit, me ndryshime të vogla, mbeti në përdorim deri në fillim të shek. XIX. Frëngjitë për topa të shek. XVIII-XIX të hasura në fortifikimet tona ndryshojnë prej atyre të kështjellave turke të lartpërmendura vetëm në atë që nga jashtë janë më të larta se të gjëra ose së paku formojnë një gjysmë rrethi të plotë, gjë që arrihet nëpërmjet përdorimit të qemereve trung-konikë si nga brenda ashtu edhe nga jashtë ndërsa të parat nga forma e së çarës në anën e jashtme me shtrirje horizontale nuk shkëputen nga tipi i frëngjive «grykë». Gjatë shek. XVI frëngjitë me hapje nga jashtë krahas tipave të tjerë, me sa duket qenë përhapur gjerësisht, ato i takojmë në parapetin e mureve të kështjellës Jaka (Spanjë)[40]. Në fortifikimet e jashtme të Salzburgut (Gjermani), të ndërtuara me sa duket pas vitit 1529[41], në kështjellën e Rapotenshtajnit në Austrinë e Poshtme e përshtatur për artileri në shek. XVI si dhe fortesën e Kufstajnit në Tirol, e përshtatur për artileri në gjysmën e parë të shek. XVI, pas vitit 1504[42] etj.

Por pas rënies së kështjellave të fundit shqiptare në duar të turqve, këta të fundit, me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë siç është Kalaja e Vlorës, pak ndërtuan sipas teknikave bashkëkohëse të fortifikimit. Ndërtimet fortifikuese të kësaj periudhe synonin të siguronin sundimin osman në krahina të ndryshme shqiptare, si dhe shtypjen e kryengritjeve e të revoltave fshatare, duke qenë përballë një kundërshtari të papajisur me mjete moderne sulmi e artilerie. Gjatë shek. XVII kështjellat bregdetare pranë porteve kryesore siç ishte p.sh. Kanina që mbante nën kontroll limanin e Vlorës, ishin pajisur me topa të kalibrave të mëdhenj. Udhëtari turk Evlija Çelebiu shkruante se Kanina jashtë mureve të fortesës së brendshme kishte katër topa «që shokët e tyre nuk i ka zotëruar ndonjë mbret as nuk gjendjen në ndonjë kufi të fortifikuar». Për të treguar madhësinë e njërit nga këta topa, Çelebiu thotë se në të banonte një i varfër me gjithë orenditë e tij.[43]. Topat e përmendur nga Çelebiu, nga sa kuptohet prej emërtimit që i vë ai «Balljemez» që s'është gjë tjetër veçse deformimi i «palla e mexo»,[44] ishin të prodhimit venecian. Megjithatë, deri sot, nuk kemi asnjë dëshmi të sigurt për frëngji topash me hapje nga jashtë që t'i përkasë kësaj periudhe, ndërsa prej tyre kemi me shumicë gjatë shekujve XVIII-XIX, periudhë e lulëzimit të pashallëqeve të mëdha shqiptare.

Frëngjitë me hapje nga jashtë i takojmë në disa variante për nga forma planimetrike. Lloji më i thjeshtë është ai që formohet nga një trapez me bazën e madhe nga jashtë. Të tilla frëngji hasim në Berat. Në kështjellën në derdhje të Vivarit në Butrint (Tab. IV, 2), Krujë, Shkodër etj dhe datohen në shek. XVIII-XIX, ato i gjejmë si në parapete mbi mure ku janë të pambuluara ashtu edhe në ambientet e kullave ku mbulohen me një qemer guri trung-konik. Zakonisht këto frëngji qenë ndërtuar për topa të kalibrave të mëdhenj, gjerësia e tyre në anën e jashtme shkon nga 2-3 m, ndërsa nga brenda 0,5 –

37) I. Öz. **vep.cit,** fq. 187 e vazhd.
38) K. Ferenczy, **Rekonstruktion der Burg in Diosgyor,** Bulletin IBI Nr. 39, 1981, fq. 48.
39) W. Müller – Wiener, **Die Anfänge des Festungsbaues,** Burgen und Schlösser, 1960, II. fq. 1.
40) L. Villena, **Il castello Spagnolo suoi antecedenti e Sua Comparsa,** Castellum, 22, Roma, 1982, fq. 84, fig. 20.
41) H. Max, von Aufsess, **Burgen,** München 1977, fq. 14.
42) H. Max, von Aufsess, **vep.cit.,** fq. 26.
43) Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëllimi III, Tiranë 1962, fq. 179.
44) F. Babinger, **Ewlia Tschelebi 's Reisewegen in Albanien,** Berlin, 1930.

DOKTORATURA

DO NOT COPY



Fig. 11

1 m. Rrallëherë takojmë ndonjë frëngji të vogël si në Shkodër, me gjerësi nga jashtë 1.10m e nga brenda 0.70m (Tab. IV, 4). Lartësia e frëngjive nga jashtë deri në kyçin e harkut ndryshon sipas madhësisë së tyre, lartësia e hapësirës së brendshme është më e vogël.

Nga frëngjitë e këtij lloji njëra që ruhet në Kardhiq mbi një kullë poligonale përfundon në pjesën e brendshme me një paturë drejtëkëndëshe mbi të cilën ngrihej harku[45], ndërsa frëngjia e përmendur në Shkodër ka një prag të pjerrët nga jashtë fortifikimit për të lejuar uljen e grykës së zjarrit (Tab. III, 4).

Varianti tjetër i frëngjive është ai që në planimetri ka formën e dy trapezave, të cilët kanë të përbashkët bazën e vogël. Secili nga këto trapeza mbulohet me një qemer trungkonik, i cili zgjerohet e lartësohet kundrejt faqes së murit, këta qemerë mund të jenë të barabartë si nga jashtë edhe në pjesën e brendshme të frëngjisë por në të shumtën e rasteve qemeret e brendshme janë më të vegjël. Në kështjellën trekëndëshe pranë kanalit të Vivarit në Butrint frëngjitë për topa të këtij tipi, të cilat janë më të hershme se ato që kemi përmendur deri tani (fund i shek. XVII-shek. XVIII), bien me pragje të pjerrëta s nga brenda ashtu edhe nga jashtë dhe nuk haper gjerë në anën e jashtme, duke krijuar këndе të ngushta (Tab. IV, 2).

Njëfarë evolucioni mund të ndjekim midis frëngjive të këtij varianti nga shek. XVIII në shek. XIX edhe në kështjellën e Peqinit. Në periudhën e tretë të ndërtimit në këtë kështjellë rreth viteve 1770, u rindërtuan kullat 1 dhe 2 dhe u shtuan kullat 4, 5 6[46]. Frëngjitë e topave të kësaj periudhe, me hapje në të dy anët, formojnë një kënd të ngushtë (Tab IV, 1) ndryshe nga ato të gjysmës së parë të shek. XIX (periudha e katërt e ndërtimit), të cilat janë më të mëdha, më të larta dhe zgjerohen më tepër në anën e jashtme (Fig. 11). Në një nga frëngjitë e shek. XVIII që i përket një kulle poligonale këndi, e hapur në katin e dytë, hetohet në pjesën e brendshme të frëngjisë një e thelluar në mur në formën e një tymtari, e cila përshkon edhe katin e tretë, dhe shërbente për largimin e tymrave që shkaktoheshin nga djegia e barutit pas plasjes. Në kullën tjetër të këndit, diagonal me të parën, nuk ka gjurmë oxhaku në mur, pasi ajo nuk kishte kat të tretë dhe ka qenë e mbuluar me çati ku mund të ketë pasur baxhë për largimin e tymrave të dy topave që ishin vendosur në këtë ambient, ashtu si në Kalanë e kepit të Rodonit.

Disa nga frëngjitë me hapje nga jashtë si në Kalanë e Gjirokastrës, në plan kanë formën e një trapezi që i bashkohet një katërkëndëshi të gjerë në pjesën e brendshme të fortifikimit, i pari me bazën e madhe në anën e jashtme mbulohet me një qemer trungkonik, ndërsa i dyti me një qemer cilindrik, për të lejuar një manovrim më të mirë të armës (Tab. V, 1). Këtë tip frëngjie e takojmë në kulla deri rreth mesit të shek. XIX në fortifikimet e Veronës[47]. Frëngjitë me hapje nga jashtë, por të drejtuara kundrejt zonave të caktuara jashtë fortifikimit si në Shkodër (fig. 12), Butrint, (Tab. IV, 2,6) etj, zgjerohen nga jashtë vetëm në njërën shpatull, ndërsa shpatulla tjetër formon një kënd të drejtë apo të ngushtë me murin rrethues të fortifikimit. Këto frëngji kishin për avantazh atë që nuk i shfaqeshin armikut me gjithë gjerësinë e tyre në drejtime të padëshiruara. Frëngjitë mund të ishin edhe të thjeshta në formën e një dritareje, si disa frëngji topash në Kalanë e Shkodrës (Tab. IV, 3). Ato ndërpresin një mur me gjerësi 1.15 m, janë 1.85 m të larta dhe mbulohen me një qemer

45) A. Baçe, **Kardhiqi, vep.cit,** fq. 64.
46) L. Papajani, **Kalaja e Peqinit,** Monumentet 9, 1975, fq. 55-76.
47) G. Perbellini, **La Piazzaforte d'i Verona,** në Le fortificazioni ottocentesche della Provincia di Verona, Repertorio delle architetture militari fortificate della Regione Veneta, Quaderno 1, Verona, 1981, fq. 27.

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13

të dyfishtë gurësh të punuar. Këndet e mureve, për të mos u dëmtuar, vijnë të rrumbullakosura. Në të dy anët e frëngjisë me lartësi 0.60 m janë murosur ganxha hekuri me rrathë për të lidhur shtretërit e topave (Fig. 13). Këto janë frëngjitë më të vona për topa në Kalanë e Shkodrës dhe i përkasin ndoshta mesit të shek. XIX.

* *
*

Po të analizojmë të dhënat që na ofron shqyrtimi tipologjik i frëngjive për topa në fortifikimet mesjetare shqiptare, do të arrinim në përfundimin se ato u shfaqën si të njëkohëshme me muret në një periudhë të hershme. Frëngjitë e tipit në formë vrime çelësi qenë përhapur gjerësisht në mesin e shek. XV, kur në disa vende të Evropës ato fillojnë të duken vetëm nga fundi i këtij shekulli si p.sh. në Piemont. Shkaqet e këtij fenomeni duhet t'i shohim kryesisht në rolin dhe në pozitën që zinin territoret shqiptare kundrejt ekspansionit osman, pa dyshim dhe në ndikimet e arkitekturës ushtarake italiane e veneciane të kohës, të cilat kishin bërë hapat e para në krijimin e fortifikimeve të posaçme për artileri. Gjatë shek. XV ndeshim edhe tipa të tjerë më të zhvilluar frëngjish gjithnjë me ngushtim në anën e jashtme të fortifikimit, siç janë ato që përfundojnë me një të çarë vertikale, por mjaft të gjerë dhe të lartë, për të lejuar vrojtimin e qitjes, si dhe frëngjitë që përfundojnë nga jashtë në formën e një dritareje të mbuluar me hark rrethor, ndërsa krejt frëngjia nga një qemer trung-konik dhe së fundi frëngjitë që përfundojnë me një vrimë rrethore pa të çarë vertikale për vrojtim. Frëngjitë e mësipërme janë tipike për shek. XV prej të cilave ato në formë dritareje vazhdojnë të përdoren edhe gjatë shek. XVI e ndoshta më vonë, ndërsa frëngjitë me vrimë rrethore fillojnë të rishfaqen tepër vonë në banesa të fortifikuara të shek. XVIII-XIX. Frëngjitë me vrimë të rrumbullakët kanë në dalje një hapësirë drite me gjerësi 17-30 cm, ndërsa të tjerat duke përfshirë edhe rastet e veçanta 25 deri 90 cm.

Për shek. XVI dhe XVII materiali faktik është i paktë, në këtë periudhë krahas frëngjive të tipave më të vjetër që vazhdojnë të jetojnë si ai me qemer trungkonik dhe frëngjitë me vrimë të rrumbullakët pa të çarë vertikale, shfaqen edhe frëngjitë me shpatulla vertikale kundrejt murit të mbuluar me qemer cilindrik (Butrint, Ishëm) të cilat formojnë një hapësirë më të gjerë në pjesën e brendshme. Gjatë këtyre dy shekujve nuk kemi asnjë dëshmi të sigurt që të na provojë ekzistencën e frëngjive me hapje nga jashtë. Por, duke gjykuar nga shembuj në vende të tjera, ky tip frëngjije u përhap në shek. XVI me përjashtim të kështjellave të Bosforit e Dardaneleve të ndërtuara nga Mehmeti II ku frëngjitë me hapje nga jashtë janë përdorur që në mesin e shek. XV. Nuk përjashtohet mundësia që frëngji të këtij tipi të jenë përdorur në Shqipëri gjatë shek. XVI-XVIII, por ato u përhapën gjerësisht vetëm gjatë shek. XVIII-XIX, kryesisht në periudhën e pashallëqeve të mëdha shqiptare. Më parë frëngjitë me hapje nga jashtë duhet të kenë filluar të përdoren në parapetet, mbi mure dhe më vonë në ambiente të mbyllura.

TAB I



1



2



3



4 5



6



1. PETRELA
2. PREZE
3, 6. KEPI RODONIT
4. BASHTOVE
5. BUTRINT (Kalaja e Vivarit)

0 1 2 3 4 5 m

DO NOT COPY

TAB II



DO NOT COPY

TAB III



DURRES (Shek XV) 1





DURRES (Shek XV) 2

3 DURRES (v 1502)





0 1 2 3 4 5 m

DO NOT COPY

TAB IV



1



2



3



4

1. PEQIN
2. BUTRINT
(Kalaja e Vivarit)
3, 4, 5, 6 · SHKODËR

6



5



DO NOT COPY

TAB V





1

1, 2 GJIROKASTER

3 TEPELENE

2











3

DO NOT COPY

GJERAK KARAISKAJ

DO NOT COPY

LES CANONNIERES DANS LES FORTIFICATIONS MEDIEVALES LEUR ORIGINE ET LEUR EVOLUTION

La construction des canonnières dans les fortifications médiévales se rattache à l'une des étapes de l'évolution et de l'extension d'envergure de l'artillerie à poudre.

En Albanie, les premiers canons furent importés vers la fin du XIVe sc. et le début du XVe sc. Au cours des années 1384-1404, les féodaux albanais Balsha et Nikolle Topia, furent fournis d'armes à feu par Venise et Raguse. Par un document qui fait mention de l'envoi de 50 fûts de poudre, on tire la conclusion qu'en 1401, la forteresse de Shkodra était munie de canons. Pendant les premiers décennies du XVe sc. (1417) même la principauté des Dukagjin, possédait des canons. En 1436, la forteresse de Drisht disposait d'un canon de petit calibre et avant quelques années on mentionne aussi un canonnier qui servait à Kanine, tandis que la forteresse de Kruja, en possédait 30 en 1450. D'après les données déjà mentionnées on constate que jusqu'au milieu du XVe sc. l'artillerie à poudre était largement appliquée dans les fortifications médiévales. Skanderbeg joua un rôle particulier dans ce domaine car il munit de canons toutes les forteresses qu'il surveillait. Au XVe sc. apparaissent les premières canonnières construites simultanément aux murs. On a avancé la suggestion que les canonnières simultanées aux murs apparurent vers la fin du XVe sc. et même alors, seulement sur les bases des murs et des tours parce qu'au début on ne pouvait pas manoeuvrer le canon dans les murs de la forteresse pour tirer l'ennemi qui se trouvait juste au-dessous, tandis que les plus anciennes canonnières se réalisèrent par l'aménagement des archères. Mais, d'après les données sur les forteresses médiévales albanaises et quelques exemples dans d'autres pays, on doit remettre cette date, au moins jusqu'au milieu du XVe sc.

Les canonnières, depuis le XVe sc., jusqu'au début du XIXe sc., connaissent de différentes formes et dimensions qui se rattachent au perfectionnement continuel de l'artillerie et à ses multiples calibres. A l'intérieur des types communs on distingue des variantes représentant les diverses formes utilisées par nos constructeurs et dans plusieurs cas, l'évolution dans le temps de ces canonnières. Par l'étude typologique et celui des variantes à l'intérieur des types, on peut dresser un classement chronologique qui servirait même à la datation des fragments particuliers des fortifications de la même époque que les canonnières. Se basant sur le perfectionnement de l'arme de l'artillerie, on peut classer les canonnières en trois types principaux qui représentent de différentes périodes de temps: les canonnières en embrasure rétrécie, les canonnières en piédroits et les canonnières en embrasure élargie. Ce classement ne peut pas être valable pour tous les pays européens, parce que chacun d'eux se distingue de ses particularités spécifiques tant envers la tradition de construction que de l'influence et de l'évolution différente de l'artillerie et de ses calibres.

Malgré cela, en grosses lignes il répond aux plus importantes étapes de l'évolution des canonnières dans de différents pays des Balkans et de l'Europe.

Les canonnières en embrasure rétrécie

Parmi les canonnières en embrasure rétrécie on considère les plus anciennes, celles en embrasure arrondie pour la bouche du canon et en fente verticale dans la partie supérieure pour guetter, qui sont appelées aussi des canonnières en forme de clé. (Schlusselscharte). On en conserve dans une tour de la forteresse de Petrela, où la fente verticale de guet est séparée de l'embrasure arrondie. Au cap de Rodon, les canonnières construites au cours des années 1452-63, ressemblent à celles de Petrela. Elles se conservent même à l'heure actuelle dans un mur courbé lequel forme avec le bastion le corridor de l'entrée. Dans ce bas mur se situait une batterie de six canons. Les canonnières sont formées de niches d'une largeur de 2,60 m qui se rétrécissent à l'extérieur. Elles aboutissent par des embrasures circulaires gravées sur des blocs en pierre monolithe. Dans la plupart des cas la fente verticale est séparée de l'ouverture circulaire, mais d'après les traces, quelques fois elles se joignent.

Parmi les canonnières de ce mur, celle qui occupe une position centrale nous est présentée en forme originale. La partie frontale est complètement ouverte, ayant une largeur de 85 cm, mais à l'intérieur de cette ouverture, dans les deux piedroits de la canonnière on conserve les traces de deux canaux qui servaient à glisser et fixer un grand battant en bois d'une épaisseur de 30 cm. Quand le battant était ouvert, c'est à dire, il avait glissé jusqu'à la fin du canal à gauche, l'ouverture pour la bouche du canon était de 52 cm.

Il parait que cette canonnière servait à installer un canon d'un grand calibre et puisqu'elle pouvait servir à l'ennemi pour

entrer dans la forteresse, on l'avait munie d'un battant en bois assez fort qui pouvait faire face aux coups de l'artillerie. Jointes au mur se conservent les ruines d'une ronde tour d'artillerie, dont on ne conserve aucune trace de canonnière, mais dans la voûte de sa converture écroulée on distingue les traces d'une cheminée à coupe quadrangulaire qui servait à évacuer les fumées émises par la combustion de la poudre.

Dans la forteresse de Prezë on rencontre des canonnières en embrasure circulaire de la fin du XVe sc, sans fente verticale. A l'extérieur, ces canonnières sont décorés de cercles de briques et de briques radiales en forme de rosace. Les canonnières du XVe sc. dans quelques cas représentent un simple évasement des archères. Le plus ancien exemple daté de 1466 nous est donné par la forteresse d'Elbasan. Ces canonnières aboutissaient par une large fente verticale qui servait à faire sortir la bouche du canon et à observer le tir. Au même type appartiennent les canonnières de la forteresse de Bashtove construites vers les années 70 du XVe sc ainsi qu'une tour dans la forteresse de Drisht, construite au XVe sc, mais avant l'année 1478.

Presqu'à la même époque appartient la moitié d'un pareille canonnière avec l'une des tours appartenant à la première période de construction de la forteresse de Peqin. Toutes ces canonnières mentionnées ne possèdent pas des seuils en pente à l'extérieur, pour baisser la bouche du canon afin de tirer en bas des murs, comme beaucoup de canonnières féodales médiévales de l'Europe occidentale. Les canonnières les plus évoluées de cette époque se trouvent dans une tour d'artillerie dans la forteresse de Durrës, construite, parait-il, en 1478. La tour possédait toutes les qualités d'une fortification qui pouvait affronter les coups de l'artillerie ennemie (basse, avec des murs d'une épaisseur de 3,75 m remplis de pisé) et d'autre part elle constituait un puissant centre de feu qui pouvait abriter une batterie de cinq canons. La planimétrie des canonnières est formée de deux trapèzes conjoints sur la plus petite base et le deuxième trapèze au-dessus duquel est formé l'ouverture par laquelle passe la bouche du canon, est beaucoup moins grand que le premier ayant seulement une légère coupe des côtes latérales à la sortie de la meurtrière. Donc, en général, la canonnière ressemble mieux à celle du type en saillie rétrécie.

Les canonnières de ce type, en embrasure rétrécie avec de petites modifications s'utilisèrent même au cours des XVIe-XVIIe sc.

Les canonnières en piedroits

Dans un des murs de la forteresse de Drisht, lequel avant 1478 fut adopté à l'artillerie en élargissant la largeur de 0,80 m à 2 m par la construction d'un autre mur à l'intérieur, on a percé une canonnière, d'une largeur de 0,90 m et d'une hauteur de 0,70 m. Le mur extérieur, le plus ancien, qui fut percé avec l'ouverture de la canonnière ne possède pas d'embrasure régulière. La forme de cette canonnière en piedroit peut être une solution d'occasion conditionnée par la plus ancienne période de la construction de la forteresse, mais on rencontre des canonnières en piedroit construites simultanément aux tour dans la forteresse triangulaire près du canal de Vivar à Butrin Les tours munies de ces canonnières appartiennent à la troisième période des constructions dans la forteresse vers le milie du XVIIe sc. De même, dans la forteresse d'Ishmi, se conserve les traces d'une canonnière construite simultanément aux mu pendant les années 1572-74. La cononnière eut la forme d'un fenêtre surmontée d'une voûte en pierre.

Les canonnières en embrasure élargie

Jusqu'à la fin du XVe sc et même la première moitié d XVIe sc, on ne peut pas parler de canonnière en embrasure élargie vers l'extérieur dans le territoire albanais.

S. Toy pense que l'ouverture de la canonnière, après avo connu d'autres formes que celles circulaires en général se présente en pente et assez large pour mieux manoeuvrer le can à droite et à gauche, et que dans les positions au-dessus d murs les seuils étaient en pente vers le bas afin de faire recul les opérations qui pouvaient s'y effectuer. Cette conclusion e valable pour un aperçu général des fortifications médiévale Mais dans de différents pays on rencontre des traits particuli qui se rattachent aux conditions économiques-politiques spé fiques. D'autre part, on ne peut pas suivre une chronologie types sans défauts et lacunes en s'appuyant en une région en un seul pays. Mais à part quelque cas assez rares, les c nonnières ne sont pas devenues un objet particulier d'étude de plus, on n'en avance pas des données techniques dans différentes études sur les fortifications. D'après les matéria servis par les différents pays européens, il résulte que les a ciennes canonnières en large embrasure vers l'extérieur, lesqu les substituèrent à celles en forme de clé, comme p. ex. cel construites par Jokob von Etlingen à Hessen (Allemagne) 1478, formaient en sortie un angle aigu avec le mur. De p à ces canonnières, jusqu'à la première moitié du XVIe sc, s'ut sèrent les canonnières de l'ancien type. Les canonnières d forteresses de Bosfor, construites par Mehmet II, en large emb sure vers l'extérieur, à part quelques petits changemen demeurent typiques jusqu'au début du XIXe sc. faisant ai exception.

Les canonnières en large embrasure vers l'extérieur ch nous, se présentent sous quelques variantes quant à la for planimétrique. La plus simple forme est formée d'un trapè dont la plus grande base se trouve à l'extérieur. On rencon de telles canonnières datées du XVIIe-XIXe sc, à Berat, à Butr à Krujë, à Shkodër, etc. Elles se trouvent soit dans des parap au-dessus des murs où ils ne sont pas couverts, soit d des tours, couvertes de voûte en pierre en forme de cône. S lement aux canonnières, de la forteresse de Shkodra on rem que un seuil en pente vers le bas à l'extérieur des murs d de manoeuvrer le canon dans cette direction.

L'autre type de canonnière est celui dont la planimétrie la forme d'un trapèze ayant la petite base en commun. Cha

DOKUMENT

d'eux est couvert d'une voûte en forme de tronc de cône qui s'élargit et devient plus haut vers les parois du mur. L'embrasure est presque pareille à l'intérieur et à l'extérieur mais dans la plupart des cas celle intérieure est plus petite. Dans la forteresse triangulaire près du canal de Vivar à Butrint, les canonnières de ce type, qui sont plus anciennes que celles que nous avons déjà mentionnées (la fin du XVIIe sc et le XVIIIe sc) sont munies de seuils en pente vers l'extérieur et l'intérieur et leur embrasures ne sont pas élargies vers l'extérieur, créant ainsi un angle aigu avec le mur de la forteresse.

On peut suivre une certaine évolution parmi les canonnières de ce type du XVIIIe au XIXe sc, même dans la forteresse de Peqin. Pendant la troisième période de construction dans cette forteresse, vers les années 1770, on reconstruisit les tours 1 et 2 et on ajouta les tours 4, 5, 6. Les canonnières de cette période, à double embrasure, forment un angle aigu, à la différence de celles de la première moitié du XIXe sc (la quatrième période de construction) lesquelles sont plus grandes, plus hautes et plus larges vers l'extérieur. Dans l'une des canonnières du XVIIIe sc appartenant à une tour polygonale, ouverte au deuxième étage, on distingue dans la partie inférieure, au mur, un creux en forme de cheminée qui traversait même le troisième étage et servait à évacuer les fumées émises par la combustion de la poudre après l'explosion. Dans l'autre tour, au coin diagonal à la première, on ne rencontre pas de traces de cheminée dans le mur parce qu'elle n'avait que deux étages et était couverte d'un toit qui a dû avoir une lucarne pour évacuer la fumée des deux canons qui s'y trouvaient, comme dans la forteresse du Cap de Rodon.

Quelques-unes des canonnières à embrasure élargie vers l'extérieur, comme dans la forteresse de Gjirokastra, ont une planimétrie en forme de trapèze qui joint un quadrangulaire assez large à l'intérieur de la fortification. Le premier, dont la plus grande base se trouve à l'extérieur, est couvert d'une voûte en forme de tronc de cône, tandis que le deuxième, d'une voûte cylindrique afin de mieux manoeuvrer le canon. On rencontre ce type de canonnière de tour jusque vers le milieu du XIXe sc. dans les fortifications de Verone. Les canonnières en embrasure élargie vers l'extérieur mais dirigées vers des territoires précis en dehors de la fortification telles celles de Shkodër, Butrint etc, s'élargissent à l'extérieur seulement d'un côté tandis que de l'autre côté forment avec le mur d'enceinte un angle droit ou aigu. Ces canonnières avaient l'avantage de ne pas se présenter à l'ennemi en toute leur largeur dans des directions indésirables. Les canonnières pouvaient être assez simples, ayant la forme d'une fenêtre comme p.ex. celles de la forteresse de Shkodra.

*
* *

En analysant les données avancées par l'étude typologique des canonnières dans les fortifications médiévales albanaises, on conclut qu'elles apparaissent simultanément avec les murs à une époque assez ancienne. Les canonnières en forme de clé se propagèrent beaucoup au milieu du XVe sc. tandis que dans quelques pays de l'Europe on les rencontre seulement, à la fin de ce siècle, comme p. ex. à Pienont. Les causes de ce phénomène doivent être cherchées tout d'abord dans le rôle et la position que les territoires albanais occupaient envers l'expansion ottomane; et aussi dans les influences de l'architecture militaire italienne et vénétienne de l'époque, lesquelles avaient fait les premiers pas pour la création des fortifications spéciales à l'artillerie. Au cours du XVe sc on rencontre aussi d'autres types de canonnières plus évoluées, toujours en embrasure rétrécie vers l'extérieur, comme p. ex. celles qui aboutissent par une fente verticale assez large et haute pour observer le tir et celles qui à l'extérieur ont la forme d'une fenêtre surmontée d'un arc circulaire et la canonnière, elle même couverte d'une voûte en forme de tronc de cône et enfin les canonnières qui se terminent par un trou circulaire, sans fente verticale. Les canonnières mentionnées sont typiques pour le XVe sc mais celles en forme de fenêtre continuent à être utilisées même au XVIe sc e plus tard, tandis que les canonnières en ouverture circulaire apparaissent de nouveau plus tard dans les habitations fortifiées du XVIIIe-XIXe sc.

On ne dispose que peu de matériaux sur les XVIe et XVIIe sc. A cette époque, de pair aux canonnières des plus anciens types qui continuent à exister, apparaissent les cannonières en piedroits couvertes de voûtes cylindriques (Butrint, Ishëm) lesquelles forment une plus large embrasure à l'intérieur. Pendant ces deux siècles on ne possède aucun témoignage sûr qui prouverait l'existence des canonnières en embrasure élargie vers l'extérieur. Mais se basant sur les données des autres pays, ce type de canonnière se propagea au XVIe sc. à l'exception des forteresses de Bosfor et Dardanelles, construites par Mehmet II, où les canonnières en embrasure élargie vers l'extérieur apparaissent au milieu du XVe sc. Cela n'exclue pas la possibilité de l'utilisation de ces canonnières en Albanie au cours du XVe sc. Les canonnières en embrasure élargie connurent un large emploi en Albanie au cours des XVIIIe-XIXe sc, surtout à l'époque des grands pachaliks albanais. Elles ont dû être utilisées tout d'abord aux parapets des murs et puis dans les ambiances fermées.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 1 1986

monumentet

DO NOT COPY

FAIK ALIMEHMETI

MBI DISA VEÇORI TË BANESËS FSHATARE TË ZONËS FUSHORE-KODRINORE TË TIRANËS NË VITET E PARA PAS ÇLIRIMIT

Banesa e fshatrave të zonës fushore dhe kodrinore të Tiranës, ashtu si e tërë banesa fshatare e vendit, i është nënshtruar në rrjedhë të kohës një evolucioni të vazhduar në vartësi të kushteve ekonomiko-shoqërore. Në këtë evolucion një rol me rëndësi ka luajtur familja, nevojat, kërkesat dhe mundësitë e saj. Të gjithë këta faktorë e bëjnë të natyrshëm fenomenin e bashkëjetesës së formave të thjeshta me ato të përbëra në zgjidhjet e banesave. Në këtë zonë, krahas zgjidhjeve për familjen me përbërje të vogël numerike, nuk kanë munguar edhe zgjidhje që dëshmojnë praninë e familjes së madhe me tipare patriarkale në mënyrën e saj të të jetuarit.

Në prag të Çlirimit dhe në vitet e para të pushtetit popullor, me gjithë dëmet që u shkaktuan nga lufta, u trashëgua një fond i banesës tradicionale në këtë zonë dhe, krahas modifikimit të tyre në përputhje me kërkesat e kohës, vazhdoi ndërtimi i banesave të reja. Synimi për të dhënë një tablo të banesës dhe për të nxjerrë në dukje disa veçori që e karakterizojnë atë është qëllimi i këtij artikulli, pa pretenduar për një shqyrtim tërësor e të gjithanshëm të dukurive. Si mbështetje për këto veçori shërbejnë studimet e botuara për arkitekturën popullore të kësaj zone dhe gjurmimet vetjake në terren.

Në vitet e para pas çlirimit vazhdoi të ruhet tipologjia e trashëguar nga e kaluara, duke ruajtur në kompozimin e saj mjaft nga karakteristikat që kishte pasur, këtu është vendi të kujtojmë banesën me «shtëpi zjarri», lartësia e së cilës vazhdon në dy kate. Në këtë banesë, ambienti qëndror është «shtëpia e zjarrit», një kthinë kuadratike me vatër në mes. Kjo kthinë përmbledh funksionin e «dhomës së ditës» dhe kuzhinës. Në të gatuhej, qëndrohej në kohën e lirë dhe flinin vajzat e pamartuara dhe e para e shtëpisë. Brenda saj është edhe ballkoni-korridor (mafili) dhe shkallët, duke shërbyer kështu si nyjë ndërlidhëse dhe organizuese për banesën. Roli i saj kuptohet nga pozita qëndrore që zë ndaj tërë ambienteve të tjera dhe përmasat relativisht të mëdha. Vëllimi që zë kjo kthinë, në raport me vëllimin e përgjithshëm të banesës, lëviz nga 20-50%. Po ashtu sipërfaqja e saj shkon rreth 35 m^2, ndërsa vëllimi arrin deri në 120 m^3, pavarësisht nga numri i ambienteve të tjera që e rrethojnë atë. Kjo e tregon atë si një bërthamë potenciale, elastike, e llogaritur për perspektivën, së cilës mund t'i shtohen mekanikisht një numër i madh ambientesh (deri në 12 të tilla): në katin e parë për shërbime ndihmëse, ndërsa në të dytin për fjetje. Këto veçori tregojnë se banesa me «shtëpi zjarri» ka qenë banesa më e përshtatshme për një familje të madhe, ose për një familje që synonte të rritej pa u ndarë.[1)]

Pas «shtëpisë së zjarrit», ambienti tjetër më i rëndësishëm është «oda e mikut» e pajisur me oxhak, ku pritej e flinte miku, ndërsa në jetën e përditshme

1) Një shembull të sjellë nga A. Muka (Banesa fshatare në Malësinë e Tiranës gjatë shek. XIX dhe fillimit të shek. XX). Etnografia shqiptare, IX, Tiranë, 1978, Tab. -XII f. 290) shihet siç e tregon autori, se me rritjen numerike të familjes në 60 veta u ndërtua një banesë tjetër e veçuar, pasi «shtëpia e zjarrit» ishte qarkuar tërësisht nga ambientet e tjera.

flinte i pari i shtëpisë dhe djemtë e pamartuar. Ky ambient ka sipërfaqe të përafërt me shtëpinë e zjarrit, por vëllim dy herë më të vogël, pasi zhvillohet me një kat. Dora-dorës kjo kthinë nisi të marrë mbi vete rolin e «dhomës së ditës», që përpara e luante shtëpia e zjarrit.

Kthina e çifteve, «të ramët», kanë përmasa thuaj standarte, rreth 12 m^2 që barazohet pak a shumë me përmasat e dhomave të fjetjes që bëhen sot me ndërtimin e banesave të reja në fshat.

Banesa me «shtëpi zjarri», duke qenë nga vetë programi i saj banesë e familjes së madhe, me programin e Partisë për ngushtimin e dallimeve qytet-fshat, pothuajse e kishte jetuar tanimë kohën e vet. Ana tjetër negative e saj është lënia e katit të parë për ambiente ndihmëse kryesisht për bagëtinë, në kundërshtim me normat higjieno-sanitare, përmasat joracionale dhe teprica e pavend e këtyre ambienteve. Prandaj gjatë kësaj periudhe vërehet si veçori nga një anë ndarja e kthinave të mëdha në më të vogla dhe nga ana tjetër modifikimi i kthinave në katin e parë për banim. Kjo vlen në vitet e para si pasqyrimi i shpërbërjes së sapofilluar i familjes së madhe në familje të vogla, që, ndonëse të ndara, vazhdojnë të jetojnë akoma nën një çati.

Një tip tjetër është banesa e mbyllur me dy kate. Në zgjidhjet më të thjeshta ajo paraqitet dykatëshe me komunikim të jashtëm, me nga një kthinë në çdo kat, me burgun në katin e poshtëm dhe katin e sipërm të pajisur me vatër ku zhvilloheshin të gjitha aktivitetet e jetës së përditshme dhe flihej. Si e tillë, ajo i përgjigjet bërthamës fillestare të familjes. Më tej vihet re ndarja e saj me perde dërrase provizore, në dy pjesë, në shtëpinë e zjarrit, në rolin e dhomës së ditës dhe odën e miqve të caktuar për fjetje dhe njëkohësisht edhe për qëndrimin dhe pritjen e mikut.

Më tej takon shembuj që realizohen qysh në fillim të ndërtimit me dy kthina në çdo kat. Kthinat fitojnë një sipërfaqe standarte që shkon 20-22m^2. Rritja e mëtejshme e banesës takohet në zonë me ndryshimin e numrit të ambienteve, por skema funksionale pothuajse mbeti e njëjtë. Shkallët e jashtme dhe ndërlidhja e kthinave nga jashtë me ballkon-korridor, shpesh edhe në formën e një galerie të mbyllura me dërrasa (telizi), janë veçoritë që tërheqin vëmendjen në formulimin e jashtëm të këtyre banesave dhe duke krijuar volume me mjaft plastikë. Kthinat e katit të sipërm arrijnë në tri me renditj horizontale, madje edhe në katër të tilla, duke qen me sipërfaqe të barabartë. Këto zgjidhje paraqite mjaft të arritura dhe kompakte, mjaft racionale, eko nomike me mundësi të plota komunikimi mes kth nave të katit dhe me sipërfaqe ndihmëse të redu tuara në minimum (shkallë, korridore). Kjo skemë, fo lë komunikimit të mirë të brendshëm, vazhdoi të jet funksionale për një kohë të gjatë. Galeria prej dru (telizi) më shumë ndërtohet e hapur ose pjesërish e tillë. Kjo veçori, duke ruajtur një plastikë mja tërheqëse, i ka siguruar banesës mundësinë e nj ndriçimi më të mirë, lidhjen me ambientin natyro Prania e dritareve të shumta në numër e me pë masa më të mëdha nga zgjidhjet tradicionale shpreh shumë qartë atë ç'ka theksuam më sipër.

Nuk mungojnë në këtë zonë edhe banesa tre katëshe, me nga një kthinë në çdo kat, të cilat gjith sesi kanë qenë një dukuri e rrallë, e tërhequr krye sisht nga familjet me gjendje të mirë ekonomike, q e përdornin përpara çlirimit në funksionin e «kullë së mikut». Materiale ndërtimi janë përdorur krye sisht guri me breza druri, qerpiçi, dysheme e ndë kate dërrase, çati me tjegulla vendi etj.

Përveç tipave kryesorë që përmendëm, në zo nën kodrinore e sidomos fushore të Tiranës, tako edhe banesa të tjera në vitet e para të çlirimit. Nu mungojnë, fjala-vjen, banesat përdhese. Të tilla to kon edhe njëkthinëshe, por më shumë dykthinësh Njëra nga kthinat ishte «shtëpia e bukës», ku ndo dhej vatra e zhvillohej jeta e përditshme dhe kthin tjetër ishte për fjetje. Të tilla banesa kanë pasu karakter kalimtar dhe kanë qenë me numër të vogë në çdo fshat. Ato janë ndërtuar me materiale t lehta rrethanore dhe kishin përdorim provizor, sido mos nga familjet e reja, të cilat, me ndërtimin banesës definitive, ndërtimin e mësipërm e përdo nin me funksione ndihmëse si, fjala vjen, vetëm pë gatim.

Një banesë tjetër me përhapje sidomos në fsh trat kodrinore, ka qenë «banesa e shpatit»[2]. Kjo ba nesë në zgjidhjet e saj më të thjeshta, dy ambien teve të sipërme, ka dhe një kthinë në katin e tokë «burgun» për bagëtinë dhe inventarin bujqësor. Nj zgjidhje e tillë vazhdoi të përdorej në fshatrat ko drinore, pasi ajo paraqitet mjaft racionale. Duke i përshtatur terrenit, ky tip krijoi mundësinë që m shpenzime jo të shumta të realizojë programin e kë kesave të fshatarit në fazën e parë. Më tej ajo vësh

2) Për mendimin tonë termi «banesë me gjysmëkat» i përdorur nga E. Riza dhe termi i propozuar nga A. Muka «banesë pjesërisht me kate» nuk i shpreh qartë veçoritë e kësaj banese. Mendojmë se termi «banesë shpati» e sqaron më mirë veçorinë kryesore të këtij tipi të zonës kodrinore, mbasi e lidh atë më mirë me veçoritë e terrenit, veçoritë e pjerrësisë së tij etj.

DO NOT COPY

tirëson mundësinë e zgjerimit, mundësinë e rritjes së numrit të kthinave. E parë në këtë aspekt banesat në lidhje me terrenin më shumë u vendosën paralel me pjerrësinë e shpatit.

Kushtet e reja ekonomiko-shoqërore që u krijuan pas fitores së revolucionit, veçanërisht në vitet e para pas çlirimit dhe në proçesin e kolektivizimit, sollën kërkesat e një mënyre të re jetese, e cila përherë e më shumë gjeti pasqyrim në banesën fshatare të zonës kodrinore e fushore të Tiranës. Shpërbërja e familjes së madhe solli braktisjen e tipit me shtëpi zjarri me lartësi përgjatë dy kateve. Ky tip jo vetëm nuk u ndërtua më, por edhe ato pak shembuj që u trashëguan, pësuan modifikime e transformime përherë e më të ndjeshme. Modifikimë pësoi edhe banesa e mbyllur dykatëshe, duke sjellë përmirësim të programit, por jo heqjen dorë prej tij. Kjo shprehet, së pari, me largimin e ambienteve ndihmëse nga banesa, kryesisht në largimin e bagëtive prej saj. Me këtë veprim u krijuan pa dyshim kushte krejt të ndryshme higjieno-sanitare dhe mundësi të tjera të zhvillimit volumor. Kështu, në banesat dykatëshe të ndërtuara nga vetë fshatarët, vërehen ndryshime në përmasat e kthinave, në kompozimin e tyre dhe në lidhjen me ambjentet higjieno-sanitare. Zgjidhjen më të thjeshtë e përbën banesa dykatëshe me nga dy kthina në çdo kat. Ambjentet sanitare dalin në shpinën e kthinave, duke organizuar shkarkimin me gropa septike. Në zgjidhjet e tjera të banesës dykatëshe, e cila gjithsesi paraqitet më e preferuara, ruhen nga banesa e traditës elementet e ndërlidhjes së kthinave të vendosura nga jashtë tyre në formën e një ballkoni të hapur. Kthinat me sipërfaqe rreth 20 m^2 organizohen për një shfrytëzim më racional dhe ruajnë një formulim të njëjtë me brendësinë e tyre. Dritaret me përmasa të mëdha dhe xhamllëk, suvatimet e mureve dhe ndërtimi i tavaneve rritin ndjeshëm ndjenjën e komoditetit dhe kushtet higjieno-sanitare. Këto banesa i kemi takuar në mënyrë të ndjeshme në Prezë, Fushë-Prezë, Ahmetaj, Vaqar, Kashar, Pazë, Pezë-Helmës, Priskë, Lanabregas etj.

Në mjaft zgjidhje vërehet prania e një veranda të hapur që lidhet me korridorin si nyje ndërlidhëse, që evitonte qarkullimet e tepërta e të panevojshme, dhe një zgjidhje funksionale më të organizuar. Largimi i ambienteve ndihmëse, sidomos i bagëtive, nga volumi i banesës, favorizoi edhe ndërtimin e banesave njëkatëshe, që në këto vite bie në sy më shumë, por me nivel të ngritur ndjeshëm nga toka, rreth 0.50 m. Në këto ndërtime fillon të ndihet mjaft ndikimi i qytetit dhe nga ana tjetër futja e ndërtimeve me projekt në fshat. Mjeshtri popullor, i cili luajti për një kohë të gjatë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e arkitekturës popullore mbi bazën e një përvoje të pasur, tani përherë e më shumë po u linte vendin ndërtimeve me projekt. Megjithatë, duhet thënë se për periudhën në shqyrtim 1945-1960 roli i mjeshtrit popullor është përsëri mjaft i ndjeshëm. Ai, duke kuptuar kërkesat e reja, përballoi jo pa sukses proçeset e modifikimit të tipave të vjetër dhe hapat e parë të kalimit në ndërtimet me projekt.

Më të përparuara në rajonin e Tiranës për këtë periudhë kemi paraqitur banesat në fig. 7, 8, 9, të cilat kanë program më racional e më të studiuar. Në këto ndërtesa veranda fiton thellësi, duke u kthyer në një element funksional, ku qëndron familja gjatë verës, të lidhur organikisht me hyrjen nga oborri, me orientimin dhe panoramën.

Në mënyrë të përmbledhur, mund të themi se deri në vitet 1960, në zonën që shqyrtojmë futja e projekteve-tip në ndërtimin e banesave ka qenë në hapat e parë të tij, duke mos luajtur ndonjë rol me peshë të dukshme.

Me përgatitjen e kuadrove dhe sidomos me krijimin e organizmave projektues, në detyrat e të cilëve u fut në mënyrë të planifikuar edhe fshati, vërehet një punë përherë e më e organizuar, me projekte të veçanta — tipa të miratuara nga instituti i projektimit të Ministrisë së Ndërtimit (ISP, ISPUA, ISPNr. 1) dhe më vonë të ZU Projektimit (fig. 10). Kjo fazë e ndërtimeve në fshat përbën një objekt tjetër të veçantë studimi.

Në zhvillimin urbanistik të kësaj periudhe të bie në sy një sistemim i mirë, si rrjedhojë e një pune të përbashkët për plotësimin e lagjeve të fshatrave me rrugë, kryesisht të shtruara me gurë lumi të mëdhenj, vende-vende të plotësuara me shkallë të gurta, një ngjeshje më e mirë e shtëpive sipas lagjeve, pak shtëpi të reja u ndërtuan në tokat-arë, kjo edhe për faktin që zona fushore kodrinore e Tiranës u fut shumë shpejt në rrugën e prodhimit intensiv. Kështu p.sh. në vitin 1952 u ngrit kooperativa e parë në Fushë-Prezë, në vitin 1967 përfundoi kolektivizimi në të gjithë rrethin, në vitin 1971 ngrihet kooperativa e tipit të lartë në Vaqar etj. Po kështu ndërsa në sipërfaqen e tokës-arë në vitin 1944 rreth 84 % e saj zihej nga individët. Ky raport në vitet 1945-1960 ruhet me rreth 24 % nga individët, 21 % nga sektori shtetëror (që kryesisht shtrihet në zonën fushore) dhe rreth 55 % nga sektori kooperativist.

Zhvillimi i ndërtimit të banesës pas çlirimit, krahas rritjes nga ana numerike të tyre nga disa të dhëna, rezulton që për periudhën 1951-1960 u ndërtuan në rrethin e Tiranës rreth 2200 shtëpi të reja, rreth 5200 shtesa dhomash, por ajo më kryesore në

PHOTOCOPY

tipologjinë e tyre, vihet re dalja e tipit apartament, një përmirësim cilësor mjaft i ndjeshëm i tipit të banesës fshatare që për periudhën 1945-1960 arrrin në rreth 6600 apartamente, ose rreth 400 apartamente çdo vit, duke u bazuar përafërsisht kështu me ato që ndërtoi vetë individi.

Me trajtesën që sollëm, mund të themi se pa u shkëputur tërësisht konceptet tradicionale, banesa fshatare e zonës kodrinore-fushore të Tiranës evoluoi për të mirë, duke ruajtur thelbin racional të traditës dhe duke integruar dora-dorës në plotësimin e kër kesave që buronin nga nevoja për transformime n fshatin tonë të ri, me synim ngushtimi përherë më shumë të dallimeve ndërmjet qytetit dhe fshati edhe në këtë fushë. Në këtë periudhë, që mund t quajmë kalimtare në arkitekturën e banesës fshatar e mbajti kryesisht mbi supet e veta dhe e përballo jo pa sukses mjeshtri popullor, i cili kishte tanim mbështetjen e fuqishme të mbarë shoqërisë sonë dh të shtetit socialist.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 1 Banesa të trashëguara në zonën fushore kodrinore të Tiranës deri në prag të çlirimit të vendit (Farkë e madhe, Farkë e vogël, Lundër, Kashar, Vaqar etj.)



Fig. 2 Banesa të trashëguara në zonën fushore kodrinore të Tiranës deri në prag të çlirimit të vendit (Farkë e madhe, Farkë e vogël, Lundër, Kashar, Vaqar etj.)

DO NOT COPY



Fig. 3 Banesa të trashëguara në zonën fushore kodrinore të Tiranës deri në prag të çlirimit të vendit (Farkë e madhe, Farkë e vogël, Lundër, Kashar, Vaqar etj.).



Fig. 4 Banesa të trashëguara në zonën fushore kodrinore të Tiranës deri në prag të çlirimit të vendit (Farkë e madhe, Farkë e vogël, Lundër, Kashar, Vaqar etj.)

DO NOT COPY



Fig. 5 Banesa të trashëguara në zonën fushore kodrinore të Tiranës deri në prag të çlirimit të vendit (Linxë, Priskë etj.).



Fig. 6 Banesa të trashëguara në zonën fushore kodrinore të Tiranës deri në prag të çlirimit të vendit (Linxë, Priskë etj.)

DO NOT COPY

PLANIMETRIA SHK.1:100



PAMJE KRYESORE



PLANIMETRIA SHK.1:100



PLANIMETRIA SHK. 1:100



FIG 7 BANESA TE FSHATRAVE TE ZONES FUSHORE KODRINORE TE TIRANES TE NDERTUARA NE VITET E PARA PAS CLIRIMIT TE VENDIT (PREZE, FUSHPREZE, AHMETAQ. KASHAR, VAQAR MARQINET, GJOKAJ ETJ.)

DO NOT COPY

PLANIMETRIA KATIT PERDHE



PAMJE KRYESORE





KARAKTERISTIKAT E NDERTIMIT

1	[illegible]	ME GURE	LLAQ	GELQERE
2	[illegible]RATURA	ME TULLA	KATI	PARE
		ME GURE	KATI	PERDHE
3	[illegible]ATIA	LENDE DRURI	PLEP	TU MARRELQERE
4	[illegible]HEME	KATI PERDHE	ME SHTRESE BETONI	
		KATI PARE	TRARE	LAP LLUSTER CIMENTO
5	DYERT	DRRASE	PLEPI	
6	DRITARET	DRRASE PISHE	PA STAXHICIAR	
7	INSTALIMET	SANITARE	PA UJE	ME UJE GROP SEPT
8	[illegible]NERIA	NGA VETE	PRONARI	

PLANIMETRIA KATIT PARE



PLANIMETRIA KATIT PERDHE



FIG 8 BANESA TE FSHATARAVE TE ZONES FUSHORE-KODRINORE TE TIRANES TE NDERTUARA NE VITET E PARA PAS ÇLIRIMIT TE VENDIT. (PREZE, FUSHPREZE, AHMETAQ, KASHAR, VAQAR, MAROINET, GJOKAJ ETJ.)

DO NOT COPY

PLANIMETRIA SHK. 1:100



PAMJE KRYESORE SHK. 1:100



KARAKTERISTIKAT E NDERTIMIT



PLANIMETRIA SHK. 1:100



PAMJE KRYESORE SHK. 1:100



FIG 9 BANESA TE FSHATRAVE TE ZONES FUSHORE KODRINORE TE TIRANES TE NDERTUARA NE VITET E PARA PAS CLIRIMIT TE VENDIT.
(PREZE, FUSHPREZE, AHMETAQ, KASHAR, LAQAR, MARDINET, GJOKAJ)

DO NOT COPY



Fig. 10 Banesa tip për fshatin (për zonat fushore kodrinore) projekt nga I.S.P. Nr. 1-1984

FAIK ALIMEHMETI

DO NOT COPY

SUR QUELQUES TRAITS DE L'HABITATION RURALE DES ALENTOURS DE TIRANA DANS LES PREMIERES ANNEES APRES LA LIBERATION NATIONALE

A la veille de la libération nationale et au cours des premières années du pouvoir populaire, malgré les dégâts de la guerre, on hérita d'un fond d'habitation traditionnelle dans cette région, et de pair à leur modification, selon les exigences de l'époque, se poursuivit la construction des nouvelles habitations.

Les nouvelles conditions économiques et sociales créées avec le triomphe de la révolution, surtout pendant les premières années après la libération et aussi pendant la collectivisation, exigèrent une nouvelle mode de vie qui au fur et à mesure se reflèta dans l'habitation rurale de la zone située aussi bien dans la campagne que aux alentours de Tirana. La décomposition de la grande famille apporta l'abandon du type d'habitation avec maison de feu qui occupait une hauteur de deux étages. Non seulement qu'on ne fit plus construire un tel type, mais on modifia aussi les peu d'exemples hérités du passé. Même l'habitation fermée à un étage subit des modifications, en améliorant ainsi le programme, sans pourtant l'abandonner. Cela se reflète tout d'abord par l'éloignement des ambiances auxiliaires, surtout avec l'éloignement des animaux. Par conséquent, dans les habitations à un étage construites par les campagnards, on remarque des modifications quant aux dimensions des pièces, à leur composition, à leur communication avec les ambiances sanitaires. L'habitation à un étage, composée de deux pièces au rez-de-chaussée et deux pièces au premier étage, représente la plus simple solution. L'habitation à un étage, al plus préférée, emprunte de l'habitation ancienne les éléments de communication entre les pièces, lesquels sont disposés en dehors, en forme d'un balcon ouvert. Les pièces d'une superficie de plus de 20 m^2 sont bien organisées et conservent la même formulation à l'intérieur. Les larges fenêtres vitrées, l'enduit des murs la construction des plafonds contribuent à l'amélioration des conditions de vie.

Dans de nombreux cas on remarque une sorte de veranda ouverte qui est liée au corridor en tant que noyau de communication en évitant les passages inutiles. L'éloignement des ambiances auxiliaires, a favorisé la construction des habitations à simple rez-de-chaussée, qui sont un peu plus élevées, presque 0,50 m au-dessus du terrain. Dans ces constructions, commencent à apparaître l'influence de la ville d'un part et la construction de l'habitation rurale se basant sur un projet, d'autre part. Le maître populaire, qui pendant longtemps joua un rôle assez important à l'évolution de l'architecture populaire sur la base d'une riche expérience, au fur et à mesure laissai la place aux constructions basées sur un projet. Malgré cela, i faut remarquer que pendant les années 1945-1960, le rôle du maître populaire demeure assez sensible. Lui, conforme aux nouvelles exigences, fit face avec succès au processus de modification des anciens types et aux premiers pas pour le passage aux constructions avec projet.

En résumé, on peut dire que jusqu'en 1960, dans la zone en question, l'application des projets type dans la construction des habitations, faisait ses premiers pas, c'est à dire, ne jouai pas un rôle important.

Avec l'évolution de l'urbanisme de cette époque, on remarque un meilleur aménagement, résultat d'un long travai pour compléter les quartiers des villages avec des rues, pavées de pierres, fluvieux, par endroit complétées par des marches de pierres, une meilleure concentration des habitations selon le quartiers.

D'après quelques données il résulte que après la libération de pair au progrès numérique, pendant les années 1951 1960, dans la région de Tirana, furent construites 2200 habitations nouvelles et 5200 habitations subirent des adjonctions mais ce qui est essentiel c'est l'apparition du nouveau type d'appartement, une évolution assez remarquable du type de l'habitation rurale qui au cours des années 1945-1960 attein le chifre de 6600 habitations, ou environ 400 appartements pa an.

On peut dire que sans s'écarter complétement des concep tions traditionnelles, l'habitation rurale de la zone située à l campagne et aux collines aux alentours de Tirana, évolua en conservant l'essentiel de la tradition et en s'intégrant de plu en plus à la réalisation des exigences dûes aux nouvelles tran sformations de notre village, ayant toujours en vue de diminue la différence entre la ville et le village. Cette période qu'o peut appeler transitoire dans l'architecture de l'habitation ru rale, fut affrontée non sans succès par le maitre populaire qu jouissait déjà de l'appui de toute notre société et de l'état so cialiste.

Nr. 1 1986

monumentet

DO NOT COPY

BEP JUBANI

PLOTËSIME PËR MONUMENTE ARKEOLOGJIKE NË SHQIPËRINË E VERIUT

Shqipëria e Veriut, ashtu si edhe trevat e tjera të vendit tonë, ruajnë në gjirin e tyre një pasuri të madhe arkeologjike me monumente që i takojnë periudhave të ndryshme të historisë së popullit tonë.

Që në vitet e para të Çlirimit, në këtë zonë kanë filluar të drejtojnë vëmendjen e tyre punonjës të Muzeut Arkeologjik të Tiranës, me ekspedita përnjohëse në brigejt e lumit Drin. Megjithatë, në mënyrë më të hollësishme, kjo zonë, veçanërisht malësitë e Shqipërisë Verilindore, ka filluar të gjurmohet në dy dekadat e fundit, duke u mbledhur jo vetëm lënda e nevojshme arkeologjike, por edhe një dokumentacion fotografik, i cili, për disa të dhëna, sot është i pazëvendësueshëm.

Me gjithë këtë punë të kryer deri tani, dhe botimet e herëpashershme, Shqipëria e Veriut ka akoma vend për gjurmime të tjera, sidomos në rrethet Mirditë, Lezhë, Mat e Pukë, ku ka boshllëqe më të ndjeshme në këtë drejtim.

Duke vlerësuar interesin e dobinë e këtyre të dhënave, si punë fillestare e domosdoshme për kërkime të mëtejshme shkencore, po japim këtu edhe disa të dhëna të tjera që kemi mbledhur gjatë ekspeditave përnjohëse në Shqipërinë e Veriut (fig. 1).

RRETHI I SHKODRËS

1) **Pazari i vjetër i Shkodrës** Gjatë punimeve sistemuese për ngritjen e parkut të gjelbëruar, në hyrje të qytetit të Shkodrës, në Pazarin e Vjetër, janë nxjerrë gurë të gdhendur, me sa duket, pjesë harqesh të portave, që kanë të bëjnë me ndërtime mesjetare në këtë zonë (fig. 2,3).

2) **Bushat** Në kodrat e këtij fshati herë pas here kanë dalë në dritë objekte arkeologjike, të cilat lidhen kryesisht me shekujt e parë të erës sonë. Prej tyre janë ruajtur një tokëz bronzi, një shpuese prej kocke me kokën të zbukuruar me vija zigzage të gdhendura, një monedhë bronxi e shek. IV të e. sonë dhe një rreth i dyfishtë prej argjendi (Tab. VII, fig. 23 – 25).

Në blloqet e hardhive që janë ngritur në kodrat e këtij fshati, në drejtim të rrugës për në Shkodër. gjatë punimeve sistemuese, janë zbuluar edhe varre të mbuluara me tjegulla, pa inventar, të kohës së pushtimit romak.

3) **Drisht** Të gjithë autorët që janë marrë me historinë dhe arkeologjinë e fshatit Drisht, kanë drejtuar vëmendjen gjithnjë vetëm në rrënojat e kalasë që ndodhet në lagjen e sipërme të këtij fshati.

Vetëm Shuflai, në vitin 1924, përmend shkarazi në punimet e tij një «civitas vetus», «kundrejt kodrës së qytetit të Drishtit, sipër përroit të Drishtit»[1].

Me ekspeditat e fundit përnjohëse që kemi bërë në zonën e Drishtit, vërejmë se ky «civitas vetus» i përmendur në burimet mesjetare, lidhet me një kala, e cila në popull mban emrin Muzhilë; ky qytet vërtet i ka muret fortifikuese të rrënuara, por ato mund të ndiqen qartë në të gjithë perimetrin e vet.

Kjo kala e dytë e Drishtit ndodhet në lagjen Tyrbetare të këtij fshati. Muret rrethuese, të punuara me gurë të lidhur me llaç gëlqereje, ndjekin izoipsin e lartë të majës së kodrës. Brenda vendbanimit ruhen në formë gropash të mbushura me gurë gjurmët e banesave mesjetare. Në njërin skaj të kësaj qendre

1) M. Šufflay, **Städte und Burgen Albaniens,** Wien, 1924, f. 26.

DO NOT COPY



Fig. 1

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

është në këmbë edhe sot një ndërtesë e punuar me gurë të latuar shumë mirë, me forma katërkëndësh, mbeturina e një ndërtese kulti.

Duke gjurmuar në shtresat kulturore të zhveshura të vendbanimit, kemi grumbulluar material qeramik të shek. XIV (Tab. VII, fig. 1-16), së bashku edhe me qeramikë të glazuruar të kësaj kohe. Përveç këtij materiali, në kodrën e Muzhilës, kemi gjetur edhe fragmente amforash, gjetje të zakonshme të vendbanimeve ilire të kësaj zone, që i përkasin shk. II-I p.e. sonë; kjo tregon se Kalaja e Muzhilës, në Drisht, ka qenë e banuar qysh në periudhën ilire.

Burimet e shkruara mesjetare, i përmendin të dyja këto kala, si atë të lagjes Tyrbetare, ashtu edhe atë të lagjes së sipërme që gjithnjë përshkruhet në botimet për Drishtin dhe sipas tyre në periudhën mesjetare të dy vendbanimet kanë mbajtur emrin DRIVASTUM, Drishtë.

Shkrimtari humanist shkodran Marin Barleti, duke përshkruar luftimet e osmanllinjve për të pushtuar Drishtin, flet për dy rënje kalash, për dy pushtime që u bënë në këtë fshat[2]. Ky fakt burimor, i papërfillur nga historianët e mesjetës[3], duke u lidhur edhe me gjendjen reale arkeologjike të këtij fshati dëshmojnë qartazi se në mesjetë të dy vendbanimet mbanin të njëjtin toponim.

Mbështetje tjetër, mjaft e besueshme, që vërteton njëkohësisht edhe përshkrimin e Marin Barletit për dy Drishtat, është harta e Koronelit, në të cilën gjejmë të shkruar dy herë toponimin DRIVASTUM[4], pikërisht në zonën ku ndodhen të dy këto fortifikime.

Duke sqaruar kështu këtë fakt, mendojmë se është me dobi të kihet parasysh edhe tradicioni gojor i popullit, i cili kalanë që ndodhet në lagjen Tyrbetare e quan edhe me emrin «Varosh».

4) **Qyteza e Baltojës** Në qoftë se zona në veri të qytetit të Shkodrës është e njohur për një përqëndrim më të madh vendbanimesh ilire, në skajin tjetër, jugor, ato janë më të pakta; një ndër to është ai i

2) M. Barleti, **Rrethimi i Shkodrës,** Tiranë, 1962, f. 96.

3) G. Shpuza, **Lufta për mbrojtjen e Shkodrës në vitet 1474 dhe 1478-1479**, Konf. II e St. Albanologjike, vëll. I, Tiranë, 1969, f. 220. Duke mos u mbështetur sa duhet te Barleti, thuhet se drishtianët i qëndruan rrethimit turk 16 ditë, në një kohë kur rezistenca e shqiptarëve në këto dy kështjella ka zgjatur mbi 25 ditë.

4) Coronelli, **Citta, Fortezze, ed altri Luoghi principali Dell'Albania, Epiro, e Livadia E particolarmente i posseduti da Veneti,** Venezia 1588. Shiko hartën: Corso delli Fiumi Drino e Boiana.

DO NOT COPY

Beltojës. Kjo qendër është bërë e njohur në shtyp që herët, megjithatë njoftimet e të dhënat për të janë tepër të kufizuara.

Muret e kësaj qyteze ilire, të përcaktuara me të drejtë si të tipit Gajtan, ruhen në majën e qytezës. Gjendja e ruajtjes së tyre nuk është e mirë; muret rrethuese nuk ndjekin të gjithë linjën qarkuese të vendbanimit. Që kur është vizituar për herë të parë kjo qendër, kemi vërejtur se nga e gjithë traseja e murit ka qenë ruajtur më mirë vetëm këndi i mureve, në pjesën perëndimore të vendbanimit, ku dikur ka qenë porta e qytezës, në të cilën siç shihet nga pamja e saj (fig. 4), gurët e qosheve të murit kanë qenë të punuara diçka më mirë, se sa pjesët e tjera të tij. Në muret ilire të Beltojës vërehen aty-këtu edhe gurë të vënë pa kurrfarë punimi (fig. 5).

Kultura materiale që zbulohet në vendbanim tregon se qyteza e Beltojës ka pasur një jetë të gjatë e të hershme. Nga maja e qytezës kemi mbledhur një sëpatë guri të thyer, që duhet t'i takojë fundit të kohës së bronzit (fig. 6), kurse rrëzë faqes lindore të kodrës së qytezës, buzë përroit, janë zbuluar dy sëpata shqiptaro-dalmate (fig. 7,8). Këto të dhëna dëshmojnë se ky vendbanim e filloi jetën e tij që në fundin e bronzit, duke vazhduar deri në periudhën qytetare ilire.

Në sheshin e qytezës ndeshen edhe sot copa enësh të periudhës qytetare ilire dhe të shekujve të parë të pushtimit romak. Materiale të këtilla, më të shumta, takohen edhe në tokat që shtrihen rrëzë faqes perëndimore të kodrës së qytezës së Beltojës, përballë ndërtesës së vjetër të shkollës së fshatit.

Lindja e këtij vendbanimi në këtë kodër të shkëputur dhe të pashoqëruar përreth me vendbanime të tjera ilire të fortifikuara, është e lidhur jo vetëm me mjedisin e mirë bujqësor në të cilin ndodhet qyteza, por edhe me vetë pozicionin e përshtatshëm që ka ajo përbri rrugës lumore të rrjedhjes së Bunës që të shpinte përmes grykës së lumit për në detin Adriatik. Bile, do të thoshim, se lindja e këtij vendbanimi është e lidhur kryesisht me këtë faktor ekonomiko-tregtar.

5) **Mavriq** Në luginën e lumit të Shalës, në fshatin Mavriq, ndodhet një vendbanim i quajtur në popull «Qyteza e Dakajve». Në majën e saj ruhen gjurmë të një kulle, ndërtim mesjetar, që ka pasur me sa duket më shumë karakter vrojtimi (Tab. I, fig. 1).

Në sheshin e kalasë, përreth kullës, duken planimetri banesash, të ngritura me mure gurësh të papunuar, me lidhje të thatë (Tab. I, fig. 3).

Ky vendbanim ka pasur, me sa duket, disa faz
jete e ndërtimi. Në anët e majës së kodrës ruhe
mure rrethuese të ngritura me gurë të papunuar
lidhje llaçi (Tab. I, fig. 2,5), ashtu si edhe pak mu
të ngritura me gurë të mëdhenj rrasorë, të latuar, p
lidhje llaçi (Tab. I, fig. 5).

Përballë me qytezën e Dakajve, në shpatin pe
rëndimor të malit, ndodhen rrënojat e një kishe
shkatërruar që në kohën e pushtimeve osmane. N
këto mbetje arkitekturore na tërhoqën vëmendjen gu
rët e qemerit të derës së ndërtesës, sepse në to, pë
krah motiveve fetare, janë vënë edhe motive pagan
si figura e kalit, e diellit (Tab. I, fig. 4), që lidhe
me botëkuptime shumë të hershme, parakristiane,
popullatës vendase.

6) **Toplanë** Në këtë fshat ruhen rrënojat e
ndërtesave mesjetare kulti. Njëra prej tyre quhen K
sha e Shëngjergjit. Si ndërtesë deri diku është rua
tur mirë (me përmasa 12,70x5 m); planimetria e k
mbanares (Tab. VI, fig. 1) ndiqet në formë mjaft
qartë, me përmasa 4,50x3,40 m. Muret e kësaj g
dine kanë trashësi 0,75 m. Faqja e brendshme
mureve është e suvatuar; ngjyra e suvasë ka nuan
të kuqërremtë. Porta e ndërtesës, me qemerë në fo
më harku është e ruajtur në lartësi 1,20 m.

Ndërtesa tjetër mban emrin kisha e Shënkol
(fig. 9,10; Tab. VI, fig. 3). Përmasat e saj të matu
në mjedisin e brendshëm janë: 3,60 m gjatësi e gj
rësi 1,93 m (në krahun lindor) dhe 2 m (në krahu
perëndimor). Porta është e gjerë 0,73 m. Çatia ësh
e mbuluar me rrasa guri, në të njëjtën mënyrë
edhe kisha e Brisë, në Nikaj Mertur. Katër faqet
brendshme të saj, kanë qenë të zbukuruara me afre
ke në ngjyrë uthulle, jeshile të mbyllët, kafe dhe
bardhë. Afresket nuk janë ruajtur në gjendje të m
rë[5]. Gjurmë afresku ruheshin edhe në faqen e jash
me të absidës (Tab. V, fig. 5). Të gjithë sytë e fig
rave të pikturuara ishin të gropëzuara, në kohë
vendasit nuk e mbajnë mënd, me që ka qenë si tr
ditë e lashtë që suvanë e afreskeve të kishave
përdornin gjoja për qëllime shërimi.

Absida, ka formë katërkëndëshe, me gjërë
1 m, me çatinë e vet të punuar po me të njëjtët gu
ashtu si e gjithë ndërtesa.

RRETHI I TROPOJËS

7) **Bajram Curri** Në të gjithë shtrirjen e gje
ku ndodhet sot pjesa kryesore e qytetit të Bajra
Currit, në shekujt e parë të erës sonë ka qenë r

5) Përshkrim më të hollsishëm të afreskeve jep Franc Nopça në WMBH, XII, f. 20. Aty flitet edhe për gjetje tullash romake në këtë fshat.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

vendbanim i hapët, i madh, i cili shkon në drejtim të fshatit Margegaj, deri në fund të stadiumit të qytetit të sotëm. Kanalizimet dhe punimet ndërtuese të stadiumit dhe në qytet kanë nxjerrë në dritë fragmente enësh (Tab. VII, fig. 17-19) dhe qeramikë ndërtimi tipike për vendbanimet e kësaj kohe në Shqipërinë Verilindore.

Në fshatin që ndodhet mbi qytetin e Bajram Currit, në Nimjan, punimet për hapjen e një grope gëlqereje, zbuluan një shtresë kulturore të pasur, të shek. III-IV të e. sonë. Në materialet e zbuluara bëjnë pjesë kryesisht copa enësh të punuara me çark dore, të zbukuruara në të gjitha faqet e brendshme e të jashtme me motivin e fshesës. Kjo lloj qeramike, e njohur këtu edhe nga qyteza e Bujanit, deri tani nuk është zbuluar në zonën e shtrirjes së vendbanimit antik të Bajram Currit. Në tokat e Nimjanit është zbuluar edhe krahu i një skulpture të vogël prej bronzi; në dorë mban një objekt në trajtë të një «volumen».

8) **Bujan** Në bregun e djathtë të Valbonës, në afërsi të shtëpisë së heroit popullor Mic Sokoli, ruhet një grup i vogël tumash të ngritura prej dheu (Tab. II, fig. 4). Tumat janë të vogla, më e madhja ka diametrin rreth 10 m. Në një provë të vogël gërmimi që bëmë deri në thellësi 0,50 m, në njërën nga këto tuma, u zbuluan barqe enësh ilire të hekurit të hershëm dhe një vegjë me thumbin karakteristik të kapjes me barkun e enës. Qeramika ka faqe të kuqërremta, me brumë të zi në gri, me përmbajtje të shumta të huaja. Faqet e copave të enëve janë pa shkëlqim.

Këtu ku ndodhen këto tuma tani shtrihet varreza e sotme e një lagjeje të fshatit Bujan.

Shumë vjet më parë, në afërsi me shkollën fillore të fshatit, po në këtë zonë, kemi parë një tumë tjetër (Tab. II, fig. 5), në të cilën ka qenë zbuluar një shpatë hekuri e shek. XI p.e. sonë, së bashku me një enë balte dhe një thikë hekuri.

Kështu, me sa duket, në lashtësi, në të gjithë këtë pellg, në të dy anët e rrugës së sotme të makinës që shkon nga qyteti i Bajram Currit për në hidrocentralin «Drita e Partisë» të Fierzës, ka qenë shtrirë nekropoli tumular i parë i qytezës ilire që ndodhet në fshatin Bujan (Rosujë).

Gjatë vrojtimeve në pellgun që përfshin fshati Bujan, ramë në gjurmët e një varreze tjetër tumulare që shtrihej në krahun e majtë të Valbonës. Ky grup tumular është i vendosur në rrafshinën gjatësore të kodrës, buzë së cilës kalon një rrugë tradicionale këmbësore që lidh pellgun e qytetit të Tropojës me pellgun e Drinit.

Tumat janë të ngritura prej gurësh kodrinorë të

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7



Fig. 8

natyrës shtufore, të përzier me gurë lumorë të shumtë dhe mbushje dheu. Mjaft gurë duken edhe në sipërfaqe të këtyre tumave (Tab. II, fig. 3).

Të dy këto varreza tumulare, pa dyshim që janë të lidhura me popullatën e lashtë të qytezës ilire të Bujanit (Rosujë). Kjo qytezë, e vendosur rrëzë masiveve të zhveshura shkëmbore të alpeve, ka qenë në lashtësi qendra kryesore e pellgut të Valbonës. Kërkimet arkeologjike, të bëra këtu gjatë viteve 1964-1965, kanë treguar se jeta në të ka filluar që nga fundi i bronzit e deri në shek. III-IV të e. sonë.

Është e natyrshme që zbulimi i këtyre dy varrezave tumulare, përbëri brigjeve të lumit të Valbonës, paraqet interes për historinë e këtij vendbanimi, sepse gërmimi i tyre do të na njohë jo vetëm me kulturën materiale të tumave, por edhe me konceptet rituale që kishin banorët e qendrës ilire të Bujanit.

Zhvillimi qytetar ilir që përfshiu edhe këtë krahinë solli fortifikimin me mure gurësh të latuar katërkëndësh e trapezoidalë. Vetë fakti që në të gjithë trevën fqinje të Kosovës nuk janë zbuluar deri tani mure të këtilla, dëshmojnë për vlerësimin ekonomik e politik që i bëri shteti ilir i Shkodrës kësaj qendre, dhe për rolin e rëndësishëm që kishte kjo qendër për pellgun e Valbonës.

Gërmimet arkeologjike kanë treguar se në shek. III-IV të e. sonë qyteza e Bujanit (Rosujë) u bë qendra më e rëndësishme ekonomike e ushtarake e krahinës. Në pellgun e Valbonës ka edhe fortifikime të tjera të kësaj kohe, siç është p.sh. qyteza e Shoshanit, megjithatë shtresa e hollë kulturore e Shoshanit, në ndryshim nga Bujani, tregon se ky i fundit ka ruajtur parësinë ndaj qendrave ekonomike e ushtarake të tjera të krahinës së Valbonës.



Fig. 9



Fig. 10

Jo shumë larg qytezës së Bujanit, në pyllin e dendur të gështenjave në vendin e quajtur «Kodra e Kryqit», ndodhet një varrezë e braktisur me kohë. Këtu u bë një gërmim arkeologjik për t'u njohur me natyrën e këtyre varreve. Nga punimet rezultoi se varret ishin me kufizim të rrallë prej gurësh rrasorë, me mbulesë të paktë gurësh të njëjtë. Skeleti u gjet në thellësi rreth 0,60 m, i vendosur në pozicion të shtrirë, me dorën e djathtë të kthyer në mes (fig. 11). Si inventar varri u gjetën: në gojën e kafkës dy aspra turke, kurse në dy anët e kafkës u gjetën dy brirë dhie.

Vetë toponimi i këtij vendi, ashtu edhe fakti që fshati nuk mban mend të ketë varrosur në këtë kodër, ashtu si edhe asprat turke, dëshmojnë se varreza i takon periudhës mesjetare, para myslimanizimit të krahinës.

Me interes është gjetja e parave në gojën e të vdekurit, sepse, siç dihet ky është një zakon i futur te ne në periudhën qytetare ilire, në shek. III-II p.e. sonë. Edhe brirët e dhisë të futur në varr pa dyshim që janë të lidhur me koncepte të lashta të krahinës.

9) **Selimaj** Siç është kumtuar më parë[6], në këtë fshat ruhet një kala mesjetare e vogël (Tab. III, fig. 1-4), në të cilën, po të mbështetemi në të dhënat e burimeve mesjetare të shek. XVII[7], duhet të kërkojmë vendin ku ka qenë ngritur kulla e Pjetër Spanit, sundimtar i krahinës së Pultit.

Në lindje të kësaj kulle është një fushë që quhet «gjytetzat». Afër saj, u zbuluan copa enësh të shekujve të parë të e. sonë si amfora, vorba të lyera me zmalt jeshil, ashtu si edhe copa enësh mesjetare.

Poshtë kalasë së Selimajve, në disa rrafshe të Geghysenit, ruhen edhe rrënojat e disa kishave mesjetare, që i gjejmë të përmenden edhe në relacionet e shek. XVII[8]. Njëra nga ato, e ruajtur shumë mirë, është një kapelë e vogël me përmasa 3,90 x x 3,20 m (Tab. III fig. 5, Tab. VI, fig. 2), Muret i ka të ngritura me gurë gëlqerorë rrasorë, me një mveshje gurësh të punuar drejt katërkëndëshit. Gurët e mureve shkojnë në disa raste në gjatësi deri në 57 cm. Çatia, e ngritur në formë të harkuar, është punuar me rrasa guri, të lidhura me llaç gëlqereje. Absida e kësaj kapele, e rrumbullakët është e thellë 55 cm. Në murin jugor ndërtesa ka dy frëngji më të gjëra në brendësi (0,50 e 0,15 m).

Në lindje të kësaj kapeleje shihen themelet e një ndërtese me përmasa 10 x 6,20 m. Po kështu, përbri saj, nga veriu, ruhet e ngritur në lartësi rreth 4 m, qoshja e një ndërtese, së cilës nuk i ndiqen mirë drejtimet e truallit të saj (Tab. III, fig. 5).

6) B. Jubani, **Gjetje të rastit në rrethin e Tropojës, Buletin arkeologjik,** Tiranë 1971, f. 234. A. Baçe, L. Papajani, **Kështjella dhe monumente të tjera në rrethet Pukë, Tropojë, Kukës,** «Monumentet», 1983, 1, f. 130.

7) I. Zamputi, **Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII,** vëll. II, Tiranë 1965, f. 151.

8) Po aty.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11

Nga këto mbetje arkitekturale, për ruajtjen më të mirë të saj, ka më shumë interes kapela e vogël (Tab. VI, fig. 2). Monumente të këtilla nuk kemi vrojtuar në asnjë fshat tjetër të rrethit të Tropojës. Po të mbështetemi në relacionet e viteve 1600, del që krahina e Pultit ka pasur dy kapela vetëm në krahinën e Tropojës dhe pikërisht në fshatin Gash.

Kapela që po botojmë këtu, me sa duket, është një nga ato që përmendin këto burime mesjetare. Në këtë mënyrë, ky monument mund të shërbejë edhe si pikënisje për të kërkuar shtrirjen e fshatit dhe të fisit të Gashit, gjatë mesjetës dhe qendrën e tij të viteve 1600 pikërisht në fshatin e sotëm Selimaj-Geghysen; në kohë të mëvonshme këto dy toponime, siç duket, mbuluan toponimin më të hershëm Gash.

Siç kuptohet nga materialet e cituara, këtu, Gashi në fillim të shek. XVII, ka qenë fshati më i madh i Pultit, me 97 shtëpi e 866 frymë, bile më i madh edhe sesa vetë Gjakova fqinje e kësaj kohe, e cila, sipas burimeve, në atë kohë kishte 550 frymë, së bashku me të gjitha fshatrat përreth saj[9]. Prandaj është e kuptueshme që me një grumbullim të këtillë banorësh qe e nevojshme të ngriheshin këto dy ndërtesa kulti.

9) I. Zamputi, **Relacionet...**, vëll. II, f. 97.

Një përqëndrim i këtillë i madh popullate r këtë zonë me sa duket, duhet të ketë qenë i njëj edhe më herët, që në periudhën e principatave fe dale arbëreshe, përderisa pikërisht këtu, në fshati Selimaj, u ngrit në shek. XV e vetmja kala e kohë së Skënderbeut që ruan rrethi i Tropojës. (Tab. II fig. 1-4).

10) **Cernicë** Ky fshat, i njohur në mesjetë me d toponime: Zomaj e Carnicë, shtrihet në një ven me toka shumë të mira bujqësore. Para Çlirimit k qenë pyll i dendur, kurse sot këtu janë tokat më t mira bujqësore të krahinës. Është një vend që k formën e një gjuhe gadishullore, e cila shkon që ng kryqëzimi i Valbonës me Bushtricën e zgjatet në dre tim verijug, deri në rrugën që të fut në qytetin Bajram Currit.

Ky terren i mirë bujqësor është njëkohësisht edh vend strategjik, sepse ndodhet në mesin e pellgut t Valbonës, prandaj ka qenë vlerësuar që në lashtës nga banorët e kësaj krahine.

Kështjella mesjetare e Cernicës (Tab. II, fig. 1,2 e ndërtuar nga pushtuesit turq për të mbajtur t nënshtruar krahinën nuk është monumenti i vetër që ruan ky fshat. Në skajin e tij verior, gjatë puni meve bujqësore, është zbuluar një varr i madh ko lektiv, me një vendosje shumë origjinale të trupav të vdekur: në qendër ka qenë vendosur një kotruv e vogël (fig. 12), e lyer me glazurë të zbardhemtë e zbukuruar me vija zigzage të zeza (gryka është mbuluar me glazurë të zezë). Përreth kësaj ene janë zbuluar shumë skelete të vendosura në formë të kë tillë që koka e të gjitha skeleteve ndodhej në afërs



Fig. 12

DO NOT COPY

të enës së përshkruar më sipër, pra në formë radiale, me qendër enën.

Ky varr kolektiv, siç del nga krahasimet që gjen ena e zbuluar, i takon shek. XIV[10].

Shuflai, duke folur për rrënojat e Kalasë së Cernicës, në mbështetje të toponimit «Gjytet» që mban vendi, i lidh ato me periudhën romake, duke kërkuar në të qytetin mesjetar Sapa[11].

Toponimi «Gjytet», që në Shqipërinë e Veriut përdoret zakonisht për vendbanime paramesjetare, i ka mbetur vendit përreth Kalasë së Cernicës, sepse pikërisht aty ku ndodhet kalaja, përbri saj, në shekujt e parë të erës sonë, ka qenë një vendbanim i haptë i shekujve të parë të e. sonë. Për këtë dëshmojnë jo vetëm copat e enëve të gjetura këtu, por edhe një shatë me qafë të gjatë, që vjen nga zbulimet në tokat e Cernicës (fig. 13).



Fig. 13

11) **Koçanej.** Duke dalë nga ky fshat për në drejtim të qytezës së Shoshanit, gjëndet një vendbanim i hapët i shekujve të parë të e. sonë, në vendin e quajtur Kodra e Vuthajve. Kjo qendër ka qenë shikuar nga ne shumë vjet më parë, por materiali shumë i coptuar, i mbledhur në sipërfaqe, nuk jepte mundësi për një përkufizim të saktë të kohës kur ka qenë banuar kjo qendër. Vrojtimet e fundit të bëra këtu në anët e disa kanalizimeve bujqësore, të bëra në këtë qendër, treguan se vendbanimi është njështresor dhe lidhet me shek. III-IV të e. sonë.

Materiali arkeologjik i zbuluar këtu përbëhet prej qeramike vendëse, të punuar me një teknikë të ngjashme me qeramikën ilire të hekurit të hershëm. Faqet qeramika i ka të kuqërremta, brumi i saj është i zi. Kjo qeramikë ndryshon nga ajo e hekurit të hershëm kryesisht në mënyrën e përgatitjes së brumit të saj, sepse është më i pastër dhe më i ngjeshur. Këtë lloj qeramike e kemi gjetur këtu në shtresën kulturore të vendbanimit, të shoqëruar gjithnjë me profile tjegullash, solene e kaliptere, karakteristike për këto anë në shekujt e parë të e. sonë. Një tjegull e këtillë e plotë është gjetur në vendin e quajtur Çuki i Gjakovës, në Mollëkuqe të Bujanit (fig. 14).

Tradita gojore e krahinës thotë se në këtë qendër, tani e pabanuar, dikur jetonin fshatarë, të cilët u merrnin «traminën» (gjobën) të gjithë malësorëve që shkonin me karvane për të kaluar verën në bjeshkët e Valbonës.

Interesimi i këtij vendbanimi të hapët qëndron në shfaqjen e qeramikës me tradita të hershme ilire, në shek. III-IV të e. sonë; banorët e kësaj qendre,



Fig. 19

duke kapërxyer traditat e prodhimtarisë skllavopronare romake, rikthehen përsëri në traditat më të hershme ilire. Me sa duket këto banorë janë blegtorë ilirë, të cilët nuk trashëguan në traditat praktike të tyre mënyrën e punimit të qeramikës me çark.

10) D. Razmoska, **Venecijansko srednovekovno** d[illegible]**o od Ohrid,** Macedonia acta archaeologica, 6, Skopje 1983, fig. 1.

11) M. Sufflay, **Städte...** f. 26.

Kjo shfaqje që vërejmë në Koçanej nuk është shfaqje e veçuar për Shqipërinë e Veriut; atë e kemi ndeshur edhe në qytezën e Bujanit, në vendbanimin e fshatit Mulaj të Tropojës, në tumat e Kukësit[12] dhe në Perlat Qendër të Mirditës. Në këtë shfaqje, sidoqoftë, shprehet një ringjallje e traditave të hershme ilire në shek. III-IV të e. sonë, ringjallje e cila, siç kemi shënuar shumë kohë më parë, nuk shfaqet vetëm në qeramikë, por edhe në anë të tjera të jetës materiale vendase. Në qeramikë kjo shprehet jo vetëm në teknikën e punimit të saj, por edhe në format dhe motivet zbukuruese, ndër të cilat mbizotëron motivi shiritor me gropëza.

12) **Margegaj.** Ka disa vjet që në tokat e këtij fshati, rrëzë malit, kanë dalë në dritë disa mbishkrime romake, një pjesë shtatoreje dhe një kryq guri. Duke u njohur përsëri me këtë zonë, del që nga ky vend ka edhe pjesë të tjera arkitekturore që kanë



Fig. 16/a



Fig. 16/b



Fig. 15

dalë nga nëntoka. Ndër to ka blloqe gurësh të mëdhenj, të latuar, pa mbishkrime, me përmasa 2.10 x x 0,70 m, gurë të zbukuruar me gdhendje të motive floreale (fig. 15), dhe një bllok guri që ka në faqen e tij disa motive gjarpërore (fig. 16 a-b); ky i fundit, me stilin e vizatimit të tij, të kujton shumë motivet popullore të punuara në tekstil të banorëve të sotëm të Tropojës dhe Hasit.

12) B. Jubani, **Tumat ilire të Kënetës,** Iliria, Tiranë, 1983, 2, f. 103-104.

DO NOT COPY

Gjetjet e deri tanishme tregojnë se në tokat e Margegajve, në shekujt e parë të erës sonë, ka qenë një varrezë e gjërë e cila duhet lidhur me vendbanimin e hapët të qytetit të Bajram Currit, i cili nuk ndodhet larg këtij fshati. Megjithatë gjetja e gurit me motive floreale, e kryqit të gurtë dhe vetë fakti që gurët e varreve janë zbuluar nga fshatarët me pjesën e mbishkrimit të vënë poshtë, të puthitur me njëri tjetrin, tregon se në këtë vend duhet të presim në të ardhmen që të zbulohet edhe një godinë kulti me arkitekturë të pasur, ndoshta e ndonjë bazilike.

Lidhur me këtë qendër arkeologjike, shënojmë se tradicionalisht, në kujtesën e popullit, ruhet mendimi se në tokat e margegajve ka gurë të punuar dhe varre, prandaj vendasit nuk nxirrnin këtu gurë për ndërtime, sepse në popull thuhej se kjo gjë nuk sillte mbarësi.

13) **Mulaj.** Në një ekspeditë përnjohëse, që kemi bërë në verën e vitit 1984 në fshatrat e krahinës alpine të Nikaj Merturit[13], vumë re se në fshatin Mulaj, buzë rrugës këmbësore që të çon për në qafë të Rajës, për të zbritur në luginë të Valbonës, shtrihet një brezare shumë e bukur alpine, e rrethuar me mure të gjëra 0,80 – 1,10 m (Tab. IV, fig. 1). Muri është ngritur me gurë të pa latuar, vetëm të thyer e pa lidhje me llaç gëlqereje. Ky vend në popullsinë e krahinës ruan emrin «Rrahi i Shehrit» dhe «Gjytetzat».

Meqenëse toka ishte e papunuar, lëndinë, me vështirësi mundëm të gjenim pak copa enësh prej balte të pjekur, të cilat, për nga mënyra e punimit, të kujtojnë shumë qeramikën e shekujve të parë të erës sonë, të zbuluar në Kodrën e Vuthajve, në fshatin Koçanej.

Malësorët mbajnë mend se këtu, para shumë vjetësh, janë zbuluar rastësisht vegla pune prej hekuri, ndër të cilat kujtojmë edhe një sqepar.

14) **Dushaj.** Rrethi i Tropojës ruan shumë varreza të braktisura, të fshatrave që përmenden në shek. XVII. Në njërën prej tyre, në Dushaj të Nikaj Merturit, bëmë një provë gërmimi, duke hapur një varr.

Varri qe ndërtuar me një konturë të rregullt, në formë elipsoidale, me gurë rrasorë e të formave të tjera, me një mbulesë jo të plotë gurësh. Gropa e varrit ishte e thellë rreth 0,70 m.

Gërmimi zbuloi skeletin në pozicion të shtrirë. Përreth e poshtë kokës qenë vënë pllaka të mëdha guri, direkt në nivelin e skeletit të zbuluar. Në dheun e mbushjes së varrit u gjetën tri copa ene (Tab. VII, fig. 32-33), të cilat nuk përputheshin me anët e tyre, kështu që nuk mund të plotësohej me to krejt forma e enës. Me këtë kuptohet se ena është thyer që në vendbanim dhe prej andej janë marrë vetëm pak fragmente për t'u hedhur në varr. Kjo gjetje është me shumë interesë, sepse lidhet me tradita të hershme ilire, kur siç dihet që nga koha e bronzit të hershëm ka qenë zakon të hidheshin nëpër tuma e varre copat e enëve të thyera që më parë në vendbanim dhe prej andej janë marrë vetëm pak fragmente për t'u hedhur në varr. Kështu nga gërmimi i këtij varri del se në këto malësi të thella ka qenë ruajtur ky zakon i lashtë ritual ilir deri në shek. XVII.

Po në këtë varrezë ruhej edhe një varr me një element mjaft kureshtar. Te koka e varrit qe vënë një gur i madh, siç vihen zakonisht nëpër varre. Faqja e përparme e këtij guri është e zbukuruar vetëm me një trëkëndësh të madh, të gëdhendur, motiv aq i njohur tek ilirët e që padyshim këtu, në këtë varr të shek. XVII është vënë me qëllim botëkuptimor.

Varreza për të cilën bëjmë fjalë këtu ndodhet përreth një kishe të rrënuar në kohë që as populli nuk e mban mend. Ruhet deri diku mirë planimetria e saj, në përmasa afërsisht 16 x 7, me absidë të rrumbullakuar.

15) **Curraj i poshtër.** Në shpatin lindor të malit të Rrukut përsëri thellë në alpe, në një lartësi të madhe mbi fshatin Curraj i poshtër, në vendin ku sot ruhet toponimi Stani i Marash Manit, ndodhet një vendbanim i shek. III-IV të e. sonë. Këtë vend populli e njeh edhe me toponimet Gjyteti i madh e Gjyteti i vogël.

Në këtë vend vrojtuam mure tarracimi banesash që kanë mbetur deri në tre katër rradhë gurësh, në lartësi deri në rreth 0,83 m. Gurët e mureve, në të shumtën e herës, i janë nënshtruar një farë punimi (Tab. IV, fig. 2). Gurët janë mesatarë, nganjëherë shkojnë deri në përmasa 0,80 x 0,70 x 0,25 m.

Në tarracat e banesave u gjetën copa tullash, barqe enësh me zmalt jeshil të mbylltë, copa enësh të zbukuruara me motivin e fshesës dhe copa enësh prej qelqi me zbukurim pullash ovale në reliev, të shek. III-IV të e. sonë. Nga trojet e këtij vendbanimi u zbuluan edhe dy gurë të mëdhej moknash të po-

13) Falenderojmë përzemërsisht punonjësit e muzeut të qytetit të Bajram Currit shokët Sherif Basha e Dodë Progni që më shoqëruan dhe më ndihmuan gjatë kësaj ekspedite.

POWERED BY



Fig. 17



Fig. 18

kësaj periudhe, me diametër rreth 45 cm (Tab. IV, fig. 3).

Po në këtë fshat ruhet planimetria e kishës së Luzajës, e rrënuar në kohë të hershme të pushtimit turk. Në varrezën e saj (të shek. XVII) u hapën dy varre. Në njërin nga to u gjet sekleti i vendosur mbi dy gurë, të vënë njëri te koka e tjetri te këmbët. Në këtë varr u gjet edhe një bark ene i punuar me çark këmbe, me brumin në ngjyrë rozë të çeltë.

6) **Brisë.** Në varrezën e këtij fshati ndodhet një kishë, për të cilën fshati nuk ruan në kujtesën e tij kohën e ndërtimit të saj. Vëmendja e jonë është ndalur në këtë monument, sepse ndërtime të këtilla nuk janë karakteristike jo vetëm për Shqipërinë Verilindore, por as edhe për krahinat e tjera të Shqipërisë.

Kjo godinë ka të bëjë me ndërtime mesjetare. Për nga mënyra e ndërtimit të çatisë së vet, kisha e Brisë të kujton atë të Shënkollit në Toplanë, e cila padyshim që është një ndërtim paraturk.

Godina vjen në formë katërkëndëshe, pa absidë (fig. 17 – 18). Është ndërtuar me gurë rrasorë; porta dhe qoshet e ndërtesës janë ngritur me gurë rrasorë dishka më të punuar. Porta ka pasur qemerin e vet në trajtë të harkuar (Tab. IV, fig. 4). Qemeri i portës, apo kreku, siç e quajnë vendasit, ruan në faqen e jashtëme vijëzime harkore dhe një kryq. Në ballin e ndërtesës, në të djathtë (fig. 17) ka pasur të punuar një pjesë të thelluar në murë. Në anën e djathtë të ndërtesës, muri ka pasur dy dritare (fig. 18). Në këtë vend, në faqen e brendshme, ka të punuar një pjesë të futur por më të gjërë, ashtu si në krahun e majtë të hyrjes së ndërtesës.

Kjo kishë, që shërbente në këtë fshat si kapelë varreze, ka një pamje arkitekturale të veçantë, me sa duket sepse ndërtuesit e saj janë shkëputur nga kanonet kishtare, duke shfrytëzuar elemente të arkitekturës popullore të banesës për ngritjen e kësaj godine kulti.

Duke shkuar poshtë fshatit, në drejtim të Palçit, mbi një shkëmb të veçuar, përtej Drinit, ndodhet vendi i quajtur Guri i Gjytetzave (fig. 19). Në të nuk



Fig. 19

DO NOT COPY

ka kurrfarë gjurmësh ndërtimi apo gjetje arkeologjike. Malësorët e kujtojnë këtë vend si pikë ku mbrohej popullata e paarmatosur në raste kur sulmonte ushtria e pushtuesve osmanë.

Toponimi i kësaj kodre le të kuptohet se përreth saj duhet kërkuar një vendbanim i hapët paramesjetar.

RRETHI I KUKËSIT

17) **Ferma e Kukësit.** Në brezaret përbri lumit të Drinit të Bardhë, toka shumë të mira buke, herë pas here janë bërë zbulime arkeologjike. Deri në kohën kur ato do të përmbyteshin me krijimin e liqenit të hidrocentralit të Fierzës, me vrojtimet e vazhdueshme të bëra në to, janë zbuluar gjurmë të shumta banimi të periudhës së shekujve të parë të erës sonë dhe materiale më të vona, gjë që tregon për vlerësimin që i kanë bërë kësaj zone banorët e lashtë të krahinës së Kukësit.

Në zonën ku ka qenë shtrirë vendbanimi i mirëfilltë i kësaj dhe, qendra kryesore ka qenë në vendin ku ferma ka pasur shtretërit e nxehtë për fidanët e saj, në një hapësirë rreth 4 dynymësh. Në këtë brezare të frytëshme janë ndeshur përveç tjegullave solene e kaliptere të shumta, edhe copa pitosash, peshore prizmatike të mëdha prej balte të pjekur dhe copa enësh të vogla tryeze.

Përveç këtyre, në sektorin e pemëtores kanë qenë zbuluar dy furra për pjekjen e tullave. Aty është zbuluar edhe një monedhë e Konstantinit II dhe një shat i madh prej hekuri që sot ruhet në muzeun e qytetit të Kukësit të Ri.

Në vendin e quajtur Te Çerpiqet ndesheshin shpesh tulla me trashësi deri në 6 cm. Përveç tyre, në këtë vend, para shumë vjetësh është zbuluar një varr skllavi, i mbuluar me pllakë guri. Skeleti ishte i ruajtur mirë; këmbët e tij qenë të lidhura me pranga hekuri.

18) **Bicaj** Në grykën e përroit të Tërshenës, në krahun juglindor të Shkallës së Keqe, ngrihet një pjesë shkëmbore që populli e quan Gradishtë. Në fakt, vendi që mban këtë emër, maja e shkëmbit, nuk është i përshtatshëm për banim, meqenëse sipërfaqja në pjesën më të lartë të saj ka një gjërësi vetëm pak metrash, kurse në të dy anët e saj, lindore e perëndimore, maja e Gradishtës zbret me pjerrësi të thiktë në thellësinë e luginës. Me sa dukët, kjo pikë ruan kujtimin e vendbanimit të hershëm që ndodhet në pjesën e poshtme të malit, që ndoshta fillimisht populli e ka quajtur qytezë, të ndryshuar më vonë në gradishtë, por që të dy këto toponime me kohë kanë humbur, për t'u ruajtur në kujtesë vetëm për majën më të lartë të vendit.

Për banim provizor këtu është përdorur shpella e quajtur Shpella e Gjradishtit, strehë e gjërë rreth 20 m, e thellë rreth 6 m. Në të janë gjetur vetëm barqe enësh prehistorike, ndoshta që lidhen me periudhën eneolitike; në tarracat, në të majtë të lumit të Tershenës janë zbuluar varre të sheshta të shek. IV-III p.e.sonë, në afërsi të të cilave duhet kërkuar edhe vendbanimi i kësaj kohe. Në varre u gjetën si inventar heshta e hanxharë prej hekuri ashtu si edhe copa enësh të mangëta si skifosa të vegjël dhe tasa të punuar me çark këmbe.

Në krahun e djathtë të lumit të Tershenës, mu në grykë të tij, është një majë shkëmbore e lartë, e quajtur në popull me toponimin Kulla, ku thuhet se ruhen gjurmë ndërtimesh të vjetra. Më tej kësaj gryke ngrihet mali i Gjalicës. Në një ekspeditë përnjohëse që kemi bërë sëbashku me studentët e Fakultetit të Historisë të Universitetit «Enver Hoxha» të Tiranës, deri në lartësinë më të madhe të malit (2487 m) vumë re se pak pa shkuar në majë, në një rrafshë shumë të bukur, në vendin e quajtur Kroi i Tanzot, ruhet edhe sot planimetria e një kapele të vogël, në përmasat pakashumë të kapelës së Geghysenit të Tropojës. Përreth kishës duken qartë varre elipsoidale me konture të punuar me gurë lumi. Gërmimet që filluam, në brendësi të ndërtesës nuk i përfunduam dot nga që majën e malit e mbuluan re të dendura shumë, të cilat pengonin punimet. Kjo kishë, e ngritur me sa duket për bjeshkanët që veronin në stanet e Gjalicës, lidhet si kohë me ndërtimet e shekujve XVII-XVIII.

19) **Përbreg.** Në vendin ku lumi i Lumës dredhon, duke u derdhur në Liqenin e Hidrocentralit të Fierzës (aty ku ai dikur bashkohej me Drinin e Bardhë), përballë me vendin historik të njohur me emrin Kulla e Lumës, ndodhet Kodra e Pecës, ku ruhen mbeturinat e një vendbanimi të fortifikuar të shek. III-IV të e. sonë; vendbanimi ka murin rrethues, të ruajtur pjesërisht, me trashësi 1,20 – 2 m; më mirë ruhet ana jugore e vendbanimit. Në faqen e kodrës dhe brenda fortifikimit ka troje banesash, të punuara me gurë e llaç gëlqereje.

Në shtresën kulturore të vendbanimit u gjetën barqe enësh, të zbukuruara me motivin e fshesës, tulla të trasha 3,5 – 4 cm, tjegulla solene 3 cm të trasha dhe copa pitosi. Në buzën e një pitosi të këtillë është vënë një mbishkrim (fig. 20), i bërë në një fushë 11,5 x 12,5 cm. Mbishkrimi mund të lexohet OUEIKEIS (UIKIS) ose QUEIKEIS (KUIKIS), duke u shprehur me këtë emër, pronari i pitosit: i UJKËS, i KUJKËS.

DO NOT COPY

Mbishkrimi, me trajtën gramatikore të tij, nuk i përgjigjet as greqishtes, as latinishtes, prandaj në të jemi të prirur të shohim një emër të pronarit vendas, të dhënë në formën gramatikore ilire të të folmes së kësaj periudhe, pra një fjalë të shkruar ilire.

Në të dy format e mundshme që janë për t'u lexuar, ky mbishkrim lidhet edhe me vetë emrin e sotëm të qytetit të Kukësit; siç shihet ai tingëllon shumë afër me emrin e Kukësit, i cili në rrënjën e tij ka antroponimin ŪJK, UK.

Krijimi i hershëm antik i vonë i këtij toponimi gjen mbështetje edhe në traditën gojore të popullatës së krahinës, që na është ruajtur në burimet mesjetare të shek. XVII. Në këto burime bëhet fjalë për familjen e Kukejve, që banonte në vendin ku bashkoheshin dy Drinat. Nga kjo familje, sipas burimit mesjetar, mori emrin edhe vetë fshati, dhe më vonë edhe qyteti Kukës. Burimi mesjetar thotë se «kjo familje ka prejardhje italike»[14]. Në këtë pasazh burimor, që lidhet me kujtesën e hershme të popullatës së krahinës, ndoshta duhet të shohim më shumë jo prejardhjen vërtet të kësaj familjeje nga Italia, sesa prejardhjen e vjetër të fisit, të lidhur me kohën e pushtimit romak.

Së bashku me këtë mbishkrim, në të njëjtin vend, është zbuluar edhe relievi i një kalorësi, i bërë në barkun e të njëjtit pitos, që mbante edhe mbishkrimin. Kalorësi është punuar në një fushë me përmasa 12 x 10 cm (fig. 21).

Tematika që trajtohet në këtë reliev është shumë e njohur dhe e përhapur, sidomos në gurët e varreve të shekujve të parë të erës sonë që zbulohen në trevën e Kosovës dhe fqinjësitë e saj dardane, është prandaj një motiv dardan i përbashkët që lidh këto dy krahina.

Siç shihet, figura e kalorësit dhe ajo e kalit janë punuar me një dorë e stil të lirë, megjithëse për disa anë ndihet mjaft mirë që ka qenë një dorë e stërvitur dhe e sigurt. Sidoqoftë ndjehet se ky reliev është frut i një interpretimi popullor e jo e një artisti profesionist.

Në tërësi, kompozimi është dhënë me një fantazi mitologjike, siç shihet nga mënyra e dhënjes së fytyrës dhe e organeve të njeriut e të kalit, megjithatë figurat, sidomos pjesë të veçanta të tyre, janë dhënë me një ndjeshmëri e kuptim shumë të saktë jo vetëm të proporcioneve fizike, por edhe të plasticitetit të trupit. Këtë interpretim mitologjik e përforcon në mënyrë bindëse sidomos trajtimi i gjymtyrëve



Fig. 20

të dy figurave dhe organit të kalit me një lakmueshmëri të këtillë që të kujton gjarpërin.

Edhe pse ky reliev i takon shek. III-IV të e. sonë, në të ka elemente të cilat lidhen mirë me relievin prej argjendi të shek. III-II p.e.sonë, të zbuluar në Selcë të poshtme të Pogradecit nga arkeologu Neritan Ceka, reliev që paraqet një duel luftëtarësh, në të cilin merr pjesë aktive edhe gjarpëri.

Krahasimet dhe ngjashmëritë që vërehen në mes këtyre dy paftave të periudhave të ndryshme, shprehin lidhjen e artit qytetar ilir me atë antik të vonë, lidhje e cila mund të kuptohet në mënyrë të natyrshme vetëm me ruajtjen deri vonë tek ilirët e kësaj krahine të konceptimit të njëjtë mitologjik të



Fig. 21

14) I. Zamputi, **Relacione...**, vëll. I, f. 445.

DO NOT COPY

kësaj tematike; vetëm në këtë mënyrë mund të spjegohet paraqitja e njëjtë mitologjike e figurave, me atribute botëkuptimore të theksuara patriarkale.

Paralelizmat që gjejnë këto dy relieve ndihmojnë për të sqaruar më drejt përmbajtjen e skenës luftarake të paftës së Selcës së poshtme të Pogradecit, e cila siç duket nuk shpreh një skenë reale, por thjesht një legjendë mitologjike, ndoshta një epos popullor, vazhdimin e të cilit ne do ta kërkonim në ciklin e këngëve të kreshnikëve të Shqipërisë së veriut, Kosovës e Malit të zi.

Me një interpretim të mëtejshëm të kësaj ndërlidhjeje artistike e botëkuptimore kuptohet më drejtë edhe përhapja e gjërë e figurës së kalorësit, në stelat antike të vona, që zbulohen në Dardani dhe veçanërisht në Kosovë; ky kompozim, ndonëse në literaturë mban përkufizimin «kalorësi thrak», me zbulimin e këtyre ndërlidhjeve artistike tregon se ka lidhje direkt me tabanin kulturor ilir të periudhës qytetare.

Në fshatin Përbreg ka edhe qendra të tjera arkeologjike. Në vendin e quajtur «Ara e poshtër e Nexhit» gjendet një vendbanim i shekujve të parë të erës sonë; në të janë zbuluar barqe pitosash, enë të vogla në ngjyrë gri dhe të kuqe, copa tjegullash solene rreth 2,5 cm të trasha etj.

Në vendin e quajtur Kaniç (afër kishës së Adem Kamberit) nga hapja e kanaleve ujitëse kanë dalë varre me gurë lumi të mesjetës së zhvilluar. U gjetën këtu edhe copa enësh me motivin e gropëzave, karakteristike për shek. XIV-XV. Këtij vendi i takon edhe zbulimi i një këmbane mesjetare të vogël prej bronzi, me formë pakashumë trapezoidale, mbi të cilën ruhet mbishkrimi latin E R M A E, i punuar në faqen e këmbanës me gropëza. Mbishkrimi ERMAE mund të përkethehej «kodrinsja», «këmbana e kodrinës».

Në mes këtyre dy qendrave, ka dalë vazhdimisht qeramikë ndërtimi e shekujve të parë të erës sonë. Prej vendit të quajtur Vakëf të këtij fshati, malësorët mbajnë mend ka pasë rrugë të vjetër me kalldrëm që të çonte te Kulla e Lumës e deri në Grykë të Vanave. Sipër saj ka qenë rruga e Shkodrës që lidhej me Prizrenin. Afër qytezës së Përbregut gjithnjë ka pasur vend kalimi nëpër Drin të Bardhë, dikur me urë druri më vonë me urë guri që u shkatërrua nga shovinistët serbë, e rindërtuar më vonë disa herë deri në kohën tonë.

20) **Gryka e Vanave** Rreth 40 minuta larg urës së uzinës së bakrit, në të djathtë të bregut të lumit të Lumës, në shpatin e malit të Zbinecit, ndodhet një kullë e vogël e shek. III-IV të e. sonë.

Kulla është mjaft e dëmtuar nga prurjet e rrënimet e shpatit të malit. Muret e kullës janë të punuara me gurë lumi mesatarë e të mëdhenj, të lidhur me llaç të bollshëm gëlqeror. Gjerësia e kullës është 18 m; vetë muret kanë trashësi rreth 2 m.

Shtresa kulturore, me gjithë dëmtimet e pësuara, është ruajtur deri diku mirë. Nga rrëshqitjet e dheut kanë dalë profile të shumta tjegullash, copa enësh qelqi, një stilos hekuri (Tab. VII, fig. 22), vorba të lyera me vernikun jashtë të kohës (Tab. VII, fig. 21), barqe enësh të zbukuruara me motivin e fshesës gozhda hekuri etj. Tullat që ndeshen këtu janë të një trashësie 3-4 cm.

Në rrënimet e kullës kemi ndeshur edhe copa suvaje të dyshemesë së një cisterne uji, të punuar me llaç gëlqereje në ngjyrë rozë, të përzier me copa të shtypura tullash.

21) **Brut.** Në brezaret buzë Drinit, poshtë Gurrës së Zezë ruheshin mbeturinat e një ndërtese të quajtur Kulla e Mgjushit. Dukej planimetria e saj katërkëndëshe, paksa e ngritur mbi themele; afër kullës kishte qeramikë të vogël të kohës së pushtimit osman. Vendasit mbajnë mend se në këtë kullë, shumë shumë kohë më parë, ka banuar një «beg i fortë» (që nuk i mbahet mend fisi) i cili ruante zonën nga Kolshi deri në Bushat. Këto tarraca tani janë të përmbytura nga ujët e Liqenit.

22) **Truell**. Në bjeshkët e Surrojt, duke u kthyer nga «Maja e Nuses» në të majtë, arrihet në një zonë me pemë lajthish që vendasit e quajnë Hurdhat e Truellës. Në këtë zonë, në mes drurëve të lajthive, vërehen edhe sot grumbullime gurësh në hapësira të kufizuara, të cilat lidhen, me sa duket, me rrënoja banesash. Fshatarët mbajnë mend se gjatë punimeve të rastit, në këtë bjeshkë, janë zbuluar vatra zjarri e zgjyra hekuri. Vendasit thonë «trullaki ishte kanë gjytet». Me gjithë vrojtimet e vëmendshme nuk mundëm të kapnim ndonjë gjurmë nga kultura materiale që mund të na ndihmonte për një përcaktim të kohës që i takon ky vendbanim bjeshkor.

23) **Ujmisht** Rrethinat e këtij fshati ruajnë në gjirin e vet disa qendra arkeologjike. Deri tani janë vënë re vetëm trashëgimi nga periudhat e shekujve parë të erë sonë si vendbanime të fortifikuara të hapëta dhe varreza mesjetare.

Në Malçeve, në thellësi 1,50 m, në shtëpinë e Bruhejve, u gjetën dy pitosa të shekujve të parë të erës sonë. Copa të këtilla pitosash gjenden edhe në varrezën e fshatit Malçeve. Në lagjen Rrase të këtij fshati, në tokat e punuara gjenden copa tullash me trashësi rreth 4 cm. Në këto pika pa dyshim që shtrihen vendbanime të hapta të shekujve të parë të erës sonë.

DOKTORI

Në anën e djathtë të Drinit, ndodhet një shkëmb i lartë që në popull ruan emrin Kala Çepës. Vendasit me fjalën çep shprehin kuptim lartësimi.

Kjo kodër është e rrethuar me mure të lidhura me llaç gëlqereje, në trashësi 1,50 m. Në skajin verior të qytezës duket edhe forma e një kulle. Llaçi gëlqeror është i bollshëm. vende-vende arrin trashësinë 3-4 cm.

Brenda fortifikimit u gjetën barqe enësh të vogla, ndër to ka edhe copa të zbukuruara me motivin e fshesës të shek. III-IV të e.sonë, kohë së cilës i përket edhe ky fortifikim.

Në Domaj të Ujmishtit[14] ndodhet edhe Kalaja e Lakmeçitit, në perëndim të shkollës së fshatit.

Kjo qytezë është e fortifikuar në të gjitha anët me mure të lidhura me llaç gëlqereje në trashësi të njëjtë me fortifikimin e përshkruar më sipër. Ka një sipërfaqe të vogël, rreth 800 m^2. Në shpatin e malit të kësaj qyteze ndodhet një shpellë që meriton të gjurmohet.

Në sipërfaqe të këtij fortifikimi u mblodhën copa enësh të pakta; meritojnë të përmenden në to disa barqe enësh të lyera me glazurë jeshile, që për Shqipërinë e veriut janë karakteristike për shek. III-IV të e. sonë, kohë me të cilën lidhet edhe fortifikimi i Lakmeçitit.

Në lagjen «Domaj» dhe «Shinavlash» punimet bujqësore kanë zbuluar varre të ndërtuara me rrasa gurësh të vëna anash dhe në mbulesë me drejtim lindje-perëndim. Në varret e Shinavlashit fshatarët mbajnë mend se është zbuluar vetëm një unazë bronzi.



Fig. 22

Këto dy varreza, me sa duket, i takojnë periudhës së hershme arbërore.

24) **Borje.** Në tokat që vendasit i emërtojnë me toponimin Selishtë janë zbuluar 5 sëpata shqiptare-dalmate.

25) **Shishtavec** Një sëpatë e këtillë shqiptare-dalmate është zbuluar rastësisht edhe në tokat e këtij fshati, gjatë punimeve bujqësore (fig. 22).

Zbulimi i këtyre sëpatave prej bronzi në këto dy fshatra ruan interesin e vet shkencor. Deri tani në fshatrat Borje dhe Shishtavec nuk kemi të zbuluar ndonjë vendbanim apo varrezë që t'i përkasë periudhës së hekurit të hershëm, kur edhe i përkasin sëpatat shqiptare-dalmate. Është e qartë se gjetja e tyre në këto dy qendra lidhet më shumë me lëvizjet tregtare që bëheshin në këtë krah nga pellgu i Shkodrës, përmes Kukësit, me Maqedoninë. Kuksjanët mbajnë mend edhe sot se para shumë vjetësh, vinin shqiptarë nga Maqedonia për në Kukës «me kerre e kual» duke kaluar bjeshkën e Shishtavecit, në Krue të Bardhë, Krue të Kuq për të dalë në rrafshën e Lumës. Pra, vetë këto sëpata, duke qenë objekte këmbimi, dëshmojnë se në krahun Borje-Shishtavec ka qenë një degë rruge tregëtare ilire që rrihej në kohët e lashta.

Prandaj na duket me vend që përmes zbulimit të tyre në këto pika Borje-Shishtavec të shikojmë tregtinë që bënte Shqipëria e Veriut me Maqedoninë. Ky rast lë të nënkuptojmë se sopata të këtilla duhet të presim të zbulohen edhe në Maqedoni ose metalin e këtyre sëpatave duhet ta kërkojmë në objektet prej bronzi që ka pellgu i Maqedonisë.

26) **Vilë** Simbas tradicionit popullor, emri Vilë i ka mbetur fshatit, sepse një grua ndërtoi një pallat, një vilë, dhe nga kjo fshati, që dikur mbante emrin Mlikë, filloi të quhet Vilë. Vendi i kësaj ndërtese sot nga fshatarët quhet «gjytet». Me këtë toponim, fshatarët emërtojnë disa toka në juglindje të fshatit të sotëm Vilë. Thuhet se banorët e këtij vendbanimi kanë qenë të lidhur me Kalanë e Mlikës, të njohur në shtyp edhe me toponimin Kalaja e Dodës[15]. Po sipas gojës së popullit, Mlika ka qenë sundimtar, i cili kishte pronat e tij në Lezhë.

Në vendin e quajtur Kishe të fshatit Vilë, ku ruhen edhe trojet e kësaj ndërtese, fshatarët gjatë pu-

15) A. Baçe dhe L. Papajani në punimin e cituar këtu **(Kështjella...)** japin të dhëna edhe për një kala mesjetare që ndodhet në këtë fshat.

16) A. Baçe, L. Papajani, **Kështjella...** f. 136. Shënojmë se toponimi Kalaja e Dodës është i vonë; sipas gojës së popullit Doda ka qenjë një fis që kishte në pronat e veta edhe Kalanë e Mlikës, kështu nga pronësia u krijua edhe emërtimi Kalaja e Dodës.

DO NOT COPY

nimeve bujqësore kanë zbuluar një çezmë, në thellësi 3 m, të punuar me gurë të lidhur me llaç gëlqereje. Thuhet se në gurët e çezmës ka pasur edhe mbishkrime. Në këtë vend nga fshatarët kanë qenë zbuluar edhe gurë moknasn të rrumbullakëta.

Rrëzë vendit të quajtur Kodra e Shën Mliajt ndodhet varreza e këtij fshati mesjetar. Varret ndodhen te vendi i quajtur Sheshi i Kishë. Në sipërfaqe nuk duket asnjë gjurmë varreze, është tokë e punuar. Gjatë një gërmim kontrolli që u bë këtu u zbuluan 5 varre. Buzë përroit që rrjedh përbri vendit, u fiksuan edhe 3 varre të tjera që kishte zbuluar uji. Nga të 8 varret, 5 ishin me drejtim Verilindje-Jugëperëndim, ndërsa 3 varret e tjera kishin drejtim pothuajse veri-jug. Varret kanë qenë të punuara me ana të rregullta pllaka guri dhe mbulesë prej rrasash të këtilla (fig. 23). Brenda varreve u gjetën barqe enësh të pakta dhe copa tullash. Ndërtimi i varreve, inventari i gjetur në to, ashtu si edhe vetë toponimet që ruhen tregojnë se varreza dhe godina e kultit që ndodhet këtu lidhen me periudhën e principatave feudale arbëreshe.

27) **Gështenj kalis** Në 1971 në këtë fshat u zbuluan rreth 150 copë monedha argjendi veneciane dhe të Stefan Uroshit. Afër vendit ku janë zbuluar ato, fshatarët gjatë punimeve bujqësore kanë zbuluar varre; afër tyre ruhet vendi me toponimin Kishë.

RRETHI I PESHKOPISË

28) **Suhadoll.** Në këtë fshat ruhen mbeturinat e një vendbanimi të vogël, të fortifikuar, të shekujve të parë të e. sonë, i quajtur Kalaja e Voles. E veçanta në këtë vendbanim është se këtu duken rrënojat e një ndërtese me vlera arkitekturale të larta, po të gjykojmë nga copat e pllakave të mermerit mjaft të mirë që gjenden në rrënojat e saja, kornizat prej guri, kapitele e bazamente prej guri (Tab. V, fig. 3) etj. Brenda këtij vendbanimi duken aty-këtu gjurmë muresh të lidhura me llaç gëlqereje, me përzierje tullash të thërrmuara, mbeturina banesash.

Në afërsi të këtij vendbanimi ruhet toponimi Banja në rrugën që shkon nga Suhadolli për në Borovjan, rreth 30 m larg Përroit të Kaut.

29) **Hotesh** Buzë rrugës që shkon nga Qidhna për në Shupenzë ndodhet një kodër e quajtur Maja e Xhytetzës. Është një vendbanim i vogël i fortifikuar me mure guri, me lidhje llaçi, i tipit të qytezës së Bujanit.

Brenda vendbanimit duken gjurmë banesash me mure guri, të lidhura me llaç gëlqereje. Në sipërfaqe



Fig. 23

të vendbanimit ndeshen fragmente enësh, ndër to ka edhe copa të zbukuruara me motivin e fshesës, që tregon se vendbanimi i takon shek. III-IV të e. sonë.

Fshatarët kanë vënë re se që prej kësaj qyteze e deri në Kala të Videnit, duken gjurmë rrugësh të shtruara me kalldrëm.

Po në këtë fshat, në grykë të Drinit, përtej urës së Katundit të Ri, në Kepin e Çelës, ndodhet një shpellë e banuar në mesjetë, e quajtur Shpella e Këllogjenve, e cila në pjesën e hyrjes ka gjurmë të qarta punimi.

30) **Zdojan** Në këtë fshat ndodhet një vendbanim neolitik i mesëm, i vendosur në një kodër paksa të veçuar (Tab. V, fig. 2). I parë nga sipër, vendbanimi ka formë trapezoidale.

DO NOT COPY

Kjo qendër të cilën vendasit e quajnë Gradec është me interes jo vetëm për lëndën arkeologjike që përmban, por edhe nga ana e konfiguracionit të vet. Siç shihet tërë shpatet e vendbanimit kanë qenë të rrafshuara mirë, me një pjerrësi mjaft të rregullt. Si vendbanim i këtij tipi është edhe vendbanimi i Cetushit (Tab. V, fig. 1), në të cilin sheshimi i anave të pjerrëta të kodrës është bërë më i plotë.

Vendbanime me një konfiguracion të këtillë të karakterit fortifikues njeh edhe Kukësi (Kolshi), kurse për krahinat e tjera të Shqipërisë ky tip vendbanimi nuk njihet, në një kohë që ata janë shumë të ngjashme me vendbanime prehistorike që ruan trualli i Kosovës.

31) **Ushtelencë.** Në tokat e quajtura Vakufe ka qenë një vendbanim i hapët i shekujve të parë të erës sonë. Gjatë punimeve bujqësore janë zbuluar mure banesash që kanë planimetri në formën e gërmës L, qeramikë e vogël (Tab. VII, fig. 28-31), si edhe një fibul bronzi (Tab. VII, fig. 20). Copat e enëve të gjetura, këtu janë të punuara me çark këmbe; kanë përmbajtje kuarci; ngjyrën e kanë okër, gri në të zezë dhe më pak në ngjyrë të kuqe. Si forma ndeshen tasa me buzë të drejta, tenxhere me buzë të shpërvjela nga jashtë, vorba dhe pitosa. Ndeshet edhe qeramikë e zbukuruar me motivin e fshesës. Në materialin ndërtimor që ka dalë nga këto troje vlejnë të përmenden disa tulla të rrumbullakëta hipokausti.

Në Vakufet fshatarët mbajnë mend se janë zbuluar edhe varre me mure gurësh të lidhur me llaç gëlqereje.

Në juglindje të fshatit Ushtelencë (në vendin e quajtur Çuka e Shaban Hisenit), në afërsi të stallave të kooperativës në një kodër paksa të ngritur (Tab. V, fig. 4) ka qenë një vendbanim i shek. IV-III p.e.sonë. Këtu u gjet një fund skifosi dhe një fund pjate, lyer me vernik të zi, në brendësi me brumë të kuqërremtë, të pastruar krejtësisht.

Kjo qendër është me vlerë, sepse përbën një nga vendbanimet e pakta të periudhës qytetare ilire që ka rrethi i Dibrës. Materiale të kësaj kohe kemi gjetur edhe në vendin e quajtur Kalaja e Gjonit, në fshatin Kastriot të po këtij rrethi.

RRETHI I KRUJËS

32) **Laç** Nga rrethinat e qytetit të Laçit njihet në literaturë kalaja mesjetare, e cila ndodhet thellë në gjiun e maleve në lindje të qytetit. Gjatë një udhëtimi për të vizituar këtë kështjellë, së bashku me arkeologun Apolon Baçe, ramë në gjurmët e një vendbanimi të fortifikuar qytetar ilir.

Vendbanimi ndodhet mbi rezervuarin e ujësjellësit të qytetit, në krah të majtë të tij, në një kodër që ngrihet buzë rrugës tradicionale që të çon në kështjellën mesjetare të Daules, në Laç.

Kjo qytezë ilire është një vendbanim i vogël, i fortifikuar me mure gurësh të latuar, katërkëndëshe. si ato të Zgërdheshit. Në dallim nga ky i fundit, mbeturinat e ruajtura në muret e kësaj qyteze, lënë të kuptohet se në muraturën fortifikuese është përdoru edhe stili poligonal (fig. 24, 25) i punimit të gurëve.

Shtresa kulturore nuk është shumë e trashë dhe e pasur. Në vendet e gërryera nga përrenjtë e kodrës, u zbuluan pjesë enësh të vogla, të lyera me vernik të zi të shek. III-II p.e.sonë. Materialet ngjasojnë krejtësisht, për nga brumi, me ato të zbuluara në gërmimet arkeologjike të Zgërdheshit, me të cilin është e lidhur, me sa duket, edhe vetë themelimi i kësaj pike ndërlidhjeje të malësive të kësaj ane, ashtu si edhe me rrugën për në Dyrrah.

* * *

Njoftimet për qendra dhe gjetje arkeologjike të veçanta, ashtu si edhe monumente të tjera historike që përmban ky shkrim, plotësojnë të dhënat e deritanishme për trashëgiminë arkeologjike të rretheve Shkodër, Kukës, Tropojë, Peshkopi e Krujë. Është mbledhur tashmë, së bashku edhe me botimet e mëparshme, një informacion i gjerë për trashëgiminë arkeologjike që kemi në këto treva, ashtu si edhe një material arkeologjik sipërfaqësor i mjaftë sa për të përcaktuar kohën e themelimit e të vazhdimit të jetës në vendbanimet e hershme e mesjetare të Shqipërisë së Veriut.

Edhe në gjendjen e deritanishme të të dhënave arkeologjike të botuara, këto njoftime shërbejnë jo vetëm për të njohur fizikisht monumentet arkeologjike, por edhe për të kuptuar më mirë ecurinë e zhvillimit ekonomiko shoqëror të këtyre krahinave, ndryshimet demografike në to, ashtu si edhe rolin politik të ndryshëm që kishin krahinat në etapa të veçanta të historisë së lashtë të vendit tonë.

Duke u kufizuar me të dhënat që përmban shkrimi që po botojmë, vërejmë se, në qoftë se kërkimet e fundit po tregojnë se në bronzin e hershëm në pellgun e Shkodrës ka një zhvillim shumë të hovshëm ekonomik e kulturor, me një popullim të dendur të kodrave karstike të kësaj krahine, bronzi i vonë e fillimi i hekurit përbëjnë një etapë të dytë të një zhvillimi të lartë kulturor të Shkodrës. Gjetjet në qytezën ilire të Beltojës shoqërohen në këtë krahinë me një

DO NOT COPY



Fig. 24



Fig. 25

sërë shfaqjesh të njëjta në vendbanime të tjera të këtij rrethi.

Të dhënat që jepen këtu, ashtu si edhe ato që janë tashmë të njohura, dëshmojnë se zhvillimi ekonomiko shoqëror i rrethit të Shkodrës ka gjetur jehonën e vet të vazhdueshme gjithnjë në krahinën e Kukësit, në dallim nga krahinat e tjera në veri të saj. Shkodra dhe Kukësi janë dy krahina që ndodhen larg njëra tjetrës, por që i ka lidhur gjithënjë roli i njëjtë apo i përafërt ekonomiko shoqëror e politik.

Kukësi, si portë verilindore e Ultësirës së Adriatikut Jugor, është e natyrshme që duhet të kishte këtë drejtim zhvillimi; rruga Labiane e Drinit mbeti gjithnjë damari kryesor i lidhjes së Ultësirës bregdetare jugore me Ballkanin Qendror e atë të Veriut.

Kështu edhe sëpatat shqiptare-dalmate të zbuluara në Borje e Shishtavec, kultura tumulare dhe ajo qytetare që zbulohet në Kukës janë dëshmi të qarta të jehonës së këtij zhvillimi.

Edhe vendbanimet e fortifikuara, të shekujve të parë të erës sonë, që janë të shumta në krahinat Kukës, Tropojë e Peshkopi, shprehin vlerën e tyre të madhe historike, sidomos kur i shikojmë në rolin ushtarak që luanin ato në lashtësi. Duke qenë mbrojtëse të pellgjeve të rëndësishme në verilindje të Shkodrës, buzë rrugëve të mëdha të kalimit, fortifikimet e këtyre krahinave kanë qenë njëkohësisht mbrojtëse të ultësirës bregdetare të Adriatikut, bile, me sa duket, ky ishte edhe pikësynimi kryesor i ngritjes së tyre.

Këto vendbanime, siç shihet edhe nga botimet, janë vendbanime të vogla, kështjella, kulla, që në përgjithësi nuk shquhen për nivel arkitekturor të veçantë, ndonëse edhe kështu, për vetë pozicionin e tyre, ato e kanë kryer më së miri detyrën e tyre. Fortifikimet e Vigut (Shkodër), të Bushatit (Kukës), e Ad Picarias dhe e Iballës (Pukë) janë ndërtime të tjera, me vlera arkitekturale e ushtarake të rëndësishme.

Duke i krahasuar këto qendra të fortifikuara të shekujve të parë të erës sonë me krahinat fqinje, sidomos me Kosovën, vërejmë se edhe atje mbizotërojnë fortifikimet e tipit Bujan, Perbreg, Bardhoc, Kala Çepës etj, të kryera, siç shihet nga teknika e punimit, kryesisht me forcat vendase, mbi një traditë të hersmhe ilire, që qarkon me mure pjesën e lartë të izoipsit të kodrave.

Në dallim nga castellum-et që gjejmë në Shkodër, Pukë e Kukës, në trevën e Kosovës nuk ndeshen akoma fortifikime të ngritura me një planimetri komplekse, siç janë p.sh. ato të Vigut apo të Bushatit. Ky fakt, i analizuar, qoftë edhe veçmas, dëshmon për rëndësinë dhe rolin e madh ekonomik e ushtarak që kryenin krahinat tona verilindore për ultësirën bregdetare jugore shqiptare.

DO NOT COPY

Duke u ndalur në këto vendbanime, mendojmë të shtrojmë si problem çështjen e datimit të tyre. Deri tani në literaturën tonë përdoren dy datime për qendra të këtilla arkeologjike: shek. III-IV të e. sonë dhe III-VI të e. sonë. Duke njohur gjithnjë vështirësitë e zgjidhjes së problemit, do të qe e udhës që nga gjurmuesit e ardhshëm të punohet në këto fortifikime edhe me pikësynim të veçantë për të arritur një datim më të ngushtë të tyre, duke shkuar, analizuar më me hollësi kulturën materiale që zbulohet në to, ashtu si edhe veçoritë arkitekturore të tyre. Një kërkesë e tillë ndihet më shumë kur merret në analizë monumenti për t'u shfrytëzuar nga ana e vlerave historike të tij.

Prokopi i Çezaresë (i shek. V-VI të e. sonë), në veprën e tij «De Aedificis», jep një listë të gjatë rindërtimesh dhe ndërtimesh të reja të kryera nga perandori Justinian në Epirin e Ri, Dardani etj. Kjo listë shpeshherë shfrytëzohet nga arkeologët si pikëmbështetje datuese për një sërë fortifikimesh antike të vona të vendit tonë. Megjithatë tërheqim vëmendjen se Prokopi i Çezaresë edhe pse përcaktohet gjithnjë si «historian i madh» nuk duhet harruar se traktati i tij «Mbi ndërtimet» është shkruar me një shpirt të theksuar servili, me një frymë bizantine të tepruar, dhe kjo, së bashku me «Historia arcana» të tij, zbërthejnë shumë qartë formimin e tij. Prandaj edhe kjo listë ndërtimesh e rindërtimesh, për ne, duhet shikuar me shumë rezervë.

Kështu, një analizë më e imët e kulturës së vogël materiale dhe e vetë fortifikimeve do të ishte më e dobishme për vënien në një kuadër historik më të saktë të këtyre qendrave arkeologjike.

